

FONDACIONI SHKENCOR DARDANIA SACRA

DR. NUHI VESELAJ

**FOLJET MË -O-
NË GJUHËN SHQIPE**

Botime të veçanta DARDANIA SACRA: nr. 3 2002

Redaktor

Prof. dr. Engjëll Sedaj

Recensues

Prof. dr. Enver Hysa

Prof. Isa Bajçinca

Dr. Mehmet Halimi

FONDACIONI SHKENCOR DARDANIA SACRA

DR. NUHI VESELAJ

**FOLJET MË -O-
NË GJUHËN SHQIPE**

**Prishtinë
2002**

SCIENTIFIC FOUNDATION DARDANIA SACRA

DR. NUHI VESELAJ

VERBS WITH -O- IN ALBANIAN

Prishtina
2002

PËRMBAJTJA

Në vend të parathënies	9
Hyrje	13
Kreu I. ÇËSHTJE RRETH EMËRTIMIT TË PROCESEVE TEKNIKO- TEKNOLOGJIKE ME FOLJET MË -O- (-ZO-).....	23
Përfundim	37
Kreu II. FOLJE TË PREJARDHURA FORMUAR ME PRAPASHTESËN -O- ME ZGJERIM.....	39
Pasqyra e numrit të foljeve të konsultuara sipas prapashtesave sinonimike -O- me zgjerim	41
1. Prapashtesa të mirëfillta me zgjerim të prapashtesës -O-.....	42
2. Variante të prapashtesave të mirëfillta	43
3. Formante të tjera të diskutueshme.....	45
Përfundim	47
Kreu III. PËRIMTIM RRETH NDËRTIMIT DHE FORMËZIMIT TË FOLJEVE MË -O- (PA E ME ZGJERIM).....	49
(1) FOLJET E PREJARDHURA ME PRAPASHTESËN -O- PA ZGJERIM	52
1) Foljet më -O- me temë jo të qartë fjalëformuese	52
2) Foljet më -O- me temë të qartë motivuese fjalëformuese	55
Përmbyllje	70

(2) FOLJET E PREJARDHURA ME PRAPASHTESËN -O- ME ZGJERIM	72
A. FOLJET MË -O- ME ZGJERIM ME PRAPASHTESAT E MIRËFILLTA SINONIMIKE	
1. Foljet më -RO-	76
2. Foljet më -LLO-	88
3. Foljet më -TO-	93
4. Foljet më -SO-	99
5. Foljet më -ZO-	104
Përmbyllje	109
B. FOLJET E PREJARDHURA ME FORMANTET (SI)VARIANTE TË PRAPASHTESAVE TË MIRËFILLTA "-O- me zgjerim"	
1. Foljet më -NO-	112
2. Foljet më -MO-	115
3. Foljet më -RRO-	126
4. Foljet më -LO-	131
5. Foljet më -ZO-	134
6. Foljet më -IZO-	136
7. Foljet më -CO-	140
Përmbyllje	143
C. FOLJE TË PREJARDHURA ME FORMANTE TË TJERA TË DISKUTUESHME SI ZGJERIM I PRAPASHTESËS -O-	
1. Foljet më -KO-	146
2. Foljet më -SHO-	146
3. Foljet më -SHTO-	150
4. Foljet më -ÇO-	153
5. Foljet më -ZHO-	157
6. Foljet më -HO-	159
7. Foljet më -JO-	162
Përmbyllje	165
(3) GRUPE KONSONANTESH SI REFLEKSE TË DISKUTUESHME TË PRAPASHTESËS -O- ME ZGJERIM	168
KONSTATIME PËRMBYLLËSE RRETH RAPORTIT NDËRSINONIMIK TË FOLJEVE MË -O- (pa - e me zgjerim)	
	173

Kreu IV. PËRTHELLIM RRETH RAPORTIT NDËRSINONIMIK TË FORMANTEVE TË FOLJEVE MË -O-, NË PËRQASJE ME FORMANTE TË TJERA BRENDË STRUKTURËS FOLJEFORMUESE NË KUADËR TË SISTEMIT FOLJOR TË SHQIPES	181
(I). RAPORTI NDËRSINONIMIK BRENDAPËRBRENDË NËNSTRUKTURËS SË FOLJEVE MË -O- DHE NË PËRQASJE ME PRAPASHTESA TË TJERA TEMËFORMUESE E FJALËFORMUESE	182
A) 1. Foljet më -O- temëformuese në përqasje me prapashtesa të tjera temëformuese	182
2. Foljet më -O- pa zgjerim me temë të qartë prodhuese në përqasje me folje me formante të tjera prapashtesore	183
a. Foljet me prapashtesat e mirëfillta mbi temë në bashkëtingëllore	184
a) Foljet me prapashtesën -S	184
b) Foljet me prapashtesën -IS	185
c) Foljet me prapashtesën -IT	186
ç) Foljet me prapashtesën -OS	187
b. Ndërfërkime me prapashtesa të tjera të identifikua	190
a) Foljet me prapashtesën -IJ	191
b) Foljet me prapashtesën -EJ	193
c) Foljet me prapashtesën -AS	194
ç) Foljet me prapashtesën -AT	194
B) Rreth disa veçorive karakteristike të foljeve me formantim -O- në përqasje me formante të tjera foljeformuese	196
Përmbyllje	197
(II). RAPORTI NDËRSINONIMIK I FOLJEVE MË -O- PA - E ME ZGJERIM NË PËRQASJE ME FORMANTET PARASHTESORE E MËNYRA TË TJERA TË FOLJEFORMIMIT NË SHQIPE	199
1. Ndërlidhja semantike e foljeve me prapashtesim me foljet me prapashtesim në shqipe	199

Tabela e numrit të foljeve me parashtesat përkatëse aktive	199
2. Parashtesat më aktive e prodhimtare foljeformuese në shqipe.....	201
3. Paralelizmat e mundshme në raportin parashtesë / prapashtesë foljeformuese.....	208
4. Foljet e prejardhura më -O- me para-prapashtesim të dyanshëm në përqsasje me tipa të tjerë	211
5. Njëfjalëzimi i togfjalëshave foljorë lokucionorë dhe foljet më -O-.....	212
6. Foljet me siparshatesa dhe kompozita në përqsasje semantike me foljet më -O-.....	213
a) Foljet me (si)parashtesat më aktive e produktive.....	214
Tabela e numrit të foljeve me siparshatesat përkatëse.....	214
b) Mundësi paralelizmi të foljeve me (si)parashtesim me disa folje me prapashtesat -O- me zgjerim.....	215
c) Foljet me kompozim në përqsasje me disa folje më -O- me zgjerim	216
Përmbyllje	217
(III). DISA SHEMBUJ PËRFTIM FOLJESH ME FORMANTET -O- PA - E ME ZGJERIM MBI FJALË-TEMA TË NJËJTA	221
Tabela e numrit të rasteve sipas shembujve të mësipërm	222
(IV). REZULTATET NGA TRAJTIMI I KËSAJ TEME NXITJE DHE SFIDË	225
Përfundim	232
Summary.....	237
Literatura	242

NË VEND TË PARATHËNIES

(pjesë nga vlerësimet e recensuesve)

Prof. dr. Enver Hysa, punonjës shkencor i Institutit të Letërsisë dhe Gjuhësisë - Tiranë.

Deri më tani ka munguar një punim përmbledhës për formimin e foljeve në gjuhën shqipe, vështrimi i dr. Nuhi Veselajt "**Foljet më -O- në gjuhën shqipe**" synon të bëjë një sintezë të tillë...

Siç del nga studimi i pranishëm, thelbin e përbën analiza e formimeve të foljeve, ku janë analizuar, jo vetëm formimet më -O-, por edhe ato me prapashtesat -ro-, -llo-, -to-, -so-, -zo-, por nuk kanë mbetur jashtë vëmendjes së autorit edhe foljet me prapashtesa të tjera..., duke vështruar mjaft herë dhe raportet ndërsinonimike brendapërbrenda formanteve të ndryshme që veprojnë në sistemin e foljeformimit të shqipes... Ky material i gjerë, për të cilin autori ka harxhuar shumë mund e kohë, në vija të përgjithshme është analizuar drejt, por do të ishte e dëshirueshme që materiali i marrë në shqyrtim të ishte shoshitur më mire, duke rishikuar ndonjë interpretim a formulim, madje edhe duke mënjeluar në disa raste edhe ndonjë fjalë të huaj. Megjithatë do të thosha se ndërmarrja e një studimi të tillë për formimin e foljeve është plotësisht e përligjur... Autori ka hyrë në disa raste dhe në analiza semantike, pa lënë mënjane edhe prapashtesat e tjera, siç u tha, që veprojnë në sistemin foljor të shqipes, por që zënë një vend më të vogël, si dhe parashtesat, të cilat, edhe pse, disa prej tyre, me prodhimtari jo të madhe, luajnë një rol në formimin e foljeve.

Në fund, mendoj se botimi i këtij punimi, të cilin vetë autori e ka cilësuar *punim-sprovë*, është një përpjekje e mirë që do të shënojë një hap përpara në studimet për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, e rëndësi-

shme kjo si për materialet e analizuara, ashtu edhe për vëmendjen që dr. N. Veselaj i ka kushtuar formimit të foljeve, e cila ka qenë deri vonë një fushë pak e studiuar.

Prof. Isa Bajcinca, mësimdhënës i Fakultetit të Filologjisë - Prishtinë

Ndonëse nga titulli "**Foljet më -O- në gjuhën shqipe**" del sikur autori në këtë punim do të shqyrtonte vetëm foljet e prejardhura e të formuara me prapashtesën -O/j, megjithatë, deshi s' deshi, ndonjëherë qoftë edhe për të dhënë interpretime të tjera nga ato që kanë dhënë studiues të tjerë lidhur me foljet e prejardhura me prapashtesa të ndryshme, interesin e tij ai e ka zgjeruar edhe në çështje të tjera të sistemit foljor të shqipes. Bile jo vetëm që ka rrokur pothuaj tërë gamën e foljeve të prejardhura, formuar nga prapashtesa -O- e pazgjeruar, dhe nga prapashtesa -O/j me zgjerim (fjala e tij), ku përveç: -ro, -llo, -to, -so -zo trajton edhe, siç i quan ai, *varianete të prapashtesave të mirëfillta* si dhe *formante të tjera të diskutueshme*, por trajton edhe foljet me prapashtesat -os, -it -is e të tjera...

Le të shënojmë në këtë vështrim të përgjithshëm edhe faktin se autori ka qëmtuar një literaturë mjaft të gjerë e të pasur, deri edhe lidhur me probleme historike të sistemit foljor të shqipes, dhe tërë kjo i shton vlerën këtij *punimi-sprovë*, siç e quan autori.

Si përfundim të këtij vështrimi po theksoj se punimi i dr. Nuhi Veselaj *Foljet më -O- në gjuhën shqipe* është një punim shumë serioz, me një material të bollshëm e të vjelë me shumë zell, prandaj pavarësisht nga disa vërejtje, ky punim-sprovë paraqet një kontribut të rëndësishëm për studimin e sistemit të foljes në gjuhën shqipe dhe, më duket, jep një material shumë të pasur, i cili nuk mund të mos përfillet nga gjuhësia shqiptare, sidomos nga hartues të gramatikës së gjuhës shqipe dhe nga autorë që merren me çështje të fjalëformimit e të standardizimit të shqipes, e të mos flasim për hauues të fjalorëve të ndryshëm e të fjalorëve dygjuhësh, sidomos të fjalorëve tekniko-shkencorë.

Dr. Mehmet Halimi, bashkëpunëtor i lartë shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Në shkencë nuk ekzistojnë probleme të mbyllura, prandaj dr. Nuhi Veselaj në punimin "**Foljet më -O- në gjuhën shqipe**" duke analizuar në mënyrë të shteruar formimin e foljeve me prapashtesën -O- pa zgjerim e me zgjerim, duke hetuar karakterin autokton të këtij formanti, ka meritën që shtron, por edhe që hap probleme e ngre hipoteza të reja në fushë të shkencës së gjuhësisë sonë, madje merita e tij qëndron edhe në përpjekjen për zgjidhjen e problemeve të shtruar. Me një punë të tillë autori ka trajtuar, pothuajse, të gjitha formatet më aktive e prodhimtare foljeformuese (parashtesat e prapashtesat) të gjuhës shqipe dhe kështu ai pasuron fjalëformimin e gjuhës shqipe përgjithësisht.

Në fund mund të konstatojmë se autori i njez thellësisht problemet që i merr në shqyrtim, madje i përthellon ato, propozon dhe sugjeron mundësi pasurimi të gjuhës sonë me mjete të brumit të saj autokton. Ai, në të vërtetë, ka depërtuar me studimet e veta në thellësi të çështjeve të foljeformimit deri më tani të paprekura në këtë fushë, prandaj botimi i veprës "*Foljet më -O- në gjuhën shqipe*" do të jetë padyshim kontribut për shkencën tonë të gjuhësisë.

HYRJE

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik-shoqëror e gjuhësor në kohën moderne s' mund të mendohet edhe pa zhvillimin e teknologjisë. Themi edhe "*zhvillimi gjuhësor*", ngase krahas me zhvillimin tekniko-teknologjik, dalin edhe koncepte të reja, të cilat gjithsesi i kërkojnë emërtimet përkatëse. Prandaj edhe në shqipen standarde, për t'u bërë ballë sfidave të tilla del e nevojshme të njihen, madje edhe të (ri)studiohen e të ndiqen më me kujdes rregullat e formëzimit dhe të fjalëformimit si të sistemit emëror, ashtu edhe të atij foljor. Dihet se për emërtimin e proceseve të punës, përkatësisht të proceseve tekniko-teknologjike, hyjnë domosdo në përdorim foljet, përkatësisht emrat prejfoljorë. Me një çështje të tillë do të ballafaqohet çdo studiues, që, sadopak, do të jetë i interesuar a i implikuar për zgjidhjen e problemeve të kësaj natyre. Me një problematikë të tillë rreth emërtimeve të proceve të punës e të tjera, isha i ballafaquar edhe vetë ndërsa punoja në Uzinën e Amortizatorëve - Prishtinë, në vitet '70 të shekullit që sapo e lamë pas. Ishte koha kur neve (në Kosovë) paksa na ishte dhënë e drejta legjislative (edhe pse formale) për zbatimin e dygjuhësisë (serbokroatisht-shqip) edhe në dokumentacionin teknik e teknologjik. Dhe vërtet, atëbotë, ne shfrytëzuam rrethanat, dhe bëmë përpjekje me vetëdëshirë që, pos zbatimit të dygjuhësisë në dokumentacion teknik, të hartonim edhe një fjalor tekniko-teknologjik shqip-serbokroatisht për nevojat e asaj uzine e më gjerë. Në këtë kontekst, për t'u kryer puna sa më mirë, u pa e nevojshme që t'i bëhej një qasje më e thelluar edhe sistemit foljor të shqipes. Nga një përpjekje e tillë u bindëm se struktura foljeformuese e gjuhës sonë, duke qartë se fshihte në vetvete, forma e njëherazi edhe mundësi më të mëdha shprehëse nga ato që njiheshin na fuqizoheshin në njëfarë mënyre në burimet tona përkatëse normative të kohës. Në këtë kuadër dilte e nevojshme që hapi i parë nisës të fillonte patjetër në studimin e strukturës foljefor-

muse në përgjithësi, ndërsa ajo me prapashtesim në veçanti, ku prapashtesa -O- patjetër zë vendin kryesor, ngase, siç vërehet lehtë, folja më -O- vërtet paraqitet si njëfarë *boshti kurrizor në kuadër të sistemit verbal të shqipes*. Një konstatim i tillë për vendin e foljeve më -O-, që nga Dozoni e kënde, dilte i theksuar pothuajse nga të gjithë studiuesit e gramatikanët tanë, që kishin qëmtuar, sadopak, në këtë drejtim. Edhe pse ky fakt ishte studiuar më tepër në rrafshin diakronik, nuk mungonin konstatimet me peshë edhe nga pikëpamja e rrafshit sinkronik. Ndër të tjera, janë të rëndësishme këto dy veçori të konstatuara qysh me kohë lidhur me këtë:

së **pari**, është karakteri autokton i prapashtesës -O- dhe

së **dyti**, mundësia e saj të dalë dy trajtash: edhe në trajtën e pazgjeruar edhe në atë të zgjeruar.

Këto dy veçori që në këtë punim-sprovë u quajtën: **folje me prapashtesën -O- pa zgjerim** dhe **folje me prapashtesën -O- me zgjerim**, veç e veç e në ndërlidhje, u trajtuan mjaft gjerësisht. Gjithnjë është fjala për funksionin foljeformues të këtij formanti kompleks.

Ç'është e vërteta, në gramatikën e Akademisë (1976, 1995, 2002), në kuadër të prapashtesave të tjera, në mënyrë mjaft modeste, si prapashtesë e mirëfilltë foljore, ceket edhe prapashtesa: -O- e shoqëruar nga pesë prapashtesa të tjera me -O- të zgjeruar: -LLO-, -RO-, -TO-, -SO- dhe -ZO, ku jepet sqarimi se "*katër prapashtesat e fundit, për nga burimi, janë zgjerime të prapashtesës -O-, por në gjendjen e sotme ato paraqiten si prapashtesa sinonime*". Konstatime e vlerësime me interes (ndonëse jo të plota) janë dhënë edhe në punimet e prof. A. Kostallarit, në burimin normativ "*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*" (1976), në ndonjë punim të prof. Egerem Çabejt, pastaj në veprën "*Historia e gjuhës shqipe*" (*Morfologjia historike*) të prof. Idriz Ajetit, nën titullin: "*Foljet (-verbat)*", Prishtinë 1965, e ribotuar më 1983), në monografinë e prof. Shaban Demirajt "*Sistemi foljor në evolucionin e tij historik*", të botuar në veprën "*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*", Prishtinë 1988, në veprën e F. Sulejmanit me titull "*Praktikumi i gjuhës shqipe*" (Prishtinë, 1981), por fragmentarisht edhe në ndonjë punim të veçantë nga autorë të ndryshëm, që ato si më të rëndësishme që më ranë në dorë, do të ceken në referencat përkatëse në këtë punim-sprovë. Gjithsesi material më të plotë dhe më të sistemuar, por jo shtrues, madje as të mjaftueshëm për temën tonë, ndeshëm në veprën e

prof. Selman Rizës me titull *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, në kapitullin e veçantë **Foljet e pathjeshta** (Shih: Selman Riza Vepra 2, (ASHAK) Prishtinë 1997). Ky punim, i cili, siç e vlerëson prof. Enver Hysa, "për sistemin foljor" të shqipes bashkëkohore përbën pa dyshim veprën më të plotë të hartuar për këtë pjesë të ligjëratës nga një dorë e sigurt dhe një njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe i dialekteve të saj", ngase "për herë të parë në historinë e studimit të kësaj kategorie gjuhësore struktura fjalëformuese e foljes gjen një trajtim e analizë kaq të gjerë e të plotë", vërtet ka merita të pamohueshme, por sa i përket temës që po trajtohet prej nesh nuk është krejtësisht i pa cen. Nuk di sa do ta ketë penguar thellimin e duhur të autorit si dhe të tjerëve në problematikën e formimit të foljeve më -O- dhe përgjithësisht vetë koncepti i formuar rreth kësaj çështjeje, por edhe koncepti lidhur me formën përfaqësuese të foljes. Siç dihet, si është shënuar edhe në gramatikën shkencore të Akademisë, shumica e gjuhëtarëve konsiderojnë se si formë përfaqësuese e foljes duhet të merret njëjësi i kohës së tashme të dëftores veta e parë, ndërsa prof. S. Riza, siç del nga vepra e tij, konsideronte se si formë e tillë përfaqësuese duhet të merret jo e tashmja e vetës së parë njëjës të dëftores, po pikërisht trajta e pjesores, përkatësisht e paskajores reliktoare, siç e quante dhe gjykonte ai, konkretisht me mbarese - prapashtesat -UAR (tipi (me) mend/uar) e -UR (tipi (me) përdor/ur).¹ Kështu prof. S. Riza, siç e thekson edhe Ludmilla Buxheti² në punimin me titull: "*Foljet me prapashtesën -O në gjuhën e sotme letrare shqipe*", ngatërron fjalëformimin me formëformimin, ngase si prapashtesa foljore konsideron vetëm formantet -UAR dhe -UR e jo prapashtesat -O- j si p.sh. *mend/Oj*, përkatësisht prapashtesën zero ose pa ndajshtesë si p.sh. *përdor* si dhe prapashtesat e tjera si p.sh. *-(ë)so-* (kripësoj), *-zo-* (lulëzoj), *-ro-* (flakëroj) etj, madje as me *-is* (pajis), *-it* (rendit), *-os* (vendos) e të tjera, siç trajtohen në burimet e sotme normative. Ndonëse gjatë analizës edhe prof. S. Riza njeh tingujt ndërrhyrës për formimin e foljeve më -O- me zgjerim dhe i trajtom veçanë edhe foljet me -OS, -IT etj., por pa i cilësuar ato prapashtesa si të mirëfillta, d.m.th. pa mbarsat gjegjëse.

¹ Shih: Enver Hysa, *Ndihmesa e prof. Selman Rizës në studimin e sistemit foljor të shqipes*, Gjuha jonë 3-4, Tiranë 1999 f. 21-24.

² Unë e shtova pjesëzën (me) për arsye se sot për sot në asnjë analizë s'mund të nënkuptohet paskajorja e mirëfilltë pa këtë element.

³ Shih: të *Studime filologjike* 1-4, Tiranë, 1994.

Rreth të metave për këtë pikë të trajtimit të prof. S. Rizës pajtohem i studiuesen L. Buxheli të bërë në punimin e saj të cekur me sipër. Në të vërtetë, ndonëse autorja në këtë punim trajton vetëm foljet me prapashtesën -O pa zgjerim kryesisht me temë të qartë fjalëformuese, siç po quhen këtu, duke i lënë jashtë trajtimit të hollësishtëm foljet më -O pa temë të qartë fjalëformuese si dhe foljet më -O me zgjerim, punimi në fjalë i takon një cilësie të lartë, sidomos kur kemi të bëjmë me bazën sintaksore të foljeve përkatëse në raportin e zbërthimit togfjalësh foljor/folje më -O e njëfjalëzuar mbi këtë bazë, por edhe të ky punim mbetet ndonjë gjë për t'u rishikuar a për t'u sqaruar më mirë në harmoni me të arriturat e reja në këtë fushë kërkimore.

Sidoqoftë, në për temën tonë nga konsultimi i veprës së prof. S. Rizës, të Ludmilla Buxhelit dhe të të tjerëve përfituam mjaft dhe nga ato shfrytëzuam disa të dhëna të vlefshme dhe gjithsesi jo me pak interes. Ç'është e vërteta, ne mendojmë se praktikimi i trajtës së njëjësit të dëftores veta e parë (në raste edhe veta e tretë njëjës) si formë përfaqësuese e foljes sipas *analizës morfologjike*, shënimit në fjalor etj., tashmë ka jetëzim dhe është treguar si zgjidhje praktike e përligjur, mirëpo kur është fjala te analiza fjalëformuese, pikërisht tema e pjesores, përkatësisht e paskajores (sipas S. Rizës) është ajo që në shumicën absolute të rasteve, sidomos në të kaluarën, del më e shfrytëzuar si temë prodhuese motivuese në formimin e prejfoljorëve dhe të vetë foljeve paralele. Prandaj që të dyja format e sipërcekura ashtu si dhe trajta e të kryerës së thjeshtë në *analiza morfologjike* dhe ajo e pjesores ose e paskajores me + pjesore në *fjalëformim*, bashkë me trajtën e të kryerës së thjeshtë, me të drejtë shërbejnë si forma kryesore orientuese në trajtimin sintaksor e semantic të temës në shqyrtim.

Pikërisht për temën në fjalë, në analizën tonë ne i marrim në konsideratë të dyja format edhe të tashmën edhe pjesoren (paskajoren), sepse etimologjikisht kemi të bëjmë me të njëjtin formant trajtëformues ose fjalëformues. P.sh. nga togfjalëshi bëj mësim del folja **mësOj** ose (me) **mësUAR** **mësUE**(m), ose nga emri **pun(ë)** del folja **punOj** përkatësisht **punUA/r** **punUE**(/m), ku -O-ja ose -UA- a -UE-ja (*UO) shërbejnë qoftë si formante trajtëformuese të foljes së parme (pa temë të qartë fjalëformuese), qoftë si formante foljeformuese (me temë të qartë fjalëformuese). Siç po shihet, ne, si shumë të tjerë, dallojmë mbaresat -j për formën e parë për-

faqësuese dhe -r(*n)e -m ose zero, për formën e dytë përfaqësuese. Dihet se -UA e -UE (*-UO) janë variante fonetike a zbërthim i -O-së së kryehershme, e cila edhe shfaqet si një dukuri normale gjatë zgjedhimit të foljeve të këtij nëntipi. Krahaso: punoj punova (kam) punuar, punuekam etj. Prandaj ne mendojmë se formanti -O- përkatësisht -UA- a -UE- në analiza fjalëformuese duhen shënuar veçan apo duhen dalluar nga mbaresat përkatëse, por megjithatë, për hir të manipulimit më të lehtë, ne parapëlqyem morfin -O si formë më praktike përfaqësuese të formantit, ashtu siç vepron edhe L. Buxheli.

Vëzhgimet e vërejtjet tona lidhur me temën në shqyrtim, d.m.th. rreth formimit të foljeve më -O-(pa -e me zgjerim), duke e konsideruar si çështje të hapur dhe, sigurisht, jo mjaft të trajtuar më përpara, patëm rast t'i shtronim në dy trajtesa, të cilat i patëm paraqitur si kumtesa në sesionet përkatëse shkencore që organizoheshin në kuadër të "Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", mbajtur në Prishtinë, më 1987 (*Çështje të emërimit të proceseve tekniko-teknologjike me foljet më -O-/-ZO-*) dhe më 1989 (*Folje të prejardhura me prapashtesën -O- me zgjerim*).

Meqenëse problemet e shtruara në këto dy kumtesa, të cilat, në të vërtetë, ishin shkëputur, në njëfarë mënyre, nga lënda e kësaj teme, e cila atëherë ishte në përgatitje e sipër, nuk mund të trajtoheshin me gjerësinë e duhur edhe për hir të përmasave që ka, vetvetiu, një kumtesë, m'u duk e arsyeshme që ato, që të dyja, në këtë punim-sprovë të përfshihen si pjesë përbërëse të këtij punimi, duke zënë kështu dy kreerë të parë dhe për të vazhduar tutje analizën edhe me dy kreerë të tjerë. Në të vërtetë, me inkuadrimin e dy kumtesave në këtë punim kemi për qëllim të tregojmë se lënda e shtruar atëherë nuk e ka humbur as sot aktualitetin. Madje konceptet e shprehura atëherë, të cilat studiuesve besoja se mund t'u shërbenin, si çelës për të hapur dyer të reja për t'u futur më tutje në fusha të reja hapësinore rreth paraqitjes së çështjes në fjalë dhe njëherazi të shërbenin si dritë orientuese për t'i parë e dalluar më mirë thesaret me vlerë që na i ofron dhe na i dhuron gjuha jonë, deri më tani nuk di se do të jenë shfrytëzuar si duhet, prandaj edhe këtu po përfshihen për të njëjtin qëllim.

Në kreun e tretë, "Përimtim rreth ndërtimit dhe formëzimit të foljeve më -O- pa -e me zgjerim", siç e tregon edhe vetë titulli, që është

kreu më i gjerë i këtij punimi, duke shfrytëzuar konstatimet, siç u tha, nga dy krerët e mëparshëm e duke e përpunuar atë material, veç tjerash në mbështetje të analizës së shembujve konkretë, synohet të argumentohet e vërteta, jo vetëm rreth ekzistimit të formanteve të tilla në gjuhën tonë, por edhe rreth domosdoshë së njohjes më të përhulluar të problematikës së tillë. Vend i veçantë më i gjerë iu dha edhe analizës rreth formimeve të foljeve me prapashtesën -O-, qoftë atyre më -O- pa zgjerim (pa temë të qartë prodhuese ose të parme), qoftë atyre të prejardhura (ose me temë të qartë fjalëformuese si dhe atyre nën ndikimin e partisipit të latinishtes). Po ashtu u veprua edhe me foljet me prapashtesat -O- me zgjerim, të quajtura të mirëfillta: -ro-, -to-, -llo-, -so-, -zo-, (si) varianteve të tyre: -no-, -mo-, -rro-, -lo-, -izo-, -co- dhe formanteve të tjera të diskutueshme: -ko-, -sho-, -shto-, -ço-, -zho-, -ho-, -jo-, ku paraqiten argumente mjaft bindëse se ato priren të mbulojnë, secila veç e veç e në ndërkëmbim së bashku, nënfusha të caktuara semantike. Së këtejmi po në bazë të analizës së shembujve të caktuar konkretë mund të bindemi se formantet e caktuara, më shumë ose më pak, japin shenja se mund të cilësohen qartë në një shumicë rastesh edhe si ndajshesa të specifikuara me elemente specializimi, kuptohet për nënfusha të caktuara semantike.

Në kreun e katërt, me titull "Përthellim rreth raportit ndërsinonimik të formanteve të foljeve më -O-, në përfaqje me formante të tjera brenda strukturës foljeformuese të shqipes", bëhet përpjekje, që në bazë të prirjeve që ndjehen dhe vërehen në stile të caktuara të gjuhës sonë, po në vazhde të materialit sipas kapitujve të mëparshëm, të përceptohen dhe të përcaktohen më qartë nënfushat e caktuara semantike, tash jo vetëm brendapërbrenda strukturës së foljes më -O- (pa - e me zgjerim), por edhe në kuadër të sistemit foljor të shqipes përgjithësisht, në përfaqje me nënstrukturat përkatëse foljeformuese, siç është formimi i foljeve me prapashtesa të tjera, pastaj me parashesa, paksa me para-prapashtesa njëherazi, me siparashesa si dhe me njëfjalëzimin e lokucioneve foljore dhe të atyre me kompozim.

Në fund dolën edhe rezultatet që, për mendimin tonë, kanë rëndësi e vlerë jo të vogël për gjuhën dhe gjuhësinë tonë, qoftë në rrafshin praktik, qoftë në atë teorik, ngase, në këtë punim, është prekur, si të themi, në miniaturë tërë sistemi foljeformues aktiv e në perspektivë i gjuhës shqipe.

Edhe pse, e themi qëllimisht, synimi kryesor në këtë punim-sprovë nuk është analiza shteruese e temës, por në radhë të parë të shtruarit dhe të diskutuarit e saj, gjatë analizës bëhet përpjekje të ecet më tej në thellësi, d.m.th. jepen vlerësime dhe konstatime të caktuara, të cilat nuk mund të thuhet se të gjitha kanë dalë si konstatime a gjykime të rastësishme, por ato rezultojnë pas një analizë mjaft të përhulluar, ndonëse mund të jetë e përshkuar nga një guxim dhe nxitim i ligjshëm i një studiuesi jo aq me përvojë në këtë fushë dhe me pa mundësi grumbullimi të materialit të mjaftueshëm shterues.

Jam i vetëdijshëm se edhe ky punim, "Foljet më -O- në gjuhën shqipe", që mund të quhet, jo pa arsye, punim-sprovë, mund të ketë ndonjë dobësi a mangësi të rastit. Në këtë kontekst, po cek se janë tri të meta nga të cilat e di se vuan paksa ky punim dhe që mund të vërehen lehtë:

e para, lidhet me pamundësinë për të konsultuar burime më të shumta e madhore leksikografike, siç janë skedarët e gjeografisë gjuhësore të shqipes etj.;

e dyta, ka të bëjë, gjithashtu, me pamundësinë që të konsultohen të gjitha veprat përkatëse teorike të gjuhëtarëve, jo vetëm në gjuhën tonë, por edhe në gjuhë të huaja, që trajtojnë temë të ngjashme dhe

e treta, pamundësia që të jem në kontakt dhe të konsultohem drejtpërdrejt me kuadrat tanë kompetentë, të cilët jo vetëm e kuptojnë, por edhe kanë dhënë ndihmesë të çmuar në vijëzimin e çështjeve, siç është edhe kjo jona që po trajtohet këtu.

Pa marrë parasysh këto mangësi, të cilat mund të plotësohen ndërkohë, dhe ndonjë tjetër të natyrës subjektive që ka të bëjë edhe me vetë ndërthurjen shprehëse gjuhësore, mendoj se kjo lëndë, aq sa është paraqitur këtu, mund të shërbejë si bazë e mirë prej kah do të ecet më tutje, drejt njohjes, shndërrimit dhe zgjidhjes së çështjeve të shtruara.

Sidoqoftë, me këtë punim-sprovë kemi për qëllim të arrijmë këta tre objektiva:

Së pari, jo vetëm të vëmë në pah thesarin e tillë gjuhësor, ende jo aq të njohur dhe të përpunuar gjithsesi jo sa duhet nga bota jonë shkencore, por edhe ta shtrojmë e ta trajtojmë atë, duke e vënë në pah sidomos fuqinë shprehëse potenciale, si me thënë, "të fshehur", që ka thesari i tillë, ende jo i përfaqësuar si e lyp puna në fushën e fjalëformimit e të formëzimit në gjuhën tonë.

Së dyti, të nxism kuadrot tanë përkatës profesionale që të vazhdojnë më tej në trajtimin e kësaj teme kaq të rëndësishme për bashkësinë tonë folëse nga një spektër më i gjerë vrojtimi. Në këtë drejtim nuk duhet përjashtuar as puna e nevojshme ekipore, veprim ky i cili po të organizohet si duhet, jo vetëm se do të kishte më shumë mundësi grumbullimi e konsultimi të materialit përkatës, por do të mund të jepte edhe gjykime dhe vlerësime më me peshë e kompetencë edhe në raport me gjuhët e huaja.

Së treti, pa marrë parasysh trajtimet a qasjet e ndryshme teorike, që njihen ose që mund të dalin nga analizat që mund të pasojnë, mendoj se nuk është e tepërt kërkesa lidhur me gjykimet dhe konstatimet që tashmë shihen se janë të mbështetura në fakte bindëse, që ato të favorizohen pa ngurrim, d.m.th. të nxiten paksa, në mënyrë që të gjejnë sendërtimin e duhur në jetë praktikisht.

Pikësypnimit e parë e quaj të arritur me botimin e këtij punimi, pikësypnimit i dytë i takon aktualitetit në zhvillim e sipër, varësisht nga interesi që do të shprehin kuadrot përkatës, ndërsa pikësypnimit i tretë do t'i takojë të ardhmes, besoj jo të largët. E them *jo të largët*, ngase tema që është shtruar këtu kemi bindjen se ka rëndësi të madhe, jo vetëm teorike, por edhe praktike, madje ajo kalon edhe në suaza të niveleve më të larta të kulturës së gjuhës dhe të sociolinguistikës shqiptare e më gjerë. Në këtë kompleks ka vend të angazhohen dhe ta thonë fjalën e tyre kuadrot kompetentë e ndër ta do të veçoja krijuesit e të gjitha profileve edhe ata të fjalës së bukur, përveç tyre edhe stilistët, pragmatistët e standardologët, të cilët, si të thuash, edhe gëzojnë më tepër liri inventive e kreative, për të bërë risi në gjuhë a për t'i vlerësuar e interpretuar ato, madje edhe për të dhënë sugjerime edhe për përvetësimin e tyre. Mirëpo, në mënyrë që ato risi të jenë më të shëndetshme dhe jetëgjata, duhen pasur mbështetje në gjedhet ekzistuese fjalëformuese e formëzuese, por edhe në prirjet që dalin nga struktura e sistemit të gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të sistemit të saj foljor ekzistues në veçanti. Prandaj kjo temë duhet vlerësuar në kontekst të të gjitha stileve të ndryshme të ligjërimit, jo vetëm nga pikëpamja fjalëformuese që ka të bëjë me gjedhet formale e funksionale gramatikore (morfologjike e sintaksore), por gjithsesi edhe nga aspekti kuptimor semantik, stilistik e pragmatik.

Në fund të kësaj paraqitjeje, përzierësisht falenderoj dashamirësin e madh të gjuhës shqipe standardologun tonë veteran z. **Mehmet Gjevo-**

rin dhe posaçërisht zotërinjtë prof. dr. **Enver Hysën**, punonjës shkencor i Institutit të Letërsisë dhe të Gjuhësisë - Tiranë, profesor **Isa Bajcincën**, *ligjërues i lartë në Fakultetin e Filologjisë - Prishtinë*, si dhe dr. **Mehmet Halimin**, bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, të cilët patën durim ta lexonin dorëshkrimin e të japin vërejtje konkrete me gojë, por edhe pse, këta tre të fundit, patën mirësinë të japin edhe vlerësimet me shkrim (*recensionet*) për botimin e kësaj vepre, pjesë nga të cilat po jepem në vend të parathënies.

(Prishtinë, maj 2002)

Kreu I

ÇËSHTJE RRETH EMËRTIMIT TË PROCESVE TEKNIKO-TEKNOLOGJIKE ME FOLJET MË -O- (-ZO)*

Si në çdo fushë të caktuar të jetës së njeriut ashtu edhe në fushën e prodhimit, përkatësisht të proceseve të prodhimit, imponohet nevoja e emërtimit të koncepteve, veprimeve a operacioneve të veçanta dhe më të përituara të proceseve të caktuara teknologjike e të tjera. Për emërtimet e tilla, siç dihet, nga aspekti leksiko-gramatikor përdoret zakonisht një folje, përkatësisht një emër prejfoljor i veprimit (nomina actionis). Ndërkaq pikërisht në raportin e emërtimit: **folje/emër prejfoljor i veprimit** dalin mjaft çështje që kërkojnë trajtim më të plotë. Konstatimet e deritashme në burimet tona normative rreth këtij raporti nuk mjaftojnë. Përgjithësisht, jo vetëm në nënfushën e proceseve teknologjike, por edhe në fusha e nënfusha të tjera, për arsye të ndryshme, ndodh që më përpara "të lindë" emri prejfoljor i veprimit sesa vetë folja, si p.sh. pikësim, foljezim, risim, vapullim, triskëtim, homologjim etj. Ndërkaq folja, me të cilën shënohet "një veprim a gjendje", edhe pse nuk është e shënuar në fjalorët përkatës, siç është rasti lidhur me emrat e mësipërm, nënkuptohet dhe gjithsesi ajo mbetet strumbullari kuptimor mbështetës ku gjen sqarim përfundim i vetë formës së emrit të veprimit.

Çështje e vërteta, sipas burimeve përkatëse normative, kjo kategori emrash prejfoljorë përftohet zakonisht dy mënyrash: e para, me prapash-

* Është botuar në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 1987

tesën -IM, e cila "bashkohet me temën e kohës së tashme të foljeve që mbarojnë më -OJ dhe më -E/I"¹ dhe e dyta, me prapashtesën -JE, e cila "bashkohet me të gjitha ato tema foljesh me të cilat nuk bashkohet prapashtesa -IM",² mirëpo në këtë rregullsi ka mjaft përjashtime, madje "përjashtimet" e tilla aktualisht janë gjithnjë e më të ndjeshme si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm që ndikojnë në gjuhën.

Në këtë kompleks po cek vetëm dukurinë e bashkjetesës së treshit sinonimik (emrave prejfoljorë nga tema e njëjtit motivuese),

si p.sh. shkrim/shkruarje/ të shkruarit (shkruaj); çmim/çmuarje/ të çmuarit (çmoj); lëshim/lëshuarje/ të lëshuarit (lëshoj); shpim/shpuarje/ të shpuarit (shpoj); kthim/kthyerje/ të kthyerit (kthej); shtrim/shtruarje/ të shtruarit (shtraj) etj., dukuri kjo që është e pranishme në jetën tonë të përditshme.

Gjithsesi studimi me kompetencë i kësaj dukurie, me mprehtësinë që meriton, mbase do të nxjerrë në pah se treshi sinonimik i sipërcekur në gjuhën tonë, mos vallë, do të konsiderohet si një begati, jo vetëm për të shprehur ngjyrimet stilistike për të njëjtin koncept, por ato do të mund të cilësohen si fjalë të veçanta (terma) për të shprehur koncepte të ndryshme varësisht nga konteksti ose nga vetë diskursi që shprehet. Ç'është e vërteta, nga aspekti që po shrohet këtu ndonjëri nga shembujt që u konsultuan mund të shërbejë si provë për njëfarë kundërvënije kuptimore, ngase me emrat e tipit: shkrim, çmim etj., shprehet rezultati i veprimit, me emrat e tipit: shkruarje, çmuarje etj. shprehet veprimi si proces në vazhdim (kryesisht) dhe së fundi, me emrat asnjans të tipit: të shkruarit, të çmuarit - shprehet koncepti i temës a i procesit të caktuar.

Gjithsesi një kundërvënie e tillë kuptimore e sinonimeve në fjalë del më qartë në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja, jo vetëm në "gjuhën e përkthimit", kur kemi të bëjmë me terminologji tekniko-shkencore e teknologjike, por edhe për koncepte të tjera të fushave të caktuara, ngase jeta shtron nevojën edhe për ato shprehje e nuanca, të cilat deri më tash nuk ishin aq të ndjeshme dhe të domosdoshme.

Duke e lënë të hapur këtë çështje, që gjithsesi meriton dhe imponon studim të veçantë, po e cek edhe një çështje tjetër, gjithashtu, jo pa interes për temën e shtruar. Është fjala se cilat procese është më drejt të shprehën

¹ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë, 1976

² Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë, 1976

më foljet më -o/j, përkatësisht emrat më -im të tipit: vendoj/vendim, burgoj/burgim, ngjyroj/ngjyrim, gëlqeroj/gëlqerim etj. e cilat me tipin tjetër të foljeve më -os, përkatësisht emrat më -je si p.sh. vendos/vendosje, burgos/burgosje, ngjyros/ngjyrosje, gëlqeros/gëlqerosje³ etj. që janë derivate nga tema e njëjtit motivuese si në shembujt e mësipërm: vend, burg, ngjyrrë, gëlqere. Nga analiza e shembujve të caktuar në kontekst del se sipas stilit funksional të caktuar, secila trajtë konkurren për nënfushën e caktuar semantike, duke e arsyetuar kështu ekzistencën e vet. Edhe mbi këtë çështje lypset qasje më e thelluar dhe e gjithanshme.

Për shkak se lyp shumë kohë dhe vend analizimi në hollësi i varianteve prapashtrësore të zgjerimit të foljeve më -o- si më -to-, -so-, -ro-, -llo- etj., prapashtesa këto me të cilat është emërtuar sigurisht edhe ndonjë proces teknologjik krahas proceseve të tjera, nuk do të bëhet këtu, por do të zihen në gojë patjetër foljet më -o-, përkatësisht më -zo-, sepse pikërisht te foljet më -o- (pa zgjerim) bie pesha kryesore e emërtimeve të proceseve teknologjike, por edhe te foljet më -zo- (-z+o), ngase kjo prapashtesë "është shumë produktive e aktive në gjuhën e sotme letrare, sidomos në publicistikë e në terminologjinë teknike - shkencore"⁴, siç thuhet me të drejtë te "Gjuha letrare për të gjithë", natyrisht e imponuar pjesërisht si formë në raste të caktuara edhe nga gjuhët e huaja, siç do të shohim më poshtë.

Për të pasur më të qartë kundërvënien kuptimore të foljeve më -o-, në krahasim me ato më -zo-, është e domosdoshme të rikujtohet kuptimi leksikor i togfjalëshit "proces teknologjik" në kuadër të teknologjisë së prodhimit. Me togfjalëshin "proces tekniko-teknologjik", përkatësisht "proces teknologjik" kuptohen procese të ndërlikuara a "një varg veprimesh të veçanta të lidhura njëri me tjetrin në mënyrë të vetëdijshme për të arritur një përfundim të caktuar", veprime këto që kanë të bëjnë me kryerjen e ndonjë "shërbimi" ose të ndonjë veprimtarie të fushës tekniko-teknologjike, siç është p.sh. "përpunimi fizik, kimik etj" i diçkajes në një "proces prodhimi" që për kryerjen e veprimeve të tilla gjithsesi përdoren edhe mjetet e caktuara "të mjeshtrisë e të teknikës".⁵

³ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.

⁴ Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë, 1976, f. 229.

⁵ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1080, f. 1554, 1976, 1977.

Në literaturën profesionale, teknologjia e prodhimit, zakonisht, ndahet në **teknologji mekanike** dhe në **teknologji kimike**⁶. Në **proceset teknologjike mekanike** zakonisht kryhet punimi a përpunimi (fizik) i materialit pa i ndryshuar substancën, proces ky që në gjuhën tonë rëndom shprehet me foljet më -O- e me ndonjë tjetër tip foljesh, kurse për **proceset teknologjike kimike**, ku zakonisht gjatë procesit të punës bëhet shndërrimi i substancës ose kryhen punë e veprime më të specializuara, në gjuhën tonë përdoren zakonisht foljet me formantin prapashtesor **-ZO-**. Sigurisht edhe nga kjo rregullsi ka përjashtime, por një ndarje të tillë, së paku si koncept metodologjik, na mundëson vetë lënda e vjelë nga burimet përkatëse të gjuhës sonë letrare, siç do të shohim më poshtë, përkatësisht këtë e arsyetoon, në të vërtetë, tani edhe vetë praktika jonë gjuhësore.

Pasi është fjala për procese tekniko-teknologjike patjetër në këtë tekst, del çështja e shqyrtimit të importimit të ndërkombëtarizimave ose të emërtimeve speciale të proceseve të caktuara nga gjuhët e huaja përkatëse, prej nga janë importuar edhe vetë veglat, veglëritë, pajisjet, të cilat hyjnë në punë për kryerjen e proceseve a të operacioneve të caktuara teknologjike. Meqenëse terminologjia përkatëse tekniko-teknologjike është pronë gjithnjëzore, prandaj, nga një fakt i tillë, më pak ose më shumë, secila gjuhë ka pësuar ndikim nga ndonjë gjuhë më e zhvilluar, përkatësisht ka pasur dhe ka ndërlikime të ndërsjella. Por në këtë kuadër, krahas pranimit të "gjuhës së përbashkët teknike", secila gjuhë, megjithatë, ruan edhe veçoritë e veta drejtshkrimore, drejt-trajtëformuese dhe drejt-fjalëformuese, që e bëjnë të dallohet nga gjuhët e tjera. Kështu ndodh edhe me gjuhën tonë. Natyrisht lidhur me temën në shqyrtim lypset dalluar elementi ndikues (huazues) nga elementi vetjak si rezultat i strukturës së mëvetësishme fjalëformuese të gjuhës sonë. Lypset konstatuar, njëkohësisht, edhe risitë që dalin nga pasqyrimi i këtij realiteti të ri që lind në saje të zhvillimit të pandërprerë të shoqërisë dhe të të menduarit ndaj këtij realiteti, përkatësisht ndaj zhvillimit të koncepteve të reja mendore-gjuhësore në ndërlidhje dialektike me ecuritë të tekniko-teknologjike, pra, krahas ngritjes së vetëdijes shoqërore e teknologjike.

⁶ *Knjigovodstveni leksikon*, Beograd 1964, f. 744 dhe *Mala enciklopedija Prosveta 3*, Beograd 1978, f. 384.

Pikërisht lidhur me pasqyrimin e trajtave shkrimore të emërtimeve të gjuhëve të huaja del e nevojshme të jepen sqarime. Është e nevojshme të konstatohet tema fjalëformuese e termit të caktuar se mos kemi të bëjmë me *përthimin (konvertimin)* e prapashtesë-mbaresës nga temë-folja e gjuhës së huaj apo kemi të bëjmë me temën motivuese prodhuese të cilës i shtojmë prapashtesën e mirëfilltë foljore të gjuhës sonë.

Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se kur fjala e huaj, qoftë emër ose mbiemër zakonisht është e pranuar si fjalë e fondit aktiv të gjuhës sonë, atëherë është tejet e pranueshme mënyra e përfutimit të foljes së caktuar nga temat e mirëfillta, kështu që normalisht sikurse tek emrat autoktonë si *punë, sharrë* etj. në mbështetje të të cilave (kur shërbejnë si tema prodhuese motivuese) që dalin foljet me -OJ, si punoj/punim, sharroj/sharrim etj., ashtu dalin edhe emërtimet e proceseve të punës nga ndërkombëtarizmat e fjalët e huaja si p.sh. *frezë: frezoi/frezim, tomoj/tornim, nikel: nikeloi/nikelim, nivel: niveloi/nivelim, beton: betonoi/betonim, zink: zinkoi/zinkim, aktiv: aktivoj/aktivim, sistem: sistemoj/sistemim* etj.

Mirëpo kemi raste, jo të pakta, kur në shqipe, për procesin e caktuar huazohet trajta foljore nga gjuha e huaj dhe me këtë rast "përkthehet" vetëm prapashtesë-mbaresa e gjuhës së caktuar dhënëse p.sh. *montoj* (krahaso fr. monter, gjerm. montieren, rus. montirovatj, serbokr. montirati etj.); *instaloj* (lat. anstallare, angl. install, fr. installer etj.); *aspiroj* (lat. aspirare, serbokr. aspirirati etj.); *abonaj* (gjerm. abonieren, fr. abonner, serb. abonirati etj.); *ofroj* (lat. offerere, it. offrire, serbokr. oferirati etj.).⁷

Në shumicën e rasteve të lartpërmendura, trajtat në gjuhën tonë nuk paraqesin ndonjë problem drejtshkrimor, pasi ashtu e kanë fituar "qytetarinë" në fondin aktiv të fjalësit të gjuhës sonë. Bëjnë përjashtim disa folje që paraqitin problem drejtshkrimor dhe fjalëformues ndër ne, siç është trajta *abstraktoj* (abstrakoj, abstragoj dhe abstrahoj), pastaj *konceptoj* (koncipoj) e ndonjë tjetër. Në raste të tilla, mendoj unë, zakonisht si kriter më i fortë dhe më i pranueshëm del tema e qartë motivuese si emër a mbiemër e jo trajta foljore nga gjuha e huaj.⁸

⁷ Shembujt janë vjelë nga burimet përkatëse leksikografike. Të vihen re mbarsës-prapashtesat gjeqjese në gjuhë të ndryshme në krahasim me atë të shqipes.

⁸ Për dukurinë e tillë dhe zgjidhjen më hollësisht shih në kreun III (1) të këtij punimi.

Përveç çështjeve që u shtruan më sipër rreth daljes së trajtave foljore më -O-, që meritojnë qasje më të përimtuara, po cekim edhe çështjen e daljes së prapashtesës -ZO- si prapashtesë të mëvetëshme, qoftë në raport me prapashtesën -O-, zgjerim i së cilës është edhe ky tingull-formant, qoftë edhe në raport me trajtat prapashtesore-mbaresore të gjuhëve të tjera.

Për të zbërthyer më mirë çështjen e sapocekur rreth përfutimit të prapashtesës -ZO-, e shohim të udhës që së pari, të konstatojmë reflektimin e këtij formanti nga trajtat e gjuhëve të huaja, të cilat janë të pranuar edhe në gjuhën shqipe, së dyti, të shihet gjithashtu reflektimi i trajtave të gjuhëve të huaja me formantin në fjalë, por që janë të qëndrueshme edhe të kuptueshme edhe sipas strukturës fjalëformuese të gjuhës sonë, së treti, do të trajtohen shembujt nga tema e qartë motivuese e gjuhës shqipe dhe së katërti, në daljen e këtij formanti fjalëformues të sistemit foljor të shqipes, vallë, a mos ka pasur ndikim apo reflektim prapashtesa e mirëfilltë e sistemit emëror -ZË të gjuhës shqipe?

I

Disa ndërkombëtarizma në trajtën foljore, siç u cek më sipër, si "fjalë të huazuara i janë përshtatur sistemit morfologjik të shqipes"⁹ dhe përdoren normalisht, mirëpo sa i përket temës prodhuese, ose rreth përcaktimit të prapashtesës foljore në shqipe kërkojnë sqarim, ngase u mungon tema e drejtpërdrejtë prodhuese motivuese. Këtë grup foljesh, duke e pasur si kriter largesën kuptimore të temës motivuese, në gjuhën shqipe, mund ta ndajmë në dy nëngrupe:

- foljet me temë jo të qartë motivuese dhe
- foljet me temë pjesërisht të qartë motivuese.

1. Në grupin me temë jo të qartë motivuese futëm foljet si: polemizoj, hermetizoj, incizoj, etj., të cilat në gjuhë të tjera mund ta kenë të shpjegueshme temën motivuese, por në gjuhën tonë nuk del ashtu. Ja si dalin trajtat e një shembulli të këtij nëngrupi në gjuhë të ndryshme, p.sh. shqip: polemizoj, (me) polemizuar: gjerm. polemisieren, fr. polémiser, angl. (to)

polemize, it. polemizzare, rus. polemizirovatj, serbokr. polemizirati, polemisasi.

Po kështu u dalin formantet prapashtesore edhe shembujve të tjerë të këtij nëngrupi.

2. Në nëngrupin tjetër bëjnë pjesë foljet me temë pjesërisht të qartë motivuese, pasi fjala bazë është e qartë, por trajta foljore e gjuhës shqipe është përfutur nga pjesa foljore e gjuhës së huaj e jo nga tema a fjala që ka kuptim edhe në gjuhën tonë, p.sh. sistematizoj (sistem), dramatizoj (dramë), tematizoj (temë), skematizoj (skemë etj. Sigurisht trajta e mbiemrave të huazuar, në formën e përvetësuar sistematik, dramatik, tematik, skematik nuk e kanë forcën ndikuese në formën e foljes.

Edhe nga ky grup foljesh po japim një shembull në disa gjuhë: shq. sistematizoj (sistemoj), (me) sistematizuar (sistemuar): fr. systematiser, angl. (to) systematize, rus. sistematizirovatj, serbokr. sistematizirati, sistematizovati etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm të të dy nëngrupeve të foljeve më -O-(-UA/R), në gjuhën tonë, është "përkthyer" vetëm pjesa fundore a formanti fjalëformues i gjuhëve të tjera.

Lidhur me këtë, kur kemi parasysh faktin se elementi -iz- (is-) del si element i përbashkët që i takon, si të themi, temës së përbashkët prodhuese që e kanë të gjitha gjuhët e konsultuara, siç dalin trajtat foljore të grupeve të mësipërme (polemizoj, sistematizoj), s'di sa mund të thuhet te këto raste se kemi prapashtesën foljore të shqipes -ZO-, kur shihet se kemi të bëjmë vetëm me prapashtesën e mirëfilltë -O-. Sidoqoftë kjo çështje mbetet e diskutueshme.

II

Në gjuhën tonë një grup mjaft të madh foljesh i kemi të reflektuar si ndërkombëtarizma ose trajta të përfutura sipas atij modeli ose nën ndikimin e tij, tema motivuese e të cilit është më e përafërt në krahasim me grupin e foljeve që u cekën më sipër. Gjithashtu, duke e pasur si kriter largesën ose afrinë kuptimore të foljes me temën motivuese, edhe këtë grup foljesh e merenduar në dy nëngrupe:

⁹ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, t. 229

e para, foljet me temë të qartë motivuese me formantin fundor -IZO-, pra me një -i- mbështetëse, siç e quan F. Sulejmani dhe e dyta, foljet me temë të qartë motivuese që tema u mbaron më -i- fundore plus formanti -ZO-.

1. Në nëngrupin e foljeve me temë të qartë motivuese me formantin -IZOj/ (-IZUA/r) dallojmë dy tipa foljesh: ato që dalin nga tema që është ndërkombëtarizëm a fjalë e huaj dhe ato që kanë për temë një fjalë shqipe që nuk është ndërkombëtarizëm, por që shkon si "kalkëzim", sipas modelit që japim ndërkombëtarizmat e tillë.

a) Në tipin e parë të foljeve grupohet një numër i madh ndërkombëtarizmesh a fjalësh ndërkombëtare, si p.sh. aktivizoj, automatizoj, galvanizoj, hibridizoj, ekranizoj, sinjalizoj, konkretizoj, stabilizoj, etj. Dhe për të dokumentuar se elementi

-IZ/ është i reflektuar nga gjuhët e tjera, mjafton të sjellë këta dy shembuj (folje) nga temat: **stabil-** e **polar-**, që në gjuhën shqipe, nga aspekti leksikogramatikor janë mbiemra:

1) shqip: stabilizoj, gjerm. stabilisieren, fr. stabiliser, angl. stabilize, it. stabilizzare, rus. stabilizirovatj, serbokr. stabilizovati, stabilizirati;

2) shqip: polarizoj, gjerm. polarisieren, fr. polariser, angl. (to) polarize, it. polarizzare, rus polarizirovatj, serbokr. polarizirati.

Edhe nga shembujt e mësipërm del qartë se formanti -IZ- (-IS-) është pjesë përbërëse e temës së caktuar të huazuar (kopjuar) nga gjuha e huaj dhe nuk di sa kemi të drejtë ta konsiderojmë si prapashtesë më vete në gjuhën tonë për shembujt si më lart, siç u quajt në një artikull të botuar në gazetën "Rilindja", dt. 18. I. 1986, f.14, ashtu siç është shënuar edhe në GJLSHGJ e burime të tjera.¹⁰

Mirëpo, sido që të cilësohet një formant i tillë nga teoristët tanë, është e vërtetë se nën ndikimin e këtij modeli kemi ndonjë formim foljeje të pranuar në gjuhën tonë me vetë brumin e shqipes.

¹⁰ Edhe studiuesi Shaqir Berani në revistën *Gjuha shqipe* 1/88 foljen karikaturozë që zërthen karikaturozë.

b) Ç'është e vërteta, mbase në fillim si kalkëzim, si p.sh. internacionalizoj në shqipe doli *ndërkombëtarizoj* (krahaso: nacional = kombëtar), por është e vërtetë se kemi raste që temës motivuese të fjalës shqipe t'i shtohet prapashtesa -IZO-, përkatësisht -ZO- me një -I- mbështetëse. Si p.sh. pluhurizoj, (pluhur-izoj), mashkullorizoj, femërorizoj e ndonjë tjetër, por gjithësi në një numër të kufizuar. "Këto formime nuk janë shumë aktive" thuhet në GJLSHGJ f.229,¹¹ megjithatë shihet një tendencë konkurruese e fortë me prapashtesën e mirëfilltë të shqipes -O-, përkatësisht ë/ZO, siç do të ceket më poshtë në këtë trajtesë për shembujt e rinj, duke përfshirë edhe formimet nga mbiemrat e caktuar të shqipes (zyrtarizoj/zyrtarizoj? zyrtarim/ ose zyrtarëzjo zyrtarëzim).

2. Lidhur me nëngrupin e mësipërm del edhe nëngrupi tjetër, i foljeve tema motivuese e të cilave mbaron me një -i- fundore, si p.sh. ekonomizoj, teorizoj, harmonizoj, kimizoj etj. Dhe për këtë nëngrup foljesh sjellim një shembull në gjuhë të ndryshme, për të parë kështu përkueshmërinë e formantit prapashtesor të gjuhës shqipe me ato të gjuhëve të tjera, p. sh. shq. ekonomizoj, angl. -(to) economize, fr. economiser, it. economizzare, serbokr. ekonomizirati, ekonomizovati.

Siç po shihet, nga shembulli i mësipërm elementi -Z- (-S-) është elementi i përbashkët i të gjitha gjuhëve të konsuluara, mirëpo, sipas këtij modeli në disa folje të mirëfillta të gjuhës shqipe me temë motivuese më -I- fundore, prapashtesa -ZO- del si prapashtesë e mirëfilltë, si p.sh. njerizoj, fuqizoj, hyjnzizoj, shoqërizoj, mbase shqiptarizoj (pasi elementi -I- i takon emrit përkatës: temës prodhuese: njeri, hyjni etj.). Pikërisht te fjalët e këtij tipi del prapashtesa e mirëfilltë -ZO- e gjuhës sonë, e cila, edhe më e pavarur, do të dalë te shembujt e grupit tjetër të foljeve, siç do të shohim në vazhdim.

¹¹ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, 229.

III

Edhe rreth grupit të foljeve të gjuhës sonë me prapashtesën e mirëfilltë *-ZO/j*, dalin mjaft çështje që imponojnë ndonjë sqarim ose vlerësim më të kompetentshëm.

Të gjitha foljet e këtij grupi mund t'i renditim në pesë nëngrupe, si vijon:

1. Në nëngrupin e parë do të përfshihen ato folje më *-ZO-* që kanë për temë prodhuese një emër të gjinisë mashkullore ose femërore me theks parafundor, si p.sh. miellzot, emërzoj, huazoj, petullzot, kokërrzotj etj. Kështu do të dilte edhe diellzot e jo diellëzot, siç doli në revistën "Zëri i rinisë", dt. 24. V. 86. f. 24. Nuk di sa është e arsyeshme që në këtë nëngrup të hyjë folja tërthorzoj,¹² ndoshta më mirë do të shkonte me një *-E-* fundore (tërthore) ose një *-Ë-* mbështetëse: tërthorëzot apo tërthorotj?

2. Si nëngrup të veçantë përbëjnë foljet më *-ZO-*, kur kjo prapashtesë i bashkohet temës më *-Ë-*, zakonisht një emri të gjinisë femërore, si p.sh.: kripëzot, bigëzot, banjëzot, degëzot, rrënjëzot, petëzot, tokëzot, njëzot, brumëzotj etj.

3. Nëngrup më vete përbëjnë foljet më *-ZO-*, që kanë për temë prodhuese një emër të gjinisë femërore që në trajtën e pashquar marrin zanoren *-E* si p.sh. fijezoj, rrokjezoj, hijezotj etj.

4. Nëngrup më vete venduam një numër të caktuar foljesh, të cilat, gjithashtu si ai në nëngrupin e mësipërm, kanë në temën prodhuese zanoren *-e*, e cila para prapashtesës *-ZO-* errësohet në zanoren *-Ë-* si p.sh. gëlqerëzotj (gëlqere), vallëzotj (valle), faqëzotj, (faqe), lulëzotj (lule) dhe lëvoërëzotj (lëvore).

Vërejtje: Nga lënda e regjistruar në FGJSSH lidhur me nënëngrupin 3. dhe 4. mund të nxirret si rregull që shembujt më "të rinj" emrat femërorë si fijezoj, rrokjezoj, foljezoj, hijezotj etj. nuk e errësojnë *-E-* në fundore në *-Ë-*, siç ndodh në shembujt e "vjetër", si p.sh. gëlqere/gëlqerëzotj etj. Prandaj këtë prirje (rregull) është mirë ta respektojmë në shembujt e tjerë si hojezoj/hojzohet e jo hojëzoj/hojëzohet, siç doli te "Kosovarja" nr. 5/86 f.24. Sidoqoftë, tërhiqet vëmendja rreth kësaj dukurie, d.m.th. të

¹² Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 1996.

dukurisë së mosshurdhimit të zanores *-E-* para prapashtesës *-ZO-*, ngase një shurdhim i tillë del i rekomandueshëm sipas ndonjë burimi normativ¹³, duke u paraqitur kështu si çështje e diskutueshme, sepse siç e pamë te mjaft shembuj të rinj ky sirregull nuk respektohet!

5. Nëngrup më vete përbëjnë foljet më *-ZO-* që dalin nga një temë prodhuese që zakonisht është emër i gjinisë mashkullore dhe këtë rast marrin një *-Ë-* mbështetëse si p.sh.: sendëzotj, lëngëzotj, pyllëzotj, shtetëzotj, kunjëzotj, çiftëzotj, grupëzotj, sapunëzotj, telëzotj, bykëzotj, füllëzotj, dhëmëzotj etj.

U tha më sipër se formanti *-Ë/ZO-* është në konkurrencë formale me formantin tjetër *-IZ/O-* pa të drejtë, ngase *-IZ+O*, më tepër është si një infiks i shpifur nga modelet e formës shkrimore të trajtave foljore të gjuhëve të huaja. Gjithsesi, çështja e përdorimit të *-I-së* ose *-E-së* mbështetëse tek temat fjalëformuese të gjuhës shqipe mbetet si çështje që duhet ta trajtojnë dhe ta rekomandojnë kuadrot tanë kompetentë. Kemi raste kur i njëjti autor përdor edhe njërin edhe trajtën tjetër. Po e cek vetëm profesorin e mirënjohur, autorin e fjalorëve të terminologjisë ekonomike, Hajrullah Goranin, i cili shënon trajtat fshatarizim (FTHSHE SSH f.183) dhe atë fshatarëzim (FTSHE SHS f.98),¹⁴

Duke e quajtur më "shqipe" trajtën më *-O-*, përkatësisht *-ËZO-*, sipas mendimit tonë, gjithsesi për fjalë-temat emërore me burim të shqipes, duhet të rekomandohet formimi më *-ËZO-* a *-O-* e jo *-IZO-*, ngase një mbështetje e tillë del nga shumica absolute e shembujve të regjistruar në FGJSSH, por, lidhur me këtë është mirë të konstatohet nënfisha semanticke që shprehet me foljet e tilla. Prandaj, me rastin e formimit të foljeve të reja më *-ZO-*, patjetër duhen pasur parasysh fakti, që u cek më sipër, rreth ruajtjes së prapashtesës *-ËZO-* nga goditja që po i bëhet nga formanti *-IZO-*, kur është fjala për temat që janë të fondit aktiv të shqipes e nuk janë ndërkombëtarizma ose trajta foljore të huazuara ashtu nga gjuhë të huaja, p.sh. jo afatizotj/afatizim ("Rilindja", dt. 16. XII. 86 f. 18) por afatizotj/afatim ose afatëzotj/afatëzim, siç na rekomandohet nga FSHSK 1981

¹³ Shih: *Fonetika dhe gramatika...* II, f. 253.

¹⁴ Dr. Hajrullah Gorani, *Fjalor i termave dhe shprehjeve ekonomike shqip-serbokroatisht*, Prishtinë 1985 dhe *Fjalor i termave dhe shprehjeve ekonomike serbokroatisht-shqip*, Prishtinë 1986.

f. 8¹⁵ dhe FTSHESHK f.13), jo thesarizoj/thesarizim (FTSHESHKSH f. 329),¹⁶ por thesaroj/thesarim ose thesarëzjoj/thesarëzjim etj. Po kështu mund të jepet vërejtje edhe për trajtën bakërizim¹⁷, pasi trajtë e drejtë është trajta bakërizim nga bakërzjoj si emërzjoj, motërzjoj etj. e jo ajo bakërizoj (bakëri+zoj). Gjithashtu më të drejta do t'i quanim edhe trajtat artëzjoj (se artizoj (art) (Rilindja për fëmijë, dt. 22. VII. 1986 f. 3), pastaj edhe trajtat se artizoj si: zyrtar, letrar etj., mbase më drejt mund të dilnin zyrtarëzjoj, letrarëzjoj se sa zyrtarizoj, letrarizoj (FTSHE¹⁸ f. 349), formantit ëzjo- e jo IZO- shihet edhe në shkrimet e ndryshme të ne, p.sh. kriterëzjoj (GJSH¹⁹ nr. 1/83 f.8), solidarëzjoj ("Rilindja" dt. 12. VI. 1986 f.5) etj. Sa për të tërhequr vëmendjen se sa është i parapëlqyeshëm dhe është i përdorshëm modeli fjalëformues më -Ë/ZO- në gjuhën tonë do të paraqit dy shembuj me kuptimin "shndërrjoj ndryrë në sapun" (FGJSSH f.1733),²⁰ kurse, po për këtë koncept, në gjuhë të tjera, dalin trajtat me prapashtesë-mbaresë tjetër p.sh. gjerm. saponifizieren, angl. saponify, fr. syronifier, it, saponificare, serbokr. saponifikovati. Në të vërtetë, sipas modelit të trajtave të gjuhëve të tjera, edhe në shqipë do të mund të arsyetohej trajta saponifikoj a saponifikoj, ashtu siç i kemi të reflektuara trajtat foljore, si p.sh. modifikoj, radiofijokj, kualifikoj, gazifikoj, elektrifikoj, planifikoj etj. por, në sajë të modelit tejet të parapëlqyer të strukturës vetjake fjalëformuese të shqipes është pranuar trajta sapunëzjoj si kripëzjoj, gurëzjoj, gëlqerëzjoj etj.

Edhe rasti tjetër **planëzjoj** është formuar sipas këtij modeli, madje edhe pse që më parë e kishim të pranuar foljen planifikoj. Pa marrë parasysh se cila trajtë do ta fitojë konkurrencën ose çfarë nuancimi kuptimor do të zërrë në kontekstin e aktual leksikor, këtu tërhiqet vëmendja te pri- rja aktuale, karakteristike kjo e gjuhës sonë, ku "po linden" gjithnjë e më shumë folje me prapashtesën -ËZO- në raport me të tjerat, kur me këtë prapashtesë speciale po shprehen edhe procese a operacione speciale (ki-

¹⁵ Fjalor shqip-serbokroatisht, Prishtinë, 1981, f8.

¹⁶ H. Gorani, vepra e cit.

¹⁷ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, f. 85.

¹⁸ H. Gorani, vepra e cit. f. 349

¹⁹ Revista Gjuha shqipe nr. 1/83, f. 8.

²⁰ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, f. 1733.

mike), por edhe të tjera, gjithsesi të ndërlikuara. Ç'është e vërteta, trajtat më -IZO dhe ato më -O- pa zgjerim mbi temën e qartë fjalëformuese afrohen më shumë a identifikohen kuptimisht njëra me tjetrën, kurse formimet më -(Ë)ZO mbulojnë zakonisht nënfushë krejt tjetër semantike.

IV

Shtrohet çështja rreth krijimit të foljeve me prapashtesën -ZO, se mos vallë këtë e ka ndihmuar prapashtesa e mirëfilltë emërore -ZË e gjuhës shqipe, me të cilën formohen "emra femërorë, me kuptim zvogëlimi e përkdhelie"²¹? Prof. Shaban Demiraj supozon se prapashtesa -ZO- (foljore) do të ketë dalë "nga bashkimi i prapashtesës -zë dhe prapashtesës -o-".²² Në të vërtetë, qoftë si shtytës të brendshëm, qoftë nga të jashtëm, sot për sot prapashtesa -ZO- paraqitet si një element aktiv e produktiv për formimin e foljeve. Ç'është e vërteta, te shembujt e rinj, siç u cekën më sipër ndikimi i prapashtesës emërore -ZË- është pothuajse fare i padiktu- shëm, mirëpo në ndonjë rast si lulëzjoj (nga lulëz), motërzjoj (motërzj) etj. mbase mund të ketë pasur në krye të herës ndonjë nuancë ndikimi në përfundim e prapashtesës së mirëfilltë -ZO-, pas një bashkimi të elementeve: Z(ë)+O, por siç u pa në këtë trajtesë, elementi -Z- (-s-) është reflex dhe i gjuhëve të tjera, por mund të jetë edhe një zëshmim i tingullit -S të shqipes. Megjithatë, ekzistenca e prapashtesës së mirëfilltë -ZO si zgje- rim i prapashtesës -O- kursesi s'mund të vihet në dyshim në gjuhën let- rare shqipe.

Këtu e shohim të arsyeshme të cekim faktin se pothuajse të gjitha proceset teknologjike kimike shprehen me foljet më -ZO-, por kemi raste që me foljet më -ZO- të shprehen edhe procese të tjera, që nuk u përkasin vetëm proceseve teknologjike kimike, por të tjera, të cilat gjithashtu janë të ndërlikuara, qoftë me kuptim figurativ, qoftë edhe nga fusha abstrakte ose që kanë të bëjnë me procese të automatizuara me kuptim kundërvënës kundrejt foljeve paralele nga tema e njëjtë prodhuese, që në shqipë marrin prapashtesën -O- ose ndonjë tjetër.

²¹ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.

²² Prof. Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipes*, Prishtinë 1971, f. 241.

Sa për ilustrim po shënojmë një shembull të tillë nga gjuha frënge dhe nga ajo gjermane, p.sh. nga **chrom** (krom) kemi dy folje paralele **chromer**, **chromatieren** (shqip kromoj, serbokr. hromirati) me kuptim të shkallës së parë dhe me **chromiser**, **chromatisieren** (shqip: kromëzoj, serbokr. hromizirati a hromizovati) me kuptim të shkallës tjetër.

Po kështu kemi rastet: gazoj/gazifikoj, niveloj/nivelizoj, sistemoj/sistematoj, aktivoj/aktivizoj që janë ndërkombëtarizma, por kemi folje të tilla paralele edhe me temë të brumit të vendit, si p.sh. huaj/huazoj, kritilla paralele edhe me temë të brumit të vendit, si p.sh. huaj/huazoj, kritilla paralele edhe me temë të brumit të vendit, si p.sh. huaj/huazoj, kritillësaj/paralele, lëngësoj/lëngëzoj, sapunoj/sapunëzoj, gëlqeroj/gëlqerësoj/kripëzoj, çiftoj/çiftëzoj etj.²³ Madje edhe të foljet si lulëzoj, petëzoj, vallëzoj në raste shihet mjaft qartë prirja e foljeve paralele me kuptim të diferencuar si luloj (bëj me lule), valloj, petoj etj. Sa për ilustrim po cek se që në fjalorin e "Bashkimit" i kemi të diferencuara kuptimet leksikore të trajtat e foljeve: *valloj* it. cirkundare, fare il giro, ndaj *vallëzoj* që ka për barasvlerës trajtën *danzare* (FB f. 483).²⁴

Në fund po theksojmë se asnjërin nga pikat e shtruara këtu nuk i quaj të shtruara, por vetëm si një përpjekje për t'i vënë në pah me qëllim të studiuësit të nxitin për t'i shqyrtuar dhe, lidhur me to, të gjejnë zgjidhjet e caktuara.

Sikurse janë gjetur zgjidhjet rreth kuptimisë së foljeve paralele si p.sh. luloj/lulëzoj, gëlqeroj/gëlqerëzoj, sapunoj/ sapunëzoj ashtu mendojmë se mund të gjinden edhe zgjidhjet për kuptimet që duhen emërtuar e që janë tejet aktuale, sot për sot, si p.sh.: grupoj/grupëzoj, afatoj/afatëzoj etj.

Gjithsesi studimi i shkallëve kuptimore të foljeve paralele (të karakterit paronimik), duke përfshirë të gjitha llojet dhe tipat e foljeve nga ndërtimi e fjalëformimi, sipas stileve funksionale do të nxjerrë në pah prapashitesat speciale të foljeve që shprehin proceset kimike, specialistike e të automatizuara, procese këto që i shtron koha dhe që na i imponon nevoja për t'i emërtuar si duhet.

²³ Shembuj të tillë ndeshim në jetën tonë të përditshme edhe në gjuhën e shkruar.

²⁴ Fjalori i "Bashkimit" (1908), Prishtinë 1978, f. 483.

Përfundim

Nga analiza del se në shqipe është e dukshme kundërvënia kuptimore ndërmjet foljeve me prapashitesën -O- dhe atyre me prapashitesën -ZO-. Në të vërtetë, shumica e proceseve teknologjike mekanike (pa mohuar edhe format me formante të tjera) emërtohen rëndom me foljet më -O- pa zgjerim, përkatësisht emrat prejfoljorë më -IM mbi këtë bazë, si p.sh.: punoj punim, sharroj sharrim (mbi fjalë-tema anase), përkatësisht: saldoj saldime, tornoj, tornim, frezjoj frezim etj. (mbi fjalë-tema të huazuara). Folje më -O- pa zgjerim u konsideruan edhe trajtat e huazuara me infiksat përkatëse -ifik-, -iz (-is), të tipit planifikoj, elektrifikoj, koksifikoj, përkatësisht galvanizoj, vullkanizoj, mekanizoj, etj. Mirëpo kur procesi i punës pëson a imponon një ndërlikueshmëri të konsiderueshme teknologjike, siç janë proceset kimike e të tjera, veprimet e tilla në shqipe emërtohen (shprehin) zakonisht me foljet me formantin -ZO, përkatësisht emrat prejfoljorë mbi këtë bazë më -ZIM, si p.sh.: lulëzoj lulëzim, kripëzoj kripëzim, koksëzoj koksëzim, sapunëzoj sapunëzim, planëzoj planëzim etj., që të gjitha mbi fjalë-temat burimore të shqipes, dukuri kjo që i takon, në radhë të parë, zhvillimit të brendshëm të shqipes.

Ndërsa te proceset mekanike që, siç u tha, shprehin zakonisht me foljet më -O-, nga njëra anë, lënda e shprehur në temën prodhuese përpunohet, por nuk pëson transformimin rrënjësor, te proceset kimike e të tjera që shprehin me foljet më -ZO, nga ana tjetër, lënda e cekur pëson shndërrim të plotë rrënjësor a të konsiderueshëm të substancës.

Prandaj, një kundërvënje e tillë del e nevojshme të konstatohet edhe në burimet tona normative, ngase lidhur me këtë çështje ka paqartësi, madje edhe interpretime të diskutueshme.

Kreu II

FOLJE TË PREJARDHURA FORMUAR ME PRAPASHTESËN -O- ME ZGJERIM*

Formimi i foljeve me prapashtesën -O- me zgjerim nuk është temë krejt e patrajtuar në gjuhësinë tonë. Është prekur, paksa, nga studiuesit tanë të mirënjohur Sh. Demiraj, S. Riza, I. Ajeti, E. Çabej, A. Kostallari etj.² Zë vend, ndonëse mjaft modest, edhe në gramatikën e Akademisë (1976)³, por edhe në tekste të tjera përkatëse normëzuese. Mirëpo lënda e shtruar deri tash, aq sa patëm mundësi ta konsultonim, jo vetëm se nuk është shteruese, por ajo mbetet e pamjaftueshme për të na dhënë koncept të plotë rreth kësaj dukurie, madje për ndonjë konstatim, del edhe e diskutueshme.

Nga të diskutueshmet a si çështje që lypsen zbrërthyer e saktësuar, po përmendim këto:

e para, sasinë, pasi numri i prapashtesave të tilla nuk paraqitet i plotë as i sistemuar në asnjërin nga burimet e deritashme;

e dyta, kriterin rreth përcaktimit të koncepteve në raportin: temë fjalëformuese+prapashtesë fjalëformuese, që lypset harmonizuar;

e treta, origjinën e elementit përkatës mbështetës të prapashtesës -O-, qoftë si relik (gjurmë e ndonjë trajte të vjetër), qoftë si element i krijuar me analogji, qoftë si veçori asociacionore e të ashtuquajturit "simbolizëm tingullor" ose qoftë edhe si një element kundër hiatit;

* Është botuar në gazetën *Rilindja*, më 16. IX.'89, f. 12 edhe në *Seminari...* XV/89, Prishtinë 1995.

² Veprat e autorëve të cituar janë shënuar në literaturë e konsultuar dhe në referencat përkatëse në krrerët vijues të këtij punimi.

³ *Fonetika dhe gramatika ...II*, Tiranë 1976.

e katërta, perceptimin e formantit të caktuar të folësi si një prapashtesë të mëvetëshme, pavarësisht nga origjina e elementit përkatës mbështetës; e pesta, vetëdijësimin për vlerën shoqërore-gjuhësore që ka një mënyrë e tillë e fjalëformimit, jo vetëm aktualisht, por edhe në perspektivë, kur kemi parasysh nevojat gjithnjë në rritje të gjuhës sonë në të gjitha rrafshet e stileve funksionale të saj.

Sigurisht dalin edhe çështje të tjera, të cilat duhen analizuar, siç është çështja e konkurrencës së prapashtesave dhe e mënyrave fjalëformuese brenda sistemit foljor, raporti me prapashtesat e sistemit emëror, pastaj dallimi i rasteve nga dukuria etj.

Duke u bazuar në parimin e përforcimit dhe të verifikimit të fakteve, sigurisht nën kushte të reja, duke i shfrytëzuar rezultatet e mëparshme, kemi arritur në përfundime të caktuara, të cilat po i kumtojmë, ndonëse pjesërisht dhe shkurt fare, sepse më gjerësisht do të kemi rast t'i paraqitin në ndonjë vend tjetër.

Në pasqyrën vijuese po japim numrin e foljeve me prapashtesat -O- me zgjerim⁴, të klasifikuara në tri grupe: prapashtesa të mirëfillta (sinonimike), varianete të prapashtesave të mirëfillta dhe formante të tjera të diskutueshme, sipas këtyre rubrikave: 1. numri rendor, 2. prapashtesa a formanti fundor, 3. numri i foljeve dhe 4. vërejtje (shembuj), të vjela kryesisht në FGJSSH, por edhe në ndonjë burim tjetër (sidomos kur kemi të bëjmë me formante të tjera të diskutueshme).

⁴ Termi togfjalësh "-O- pa zgjerim ose me zgjerim" në këtë punim u parapëlqye prej nesh kundrejt sinonimit "O- e zgjeruar me...", përkatësisht "-O- me ndërhyrje të tingullit...", ngase na u duk më i përshatshëm për natyrën e lëndës në shqyrtim.

PASQYRA E NUMRIT TË FOLJEVE TË KONSULTUARA SIPAS PRAPASHTESAVE SINONIMIKE MË -O- ME ZGJERIM

Nr. rendor	Prapashtesa a formanti fundor	Numri i foljeve	Vërejtje (shembuj)
I. PRAPASHTESA TË MIRËFILLTA			
1.	-RO	87	mbretëroj, zotëroj, kalëtoj, paqëroj;
2.	-LLO-	51	mbushulloj, rrapelloj;
3.	-TO-	103	farkëtoj, tregtoj;
4.	-SO-	107	lehtësoj, punësoj;
5.	-ZO-	120	lulëztoj, sapunëztoj, planëztoj.

II. VARIANTE TË PRAPASHTESAVE TË MIRËFILLTA

1.	-NO-	26	frytoj, shtalbnaj, çudnoj, bishtoj;
2.	-MO-	23	erëmoj, zhagmoj;
3.	-RRO-	16	bubërron, pikërron;
4.	-LO-	24	bubëlloj, cikëlloj, gocëlloj, çapëlloj;
5.	-IZO-	6	kombëtarizoj, moçalizoj;
6.	-CO-	10	gurëcoj, mëlcoj.

III. FORMANTE TË TJERA TË DISKUTUESHME

1.	-KO-	20	fillkoj, dylkoj, mukon, hejkoj;
2.	-SHO-	16	unshoj, erëshoj;
3.	-SHTO-	17	mbarshtoj, këmbështoj;
4.	-ÇO-	6	gurëçoj, gropëçoj;
5.	-ZHO-	5	drangëzhjoj, bubuzhon;
6.	-HO-	7	pohoj, pse-hoj, ua-hon, bu-hoj;
7.	-JO-	20	hijon, flijon, skijoj, lijohet.

Gjithsej 18 formante të prapashtesës -O- me zgjerim, prej tyre 13 të identifikuarra a të qartësuara e të arsyetuara prej nesh.

Të gjitha këto vlen të trajtohen veç e veç më në hollësi në trajtesa të veçanta.⁵

⁵ Kështu është vepruar në kreun III të këtij punimi.

Pasi vjelja e lëndës nuk është shteruese, as nga aspekti diakronik dhe as nga ai sinkronik, numri i foljeve mund të jetë i ndryshueshëm. P.sh. te foljet më -RO- nja 64 shembuj, për mendimin tonë, dalin të mirëfilltë, të tjerët të diskutueshëm; te foljet më -TO- të mirëfilltë dalin nja 60 shembuj, të tjerët dalin të diskutueshëm ose janë përfitim të reja, e kështu me radhë, por gjithësi në realitetin tonë gjuhësor formimet me të gjitha formantet përkatëse zakonisht shënojnë rritje.

Sido që të jetë, ndryshimet në numër nuk i vënë në dyshim konstatimet e përgjithshme të vëzhgimeve tona, edhe pse, siç u tha, për nga klasifikimi edhe varësisht nga kriteri i studuesit të caktuar, qëndrueshmëria e ndonjë trajte foljore mund të dalë e diskutueshme.

1) Prapashtesa të mirëfillta me zgjerim të prapashtesës -O-

Trajtimi i formanteve -RO-, -LLO-, -TO-, -SO- e -ZO- si prapashtesa të mëvetësishme (të mirëfillta) del i drejtë. Këtë e dëshmon numri në rritje i shembujve nga jeta.

Është me interes të theksohet ndonjë prirje që ka prapashtesa e caktuar për t'u specializuar për fushën a nënfushën e caktuar kuptimore, si p.sh. prapashtesa -ZO-, siç është cekur në një vend tjetër, prirje të specializohet në emërtimin e proceseve kimike-teknologjike në njëfarë kundërvenije të dalluar me foljet me prapashtesën -O- pa zgjerim, me të cilën shprehen kryesisht procese mekanike, siç quhen zakonisht në teknologjinë e prodhimit. Prapashtesa -RO- ka prirje të përdoret në foljet që shprehin botën subjektive të njeriut, ashtu si edhe foljet me prapashtesën -SO- e -TO-, me të cilat shprehen edhe procese të ndërlikuara e abstrakte nga veprimtaria e njeriut. Prapashtesa -LLO- prirje të shprehë ndonjë dukuri të caktuar të natyrës, sidomos kur folja ka për temë një onomatopë⁶ etj.

Gjithësi në kuadër të këtij grupi del ndonjë çështje për diskutim e natyrës drejtshkrimore e drejtfoljorë. Vërejtje mund t'i bëhet edhe ndonjë konstatimi, tashmë të vjetruar, rreth prodhueshmërisë e aktivitetit të modelit të caktuar fjalëformues.

⁶ Edhe për këtë më hollësisht në kreun II e IV të këtij punimi.

2) Variante të prapashtesave të mirëfillta

Studuesit formantet -NO-, -MO-, -RRO- i nxjerrin në lidhje origjinore me prapashtesën e mirëfilltë -RO-, njëfarë afrie e ka edhe prapashtesa -LLO- me formantin -LO-, prapashtesa -ZO- me formantin -ZO-, si dhe prapashtesa -SO- me -CO-, për këtë arsye ky grup formantesh u quajti këtu *variante të prapashtesave të mirëfillta*.

Të shohim në vazhdim ndonjë karakteristikë për secilin formant.

1. Edhe pse në gjuhën e sotme letrare te trajtat "thjesht dyjare", siç i quan I. Bajçinca,⁷ u parapëlqye në të shumtën e rasteve trajta me prapashtesën -RO-, ndaj prapashtesës -NO-. Në FGJSSH⁸, megjithatë, kanë mbetur mbi 20 shembuj (folje) me formantin -NO-, si p.sh. bishtno, rinoj, zhburnoj, çudnoj, breshno, cubnoj, hijenoj etj., fakt ky që dëshmon mirëfilli qëndrueshmërinë e këtij formanti si prapashtesë të mëvetësishme. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me qëndrueshmërinë e *njësisë së caktuar leksikore*. Pasi në gramatikat e tekstet e caktuara nuk përmendet veçan formanti -NO- si prapashtesë e mëvetësishme, e shoh të nevojshme të rikujtoj një fakt me shumë rëndësi. Në gjuhën e sotme letrare (të njësuar) është e lejueshme konkurrenca e njësisë leksikore që në përbërjen e tyre fonematike kanë bashkëtingëlloren -N- e kur është rasti për ndonjë fjalë të re ose me ngjyrim të ri semantik, as që vihet në dyshim qëndrueshmëria e trajtes me -N-. Ky konstatim vlen, pra, edhe për foljet më -NO-, prandaj ma merr mendja se një varg foljesh si drinoj, bishtno, kalbnoj, shtalbnoj, frytnoher, farefisnoj, vrugnoj, vargnoj, pleqnoj..., me origjinë nga areali verior as që ka pengesa ta fitojnë qytetarin në gjuhën letrare të mbarë truallit të shqipës, aq më tepër kur këtë e ndihmon edhe specifika e autencitetit që shprehet me fjalë të tilla. E thamë se një e drejtë e tillë del e pakontestueshme edhe sipas shkrimeve dhe mësimave të A. Kostallari, I. Ajetit, J. Gjinarit, L. Malakut, I. Bajçincës etj.

Gjithësi formanti -NO- duhet të zërrë vendin në mesin e sishoqeve të prapashtesës -O- me zgjerim.

2. Dihet historikisht se elementi -R- (-RO-) si dhe elementi -N- (-NO-) kanë lidhje burimore me elementin -M- (-MO-) e që kjo ka të bëjë me pje-

⁷ Isa Bajçinca, *Çështje të zbatimit të normës letrare*, Seminari.../478, f. 92.

⁸ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.

soren e foljeve të caktuara në një stad të hershëm të gjuhës sonë. Në analiza etimologjike e fjalëformuese pranohet ekzistenca e formantit -MO- si prapashtesë foljeformuese. Kjo shihet qartë edhe te shembujt: çukurmoj (nga *çuk - çuk* sipas Çabejt), zhurmëmon, erëmon, kallmoj, felemoj, zha-gmoj, thellëmoj, thekmoj, ngallmoj, brimoj, xixëmon etj. Nuk di pse një formant i tillë nuk është sqaruar edhe në gramatikat tona, kur kemi të bëjë me fjalëformimin.

3. Një numër i kufizuar i foljeve del edhe me fundorin -RRO-, si p.sh. bubërron, pikërrroj, thekërrroj, hakërrroj, kuqërron, vëkrron, pushkërrroj, gaf-rrroj etj. Ka të ngjarë që ky formant të përfilllet si prapashtesë më vete edhe për arsye se, duke e shprehur ekspresivitetin, merr mbi vete një tipar që nuk e ka, bie fjala, prapashtesa -RO-.

4. Në gramatikën e Akademisë (1976)⁹ pohohet ekzistenca e formantit -LO- si prapashtesë te shembujt: shoshloj, kuqëlloj. Ç'është e vërteta, në burime të caktuara hasim një numër të konsiderueshëm të foljeve më -LO- fundor, si p.sh. kakloj, çuquloj, giciloj, çikëlloj, shpendloj, çapëlloj, skutëlloj, humbëlloj etj. Ka prirje që kjo prapashtesë me elementin -L- të shfrytëzohet për ngjyrimet stilistike në njëfarë kundërvënijeje me formantin -RRO- si p.sh. kuqëlloj : kuqërron, bubëlloj : bubërron, cikëlloj : cikërrroj, cakëlloj : cakërrroj, hutloj : hutërrroj etj.

5. Në doracakun normativ "Gjuha letrare shqipe për të gjithë" (1976),¹⁰ në kuadër të prapashtesës -ZO- pranohet fakti i përfutimit të foljeve me prapashtesën -ZO-, siç thuhet aty, "nga tema e vetë shqipes" dhe për këtë jepen shembujt: kombëtarizoj, shqiptarizoj. Mendojmë se favorizimi i kësaj prapashtese për shembuj të tjerë, pos atyre të pranuar në FGJSSH, nuk është i nevojshëm, sepse një funksion të tillë e kryen plotësisht prapashtesa -O-, përkatësisht ajo -ZO- e shoqëruar me mbështetësen -Ë- (-Ë/ZO-). Ndërkombëtarizmat më -ZO- në interpretim mendoj se më tepër i takojnë formimit më -O- pa zgjerim, sepse elementi -IZ-, qoftë i cilësuar edhe si infiks, i takon gjuhës dhënëse.¹¹

6. Ndonëse me origjinë dialektore formanti -CO- është i pranishëm te disa folje, fjalë këto aktive të fjalësisit të gjuhës sonë, si p.sh.: mëlçoj

(ëmbëlsoj), gurëcoj, laracoj etj. Në burime të ndryshme e në të folme dialektore ky fundor haset në numër të konsiderueshëm të foljeve. Pse ndonjë arsyeje stilistike rreth pasqyrimet të autenticitetit të mjedisit, krijimi i foljeve të reja me këtë formant nuk më duket i parapëlqyeshëm ndaj formantit -SO-.

3) Formante të tjera të diskutueshme

Formantet e këtij grupi kanë origjinë të ndryshme. Ndonjëri prej tyre, nga autorë të caktuar, edhe është cilësuar kapërcimthi si prapashtesë fjalëformuese. Në vazhdim, për secilin formant, po japim ndonjë shembull karakteristik, të shoqëruar me ndonjë të dhënë me interes.

1. Pa marrë parasysh origjinën e elementit -K- te shembujt: tfillkoj, fillkoj, gjinikoj, shoshkoj, udhako, birkoj, pastaj mukon (nga mu - mu), hejkon (nga hej - hej), çërrkoj, kilikoj etj., nga zbrëthimi i morfemave fjalëformuese del mirëfilli formanti -KO-, si prapashtesë e formuar nga prapashtesa -O- me zgjerim të elementit -K-. E. Çabej foljen dylkoj e zbrëthen dyll + KO/j.¹²

2. Te shembujt mujshej, turrshej, hershej, erëshej, dyshej, krahashoj etj. mund të diskutohet rreth origjinës së elementit -SH-, por te folësi shembujt e tillë mund të perceptohen si folje të formuara me prapashtesën -SHO-, siç është rasti: erëshej, krahashoj. Gjithsesi për këtë dukuri vlen të diskutohet.

3. Prof. I. Ajeti bashkë me prapashtesa të tjera që janë formuar "me zgjanimin" e prapashtesës -O-,¹³ shënon edhe formantin -SHTO/j. Në burime të caktuara hasim një numër të konsiderueshëm të foljeve me këtë fundor, si p.sh. kundërshtoj, mbarshtoj, këmbështoj, mundshtoj, krahishtoj, pastaj ligshtoj,¹⁴ llaqshtoj, rishtoj etj. Bashkë me origjinën e këtij formanti mund të diskutohet edhe funksioni i tij.

4. Kemi disa folje me fundorin -ÇO-, si p.sh. hapërçoj, gulçoj, grapçoj, dyllçoj, gurëçoj, ngridhçoj, grepçon e ndonjë tjetër. Gjithsesi, prania

⁹ Fonetika dhe gramatika II, Tiranë 1976.

¹⁰ Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976.

¹¹ Shih. për këtë më gjerësisht në kreun I të këtij punimi.

¹² Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore IX*, Prishtinë 1989, f. 371.

¹³ Prof. I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1965, f. 68.

Kreu III

PËRIMTIM RRETH NDËRTIMIT DHE FORMËZIMIT TË FOLJEVE MË -O- NË SHQIPE (PA - E ME ZGJERIM)

Prapashtesa -O- (*on/onj), e cila, siç është konstatuar me të drejtë nga studiuesit, pa dyshim, është ndajshtesa më aktive dhe produktive të "kategoria" e foljes ose të "klasa foljore" (prof. Eqerem Çabej, prof. A. Kostallari¹ e të tjerë), përkatësisht është "*grupi më masiv... me prodhorësi kryekëput të pakushtëzuar dhe praktikisht të pakufizuar... ose tipi strukturor më i forti në numër nga gjithë të tjerët, por edhe më me pjellori në strukturë (në diatezën veprorë e pësore)*" (prof. Selman Riza)².

Ç'është e vërteta, foljet me këtë formant që u cilësua edhe si modeli më prodhimtar i zhvilluar "nën ndikimin morfologjik, semantik e sintaksor"³ në gjuhën shqipe (L. Buxheli) ose si një kategori, klasë a nënklasë (më mirë: **tip a nëntip** strukturor),³ zënë vend kyç në sistemin foljor të gjuhës shqipe, fakt i vërtetuar ky si në planin historik, ashtu edhe në planin aktual, prandaj për foljet më -O na duket i drejtë konstatimi se mund të cilësohen edhe si një *shtyllë kurrizore e sistemit verbal të shqipes*.

Studiuesit për nga origjina këtë prapashtesë e ndërlidhin me kategorinë e foljeve me *-*anio*, të indoevropianishtes⁴, me fjalë të tjera, kjo konside-

¹ Kështu është cilësuar nga punimet e tyre nga studiuesit E. Çabej, A. Kostallari e të tjerë.

² Prof. Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1989.

³ Shih lidhur me këtë: *Gramatika e gjuhës shqipe (morfologjia)*, Tiranë 1985, f. 59 e 280.

⁴ Prof. Shaban Demiraj te *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, f. 765 konstaton se në polemikë me shkencëtarë të tjerë H. Pedersen i ka theksuar se nuk ka një bazë për të vënë në dyshim karakterin thjesht shqiptar të mbaresës -ONJ, ndeshje e saj e shpeshtë në hua-

rohet si një prapashtesë autoktone e sistemit foljor të shqipes dhe, siç e theksojnë veçan prof. Sh. Demiraj, në shqipe kjo del, jo vetëm si element i veçueshëm, por "edhe si element i paveqeshëm në temat e disa foljeve"⁵ të gjuhës sonë.

Pikërisht, pra, këto dy veçori të formantit **-O-**: *si element i paveqeshëm* (kuptohet si prapashtesë temëformuese) dhe *sidomos si element i veçueshëm* (si prapashtesë fjalëformuese) që del dy trajtash: edhe *pa zgjerim* edhe *me zgjerim*, do të trajtohen mjaft gjerësisht në këtë kapitull të këtij punimi. Mirëpo, para se të kalohet në analizë më të hollësishme, sipas dy nënkrerëve përkatës rreth raportit të termave: *temë prodhuese/formant fjalëformues*, do ta kemi parasysh konstatimin që jep prof. Jani Thomai lidhur me këtë realie. Ai shpjegon se "në njësitë leksikore del se në aspektin emërtues kuptimi i temës prodhuese është më thelbësor, kurse në aspektin "komunikativ" është kuptimi i formantit më thelbësor". Në të vërtetë, siç shpjegon po ky autor, që të dyja këto elemente "te bërthamat e fjalës (...) njëkohësisht lidhen, ndërthuren, ndikojnë mbi njëra-tjetrën, plotësojnë njëra tjetrën, kundërvihen në funksione dhe shtrihen në njësitë e vetme leksiko-semantike", mirëpo, sidoqoftë, "thelbin semantik e përbën tema prodhuese, kurse formanti sjell kryesisht modifikime (të shumëfishta a të pjeshme), si modifikime kuptimore, kategoriale, gramatikore e "predikative".⁶

Prandaj, në rastin tonë, që të dyja këto komponente do të kihet parasysh. Ndajshitesat fjalëformuese, kryesisht prapashtesat, si "elemente të kuptimshme të fjalës"⁷ do të trajtohen domosdo në lidhshmëri me temat prodhuese (duke pasur parasysh patjetër formën funksionin dhe kuptimin e tyre gramatikor e semantik) dhe kjo, praktikisht, do të bëhet si vijon:

së pari, do të trajtohen foljet e parme me prapashtesën **-O-** pa zgjerim, kur **-O-**ja del, në mjaft raste, si element i paveqeshëm (prapashtesë temëformuese), në një të anë, d.m.th. folja del pa temë të qartë prodhuese motivuese, por edhe në numër më të madh rastesh ajo del si element i veçueshëm (si prapashtesë fjalëformuese), në anën tjetër, d.m.th. folja del me temë të qartë prodhuese motivuese dhe

zimet latine nuk provon asgjë (...) shqipja -ONJ buron nga një -ANIO dhe lidhet me formimet e së tashmes indoevropiane në hundore".

⁵ Po aty, f. 764.

⁶ Jani Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë 1989, f. 235.

⁷ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (1976) f. 198.

së dyti, do të trajtohen foljet me prapashtesa **-O-** me zgjerim, d.m.th. kur ajo përveç temës së qartë fjalëformuese merr patjetër një element mbështetës si ndërshtesë a një *tingull a gruptingujshi ndërhyrës*, siç e quan prof. S. Riza, që në këtë punim këto formante u quajtën "prapashtesa **-O-** me zgjerim", të cilat, siç është sqaruar më përpara, i ndamë në tri grupe: a) prapashtesa të mirëfillta, b) prapashtesa (si) variante dhe c) si formante të tjera të diskutueshme.⁸

⁸ Shih te kreu II i këtij punimi.

(1). FOLJET E PREJARDHURA ME PRAPASHTESËN -O- PA ZGJERIM

Në përputhje me sa u tha pak më sipër, për lehtësi qasjeje, foljet më -O- pa zgjerim i ndamë, pra, në dy grupe:

1) në grupin e parë, foljet e parme ose foljet më -O- me temë jo të qartë prodhuese (fjalëformuese) dhe

2) në grupin e dytë foljet e prejardhura më -O- me temë të qartë a të zbërthyeshme fjalëformuese, ku po fusim edhe grupin e foljeve të formuara kryesisht mbi temë mbiemërore, përkatësisht ato nën ndikimin e participit latin.

1) Foljet më -O- me temë jo të qartë fjalëformuese

Të gjitha foljet më -O- me temë jo të qartë fjalëformuese (ose folje më -O- temëformuese), si fjalë të parme, duke u nisur nga gjendja e sotme e leksikut të shqipës letrare, mund t'i ndajmë në dy nëngrupe: a) ato me origjinë anase dhe b) ato të huazuara, por që i janë përshtatur sistemit morfologjik të shqipës.

a) Lidhur me foljet e nëngrupit të parë del çështja e shpjegimit të formantit fundor -O- si prapashtesë temëformuese. Ky formant në krye të herës, së paku për ndonjë shembull, mbase mund të ketë qenë prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese, por në gjendjen e sotme ajo nuk ndihet si e tillë, pasi fjalë-folja e caktuar, për nga ndërtimi është e pazbërthyeshme, së paku kështu duket në gjendjen e sotme. Ja disa shembuj: shkoj (= eci rrugës), behdoj, mësoj, bulmoj, koj, pushoj, shtoj, shtroj, mëtoj, fitoj etj. Foljet e këtij nëngrupi dalin në numër të kufizuar, ndonëse janë mjaft aktive në komunikim të përditshëm në gjuhën tonë.

b) Foljet e nëngrupit të dytë, d.m.th. foljet më -O- pa zgjerim me origjinë të huaj janë në numër më të madh, siç është vërejtur edhe nga Kristian Monteku, i cili konstaton se "*një pjesë e mirë e foljeve (tri të katërtat) që kanë prejardhje nga huazimet ... i nënshtrohen asimilimit në shqipe*", pikërisht duke u futur në "*modelin e zgjedhimit më të thjeshtë dhe më të*

*rregullt, atë të foljeve më -O-.*⁹ Dihet se fjalët e huazuara më tepër i takojnë stilit libror, siç janë p.sh. huazimet: evokoj (= kujtoj të kaluarën), abdikoj, abuzoj, aderoj, asimiltoj, dedikoj, deklamoj, dirigjoj, eksploroj, denoncoj, ekzistoj, emetoj, kompiloj, konstatoj, debutoj, infektoj, falimentoj, diskretoj, konkurroj, pretendoj, mitraloj, furnizoj, improvizoj, incizoj, amorigizoj, sintetizoj, rekuizoj etj. Shumica e trajtave të lartcekura vijnë nga gjuhët romane, përkatësisht ato neolatine, por edhe nga gjuhë të tjera. Nuk është pa interes të dallohen huazimet, qoftë nga latinishtja letrare, qoftë nga ajo vulgare, të cilat në mjaft raste gjejnë mbështetje edhe në italishten e sotme. Lidhur me këtë mjafton të krahasohen vetëm këta shembuj: *këndo*/me këndue kënduar: lat. cantare, *lëvdoj*/me lëvdue lëvduar: *këndo*/me këndue kënduar: lat. cantare, *lëvdoj*/me lëvdue lëvduar: lat. laudare, *kërkoj*/me kërkue kërkuar: lat. cercare, *pësoj*/me pësue pësuar: lat. patire etj. (huazime të hershme), përkatësisht *axhustoj* me axhustue axhustuar: it. aggiustare, *montoj* me montue montuar: it. montare (huazime të mëvonshme) etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm, sidomos nga huazimet e mëvonshme, rastet e tilla mund të quhen edhe si huazime hibride pjesërisht, themi kështu, ngase është huazuar tërë fjalë-tema nga gjuha e huaj, por formantit fundor a mbareta e foljes së gjuhës përkatëse, më drejt të infinitivit të gjuhës së huaj automatikisht është zëvendësuar me barasvlerësin përkatës konkretisht, me prapashtesën -*Oj* (-*ua*/*j*) të gjuhës sonë, prapashtesë kjo që motivon fjalë-foljen e ashtuquajtur me "rrënjë të lidhur", pasi në këto raste tema fjalëformuese nuk motivon drejtpërdrejt semantikisht.

Në kuadër të këtij nëngrupi del i veçuar edhe nëntipi i foljeve të huazuara me infiksat: -*ifik*-, -*iz*-, atiz-, -*ir*-.

a) Me elementin infiksor -*ifik*-: -*ifik*-/*Oj* tipi kodifikoj dalin disa folje të huazuara në shqipe. Siç po shihet nga shembulli i mësipër, para prapashtesës -O- del infiksi -*IFTK*-, i cili duket qartë edhe të shembujt: gazifikoj, elektrifikoj, falsifikoj, modifikoj, verifikoj, sakrifikoj, lubrifikoj, verifikoj, mistifikoj, koksifikoj etj. Edhe në gjuhën italiane b.f. del po ashtu infiksi i tillë, si p.sh.: shq. elektrifikoj - it. elettrificare, fr. électrifier. Po kështu pasqyrohet barasvlerësia edhe të shembujt e tjerë. Numri i foljeve të tilla në gjuhën tonë nuk është i madh. Është e vërtetë se mbi këtë bazë në shumë raste procesi teknologjik shprehet me barasvlerësin tjetër para-

⁹ Kristian Monteku, *Gjuha jonë 3-4/99*, Tiranë 1999, f. 93.

si të themi, numri i tyre del me mundësi të pakufizuar shumimi, siç e cek edhe prof. S. Riza.

Edhe foljet me temë të qartë motivuese mund t'i ndajmë në dy grupe. Në grupin e parë do të radhisim ato folje që kanë si temë fjalëformuese një fjalë-temë të fondit aktiv autokton ose të përvetësuar me kohë brenda fjalësit të gjuhës shqipe, ndërsa në grupin e dytë përfshihen ato folje që kanë për temë fjalëformuese një fjalë të huazuar nga një gjuhë e huaj, e cila zakonisht e ka cilësinë e fjalës ndërkombëtare.¹³

Grupi i parë i foljeve, d.m.th. i foljeve më -Oj mbi fjalë-temën shqipe a të përvetësuar qysh herët si të tillë, përfshin një numër të konsiderueshëm foljesh. Prireja që mbi fjalë-temat e shqipes të përftohen folje -O- me zgjerim në mjaft raste del më e fortë, se përfitimet drejtpërdrejt me prapashitesën -O- pa zgjerim që mund të jetë tema: emër, mbiemër, ndaj-folje, folje etj. Sa për ilustrim po i shënojmë disa shembuj, si p.sh.: mendoj (mend)/, ajktoj (ajkë), arsimoj (arsim), cuboj (cub), baltoj (baltë), luftoj (luftë), fluturoj (flutur), breshëroj (breshër), flluskoj (flluskë), shpejtoj (shpejt), humboj (humb), pohoj (po-po) etj. Po kështu në jetën e përditshme, sidomos në stilin poetik ndeshim mjaft përfitime të reja, d.m.th. të foljeve më -Oj në mbështetje, pothuajse, të çdo pjese të ligjëratës si p.sh.: tatimoj (tatim // *tatoj), frymjoj (frymë), dittoj (ditë), miroj (mirë), hundoj (hundë), ehjoj (eh- i si pasthirrme) etj., ndonëse edhe në këso përfitimesh s' duhen bërë teprime.

b) Po i shënojmë disa shembuj nga grupi i parë, duke i ndarë në katër nëngrupe sipas veçorisë së temës prodhuese që kanë, p.sh.:

- muzikoj (= bëj muzikë), rehatoj, sakatoj, sahatoj, batalloj, beharoj, hallalloj, hendekoj, kamxhikoj, (turq. kamçi), pastaj: abstraktoj, aktivoj, ambientoj, acidoj, akordoj, ambalazhoj, kapeltoj, argumentoj, apostrofoj, interpretoj, kodoj, fermentoj, debitoj, bojkotoj, komandoj, konceptoj, konspiktoj, kontrakttoj, protestoj, patrolloj, avancoj, stenografoj, sulfuroj, telefonoj, titulloj, torturoj, pompoj, protestoj, referoj, pilottoj, protokolloj, doganoj, kazermoj, katranoj etj., sigurisht dallimi i temës së caktuar prodhuese del shumë i qartë, si p.sh.: muzik(ë) muzik/Oj, hendek hendek/Oj etj.;

- arbitroj (= ndërmjetësoj si arbitër, bëj punë arbitri), kadastroj (kadast(ë)r+OJ), kronometroj, kalibroj, pudroj, shifroj, centroj etj., ku edhe

¹³ Çdo fjalë të huazuar e pranuar për nevojë në shqipe mund të quhet fjalë ndërkombëtare, por secila prej tyre nuk mund ta ketë cilësinë e ndërkombëtarizmit.

pse ndodh njëfarë modifikimi i qartë së temës nga E-ja e zhdukshme, megjithatë ajo mbetet gjithsesi e trajtë, si p.sh.: kadastër kadast/r/Oj, shifër shif/r/Oj etj.;

- emocionoj(= i ngjall dikuj emocione), funksionoj (funsion+Oj), seleksionoj, revolucionoj, racionoj, variacionoj, subvencionoj, pasionoj, staxhionoj, pensionoj, asociacionoj etj., fjalë këto me cilësi ndërkombëtarizmi me formantin -ION fundor;

- drenazhoj (= bëj drenazh) e drenoj (= bëj drenime), patinazhoj e patinuj, montazhoj e montoj etj. si trajta paralele këto që shërbejnë të dyja për formimin e foljeve më -Oj në shqipe, e para zakonisht mbi emrin përkatës me -AZH fundor, ndërsa trajta e dytë, qoftë nga emri si patinë, qoftë, aq më tepër si temë e foljes që në gjuhët përkatëse, merr prapashitesën a mbaresën përkatëse, siç u përmend në nëntitullin e mëparshëm.

Ky proces, siç është sqaruar në kreun e parë të këtij punimi, del edhe më qartë te shembujt e tipit: it. paralizzare, fr. paralyser – shq. paralizoj (paralizë); it. elettrolizzare, fr. electrolyser - elektrozioj (elektrolizë), shembuj këta të cilët mund shpjegohen, pra, dymënyrësh, së pari, si formime nga infinitivi i gjuhës përkatëse dhe së dyti, si formime vendëse të formuara në mbështetje të temës së qartë fjalëformuese, siç janë b.f. emrat e huazuar: paralizë, elektrolizë etj. Kur cilësohen kështu, d.m.th. sipas mënyrës së dytë, foljet e tilla në shqipe merendohen në grupin e foljeve me temë të qartë fjalëformuese. Mirëpo sipas zbërthimit folja përkatëse del se bën pjesë bashkë me foljet e tjera të huazuara. Kjo çështje shihet edhe te disa shembujt të tjerë që vetëm tërthorazi nënkuptohet ndërkombëtarizma përkatëse e huazuar në shqipe. Për këto çështje që u cekën edhe në kërretë e më parshëm do të bëhet pak fjalë edhe në pjesën e nënkruar vijues, te nëntipi i foljeve: kimizoj, ekonomizoj, simpatizoj etj. Sidoqoftë, edhe ky nëngrup foljesh, siç u tha, mund të zbërthet, pra, edhe nga fjalë-tema emërore a mbiemërore përkatëse e huazuar në shqipe, plus prapashitesa vendëse -Oj.

Nga shembujt e mësipërm mund të nxirret i drejtë konstatimi, që është cekur edhe më përpara, se, pothuajse, çdo fjalë kuptimlode (emër, mbiemër a ndajfolje) e huazuar në shqipe, po që nevoja, mund të shërbejë si temë fjalëformuese për formimin e foljeve përkatëse me prapashitesën -O-, pavarësisht nga fakti se edhe në gjuhë të tjera ndërtimi i tyre mund

10. korrektoj (me korrekture, korrektuar): /lat. corrigere, correctum; serbokr. korigirati; gjerm. korigieren, fr. corriger, it. correggere (shqip edhe: koriggjio me koriggjue)/.

11. konstruktoj (me konstruktue, konstruktuar): /lat. construere, constructum; serbokr. konstruisati, konstruirati; gjerm. konstruieren; angl. (to) construct; fr. construire/.

12. korruptoj (me korruptue, korruptuar): /lat. corrumpere, corruptum; serbokr. korumpirati; it. corrompere/.

13. kontrakttoj (me kontraktue, kontraktuar): /lat. contrahere, contractum; serbokr. kontrahirati; it. contrattare; fr. contracter/.

14. depozittoj (me depozitue, depozituar): /lat. deponere, depositum; serbokr. deponirati; gjerm. deponieren; fr. deposer/.

15. projekttoj (me projektue, projektuar): /lat. proicere, projectum; serbokr. projicirati, projektirati; gjerm. projektieren/.

16. indukttoj (me induktue, induktuar): /lat. inducere, inductus; serbokr. inducirati, indukovati; gjerm. induzieren; fr. induire; angl. (to) induce, it. indurre/ etj.

Pra, siç po shihet nga shembujt e mësipërm, trajtat e normëzuara foljore të gjuhës shqipe, të cilat i ndeshim të regjistruara në fjalorin drejtshkrimor si dhe në fjalorin tonë normëzues përshkruess, në shumicën e rasteve ndryshojnë për nga tema fjalëformuese, në krahasim me zgjidhjet e përvetësuara në gjuhë të tjera, tema prodhuese e të cilave mbështetet zakonisht në infinitivin e gjuhës latine, kurse këto të shqipes nuk janë të ndikuara nga një temë e tillë, por, siç u tha, nga participi, përkatësisht participori i caktuar.

Pasi nuk kam hasur në ndonjë burim që e trajton më në hollësi këtë çështje do të mbështetemi në konstatimin e akad. Idriz Ajetit, i cili në artikullin "Për përdorimin e drejtë të disa trajtave foljore" të botuar edhe të "Studime gjuhësore..."¹⁵, cek dy folje të kësaj kategorie: **konceptoj** (koncipoj) dhe **krematoj** (kremoj), duke na e tërhequr vërejtjen si vijon:

"Tash sa kohë të "Rilindja", në emisionet televizive e në publicistiken tonë ka zënë të qesë krye dhe të lëshojë rrënjë një prirje përdorimi të fjalëve të huaja që thejnë praktikën e përshtatjes së leksikut të huaj në shqipe. Nga folja e latinishtes koncipie, concipere, concépi conceptum, serbk.

¹⁵ Dr. Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes III*, Prishtinë 1985.

koncipirati dhe conceptirati, shqip në kundërshtim me praktikën e derisotme, po del në shtypin tonë, në emisionet televizive dhe gjetkë, nën ndikimin e serbokroatishtes koncipoj, concipuar, në vend se të ndiqet rruga e mëparshme duke u marrë tema e participi latin conceptum dhe concept e të formohet trajta konceptoj, conceptuar. Në këso lloj punësh, përveç tjerash, do të mbahet parasysh edhe lehtëshqiptimi i ndonjë fjale të huaj. Ç'është e vërteta, forma konceptoj, conceptuar del shumë më e lehtë për t'u shqiptuar sesa koncipoj, concipuar..."¹⁶

Duke kërkuar që të mbahet e gjallë kërshëria rreth përbajtjes së fragmentit të mësipërm, po paraqisim edhe fragmentin tjetër, tash lidhur me foljen "krematoj (kremoj)":

"Ka sa kohë që në shkrimet tona ka zënë të shfaqet: u kremua trupi NN duke ndjekur analogjinë e serbokroatishtes: kremiran, kremirati, e kjo nga baza latine cremo, cremare, cremavi, crematum me kuptimin digjet trupi i njeriut në furrë të posaçme; ka pastaj në këtë gjuhë kremacija (lat. crematio) si dhe krematorium (crematorium). Në qoftë se dikush vendos të përdorë (edhe këtu do masë) këtë togfjalësh, do të mbështetet e tema latine e participi crematum sikurse pamë të rasti conceptum, pra u krematua... sepse u kremua mund të ngatërrohen me krem, përveç tjerash".¹⁷

Pra, siç po shihet nga dy sekuenat e mësipërme, prof. I. Ajeti parapëlqen (rekomandon) trajtën **krematoj**, **krematohet** e jo atë **kremoj**, **kremohet**, përkatësisht në rastin tjetër parapëlqen trajtën e normëzuar **konceptoj**, **konceptohet** e jo **koncipoj** **koncipohet**.

Nga kjo ndërhyrje e prof. I. Ajetit, edhe pse cekën vetëm dy raste (trajta foljore): **konceptoj**, që është edhe në FGJSSH dhe **krematoj**, që është fjalë "e re", e farkëtuar sipas modelit të "praktikës së përshtatjes të leksikut të huaj", siç e cek autori, do të mund të nxjerrim këto përfundime me interes për temën në shqyrtim:

E para, reflektimi i trajtave foljore të shqipes të sipërsënuara në këtë trajtesë është mbështetur në participin e latinishtes e jo në infinitivin e asaj gjuhe, edhe pse pikërisht në infinitivin latin gjejnë mbështetje shumica e rasteve të gjuhëve të tjera e, ndër to, me sa dimë sidomos kjo praktikë del më e dalluar në gjuhën gjermane si dhe në atë serbokroate.

¹⁶ Po aty, f. 72.

¹⁷ Po aty, f. 75.

E dyta, mund të supozohet se "praktikën" e tillë të mbështetjes së foljeve të gjuhës sonë në trajtën shkimore të participit latin, e ka ndihmuar dhe e ndihmon pikërisht trajta prejparticipore (mbiemërore a emërore) e latinishtes, që është potthuajse e njëtrajtshme në atë gjuhë me participin dhe se pikërisht në këtë trajtë a njësi leksiko-gramatikore është pasqyruar si ndërkombëtarizëm edhe në gjuhë të tjera, siç është b.f. shembulli *koncept* (nga *conceptum*), që e vëren dhe e merr si shembull ilustrues autori.

E treta, edhe pse nuk është fakt i dorës së parë, mund të thuhet se një trajtë të tillë foljore në gjuhën tonë do ta ketë ndihmuar edhe "lehtëshqiptimi", siç e cek autori për trajtën *konceptoj* ndaj asaj *koncipoj*. Sigurisht këtu autori do të ketë pasur parasysh prirjen e gjuhës sonë që të ruajë elementin -T- fundor në mjaft raste, madje ky element, siç dihet, paraqitet edhe si një mjet ose si element mbështetës i prapashtesës -O- me zgjerim në disa raste, duke anashkalluar formimin e shkallës së parë të foljeve më -O- pa zgjerim. Kështu, sipas konceptit të sotëm, kjo shihet qartë pikërisht në përfitim e foljeve në nëntipin, si: dëmtoj, coptoj, oborrtjo etj., ku elementi -T- i bashkohet prapashtesë -mbaresës foljore -O/je dhe kështu formon prapashtesën -TO-je. Në të vërtetë, për rastin konkret mendoj se "lehtëshqiptimin" e ndihmon, a e ka ndihmuar pikërisht fjala e qartë e përkapur, e cila edhe shërben si temë motivuese për foljen e caktuar: **koncept-i** + oj - konceptoj, mirëpo edhe ndikimi i modelit fjalëformues me prapashtesën foljore -TO- asociacionisht, asesi s'bën të mohohet (Rikujto edhe një herë nëntipin: dëmtoj, tregtoj, arsyetoj).

Në gjuhën tonë, pra, për përfitim e trajtave foljore objekt shqyrtimi këtu, përveç participit latin e ka motivuar edhe emri a mbiemri prejpjesor, jo vetëm i gjuhës latine, por edhe i ndonjë gjuhe tjetër dhënëse, ku emri a mbiemri i caktuar me cilësinë e fjalës ndërkombëtare, është përvësuar që me kohë në atë gjuhë, ashtu siç ka ngjarë edhe në gjuhën tonë, prandaj padyshim fjalë-tema e tillë mund të shërbejë edhe si temë motivuese për krijimin e foljeve të caktuara më -O-. Gjithashtu tërthorazi qëndrueshmëria e trajtave të tilla në gjuhën tonë, siç u tha, ndihmohet edhe nga vetë modeli fjalëformues i sistemit foljor të shqipës, duke pasur parasysh formimin e foljeve me prapashtesën -TO/je.

Mirëpo në këtë kontekst nuk del gjithçka kuptueshëm. P.sh. te foljet induktoj, deduktoj, reduktoj etj. mbiemri i gjuhës latine (*induct/us, deduct/um* ose *reduct/us*) nuk del qartë, sidomos sa i përket gjuhës sonë letrare sot, por, megjithatë, folja ka prirje të formohet mbi bazë të participit. Lidhur me këtë mund të supozohet se vetë procesi i interferencës fjalëformuese në raportin *particip / mbiemër a emër prejpjesor* etj., që sigurisht meriton të sqarohet nga specialistët edhe më në hollësi, do të ketë ndikuar në dhënie ose stabilizimin e temës "foljeformuese", siç dalin aktualisht rastet e lartpërmendura në gjuhën tonë. Me fjalë të tjera, mbiemri *induktiv*, emrat *induktor* (aparati), *induksion* (krahaso: lat. *inductio/onis*) etj., mund të kenë dozë ndikimi për parapëlqimin a stabilizimin, b. f., të trajtës foljore induktoj në gjuhën tonë, pra tema: *indukt + prapashtesë- mbaresa -o/je*, prej nga del normalisht induktoj (me induktue, induktuar).

Shikuar sipas gjendjes së sotme të sistemit fjalëformues foljor të gjuhës sonë, atëherë në rastet si *koncept - konceptoj*, *projekt - projektoj*, *konstrukt - konstruktoj*, *abstrakt - abstraktoj*, *korrekt - korrektjo*, *depozit - depozitajo* etj., vetë tema motivuese i bën të qëndrueshme trajtat foljore si më sipër.¹⁸

U tha pak përpara se lidhur me drejtshkrimin, përkatësisht foljeformimin e trajtave në fjalë, sidomos ndër ne, paraqiten lëndunde ose shmangie nga norma. Sa për ilustrim do të cek vetëm disa shembuj të nxjerrë nga burimet tona të caktuara të ditës, por, siç e kam vërejtur në kohë të fundit, ishin prezente në raste edhe në burime të caktuara që po botohen në Shqipëri e gjetiu:

1) a) **abstragoj** (në vend abstraktoj): "Përparimi" nr. 6/83 f.16; FESH L f. 494 f.42, 43¹⁹; "Jeta e re" nr.1/84 f. 234; FSHF (Kokona) f. 15²⁰;

¹⁸ Del e nevojshme të përmendet edhe një fakt që nuk është i panjohur në gjuhësinë tonë. Dihet si në planin historik ashtu dhe në atë aktual, me rastin e huazimit të fjalëve mbi bazë latine (emra a mbiemra prejpjesorë), formanti fundor -UM, përkatësisht -US, (-IS) etj. i latinishtes bie ashtu siç ngjan edhe në disa gjuhë të tjera. Kjo zhdukje e formantit në fjalë në shqipë shihet qartë sidomos në disa huazime të hershme, si p.sh: *canis - qen, gailus - gjall, pastaj* edhe në disa huazime më të vona, si p.sh.: *actum - akt, instrumentum - instrument, adjectivum - adjektiv, abstracum - abstrakt etj., përkatësisht acidus - acid, abortus - abort, absolutus - absolut, defectus - defekt, concursus - konkurs, contactus - kontakt etj.*

¹⁹ Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit, Prishtinë 1984, f.484, 42, 43.

²⁰ V. Kokona, Fjalor shqip-frëngjisht, Tiranë 1977, f. 15.

FISH (H.Voci) f.41²¹; Gazeta "Bujku", 20. III. 1995 f.9 - gjithashtu e hasim edhe në veprat e Çabejt, R. Ismajlit, E. Sedajt etj.

Siç mund të shihet nga shembulli përkatës, vetëm në rusishte është i reflektuar elementi -G- për -H-në latine.

b) **abstrakoj** (në vend abstraktoj): "Dituria" nr. 1-2/85 f.210; FELSH f.263; "Fjala" nr. 16/85 f.12; nr. 9/86 f.14; "Zëri", 3. II. 1994 f.24; "Rilindja" dt. 13.II.1986 f.10; dt.3.V.1985 f.15; dt. 18.IX.1985 f.2; dt. 15.II.1985 f.16; dt. 16.II.1985 f.5; dt. 14.II.87 f.12; dt. 12.VIII.1987 f.5 etj.

Në rastet e mësipërme kemi zhdukjen e -T-së fundore para prapashitesës foljore -OJ/.

c) **abstrahoj** (për abstraktoj): "Rilindja" dt. 9.XI.1985, f.13; dt. 27.II.1986 f.4 etj., "Zëri", 26. I. 1995 f.8; 25. II. 1995 f.20; "Forum", 17. I. 1994 f.17; "Koha", 5. x. 1994 f.31; gazeta "Bujku" 6. XII. 1994 f.9 etj.

Sigurisht në këto raste shihet ndikimi i trajtës së infinitivit latin, përkatësisht atij të gjuhës serbokroate te disa autorë të ne.

Që të tria trajtat, pra, *abstragoj*, *abstrakoj* dhe *abstrahoj* në shqipë bien ndesh me normën e sotme letrare, ndonëse herë pas herë kështu në kundërshtim me normën kemi raste t'i ndeshim jo vetëm në gjuhën e shtypit, por edhe në punime shkencore.

2) Në vend të trajtës së drejtë të shënuar në kllapa hasim b. f.:

- transkriboj (transkriptoj): "Përparimi" nr. 6/83 f.846; FLSH f.529; "Rilindja" dt. 1.IX.1984 f.14 etj.

- koncipoj (konceptoj); "Rilindja" dt.10.I.1985 f.16; 14.I. 1985 f.7; 7.II.1985 f.20; 28.XI.1986 f.12 etj.

- korrumpoj (korruptoj): FLSH f.110²² etj.

3) Nuk janë të rralla edhe rastet si: konspicoj, në vend konspektoj; percipoj për perceptoj; dedukoj për deduktoj; reduktoj për reduktoj; induktoj për induktoj; konstruoj për konstruktoj etj.

Lidhur me trajtat e mësipërme duhen konstatuar këto tri gjëra:

E para, kështu mund të jenë përdorur foljet përkatëse nga autorët e caktuar para se të bëhej njëzimi i drejtshkrimit të gjuhës sonë, prandaj ashtu edhe i hasim të përdorura sot, nga individë të caktuar, si me thënë,

²¹ H. Voci, *Fjalor italisht-shqip*, Tiranë 1971, f. 41.

²² *Fjalor latinisht-shqip* (H. Laca - F. Fishta), Prishtinë 1980, f.529.

nën ndikim të drejtpërdrejtë gjatë konsultimit të veprave të tyre, prandaj në rastet e tilla kemi të bëjmë me respektimin e traditës së tillë.

E dyta, nuk janë të rralla rastet kur përkthyesi i papërvojë ose njohësi jo i mirë i normës a i kulturës sonë gjuhësore, duke mos e njohur trajtën e caktuar të sanksionuar, i ndikuar drejtpërdrejt nga trajta foljore e gjuhës së huaj, bën shkarje drejtshkrimore a fjalëformuese, dukuri kjo që është mjaft e pranishme te ne edhe sot e gjithë ditën.

E treta, kemi raste kur autorët e caktuar me vetëdije e përdorin trajtën e caktuar jo sipas normës së sotme letrare, por ndryshe, ngase ashtu mendojnë se është më drejt, duke e pasur për mbështetje pikërisht infinitivin e gjuhës latine, ashtu siç është praktikuar në gjuhë të tjera dhe siç praktikohet edhe në gjuhën tonë për një seri rastesh të tjera si p.sh. kompiloj (Krahaso: lat. compilare, compilatum; serbokr. kompilirati, kompilovati), komplikoj (lat. complicare, complicatum; serbokr. komplicirati, komplikovati), simuloj (lat. simulare, sumulatum; serbokr. similirati, simulisati) etj.

Sidoqoftë, pa marrë parasysh arsyet e mësipërme dhe respektin që kemi ndaj autorëve të caktuar, mendoj se është detyrë jona të respektojmë trajtat e standardizuara, pra, t'i drejtshkruajmë foljet ashtu siç dalin të porositura nga burimet tona normative kompetente: FDGJSH dhe FGJSSH.²³

Nga lënda e shtuar në këtë kompleks imponohen mjaft çështje, për zgjidhjen e të cilave duhen angazhuar specialistë të degëve të caktuara.

Në vazhdim do të mjaftohem duke sjellë edhe ndonjë shembull që na zgjon kureshtjen dhe që kuadrat tanë kompetentë duhet t'i kenë parasysh e t'i kristalizojnë duke marrë qëndrimin përkatës se si është më së miri të veprohet.

Të vihet re se b.f. për fjalën latine corrigere në shqip kemi dy trajta foljore me vështirime të ndryshme: korrigjoj dhe korrektoj, e para del nga infinitivi i latinishtes (italishtes), kurse trajta e dytë nga tema motivuese: mbiemri *korrekt*, përkatësisht nga participi *correctum* i latinishtes.

Në të mirë të supozimit të respektimit të temës motivuese, si kritere në gjuhën shqipe del edhe ndonjë trajtë foljore në gjuhë të tjera, siç janë fjalët: **karikaturë** dhe ajo **propagandë**:

²³ Shih *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1976 dhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.

a) Në shqipe, mbi bazë të emrit *karikaturë*, kanë dalë trajtat foljore: karikaturoj dhe karikaturoz, por e ndeshim mjaft dendur edhe në trajtën *karikoj*.²⁴ Trajta e fundit *karikoj*, siç u tha del nën ndikim të drejtpërdrejtë nga gjuhët e huaja, si p.sh. serb. *karikirati*, it. *caricare* (lat. *caricare*), gjerm. *karikieren*, mirëpo në serb. del edhe *karikaturisati*, fr. *caricaturer* (karikaturoj).

b) Lidhur me fjalën *propagandë* në shqipe del folja propagandoj (me propagandue, propaganduar) si trajtë e normëzuar, por në raste mjaft të shpeshta del edhe propagoj.²⁵ Trajta propagoj vjen nën ndikimin e trajtave të gjuhëve të huaja, si p.sh. it. *propagare* (lat. *propagare* *propagatum*), fr. *propager*, gjerm. *propagieren*, serb. *propagirati* e *propagovati* etj. Mirëpo edhe në italishte del trajta *propagandare*, angl. (to) *propagandize* (propagandoj me propagandue).

Gjithsesi kur kemi parasysh faktin se me trajtat *karikoj*, *propagoj*, nuk shprehet asnjë koncept tjetër, pos atij që mbulohet me *karikaturoj*, *propagandoj*, atëherë trajtat e tilla duhen trajtuar si lajthitje dhe nuk duhen përdorur, ngase trajtat e normëzuara edhe kanë mbështetje në fjalë-temën e qartë fjalëformuese. Po kështu duhet të veprohet, pa ngurrim, edhe në rastet e tjera si p.sh. konceptoj, konstruktoj etj., të cilat edhe mund të përkohet edhe me trajtat e gjuhëve të tjera, si p.sh. serbokr. *konceptirati* (konceptoj), angl. (to) *construct* (konstruktoj); fr. *contracter* (kontraktoj) etj. Kështu pra, siç po shihet, edhe në ato gjuhë bëhet thyerje e praktikës lidhur me përfitimën e foljes së caktuar vetëm mbi bazë të infinitivit të latinishtes. Në këtë grup foljesh do të hynin edhe foljet si kompletj (FSHSH 1981 f. 443)²⁶/lat. *complere*, *completum* serbokr. *kompletirati*; kreditj (FSKSH 1981 f. 459)²⁷/lat. *credere*, *creditum*, serbokr. *kreditirati* e *kreditovati*/; receptoj /lat. *recipere*, *receptum*, serbokr. *receptirati*/ etj.

Edhe pse mbetet çështje e hapur rreth mënyrës se cila trajtë duhet favorizuar në shqipe për rastet e papërfshira në FGJSSH, d.m.th. në infinitivin latin ose në participin, përkatësisht mbështetjen në njësinë përkatëse leksiko-gramatikore të prapjesores së pranuar si ndërkombëtarizëm,

²⁴ Trajtën *karikoj* në vend *karikaturoj* a *karikaturoz* shih edhe te *Fjala* nr. 20/86 f.3; *Koha*, 2. III. 1995, f. 25 etj.

²⁵ Trajtën *propagoj* e ndeshim edhe te *Përparimi* nr. 8/85 f. 21, *Fjala* nr. 8/87 f. 3; *Koha*, 22. II. 1995, f. 31; 1. III. 1995, f. 41; *Bujku*, 20. III. 1995, f. 4 etj.

²⁶ *Fjalori shqip-serbokroatisht*, 1981, f. 443.

²⁷ Po aty, f. 459.

lidhur me këtë mendoj se del e nevojshme të jepet ndonjë sugjerim së paku parimor mbi bazë të lëndës që na imponohet.

Çështje e vërteta, për shumë raste të reja duhet të zbatohet "praktika e përshtatjes së leksikut", siç e thekson prof. Idriz Ajeti në artikullin që e përmendëm më sipër, ku bëhej fjalë për foljen krematoj (lat. *cremare*, *crematum*). Po kështu pra mund të veprohet për shembujt si kreatorj, lat. *creire*, *creatum*, serbokr. *kreirati*), ekstraktj nga ekstrakt (lat. *ecstrahere*, *ecstrahere*; serbokr. *ekstrahirati*), adskriptj (lat. *adscribere*, serbokr. *adskribirati*), proskriptj (lat. *proscribere*, serbokr. *proskribirati*), oponentj (lat. *opponere*, serbokr; *oponirati*), supletj a suplementoj (lat. *suplere*; serbokr. *suplirati*), konstitutj (lat. *constituere*; serbokr. *konstituirati*), ndonjë ndër ne po praktikohet trajta konstituoj (=kushtetj!) etj.

Më sipër u cekën vetëm disa nga trajtat foljore të diskutueshme me të cilat po ballafaqohemi në jetën tonë të përditshme, por dihet, ç'është e vërteta, se numri i tyre është shumë më i madh. Gjithsesi mendoj se trajtat e propozuara mund të shërbejnë, siç u tha, edhe si zgjidhje parimore, sepse, konkretisht, siç dihet, për disa nga kuptimet e foljeve të sipërcëkuara të latinishtes ose të serbokroatishtes, ashtu si edhe të gjuhëve të tjera, sipas kontekstit duhen kërkuar barasvlerësit përkatës nga fondi aktiv i fjalësisit të shqipes, me të cilat mbulohet, qoftë plotësisht, qoftë njëherë për një herë pjesërisht, nënfusha kuptimore e kërkuar sipas stileve të caktuara funksionale.

Në vazhdim del e nevojshme të ritheksohen disa raste të veçanta, kur zanorja fundore e temës së caktuar te foljet e pathjeshta zhduket me rastin e përngjizjes me prapashtesën -Oj të foljes, ngase siç theksohet në gramatikë "zanorja fundore e temës fjalëformuese, si rregull, bie kur prapashtesa fillon me zanore". Mirëpo nga praktika edhe këtu mund të dalë ndonjë përgjithësi. Sidoqoftë, ne këtë dukuri po e konstatojmë konkretisht vetëm te trajtat foljore më -O- që kryesisht i ndeshim në FGJSSH:

1. Kur tema mbaron me zanoren -Ë, atëherë një zanore e tillë, siç mund të jetë vënë re në shembujt e mësipërm (normalisht) zhduket: p.sh:

(2) FOLJET E PREJARDHURA ME PRAPASHTESËN
-O ME ZGJERIM

Siç është përmendur më përpara numrin më të madh të foljeve në shqipe, jo vetëm me prapashtesim, por përgjithësisht, e përbëjnë foljet më -O- pa zgjerim me temë të qartë fjalëformuese. Ky fakt vërtetohet edhe nga lënda e vjellë nga FGJSSH, mirëpo edhe numri i foljeve me prapashtesën -O- me zgjerim nuk mbetet fort prapa. Ç'është e vërteta, në raportin rreth foljeve të pathjeshta më -O- pa zgjerim ndaj atyre më -O- me zgjerim është me interes të veçohen këto karakteristika:

E para, foljet me -O- me zgjerim, në përdorim e sipër, me i marrë të gjitha së bashku ia kalojnë numrit të përgjithshëm të foljeve me -O- pa zgjerim²⁸, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, kur kemi parasysh formimet e karakterit paronimik, diatezor etj., d.m.th. formimet paralele mbi të njëjtin temë prodhuese si dhe mundësia e pakufizuar që jepet mbi këtë bazë, numri i foljeve -O- me zgjerim del shumë herë më i madh. Së këtijmi, si nga ana teorike, dhe sidomos nga ajo praktike del e nevojshme të bëhet trajtimi dhe vlerësimi i përfimeve të foljeve me prapashtesën -O- me zgjerim në jetën tonë gjuhësore.

E dyta, në këtë kuadër, vlen për t'u cekur, edhe një fakt tjetër shumë i rëndësishëm. Pothuajse tek të gjitha rastet e përfimit të foljeve me variantet e tilla, d.m.th. të prapashtesave -O- me zgjerim, kemi të bëjmë me formime mbi temë të qartë motivuese, përkatësisht pothuajse të gjitha foljet e tilla (-O- me zgjerim) kanë mbështetje në fjalë-temat e burimit aktiv të shqipes, qofshin këto fjalë autoktone, qofshin të huazuara, por të përvetësuara që me kohë, prandaj analiza e formimeve në fjalë nuk zgjon vetëm kërshtërësi të studuesit dhe të çdo shqipfolësi për të njohur dhe për të zbuluar thjesht një thesar me vlera të pakrahasueshme të gjuhës sonë, por edhe nxit e i mundëson atij për ta njohur më mirë dhe për ta shfrytëzuar këtë thesar tejet me vlerë, të cilin na e dhuron veçantisht vetë natyra e sistemit foljor të gjuhës shqipe.

²⁸ Numri i foljeve më -O- pa zgjerim i vjellë nga FGJSSH-ja, sipas një njehësimi të lirë, kap shumën 630 që është më i vogël në krahasim me numrin e foljeve -O- me zgjerim, të cilat tin, siç u cek, se pothuajse të gjitha foljet më -O- me zgjerim janë të formuara mbi fjalë-temat autoktone shqipe, ndërsa ato më -O- pa zgjerim janë të përfuara më shumë mbi fjalë-tema të huazuara.

E treta, gjithashtu, në këtë kontekst, del e nevojshme të njihet edhe një e vërtetë tjetër. Ndërsa mbi fjalë-temat e huazuara mbizotërojnë përfimet më -O- pa zgjerim, në një shumicë rastesh del se fillimisht mbi fjalë-tema të shqipes dalin të përfuara në gjuhën tonë foljet përkatëse me -O- me zgjerim, duke u anashkaluar, si të themi, forma e shkallë së parë model "-O- pa zgjerim". Shembuj konkretë do të ceken gjatë analizës së formanteve të caktuara veç e veç, dukuri kjo që vazhdon në raste edhe sot e kësaj dite, mirëpo mundësia e daljes së foljes me prapashtesën -O- pa zgjerim si model për çdo fjalë-temë kuptimplote të shqipes nuk mohohet në asnjë mënyrë.

E katërta, ndërsa te foljet më -O- pa zgjerim, siç u tha, ndërmikimi a reflektimi i drejtpërdrejtë i fjalëve të huaja të huazuara është i madh, te foljet më -O- me zgjerim, një ndikim i tillë, pothuajse, nuk hetohet fare, pos foljeve më -IZ/O- e vetëm ndonjë rast më -TO-, ngase në gjuhën e sotme, pothuajse pa përjashtim të gjitha foljet më -O- me zgjerim janë zhvillim i brendshëm i gjuhës sonë.

E pesta, po të gjurmohet etimoni i disa tingujve ndërhyrës të -O-së me zgjerim, domosdo na nxisin të konstatojmë vazhdimësinë e mundshme reliktove të prapashtesave përkatëse, qoftë, me origjinë mbiemërore, qoftë "të sistemit participor të protoshqipes" siç e cek prof. Besim Bokshi, siç janë tingujt -t (*to); -m (*MO), -s (*ntio); -j/Ē (*j,Ē); -n/r (*no/a) e -sh/Ēm (*sio-mo).²⁹ Me fjalë të tjera, gjatë analizës domosdo duhen pasur parasysh zgjidhjet e supozimet e dhëna më përpara në këtë drejtim, dukuri kjo, e cila sadokudo na detyron që çështjen ta trajtojmë, jo vetëm në aspektin aktual, sipas vijës horizontale, por edhe në atë historike, sipas vijës vertikale.

Sidoqoftë, dukuritë e lartpërmendura del e nevojshme dhe e rëndësishme të njihen me tërë ndërlikueshmërinë që i shoqëron, ngase jetojmë në aso rrethanash të zhvillimit shoqëror, kur ndikimi i gjuhëve të huaja ndaj gjuhës sonë, edhe në sistemin foljor, është gjithnjë më i theksuar, sidomos në nënfusha të caktuara semantike, siç është edhe "gjuha teknike" dhe sigurisht në këtë drejtim shënohen trysni të ndjeshme, qoftë në formë leksemash (fjalë të huazuara), qoftë si elemente formantesh të veçanta. Tash nuk e kam fjalën vetëm për gjuhën teknike, sipas kuptimit të ngushtë

²⁹ Besim Bokshi, *Pjesorja e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1998, f. 45, 90.

të fjalës, por edhe për të gjitha stilet funksionale të gjuhës. Një dukuri e tillë vjen për shkak të interferencave të ligjshme që dalin në mes të gjuhëve në takim. Këto interferenca, janë sigurisht të pashmangshme, për shkak të marrëdhënieve ekonomike, kulturore, tekniko-teknologjike e shoqërore në mes të popujve dhe shteteve, që vjen si domosdoshmëri e jetës. Gjithsesi këto trysni do të jenë më të lehtëpranuara dhe më të lehtëpranueshme, nëse i njohim më mirë aftësitë shprehëse potenciale të gjuhës sonë, sidomos kur njohim mirë sistemin fjalëformues e formëzues të gjuhës sonë, si atë emëror, ashtu edhe atë foljor, sisteme këto që janë të pandara në rrjedhën e mirëvajtjen e gjuhës. Meqenëse, ne, në këtë punim u përqendruam në sistemin foljor, përkatësisht në temën e veçantë, d.m.th. në trajtimin e foljeve më -O-, prandaj edhe përhëllimi do të jetë, pa dyshim, po në këtë drejtim. Të gjitha foljet e përfutuara më -O- me zgjerim, për hir të specifikës që kanë, siç u pa në kreun e dytë të këtij punimi, duke pasur për bazë cilësimin e formanteve prapashtesore, i ndamë në tri grupe:

A. foljet me prapashtesat -O- me zgjerim të mirëfillta: -ro-llo-, -to-, -so-, -zo-;

B. me prapashtesat svariante të prapashtesave të mirëfillta: -no-, -mo-, -ro-, -lo-izo-, -co- dhe

C. me formante të tjera: -ko-, -sho-, -shto-, -ço-, -zho-, -ho- dhe -jo-.

A. FOLJET ME "O ME ZGJERIM" ME PRAPASHTESAT E MIRËFILLTA SINONMIKE

Siç e kemi theksuar edhe më përpara, pesë prapashtesat e foljeve "-O- me zgjerim": -RO-, -LLO-, -TO-, -SO dhe -ZO, d.m.th. me tingujt ndërhyrës: r, ll, t, s dhe z para prapashtesës -O-, përkatësisht të O-së "së zgjeruar" me tinguj të tillë, ceken qartë në gramatikën e Akademisë (1976)³⁰ si dhe në "Praktikumin" e F. Sulejmanit, por edhe në burime të tjera, prandaj ne, në mbështetje të konstatimeve nga këto burime, ndonëse atje quhen variante të prapashtesës -O-, i quajtmë **prapashtesa të mirëfillta sinonimike** foljeformuese. Madje për të qenë më bindëse *mirëfillësia* e tyre e shohim të nevojshme të ricëken argumentet që duken, por edhe të japim ndonjë fakt plotësues, jo pse duam të vëmë në dyshim vlerësimin që është dhënë për to, por për arsye se nga qëmtimi i mëtejshëm i kësaj tematike bashkë me verifikimin e fakteve të njohura, do të ecet me tutje në këtë rrugë, d.m.th. do të sillen edhe fakte e supozime të reja, në mbështetje të argumenteve që dalin nga vëzhgimi i zhvillimit të brendshëm të gjuhës dhe që hetohen në bazë të kundërimeve të caktuara të bëra me akribi të hollë profesionale. Me fjalë të tjera, gjatë verifikimit të të dhënave të caktuara, që janë të ditura, do të preken sadokudo edhe gjëra të diskutueshme ose do të bëhet i diskutueshëm edhe ndonjëri nga konstatimet e mëparshme. Kjo arsyetohet edhe nga fakti se kemi të bëjmë me një lëndë, me sa dimë, pak të prekur, nga studiuesit tanë, sigurisht jo të trajtuar me gjërësinë e thellësinë e duhur.

Në vazhdim, gjatë analizimit të foljeve me prapashtesat përkatëse, sipas radhës që u përmendën më sipër, do të vihen në pah a do të vijëzohen kriteret që i cilësojnë formantet e caktuara si prapashtesa të mirëfillta³¹, kritere këto, të cilat do të jenë të zbatueshme edhe për cilësimin e formanteve të grupit të dytë dhe të atij të tretë, edhe pse ato nuk u quajtmë prapashtesa të mirëfillta. Me fjalë të tjera, pa marrë parasysh origjinën e tyre formantet në fjalë në ndjenjën gjuhësore, janë perceptuar a mund të përkapen si prapashtesa të vijëzuara, ngase funksionalisht i plotësojnë kushtet, siç janë:

³⁰ Fonetika dhe gramatika... II, Tiranë 1976.

³¹ Për kriteret është bërë fjalë në kreun II të këtij punimi, por edhe këtu do të ricëket më poshtë ndonjëri prej tyre, por me parafrazim paksa tjetër.

1. numri relativisht i madh i foljeve që ndërtimisht del si një grup formal fjalëformues më vete me tejdukshmëri të vërejtshme;

2. faktori semantik, sepse formanti i caktuar del ose mund të specifikohet për nënfushën e caktuar kuptimore dhe

3. e vërteta se forsmat e tilla paraqiten si model jo i tejkaluar kohe, por me fuqi të gjallë potenciale që shërbejnë sot e gjithë ditën dhe kemi bindjen se shumica prej tyre do të shërbejnë edhe nesër si gjedhe për përfitime të reja.

Pikërisht mbështetja në kriteret e mësipërme do të paraqitë interes të një rëndësie të veçantë, ngase, duke u përdorur e shfrytëzuar kriteret e njëjta do të sqarohet e përvijëzohet më mirë, ecuria për përcaktimin e dy grupeve të tjera të foljeve -O- me zgjerim, jo si raste, por si dukuri faktike e jetëzuar në gjuhën tonë.

Për hir të natyrës së lëndës që po trajtohet në këtë nëntitull, del e pamundshme që disa nga konstatimet që janë dhënë në kreun I dhe II, të mos përsëriten a ritheksohen, dhe kjo bëhet nga nevoja e përhellitimit lidhur me rivërtetësinë ose verifikimin e fakteve përkatëse që disa prej tyre atëbotë vetëm sa viheheshin në pah.

1. Foljet më -RO-

Prapashtesa foljore -RO- nuk ceket nga prof. Shaban Demiraj në tekstin shkollor "*Gramatika e gjuhës shqipe*",³² Tiranë 1966. Aty përmenden vetëm dy simotra të tjera si prapashtesa me zgjerim të -O-së: -TO- dhe -ZO-, mirëpo këtë e sheh të nevojshme ta bëjë po ky autor në "*Gramatikën e gjuhës së sotme shqipe*" (1971)³³, ku krijimet me prapashtesën -RO- i cek në një pikë të veçantë. Lidhur me këtë ai thekson se nga trajtat: "mbretëri, nusëri, zotëri" kanë dalë foljet më -O-: mbretëroj, nusëroj, zotëroj. Siç nënkuptohet, folja doli me zhdukjen e -I-së fundore të temës, me rastin e përngjizjes me prapashtesën -O-. Autori shton me tutje: "për analogji me këto janë formuar foljet gocëroj, nxiron" (Po aty f. 240). Kështu ky

³² Shaban Demiraj, *Gramatika e gjuhës shqipe* (për shkollat e mesme), Tiranë 1966

³³ Shaban Demiraj, *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1971.

studiuës, me sa dimë, për të parën herë në një gramatikë normative, konstaton funksionin e prapashtesës -RO- si formant të mëvetëshëm për shembujt: *gocëron, nxiron*.

Siç do të vërtetohet në vazhdim, ky konstatim merr zgjerim, duke i perceptuar si krijime të tilla, d.m.th. me prapashtesën e mirëfilltë -RO- edhe trajtat e nëntipit, jo vetëm *gocëroj*, nga i cili nuk duket se del i zhvilluar emri më -RI, si b.f. *gocëri*, por edhe të atij mbretëroj, nusëroj etj., ku i ndeshim të zhvilluar emrat më -RI, si *mbretëri, nusëri*. Ky evoluum në përkapjen a perceptimin e formave të tilla, pra, do të jetë i mëvonshëm dhe ka mbështetje praktike metodologjike.

Në gramatikën e Akademisë (1976)³⁴, thuhet se "me këtë prapashtesë janë formuar një numër relativisht i kufizuar foljesh, kryesisht nga tema emërore", edhe pse për ilustrim aty jepen këta 11 shembuj: *mishëroj, lajmëroj, flakëroj, gocëroj, turpëroj, vjershëroj, si dhe nusëroj e zotëroj*". Në "Shënim" ceken edhe këta tre shembuj të tjerë më -RO: *shqipëroj, shkri-fëroj dhe nxiron*. Edhe në burimin tjetër normativ "Gjuha letrare ..." (1976)³⁵ jepet konstatimi se "*kjo prapashtesë është pak produktive. Me anë të kësaj prapashtese është formuar një numër i kufizuar foljesh, kryesisht nga tema emërore, e në raste të rralla nga ndonjë temë mbiemërore, foljore a ndajfoljore*". Për ilustrim jepen këta shembuj: *flakëroj, lajmëroj, lavdëroj, ligjëroj, mishëroj, plehëroj*, pastaj: gjallëroj, shkri-fëroj, shqipëroj.

Në "Praktikumin" e F. Sulejmani³⁶ pos *lajmëroj, mishëroj, ligjëroj, lavdëroj, turpëroj, shqipëroj, shkri-fëroj, vjershëroj, zotëroj e mbretëroj*, jepen edhe këta shembuj: *fisnikëroj, trimëroj, robëroj, qytetëroj, pleqëroj* - duke e rritur kështu numrin e shembujve të foljeve më -RO-.

Edhe në aspektin e studimeve teorike-historike kemi raste që studiuesit elementin -R- ta konsiderojnë si element prapashtese. Prof. E. Çabej³⁷ me prapashtesën -RO- pos tjerash merr në trajtim edhe trajtat *zbutëroj, shenjtëroj* (lat. *sacrare*)³⁸ si dhe *eshër* si pluralia tantum³⁹. Kjo vërtetohet edhe nga vepra e prof. Idriz Ajetit, i cili formantin, -ëNO-

³⁴ *Fonetika dhe gramatika... II*, Tiranë 1976.

³⁵ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976.

³⁶ Mr. Fadil Sulejmani, *Praktikumi i gjuhës shqipe*, Prishtinë 1981.

³⁷ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore IV*, Prishtinë 1977, f. 382.

³⁸ Po aty f. 402 dhe *St. gjuhësore III*, Prishtinë 1976, f. 229.

³⁹ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, f. 229.

-ëRO- po nga kundrimi i studimeve të morfologjisë historike e quan "prapashtesë sufiksale",⁴⁰ duke i futur në këtë nëntip të foljeve me prapashtesën -RO- edhe shembujt: *buoj /bunoj dhe përparoj(!)*. Edhe në veprën e prof. Selman Rizës i gjejmë të trajtuar këta shembuj të foljeve më -O-, përkatësisht me "togtingujshit -ËN dhe ËR": (me) *lajmëruar, mbretëruar, moshëruar, zotëruar; lavdëruara; gruenuë(m), hienuem; gjallëruar, idhënuem*41.

Këtu, nuk është vendi të ndalemi gjatë rreth dukurisë së rotacizmit të jorotacizmit, por po shfrytëzoj rastin të rikujtoj faktin se lidhur me formantin -R- kemi të bëjmë, pikërisht me ballafaqimin e ndërkëmbimin e bashkëtingëlloreve N/R, po sipas raportit kundërvënës: jorotacizëm/rotacizëm dhe se mu ky proces ka dorë në perceptimin ose jo si prapashtesë foljeformuese të elementit -R-, përkatësisht -N-, si mbështetës foljeformues të -O-së me zgjerim, mirëpo për këtë do të bëhet fjalë pak më gjërësisht në pjesën e dytë të këtij nënkreu, kur të merret në shqyrtim formanti -NO- si variant më vete, përkatësisht si prapashtesë e mëvetësishme foljeformuese.

Gjithashtu e shoh të arsyeshme të ndalem paksa rreth evoluimit të gjykimit që pasoi në të mirë të konstatimit rreth përkapjes së formantit -RO- si prapashtesë të mëvetësishme, dhe kjo dëshmohej edhe nga rritja suksesive e numrit të shembujve me këtë formant prej burimi në burim. Siç e pamë nga burimet e lartcëkura, siç janë b.f. trajtat foljore: *mbretëroaj, nusëroaj, zotëroaj*, të cilat tashmë pa hamendje perceptohen si fjalë të prejardhura me prapashtesën -RO-, d.m.th.: mbret-, zot- nus(e)- e jo nga tema e shumës b.f. mbretër, zotër, madje as nga emrat mbretëri, zotëri, nusëri, siç cekeshin në fillim të trajtimit të lëndës së tillë nga prof. Sh. Demiraj, i cili, siç e kemi përmendur, i shpjegonte të përfuara me "zhdukjen e I-së fundore", d.m.th. nënkuptohet se po të konceptohen ashtu i takojnë grupit të foljeve më -O- pa zgjerim, mundësi kjo që mbase nuk mohohet shkencërisht. Por qëllimi ynë këtu është të tërhiqet vëmendja pikërisht rreth dukurisë së evoluimit të këtij gjykim-koncepti, nëse mund të thuhet kështu, lidhur me formëzimin e nocionit, i cili del i trumbullakësuar në saje të modelit të ri tashmë të pranuar, pra jo nga emri me prapashtesën -RI as nga trajta e shumës, por në radhë të parë, siç e konsi-

derojnë të gjithë gjuhëtarët eminentë të sipërcekur, si një prapashtesë më vete. Po theksoj se në rastet e tilla shpjegimi a konstataimi i ri nuk bie ndesh shkencërisht me atë që e thoshte fillimisht prof. Sh. Demiraj, pasi tashti kemi të bëjmë me gjëra që ndryshe-ndryshe mund të interpretohen. Kështu, pra, varësisht nga këndvështrimi i kundëritim që të dyja a të tria interpretimet nuk mund të quhen të pambështetura, i pari tregon zanafillen (etimologjinë), i dyti, shumësin e emrit dhe i treti, më i rëndësishmi sot për sot, paraqet perceptimin e formëzuar të ri, si zhvillim i brendshëm i shqipes, që del i pranueshëm tash për tash sipas dijes së **fjalëformimit**, d.m.th. i një disiplinë tjetër, si të themi, të re gjuhësore, që e trajton fjalëformimin si objekt më vete duke e vështuar, si nga ana kontekstore formale, ashtu edhe nga ajo funksionale, kuptimore, e cila po formëzohet si disiplinë më vete dita - ditës në kuadër të gramatikës, si një rrafsh identifikues më vete, duke iu referuar edhe më shumë semantikës, ndonëse në tekstet e aktuarra të deritashme ende nuk del e shpëputur nga gjiri i morfologjisë.

Kriteri i tillë, paksa i ndryshuar i cilësimit, ka rëndësi të ceket në mënyrë të veçantë, ngase është e vërtetë se prapashtesë-mbarena -RO-, sidomos në gjendjen e sotme të gjuhës letrare perceptohet pa mëdyshje si prapashtesë e mëvetësishme, pa marrë parasysh faktin se te mjaft shembuj zanafilla e saj mund të jetë shpjeguar ndryshe, madje, vërtet, edhe mund të jetë përfuatur ndonjë rast nën ndikimin e emrave të prejardhur me prapashtesën -RI, siç ishin rastet e sipërcekura: *mbretëri, nusëri, zotëri* (i), por që sot nuk gjejmë shpjegim të tillë.

Këtë fakt po e theksoj mbase me tepri, por kam për qëllim të vë në dukje edhe një herë arsyen pse pikërisht ky kriter përcaktohet (pa hyrë në stërholime etimologjike etj.) do të dalë i zbatueshëm (analogjikisht) edhe për cilësimin e disa prapashtesave të tjera, siç veprohet edhe në këtë punim, pra, pavarësisht nga prejardhja a dukja e tyre në zanafille.

Po e cek edhe një rast tjetër të ngjashëm, rastin "nxiron". Folja "nxiron", siç e pamë nga prof. Sh. Demiraj, konsiderohej e dalë nga folja nxi(j), por mund të shpjegohet edhe nga pjesorja NXI- (me nxi) + -RO- nxiroj a nxiro-n, madje mund të shpjegohet edhe nga mbiemri "i nxirë" (*nxir+oj*) e kjo etimologjikisht nga përngjizja e togut "në të zi" > nt'zi > nxi ose mund të interpretohet edhe nga pjesorja e letrarishtes së sotme (mbi bazë të toskërishtes) NXIR(Ë) a (nxir-UR)- ose sipas ndonjë mënyre tjetër(!),

⁴⁰ Dr. Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes III*, Prishtinë 1988, f. 160.

⁴¹ Selman Riza, *Vepra 2*, Prishtinë, f. 284.

por kjo nuk pengon aspak interpretimin që e jep prof. Sh Demiraj, që forma e tillë foljore të perceptohet si folje e formuar me prapashtesën -RO (*nxi+roj*).

Nuk më duket e tepërt dhe pa vend të rikujtohet edhe një fakt tjetër. Prof. A. Kostallari⁴² fjalën **zot-** e shënon si temë prodhuese për fjalën *zotni* e *zotëri* si dhe për foljen *zotëroj* e *zotohem*. E ngjashme me këtë del edhe konstatimi të "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", ku thuhet se emri kripshmëri "nuk lidhet kuptimisht me mbiemrin "i kripshëm", po me emrin "kripe", ashtu si edhe përcjellshmëri, jo me *i përcjellshëm*, po me foljen *përcjell*, *pjellshmëri jo me i pjellshëm*, po me foljen *pyell* (*me pjellë*), *vdekshmëri*, jo me *i vdekshëm*, po me emrin (prejfoljor): (*me*) *vdekë vdekje*.⁴³ Së këtejmi del se sikurse emri ashtu edhe folja e prejardhur formohen nga tema e njëjtë fjalëformuese, d.m.th. nga tema bazë (emri i parmë): **ZOT-**, siç u cek më sipër e jo nga rjedhojat e prejardhura të këtij emri.

Nga morfologjia historike dihet se trajta mbretër a mbretëri, priftër priftëri etimologjikisht dalin parësore ndaj trajtave mbret e prift, ngase historikisht, fjalët e tilla konsiderohet se janë refleksë të latinishtes letrare: imperator (mbretër mbret) imperatori (mbretëri), përkatësisht preisbyter (priftër prift). Pra historikisht konsiderohet i drejtë shpjegimi se te këto dy fjalë, duke qenë fjalë të huazuara a të interfertueshme që moti nga latinishtja, elementi -R- i takon temës bazë të hershme fjalëformuese prej nga mund të shpjegohen edhe trajtat e foljeve *mbretëroj*, përkatësisht *priftëroj*. Mirëpo kur kemi parasysh logjikën e sotme, të përkufizuar edhe në gramatikë se si formë përfaqësuese e temës prodhuese, në analizën e sotme, merret njëjësi i emrit të pashquar në emërore, vertet, asociacionisht, del sheshazi e vërteta e pakontestueshme se sot për sot, pra, vetëm trajta "**mbret-**", përkatësisht ajo "**prift-**" motivon, ashtu siç u pa edhe të fjal-tema **zot-** që motivonte. Për çdo rast, pra, në strukturën foljeformuese të letrarishtes së sotme, foljet përkatëse: **mbretëroj**, **priftëroj**, **zotëroj** do të konsiderohen si folje të prejardhura me prapashtesën -RO- dhe përputhen plotësisht me natyrën e gjuhës shqipe, ashtu si edhe emrat mbret, prift, zot, kur kemi të bëjmë me "rregullat" e fjalëformimit.

⁴² Prof. Androkli Kostallari, te *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë 1972, f. 552.

⁴³ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976, f. 224.

Po kështu mund të thuhet jo vetëm për shembujt me temë emërore, por edhe për foljet më -RO- j me temë mbiemërore, si p.sh. gjallëroj, madhëroj, trimëroj etj., edhe pse si temë fjalëformuese mund të ndikojë edhe emri me prapashtesën -RI: gjallëri, madhëri, trimëri e kështu me radhë. Sigurisht, kështu mund të thuhet edhe për foljet me temë ndajfoljore: shqipëroj, lumëroj e të ngjashme, por mbase nuk mund të bëhet as vërejtje për foljet e përfutura nga tema foljore e shkallës së parë, si p.sh. shkri-fëroj, zëroj, nxiroj (me kuptim figurativ: vras⁷⁴).

Me fjalë të tjera, në disiplinën e fjalëformimit, kriteri i përcaktimit të cilësimit nuk bazohet domosdo në prejardhjen etimologjike etj., po pikërisht në ndërlidhjen kuptimore që ka sot për sot folja e caktuar në raport me fjalë-temën bazë të caktuar fjalëformuese motivuese. Është e vërtetë se, sipas gjendjes së sotme, folja më -RO-, si *nusëroj*, *zotëroj*, *priftëroj*, *mbretëroj* është shumë më afër kuptimisht me fjalët e parme në njëjës: *nuse*, *zot*, *prift*, *mbret* (qoftë edhe në përdorim figurativ) sesa me derivatet përkatëse: emrin a mbiemrin e prejardhur: *nusëri*, *zotëri*, *priftëri*, *mbretëri*; gjallëri, (i)nxir(ë) etj. Kështu pra zbërthimi i foljeve më -RO-, pa hyrë në variantëzime mendimesh e kuptimesh figurative, mund të dalë edhe kështu:

- "ajo që vepron (sillet) si nuse" - *nusëron*;
- "ai që vepron (sillet) si zot (si i zoti, dalzotës)" - *zotëron*;
- "ai që sillet (vepron, sundon) si mbret" - *mbretëron*...
- "ai që merr përsëri forcë e jetë" - *gjallëron* etj.

Lidhur me këtë nuk është pa interes të dihet edhe një fakt tjetër. Studuesit Xhuvani - Çabej konstatojnë se prapashtesa -(Ë)RI si prapashtesë emërore e ka "*burimin te prapashtesa -I, së cilës i erdhi e iu shtua elementi -R- në krye (...)*"⁴⁵, po dy formantet emërore -I- ose RI a -(Ë)RI u bashkuan, pa u përjashtuar ngjashmëria në ecurinë me modelin e formimit të foljeve më **ro**. Ndonëse, siç del nga analiza, prapashtesa foljore -RO- ka rrugë tjetër formëzimi kundrejt prapashtesës emërорë -RI a -(Ë)RI.

⁴⁴ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1227.

⁴⁵ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesa e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 475.

Nga sa u tha më sipër, duke e pasur parasysh përgjithësimin e formantit -RO-, në "ndjenjen gjuhësore" të shqipes letrare, në përdorim të sipër, del i diskutueshëm, përkatësisht duhet të pranohet me rezervë konstatimi i dhënë në gramatikën e Akademisë (1976), ku siç e pamë më sipër, thuhet se "me prapashësën -RO- janë formuar një numër relativisht i kufizuar foljesh",⁴⁶ ashtu si edhe konstatimi edhe më i ashpër që del në burimin tjetër normativ "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", ku thuhet se "kjo prapashësë është pak produktive".⁴⁷

Konstatimet e mësipërme rreth prodhueshmërisë nuk dalin të diskutueshme për arsye të ndryshimit të koncept-qëndrimit rreth përcaktimit të kriterit rreth cilësimit të foljeve përkatëse me prapashësën -RO-, numri i të cilave mund të ndryshojë, por ato dalin të paqëndrueshme aktualisht pikërisht për arsye të shtimit suksesiv të numrit me shembuj të rinj nga jeta që pasqyrohen kështu prej burimi në burim, sidomos në domenin e krijimtarisë letrare.⁴⁸

Për të qenë të qëndrueshme krijimet e tilla, është e domosdoshme që rastet të kalojnë në dukuri ndërsa dukuria të ketë mbështetje në model, kurse modeli për të qenë i qëndrueshëm duhet të ketë mbështetje në nënfushën e caktuar semantike, e cila vijëzohet nga nevoja dhe nga logjika e brendshme gjuhësore dhe kështu del që të gjitha këto komponente duhet të gjejnë mishërim në ndjenjen gjuhësore dhe, së ketejmi, bëhet materializimi në strukturën e caktuar brenda sistemit gjuhësor.

Pikërisht rreth këtij procesi do të bëhet fjalë në njëfarë mënyre në kreun vijues të këtij punimi. Është i vërtetë konstatimi se me prapashësën -RO-, "krijohen folje zakonisht mbi temë të një emri" siç thuhet në gramatikën e Akademisë, por, për t'iu përgjigjur çështjes së shtruar më sipër, më mirë del e nevojshme të shihet më në hollësi se këta emra çfarë tregojnë dhe në cilin nëngrup semantik mund të ndërfuten.

Nga shembujt e vjelë në FGGSSH (1980) si temë prodhuese fjalëformuese prijnë emrat e nëngrupeve si:

⁴⁶ Fonetika dhe gramatika ... II, Tiranë 1976, f. 475.

⁴⁷ Gjuha letrare shqipe për të gjithë, f. 228.

⁴⁸ Kështu ndërsa në FGGSSH (1954) ndeshim një 30 raste të tilla, në FGGSSH (1980) ndeshim mbi 50 sosh, d.m.th. mbi 20 folje më shumë, kurse në jetën tonë të përditshme, siç do të shohim në vazhdim, numri i tyre del me rritje edhe më të shënuar.

- emra të përgjithshëm njerëzish: burrëroj, fisnikëroj, fqinjëroj, hasmëroj, mbretëroj, (mbi)zotëroj, pleqëroj, shoqëroj, robëroj, skllavëroj, (sh)priftëroj, vëllazëroj, lavdëroj, vejëroj; - emrat e kuptimit: flakëroj, lavdëroj, mblesëroj, shpirtëroj, turpëroj, zëroj, kreshpëroj, ligjëroj, lajmëroj, testëroj (teste), zhurmëron;

- emrat e sendeve konkrete (në përdorim të ftyruar): bulbëroj, fillëroj, sh/kishëroj, mishëroj, zuzëroj, lesëroj, çipëroj;

- emrat e përgjithshëm të vendeve (të përdorur figurativisht): lehtëroj, llucëroj, qytetëroj;

- emrat e kafshëve (në përdorim figurativ): kafshëroj, kalëroj, shtazëroj, mizëron (FSHSK 1981).⁴⁹

Ndonëse të një numër i konsiderueshëm i shembujve të sipërcekur mbi temën e njëjtë prodhuese nuk dalin foljet paralele më -O- pa zgjerim, një mundësi e tillë si rezervë ekzistuese, teorikisht, nuk mohohet.

Sidoqoftë, foljet më -RO- mbi temë emërore në 37 shembujt e konsultuar, pos ndonjë rasti të veçuar, që të gjitha lidhen me veprimin e njeriut, ngase përfutimet mbi temë të një emri të përgjithshëm të njeriut, por edhe ato mbi fjalë-temat e caktuara, me të cilat emërtohet një kuptim, një kafshë, një vend etj., figurativisht emërtojnë veprimin a gjenden që lidhet fort me njeriun. Madje edhe përfutimet mbi temë mbiemërore, si p.sh. gjallëroj, madhëroj, trimëroj etj., ato foljore, si p.sh. shkriëroj, nxiron, ato me temë ndajfoljore si: shqipëroj, lumëroj, por edhe ato onomatopeike: hungëroj, glluguroj e murmuroj etj. që të gjitha emërtojnë një proces që, gjithsesi, ndërlihet me punën, veprimin a jetën e njeriut. P.sh. thuhet: *hungëron ariu* (folje pavetore), por *ai hungëroi si ariu* etj. Me fjalë të tjera, edhe foljet pavetore e të tjera ndërlihen gjithsesi me botën e njeriut. Nuk di sa njihet ndonjë rast që del jashtë kësaj kornize. Pra, sidoqoftë, foljet e tilla shprehin kuptim përfurcues, i cili figurativisht ndërlihet në kontekst me botën shpirtërore të njeriut. Gjithsesi të foljet me prapashësën -RO-, veprimin e mbart njeriu si veprimtar i nënfushës së caktuar semantike. Andaj nuk është çudi, pra, që emërtimet e proceseve të tilla prijnë të përftohën, në radhë të parë, në fushën e krijimtarisë artistike letrare, rëndom në poezi a vjershërimë, por edhe në prozë e kontekste të caktuara.

⁴⁹ Fjalori shqip-serbokroatish, Prishtinë 1981, f. 581.

Përvijezimi që u paraqit më sipër, d.m.th. nënfusha e botës shpirtërore të njeriut, sigurisht meriton përpunim a vëmendje më të thellë. Natyrisht duhet të përfordhet a ilustruohet edhe me të dhëna të tjera. Kjo kuptimësi do të dalë edhe më qartë në përqasje me simotrat e saj sinonimike edhe të karakterit paronimik. Ka raste kur prapashtesa -RO-, më drejt, folja me këtë prapashtesë, mban bazën a pozitën e mesme të drejtpeshimit në mes të ngjyrimit të intensitetit stilistik a kuptimor prej nga fillojnë foljet me formantin përkatës -RRO- ndaj atyre me formantin -LO-. Në të mirë të një konstatimi të tillë flasin jo vetëm shembujt që u volën nga burimet e lartcekura, por edhe shembujt e rinj nga ligjërimi i përditshëm. Le të rikujtohet vetëm shembulli: kuqëron ndaj kuqëron dhe atij kuqëlon.

Në mbështetje të asaj që u tha deri këtu po risjellim sa për ilustrim ndonjë shembull nga ata që u cekën më sipër që nga burimi në burim dalin me këtë formant prapashtesor. Në FGJSSH (1980), p.sh. dolin shembujt: kalëroj, shpriftëroj, shkishëroj etj. që nuk ishin të regjistruar në FGJSH (1954), por edhe më tepër, për nga cilësia e për nga sasia, flasin shembujt e vjetër nga burimet e caktuara te ne që do të sillen më poshtë, numri i të cilëve është i madh, për mos me thënë i pakufizuar, dhe se pikërisht shembujt u hetuan rastësisht, por jo qëditërisht pse kryesisht në stilin poetik. Ja disa nga shembujt që i shënova nga burimet e caktuara, pra, jo të përzgjedhura, por nga ato që pata rast t'i hetoj nga realiteti ynë gjuhësor:

- me temë emërore: vjeshtëron, shkrumëron (F. Gunga), hapëroj, vargëroj, mësitëroj, ujëron, ashtërohet, kishëroj, rrathëroj, djalëroj, fëmijëron, ethëron (ethe), lugatëron, jermëron, belbëron, dritëron, vdekëron, fundëroj, mitiroj, kurthëroj, velëron (veluron), shenjëron, shkrumbëron, premhtëroj, çapëron, prishëron, breroj, blioron (!), shkrepëroj, fjalë(u)ron, kicërohet, kinezëroj, kurvëron, erëron, frytëroj, kremtëron, krimbëron, vragëroj, hirëron, doçëroj, mizëron, paqëron, shoqëron, shtetëron, shke-ncëroj, gjakëron, grekëron, diellëron, thithmëron⁵⁰ etj.

- me temë onomatopëike: llapëron, cinëroj, capëron, titëroj, çuqëroj, shkrapëroj, nanuron, bulbëron etj.

- me temë mbiemërore: majmëron, dyjaron (!), shurdhëron,

⁵⁰ Rilindja për fëmijë, 19. II. '02, f. 20.

- me temë foljore: bredhëroj, hedhëroj, dridhëroj, ngaroj, shkrepëroj etj.⁵¹

Pa dyshim po të qëmtohen të gjitha burimet në të gjitha trevat shqipfolëse, do të ndeshim, me siguri, edhe në shembujt e tjerë, por më duket se edhe këta që u sollën këtu, që kalojnë njëqindshin, mjaftojnë sa për të tërhequr vëmendjen mbi këtë dukuri, fakt ky që hartuesit e teksteve normative në të ardhmen duhet ta kenë parasysh, në mënyrë që mos të bien pre e formulimeve tash të vjetëruara, lidhur me shumësinë e shembujve të tillë që ndeshen të regjistruara në burimet e caktuara të deritashme normative, me të cilat ende po manipulohet. Nga analiza e shembujve që i shënuam më sipër arritëm në përfundimin se pjesa dërrmuese e tyre dilnin si fjalë të domosdoshme dhe kjo arsyetohej nga vetë konteksti.

Me një fjalë, vetë hijesa a ngjyrimi stilistik nga konteksti: *bota shpirtërore e njeriut*, arsyeton përdorimin e trajtës përkatëse. Kuptimi i foljeve lidhet me temën motivuese fjalëformuese, natyrisht në mënyrë paksa të fyturuar, pavarësisht nga kategoria e fjalë-temës fjalëformuese, qoftë ajo emërore, mbiemërore, ndajfoljore, foljore a onomatopëike. Duke e përfuruar konstatimin e mësipërm mbi përcaktimin e nënfushës semantike si diçka me rëndësi, i cili nuk ka asnjë të keqe për t'u vetëdijësuar edhe më tej dhe për t'u vlerësuar drejt nga opinioni përkatës i profileve të caktuara të gjuhës sonë, në vazhdim do të cek edhe ndonjë çështje periferike të diskutueshme, por me interes që lidhet, gjithsesi, në njëfarë dore, me foljet më -RO-:

⁵¹ Përveç disa shembujve më -RO-, të lartpërmendur, të cilët i ndeshim në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954), edhe te Fjalori i Gazullit, si p.sh. kurthëroj, *Fjalorin shqip-serbokroatisht* (1981) (majmëroj) etj., të cilët nuk janë regjistruar në FGJSSH (1980), përfitime me këtë formant i ndeshim, qoftë në shkrimet e prof. A. Kostallarit: shkrapëroj, thuqëroj, të E. Çabejt: mblesëroj, guguroj, të Ibrahim Goçit ujëron, kimëroj e ndonjë tjetër, por më tepër kam ndeshur në shtypin e ditës, si p.sh. në gazetën "Rilindja" e në botime të tjera të Prishtinës: ethëron, zëroj, çuqëroj, velëron, llapëroj, shkrumbërohet, lugatëron, nanë(u)ron, mitëron, velëron, dridhëron, bishëroj, vargëron, etj.; revistat si: Zëri (i rinisë): zhurmëroj, ashtërohet, djalëroj, bulbëron, fqinjëroj, krimbëron etj.; "Fjala": hapëroj, kicëroj, kurvëron etj., të cilat përsëriten edhe në burime të tjera të ditës siç është edhe gazeta "Bujku", ku ndeshëm edhe përfitime: shenjëron, paqëroj, erëron, gjakëron, krahëroj (krahëruar), vjeshtëroj etj. "Dielli": kinezëron etj. L. Poradeci: zëngëron, majmunëron, drithmëron, çfistëron, mëmëron etj. Faik Konica: pakëron, nga e folmja e Matit: dukron, Noli: krishtëron, Mjeda: pingron, P. Arbanoi: nynyron etj.

Në jetën tonë gjuhësore (ligjërimore) dukuria e shfaqjes së emrave të tillë është e dallueshme, pra mund të ndeshim edhe shembujt e tjerë dhe kjo dukuri meriton trajtim të veçantë.

Së pari, është me interes të konstatohet fakti se ky shtim i shembujve më -RO- është rezultat i nevojës që del nga vetë zhvillimi i brendshëm i gjuhës sonë (si p.sh. të themi, specifikisht, më tepër i takon gjuhës poetike). Këtu kemi parasysh, në njëërën anë, edhe faktin se në veprën poetike të Lazgush Poradecit ("mbretit magjistat të vargut shqip") ndeshim afro 40 shembuj të foljeve më -RO-, fakt ky që, në njëfarë dore, mund të kuptohet si ndikim i tij, përkatësisht i gjuhës poetike të poetëve të mëdhenj të arealit jugor, njëherazi, në anën tjetër, mund të jetë edhe si ndikim që vjen nga favorizimi pa rezervë nga individë të caktuar që u bëjnë trajtave të rotacizuara, në shenjë prestigji ndaj gjuhës sonë të njësuar letrare mbi bazë të toskërishtes. Nuk është e tepërt të sjellim në këtë vazhde konstatimin e prof. Xhevat Lloshit, i cili te një poezi e L. Poradecit ka vërejtur përthelësisht: "*duket se gjithëka qartësohet me një ritëm përkundës, me dendurinë e tingullit -R-*",⁵² pra pikërisht është ai tingulli -r- që mrekullisht "qartëson me një ritëm përkundës".

Së dyti, është e vërtetë se në njëfarë mënyrë, trajtat si *verbëroj*, *shurdhëroj*, *shkurtëroj*, *poshtëroj* mund të interpretohen dy mënyrash edhe nga tema bazë pa ndajshitesë si p.sh. verb(ë)-ROJ edhe nga i **verbër**: verbër-Oj, shurdhë, i **shurdhër** shurdhër+Oj, poshtë, i **poshtër** poshtër+Oj, por kjo s'mund të vërë në dyshim konsideratën që ato të cilësohen si folje më -RO-. Fjalën "poshtër" prof. E. Çabej e krahason me "postero", ngase, siç e thekson ai, forma e tillë "ruan mbaresën e komparativit latin të fjalës "pedem" (këmbë)".⁵³ Sidoqoftë, prapashtesa -ËR në formimin e mbiemrave, në gramatikën tonë normative, konsiderohet me të drejtë se "ka mbetur jo prodhimtare",⁵⁴ ndonëse me marrë përgjithësisht, siç e thekson L. Buxheli, temat fjalëformuese më prodhimtare janë ato me fundorin -ËR, krahaso: i vjetër > vjetroj, i pastër > pastroj, tepër teproj, vaster vistër etj. (Vepra e cit. f. 62).

Së treti, gjithashtu ka vend për diskutim edhe për temën prodhuese të foljeve me -AROJ siç janë rastet: bllacarj, laskarj e kalorj, pasi tema e qartë motivuese e këtyre foljeve del e zbehur. Krahaso: kalorj:

⁵² Xhevat Lloshi, *Silitika e pragmatika*, Tiranë 1999, f. 61.

⁵³ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, f. 109.

⁵⁴ Shih *Gramatika e gjuhës shqipe* (morfologjia) Tiranë 1985 f. 195.

kal(ë)+A + -ROJ, ndonëse për raste të reja elementi -A- nuk del i këshillueshëm, në vend të tij më praktik (po që e nevojshme) del sheshazi fundori ose elementi mbështetës -Ë-.

Së katërti, po i cek edhe trajtat foljore onomatopoeike: mumuroj, lumuroj, buburoj, guguroj e ndonjë tjetër me një -U- mbështetëse, e cila në raste të caktuara del edhe në kundërvënien të lehtë me një -Ë- mbështetëse. Lidhur me këtë, në mënyrë të veçantë, po e theksoj faktin se në gjuhën letrare kombëtare, sot për sot, del mjaft e qartë prirja, që foljet e tilla të dalin jo me zanoren -U- mbështetëse, po pikërisht me atë -Ë-, si p.sh. hidhëroj (i hidhur), murmëroj, lumëroj, bubëroj, gugëroj - e kështu me radhë dhe se një praktikë e tillë, nuk është keq të përkrahohet, kur dihet fakti se -R-ja në mjaft raste si këto, del si element epentetik dhe assesi nuk bën të alternohet a të syzohet me elementin -N-, ngase foljet më -RO- mbi temë të një tingullimitimi nuk konkurrohen nga foljet me formantin -NO.

Së pesti, po i cek edhe dy çështje që ia vlejnjë të përgjithësohen në parim: njëra ka të bëjë me favorizimin e trajtave të foljeve më -ROJ/, siç është rasti kalëroj ndaj trajtave: kalirj, kaluroj, kalorj e kalaroj, kur është fjala për të njëjtin koncept, kurse çështja tjetër ka të bëjë me shmangien e homonimisë a me mosshurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme fundore, siç është edhe rasti i foljes *drithëroj*, i formuar mbi bazë dialektore të toskërishtes, d.m.th. mbi bazë të foljes dridh (me dridhë), së cilës i është shurdhuar bashkëtingëllojja e zëshme fundore -DH në -TH, që ka sinonim formën *dridhmj*. Pra, pasi që është fjala për foljen *dridh* e nuk është fjala për emrin *drith drithëra*, kam mendimin se këto dy trajta lypset dalluar në të shkruar kështu: Kur kemi të bëjmë me kuptimin e drithit drithrave, (mundësi kjo e padiskutueshme, qoftë edhe për shprehje figurative), folja më -RO- të dalë *drithërohet* (drith+ËROhet gruri), ndërsa kur kemi të bëjmë me dukurinë e dridhjes të dridhurit, atëherë të dalë folja më -RO- *dridhëroj* (dridh+ËROj), pra, pa ndryshuar fare bashkëtingëlloren -DH- që është veçori e normës letrare. Me një veprim të tillë parimor do t'i iket homonimisë së krijuar pa nevojë dhe, njëherazi, edhe kjo trajtë do të harmonizohej me trajtat përkatëse normative, të cilat gjithsesi dalin të pashurdhuara, edhe pse mbarojnë me bashkëtingëlloren të zëshme. Lidhur me këtë praktikë, s'duhet pasur kurrfarë dileme, aq më tepër, kur kemi të bëjmë me përfitime të foljeve të reja të ngjashme.

Gjithsesi, gjatë trajtimit të foljeve me prapashtesa të tjera sinonimike, sidomos të foljeve më -NO-, duke u vënë re disa çështje të përbashkëta dhe të veçanta, do të dalë edhe më qartë fizionomia e foljeve me prapashtesën -RO-, prapashtesë e specifikuar kjo me prijje të dallueshme për mbulimin e nëfshës semantike që lidhet më fort me botën shpirtërore subjektive të njeriut.

2. Foljet më -LLO-

Ndonëse në gramatikën e prof. Shaban Demirajt (1971), ashtu si edhe në punimin e prof. S. Rizës e në burimin normativ "Gjuha letrare shqipe për të gjithë" (1976) prapashtesa -LLO- nuk përmendet fare, ashtu si edhe në punimin e L. Buxhelit, në gramatikën e B. Becit (1998), të M. Çelikut etj., por ajo ceket qartë në gramatikën e Akademisë (1976).⁵⁵ Aty, veç tjerash, thuhet se "me këtë prapashtesë janë formuar një pakicë foljesh", konstatim ky që duke e pasur për bazë realitetin tonë gjuhësor, duhet të pranohet me rezervë të ligjshme, sepse foljet e tilla nuk dalin aq me pakicë, ngase kanë një shumësi të konsiderueshme.

Foljet me këtë prapashtesë i cek edhe prof. Idriz Ajeti, i cili prapashtesën -(ë)LLO-j e quan si "zgjanim të prapashtesës -O-".⁵⁶ Lidhur me këtë edhe ky autor thekson se me këtë prapashtesë sajohet një "varg i vogël foljesh" të cilat "formohen prej mbiemrash, emrash e foljesh" dhe për ilustrim shënon shembujt: humbulloj, tundulloj, shkundulloj. Nga pikëpamja e studimeve të morfologjisë historike, po sipas këtij autori, pranohet se foljet "fërfëlloj, turfulloj" formohen me prapashtesën -LLO- dhe thekson se "të gjitha këto folje kanë dalë nga një fër-fër onomatopeik". Ky konstatim gjen mbështetje edhe në gjykimin e prof. E. Çabejt,⁵⁷ i cili foljen "fishkëlloj, fishkulloj" e quan "fjalë onomatopeike me kompleksin si fërshëllej". Këto shpjegime gjejnë mbështetje edhe në punimet e A. Xhuvanit, i cili për foljen "dalloj" thotë se "nuk është gjë tjetër veç një frekuent i vumë i verbit *daj* me prapashtesën -LLO-j, si hapulloj, humbulloj, tundulloj, tund tundulloj, hap e

⁵⁵ Fonetika dhe gramatika ... II, f. 301.

⁵⁶ Dr. Idriz Ajeti, *vepra e cit.* f. 160.

⁵⁷ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë 1968, f. 221.

hapulloj", të cilat i quan "folje frekuentive (verbum frequentativum)".⁵⁸ Edhe nga vepra e bashkautorëve Xhuvani - Çabej "Prapashtesat e gjuhës shqipe", edhe pse aty bëhet fjalë për sistemin emëror (nominal) e jo për atë foljor (verbal) të shqipes, del e identifikuar qartë prapashtesa foljore -LLO-. Aty, kur bëhet fjalë për prapashtesën -ULL-, -ULLË-, ceket emri **fishkull**, i cili, sipas tyre, i referohet foljes **fishkulloj**. Edhe më qartë kjo prapashtesë del e nënkuptuar tek emrat me prapashtesën -ULL/IM si: mbushullim, ngushullim, rregullim, vagullim, për të cilët siç konstatohet aty "kanë dalë nga foljet përkatëse me prapashtesën e lashtë vendëse në -ULLOJ: mbushulloj, ngushulloj, rregulloj, vagulloj".⁵⁹

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm, që ndonjëri prej tyre sipas gjendjes së sotme nuk del i padiskutueshëm, mund të konstatojmë se nga lënda e vjelë nga FGJSSH si dhe në punimet e studiuesve A. Xhuvani e E. Çabej, foljet e këtij tipi, nuk janë aq pakicë dhe se ky formant del tri variantëshe më: -LLO-, -ULLO- dhe -ËLLO- dhe se numri i tyre konstativ arrin në afro 50 raste të regjistruara.

Për qëllim të caktuar drejtshkrimor, në vazhdim po i japim disa shembuj, sipas varianteve të prapashtesave të sipërcekura, ashtu si i ndeshëm në burime të caktuara:

1) me prapashtesën në variantin -LLO- (pa asnjë element shtesë mbështetës) i ndeshim foljet: pishlloj, taklloj; fërfloj; caklloj, ngallloj, caplloj, zhdrivilloj; bufloj, fërfloj, rrranglloj, shapllloj, krrakllon, dërdlloj, hakllon;

2) me prapashtesën në variantin -ULLO- (me elementin shtesë mbështetës -U-) i ndeshim shembujt: gurgulloj, vrungulloj, rrushkulloj, shungulloj, zdupulloj, cungulloj; zgurdulloj, agullon, cafullon, bruzhdulloj; mbushulloj, humbulloj, grafulloj, gaculloj, gumullon, hupullon, pegullon etj.;

3) me prapashtesën në variantin -ËLLO- (me elementin -Ë- mbështetës) hasim foljet: ngazëlloj, gazëlloj, shqipëlloj, ngushëlloj, pikëlloj, shtingëlloj, përcëlloj, rrapëlloj, zëzëlloj, fërfëlloj, çiqëlloj, kërcëlloj, vringëlloj, frengëlloj; fishkëlloj, zhangëlloj, zhapëlloj, trokëlloj, vagëlloj, krikëlloj, cingëlloj, piskëlloj etj.

⁵⁸ A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Prishtinë 1968, f. 34.

⁵⁹ A. Xhuvani - E. Çabej, *vepra e cit.* f. 563.

Shembujt e grupit të pare e bëjnë të diskutueshëm siporositë e dhënë në gramatikën e Akademisë (1976), ku thuhet se "kur tema fjalëformuese mbaron me një bashkëtingëllore para prapashtesës -LLO- shtohet për arsye fonetike zanorja -U-, pëkatësisht -Ë-, si p.sh.: tundullon, zbardhëllon etj." Sidoqoftë, edhe pse në FGJSSH, siç e pamë më sipër, dalin jashtë rregullës mjaft shembuj si: pishlloj, taklloj e disa të tjerë të përdorur edhe nga A. Xhuvani e E. Çabej, sirregulla e mësipërme mund të dalë e zbatueshme pra për shumicën e rasteve. Kështu mund të vihet në veprim, qoftë elementi mbështetës -U-, qoftë ai -Ë- para prapashtesës -LLO-, por lind pyetja, me sa u cek më sipër, se a ka mundësi të përcaktohet njëri nga dy elementet: -U- ose -Ë-? Cilit element mbështetës prej këtyre të dyve duhet dhënë përparësi apo duhet parapëlqyer? Çfarë kriteri duhet ndjekur?

Në jetën e përditshme, siç u tha, i ndeshim të dyja rastet, madje nga i njëjti autor për fjalë-trajten e njëjtë. P.sh. prof. E. Çabej e shënon *cafuillon* për dukurinë onomatopeike "leh geni caf caf...", por çërfëllon + përcëlloj cakëlloj po për tingullimitim.⁶⁰ Edhe në gazetën "Bujku", e burime të tjera ndeshim shembuj të tillë.

Është mjaft indikativ fakti, siç e pamë më sipër se në gramatikën e Akademisë (1976), së pari ceket elementi -U- e pastaj ai -Ë-, kurse në doracakun normativ të F. Sulejmanit *Praktikumi...*, së pari përmenden shembujt me -Ë-në mbështetëse e pastaj ata me -U-. Pra, në këto dy burime, ndonëse nuk ndahen elementet e filla, përparësinë e radhës e kanë të ndryshme, madje në burime të caktuara herë ndeshet njëri e herë tjetri element.

Sido që të jetë, në bazë të prires që vërehet sipas shembujve përkatesë më poshtë do të japim edhe mendimin tonë. Zakonisht me -Ë-në mbështetëse mbizotërojnë shembujt mbi temë onomatopeike si: memecëlloj: "për të memecëlluar shkollat tona",⁶¹ neologjizëm më -ë/LLO- i farkëtuar mjaft me vend, ku si element shtesë mbështetës del elementi -Ë-, pastaj vringëlloj, gugëllon, kuakëllon, bamëllon, bramëllon, pëshpëshëllon, fërfëllon, takëllon, dumëllon, fushkëllon, tërtëllon, vërtëllon, bamëllon, hingëllon, gugëllon, khukhëllon kuakëllon pastaj: brumëllon, tringëllon, tingëllon etj., ndërsa me -U-në mbështetëse mbizotërojnë shembujt mbi temë të një fjalë-teme të qartë (emri a folje) si p.sh.: cungulloj, zgurdulloj, tundulloj, mbushulloj, mjaullon, gurgulloj, vezulloj, humbulloj, gaculloj etj.

⁶⁰ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore IX*, Prishtinë 1989 f. 6.

⁶¹ Gazeta *Bujku*, dt. 24. XI '92, f. 6.

Kjo prire e mund të cilësohet si rregull apo jo, mbetet të gjykohet. Po theksoj faktin se një përcaktim i tillë ka rëndësi praktike për heqjen e ndërzyzjes, sidomos me rastin e përfutimit të foljeve të reja mbi këtë bazë alternative. Sidoqoftë, trajtimi i çështjeve si kjo do të na shpjerë, gjithsesi, përpara në vëzhgimet tona lidhur me priret fjalëformuese.

Sigurisht për këtë çështje duhen pasur parasysh edhe fjalë-emrat e shqipe, të cilat mbarojnë me prapashtesën e lashtë përkatëse nominale -ULL dhe -ULLË, e cila nuk është e pahetuar as në gjuhën e sotme, siç e theksojnë studiuesit e mirënjohur Xhuvani - Çabej në veprën e tyre të sipërcukur.

Edhe diçka vlen të theksohet lidhur me foljet më -LLO-. E kam fjalën për mundësinë e përcaktimit të nënfushës semantike a stilistike që mbulojnë foljet më -LLO-. Të gjitha foljet më -LLO- mbi temë onomatopeike shprehin ndonjë dukuri të natyrës, e cila kryesisht shoqërohet me zhurmim jo aq të dëshiruar, jo të lehtë, por të *ashpër* a të "rëndë" që asociacionisht mund të lidhet me stilin keqësues. Gjithsesi kemi të bëjmë me fenomene që dalin jashtë dëshirës së njeriut, si p.sh. bubëllon, fishkëllon (veriu) etj. Së këtejmi edhe ndër të gjitha prapashtesat e mirëfillta sinonimike numrin më të madh të temave prodhuese mbi bazë të onomatopesë i takon këtij tipi semantik foljor. Jo vetëm foljet mbi temë onomatopeike si bubëllon, shungullon, vrungullon, zëzëllon etj., por edhe foljet mbi temë emërore e foljore me prapashtesën -LLO- shprehin pothuajse atmosferë të stilit të natyrës së njëjtë me njëfarë rëndëse të pranishme, gjithsesi jo të këndshme, si p.sh. memecëlloj, ngushëlloj, humbulloj, mbushulloj, zhangëllon, shungullon, etj. Po e cek një fakt tjetër, jo sa për kërshtëri, por për arsye se zgjon interes. Në veprën poetike të Gj. Fishtes, varësisht nga tema që trajton (atmosferë luftë e të ngjashme), mbizotërojnë formimet me formantin -LLO-, madje për nga numri pothuajse u afrohen e vende-vende ua kalojnë foljeve më -NO-.

Në bazë të kësaj dukurie, siç u tha, mund të thuhet pa drojë se foljet më -LLO- kanë prire të shprehin nuanca kuptimore e stilistike të një natyre të karakterit jolehtësues, siç janë b.f. dukuritë e natyrës e analogjikisht me këtë edhe proceset e tjera që dalin mbi fjalë-tema foljore a emërore po ashtu shprehin veprime jo aq *lehtëpranuese*, jo të këndshme. Kjo mund dëshmohej edhe më mirë në vazhdim gjatë ballafaqimit me forma-

ntet e caktuara në raporte ndërsinonimike. Sa për kërshtëri, lidhur me këtë, këtu do të mjaftohem me shembullin **memecëllon**: *Armiku dëshiron të memecëllonjë shkollat tona*. Do me thënë armiku dëshiron që shkollat tona të jenë mëmece, jo normale. E njëjta fjalë-temë po të përdorej me qëllim jokeqësues, do të dilte me prapashtesa të tjera, si p.sh.: më -LO-, *memecëlon* (fëmija); më -RO-, *memecëron* (poeti i ri), mos *memeco*, po fol mirë (në stilin neutral) etj.

Po e përmend fare kalimthi edhe një shembull tjetër, b.f. me foljen **bubullon** a bumbullon, shprehet një zhurmë e fortë, ndërsa me **bubulon**⁶² shprehet një zhurmë e lehtë, jo e fortë etj. Vërejtja e mësipërme mund të ketë vend edhe për foljen *mbushulloj* të cilën e shënon A. Xhuvani si barsvlerës për abondare të italishtes d.m.th. "e mbush barkun për së tepërmi"⁶³ fjalë kjo që gjithësi përdoret për të shprehur nuanca kuptimore e stilistike të natyrës jo freskuese po rënduese. Shembuj të kësaj natyre ka mjaft me shumicë në realitetin tonë gjuhësor.

Prandaj foljet më -LLO- më tepër se çdo prapashtesë tjetër, përshtaten ose mund të përshtaten me stilin përqeshës pejorativ a për të shprehur dukuritë natyrore që shfaqen jashtë vullnetit të njeriut. S'di sa mund të lidhet kjo kuptimësi përqeshëse me përqeshjen që bëhet me të nxjerrë të gjuhës të shoqëruar me tingullin -LLË-LLË! që është a mund të jetë e pranishme edhe në skeqet humoristike ose në zënkat e ndryshme të njerëzve grindavecë. Gjithësi foljet më -LLO- më natyrshëm, se të tjerat, gjejnë përdorim në stilin tallës a përcmues a të zymtësisë. Kjo është arsyeja mbase që për konceptin "shpjegoj qartë e shqip" trajta e regjistruar në FSHS (1984) "*shqipëllor*" të mos dëgjohet gjëkund në jetën e përditshme as në kuptimin neutral. Për atë koncept, d.m.th. "*shpjegoj qartë shqip*", më i mirë do të dilte që të bëhej favorizimi i trajtës **shqipoj** (Shih: FGJSH f.541), përkatësisht **shqipësoj**, ndërsa trajta më -LLO- mund të përdoret për ndonjë shqipërim a shqipnim jo të qëlluar mirë. Edhe trajta **ngazëlloj**, ku ndër të tjera shihet një "gaz i tepërt" konkurrohet nga trajta më e favorizuar **gazmoj** si dhe ajo **ngazëllej**.

Sidoqoftë, pa marrë parasysh përjashtimet e vogla, foljet më -LLO- përgjithësisht, nisur nga fenomenet tingullimtuese edhe në nënfusha të

tjera mbulojnë një semantikë jo aq të këndshme ligjërimore. Kjo prirje, d.m.th. përdorimi i foljeve më -LLO- për koncepte përcmuese dhe të fenomeneve rënduese, gjithësi jashtë dëshirës së njeriut, na tërheq vëmendjen dhe duhet të hetohet më tej dhe të vlerësohet më mire, ngase kjo nënfushë e caktuar semantike mund të motivojë përfitime në numër jo të kufizuar shembujsh.

3. Foljet më -TO-

Lidhur me ekzistimin a për mirëfillsinë e prapashtesës -TO- asnjëherë nuk është shprehur rezervë, por rreth origjinës dhe shtrirjes së saj ende kanë mbetur gjëra që kanë nevojë për përcaktime e saktësime më të plota. Prof. Sh. Demiraj në gramatikën e tij të vitit 1971⁶⁴ shpreh mendimin se prapashtesa -TO- "duhet të ketë dalë nga bashkimi i prapashtesës -TI tregti dhe i prapashtesës -O" dhe shton se "*me të janë formuar një numër i kufizuar foljesh të prejardhura nga tema emërore si: udhëtoj, tregtoj, dëmtoj, pjesëtoj, copëtoj, farkëtoj etj.*"

Në burimin "Gjuha letrare shqipe për të gjithë" (1976), thuhet se "*me këtë prapashtesë që është më produktive se prapashtesa -RO-, janë formuar një numër foljesh kryesisht prej temash emërore*. Përveç shembujve të sipërcekur janë dhënë edhe këta: *arkëtoj, arsyetoj, udhëtoj, shkaktoj, shtegtoj, shqiptoj*. Aty shënohet e dhëna se te disa shembuj "prapashtesa -TO- del me një -A- mbështetëse si: *vizatoj, rrezatoj, miratoj*" si dhe ceket dukuria kur folja e prejardhur më -TO- ka si temë mbështetëse shumësin e një emri të pashuar tema e të cilit mbaron me një -A fundore, si p.sh. *lajkatoj (lajka), ledhatoj (ledha) etj.*

Në gramatikën e Akademisë (1976)⁶⁵ jepet një përkufizim paksa më i plotë, aty thuhet se "*me këtë prapashtesë, e cila paraqitet relativisht prodhimtare, janë krijuar folje kryesisht nga emrat*", kështu që sa i përket shtrirjes pranohet e vërteta se numri i foljeve me këtë prapashtesë "relativisht" është prodhimtar, e vërtetë kjo që është e pranishme dhe nuk vihet në dyshim as aktualisht. Në këtë burim jepen edhe këta shembuj, pothuajse

⁶² Shih Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 186.
⁶³ A. Xhuvani, Vepra II, Tiranë 1990.

⁶⁴ Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1971.

⁶⁵ Fonetika dhe gramatika ... II, f. 28.

karakteristikë, të cilët nuk i hasim në burimet e mëparshme që u përmendën më sipër, si: *pushkatoj, besatohem si dhe robothem, njoftoj, dridhtohem*.

Prof. Selman Riza si "prapashtesëzim me ndërhyrje të tingullit -t-jep këta shembuj mbi temë emërore, duke i dalluar sipas gjinisë së fjalë-temës prodhuese: (me) *shkaktuar, shtektuar, tregtuar; arkëtuat, betuar, copëtuat, pjesëtuat, rrogëtuat, udhëtuat, arsyetuat*" dhe këta mbi bazë ndaj-foljore: (me) *miratuat, shqiptuat, pezmatuat*.⁶⁶

Studiuesit ynë i mirënjohur, prof. Idriz Ajeti lidhur me këtë prapashtesë mjaft me saktësi përcakton çështjen e temës prodhuese të saj kur thekson se "foljet që dalin me -TOJ a -ETOJ formohen prej *emrash, mbiemrash, herë-herë paraqiten primitive foljesh*", duke dhënë kështu një përkufizim më të plotë rreth kësaj pike, nga sa patëm rast të lexonim në burime të tjera. Ky autor si shembuj ilustrimi, jep këto folje: *emërtoj, kuptoj, copëtoj*. Edhe prof. I. Ajeti prek çështjen e -A-së mbështetëse. Te shembujt: *rrezatoj, rrethatoj, pezmatoj* ai konstaton se "-A-ja mund të quhet e përfueme për analogji me ato fjalë që janë të pajisura me një -A- fundore".⁶⁷

Prof. Fadil Sulejmani në "Praktikumin e gjuhës shqipe" prek vetëm çështjen e -A-së si element antihiatizues. Ai shpjegon se "*disa folje të prejardhura të formuara nga fjalët temash emërore, ndajfoljore etj. me prapashtesën -TO- (në vend të zanores fundore të temës fjalëformuese) marrin për lehtësi shqiptimi zanoren -A-, si pushkatoj, besatoj, rrezatoj, miratoj*" e bashkë me të shënon edhe trajtat *vizatoj, ledhatoj*, duke mos cekur faktin se këto mund të shpjegohen alternativisht edhe si trajta të shumësit të pasquar. Pikërisht ky konstatim i studiuesit F. Sulejmani⁶⁸, na bën përshtypje të vacantë, ngase sikurse prof. S. Riza, i konstaton edhe temat ndajfoljore për këtë tip foljesh, por edhe për faktin se prapashtesën -ATOJ e zberthen: prapashtesë -TO- me një -A- mbështetëse edhe tek ata shembuj që më parë studiuesit i cilësonin si tema nga shumësi i emrit të pasquar me një -A- fundore. Po theksoj se për mendimin tonë kjo nuk është shkarje, por është një dukuri e natyrshe që vjen si përvijëzim i ndjenjës gjuhësore që del në sajë të konsolidimit të ligjshmërive të brendshme të gjuhës sonë. Çështje e vërteta, dukuria e tillë formohet nën ndikimin e proce-

⁶⁶ Prof. S. Riza, *vepra e cit.* f. 285.

⁶⁷ Dr. I. Ajeti, *St. gjuhësore...* III.

⁶⁸ Mr. F. Sulejmani, *Praktikumi...*, Prishtinë, 1980

sit të analogjisë, kështu ndodh që trajtat e ndryshme bashkohen, përngjizen në një njësi a element të vetëm, duke formuar në ndjenjën gjuhësore një njësi të re leksiko-gramatikore, gjithësi me ngjyrim a koncept të ri.

Studiuesit e historisë së gjuhës shqipe kanë mendimin se prapashtesa -TO- ka origjinë mbiemërore, formant ky që lidhet me trajtën e pjesores së shqipes, por që nuk u bë prodhimtar gjithkund, si te shembulli -të (-to): *pata *pat+TO* (Sh. Demiraj f. 366).⁶⁹ Profesor E. Çabej rastin *kaptoj* e shpjegon kap+toj nga "me të kaptë". Edhe te trajtat ajktoj (ajktoj), kultoj (kujtoj) formantin -TO- e cilëson si prapashtesë të lashtë. Po kështu e shpjegon edhe shembullin shpeshtoj.⁷⁰ Sipas po prof. Çabej: "**kuptoj** s'është gjë tjetër vetëm **kaptoj** një zgjerim faktitiv-intensiv më -(ë)toj e verbit **kap**, ashtu si madhëtoj, shtekëtoj, zitoj a si argtoj, copëtoj, dëmtoj, fajtoj, pretoj etj."⁷¹ A. Xhuvani në një punim të veçantë gjuhësor, pos të tjerash, thekson se folja "martoj" e shqipes del nga mar+toj ashtu si edhe madhëtoj e jo nga lat. "martare".⁷² Edhe prof. E. Çabej për foljen *dëmtoj* ashtu edhe për *luftoj*, edhe pse i krahason me trajtat përkatëse *dumitare, luctare* të latinishtes, kontanton me forcën e bindjes se për to (d.m.th. për dy foljet e cekura të shqipes), "s'ka vend për bazë latine".⁷³ Pos të tjerash, prof. Çabej shënon edhe këto folje më -TO-: *bythtoj, fajtoj, zitoj, vargëtoj, madhëtoj, terrtohem*.

Gjithësi rreth origjinës së saj ka vend për sqarime të mëtejshme, ashtu si edhe sa i përket përshtatshmërisë së përzgjedhjes ose përcaktimit të temës fjalëformuese me këtë prapashtesë. Në mbështetje të materialit të vjelë në FGJSSH, foljet më -TO-, sipas kategorisë gramatikore, përkatësish sipas temës prodhuese mbi këtë bazë, i merendojmë si vijon:

- 1) mbi temë emërore: *arsyetoj, ajkëtoj, emërtoj, farkëtoj, fajtoj, falloj, fjalëtoj, numërtoj, nyjëtoj, pikëtoj, pjesëtoj, palëtoj, qulltoj, robtoj, rrugëtoj, burgëtoj, dhëmbëtoj, gjakëtoj, udhëtoj etj.;*
- 2) mbi temë ndajfoljore: *shqiptoj, shpeshtoj, ëmbëltoj, mekëtoj, murëtoj etj.;*
- 3) mbi temë foljore: *njoftoj, përfiktoj, shkrijtoj, kaptoj etj.*

⁶⁹ Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988.

⁷⁰ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore* III, f. 257.

⁷¹ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore I*, Prishtinë 1976, f. 300.

⁷² A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Prishtinë 1968, f. 35.

⁷³ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore III*.

Siç po shihet, nga shembujt e mësipërm, te foljet më -TO-, numri më i madh i foljeve del i formuar mbi temë emërore, duke u paraqitur si një model fjalëformues që varësisht nga konteksti mund të përthithë edhe shembuj të tjerë, dhe kjo vlen edhe për temat mbi bazë foljore e mbi bazë ndajfoljore, ndërsa për përfutimet mbi bazë mbiemërore, siç po shihet nga konteksti, del e nevojshme të jepen sqarime më të hollësishme, pasi, ç'është e vërteta, elementi -T-, shikuar jo vetëm nga ana formale, në mjaft raste del si element që i takon temës së mbiemrit (i ndërlidhur me formën e pjesores së lashtë). Nga shembujt e konsultuar nuk duket ndonjë gjurmë e mbare-sës fundore -T- të gjinisë asnjëse të emrit.

Edhe sa i përket çështjes së përcaktimit të temës mbiemërore a ndajfoljore si p.sh. te fjala *shpeshtoj*, mund të ketë paqartësi. Mund të shtrohet pyetja: të interpretohet nga tema *shpesh-* apo nga tema (i) *shpesh(t)ë*? Pra, folja "shpeshtoj" mund të zërthehet: "përsërit shpesh", por edhe "e bëj me të shpeshhtë". Për këtë, në bazë të lëndës që u trajtua dhe u konsultua, mendoj se më tepër ka gjasa që emërtimi i tillë foljor në ndjenjën gjuhësore të folësit të interpretohet a të jetë më i përkapshëm, sipas mënyrës së parë, ngase kuptimi i ri foljor më tepër ka prirje të mbështetet në fjalë-temën bazë sesa në derivate. Po kjo ndjenjë duhet të jetë më e pranueshme për t'u favorizuar, sipas mendimit tonë, për të gjithë shembujt eventualë të rinj. Mjafton që lidhur me këtë të rikujtohet ajo që u tha pak më përparara rreth fjalë-temës zot- (zotoj) - zotëtoj etj. Në gramatikën normative folja *shpeshtoj* jepet si shembull modeli i foljes më -TO-, ndonëse sqarimi jepet "nga mbiemri "i shpeshhtë"(!) (Shih: gramatika e Akademisë (1976, f. 346).

Edhe për një çështje tjetër ka vend për diskutim këtu. Është fjala rreth vënies së -Ë-së mbështetëse apo jo, para prapashtesës -TO- te fjalë-temat, përkatësisht emrat (zakonisht të gjinisë mashkullore) që nuk e kanë një element të tillë fundor ose nuk mbarojnë me zanoren -Ë-, pasi nga pikëpamja drejtshkrimore në shkrimet tona nuk mbahet një dorë. Kështu, krahas gjakëtoj e burgëtoj dalin edhe trajtat si qulltoj, robtoj, prandaj është mirë që të merret qëndrim dhe të jepet rekomandimi i nevojshëm si rregull e qëndrueshme drejtshkrimore. Për mendimin tonë, kur tema është emër i gjinisë mashkullore, tipi qull, rob, burg, treg, gjak s' del fort e nevojshme që para prapashtesës -TO- të vihet një Ë mbështetëse.

Edhe te foljet me -TO-, siç u tha më sipër, ndeshim në raste kur prapashtesa -TO- del me një -A- mbështetëse si p.sh.: armatoj (çarmatoj), qarkatoj, miratoj, pezmatoj, pushkatoj, rrezatoj, pastaj aratoj e ndonjë tjetër. Edhe pse numri i tyre del i kufizuar, megjithatë del e nevojshme të sqarohet përfutimi i elementit -A-, qoftë nga shumësi, qoftë nga ndonjë arsye tjetër, siç është b.f. trajta e shquar e emrit përkatës. Elementi -A-, jo vetëm për farkëtime të reja, mendoj se nuk del i domosdoshëm, por edhe për ato të vjetrat mund të mënjanohet, kështu në vend të elementit -A- mund të aktivizohet elementi kundërvënës -Ë-, i cili funksionalisht atë mund ta zëvendësojë plotësisht. Në këtë mënyrë do të thjeshtësohej zgjidhja dhe do të veprohej më lehtë sipas rregullit që parashihet në gramatikë që si temë fjalëformuese të shfrytëzohet njëjësi i pashquar i emrit përkatës e jo shumësi.

E lyp puna të përmendet këtu edhe dukuria e shumimit të foljeve po me këtë prapashtesë foljeformuese. Me këtë formant dalin të krijuara disa folje morfologjikisht nga tema e qartë fjalëformuese, por semantikisht jo, ngase b.f. trajta *punëtoj* (e cila nuk del e regjistruar në FGJSSH), por del e trajtuar edhe në punimet e prof E. Çabej⁷⁴, pos tjerash e ndeshim në përdorim që nga vepra e P. N. Luarasis e deri te ajo A. Zymberit, si: bashkë/punëtoj, punëtoj punëtohet, paksa si sinonim të foljes "shërbej" apo si, "diçka që vihet në veprim", del me koncept tjetër nga folja punoj, prandaj vetvetiu imponohet nevoja e përcaktimit të nënfushës semantike që mbulojnë foljet më -TO-.

Në bazë të shembujve që qëmtuam, konstatojmë se del prirja se me foljet më -TO- pasqyrohet puna e veprimi që lidhet jo drejtpërdrejt me temën e cekur prodhuese të foljes përkatëse, po me prejfoljorin që del nga vetë folja d.m.th. me këto folje nuk tregohet aq fort bota e brendshme e njeriut sesa aktiviteti i tij i jashtëm, nëse mund të shprehemi kështu. Te një bindje të tillë arrijmë, kur të krahasohet diferencimi i kuptimeve të foljeve paralele të regjistruara në burimet e tashme normative, si p.sh. frymjoj/frymëtoj, emëroj/emërtoj, numërtoj, fjalëtoj, ëmbëltoj etj. si dhe në përjasje me prapashtesat e tjera sinonimike. Me fjalë të tjera, vetëm morfologjikisht tema e cekur fjalëformuese del e qartë, sepse kuptimisht në shumicën e rasteve zberthimi nuk del mbi këtë bazë si p.sh. *arkëtoj*, jo

⁷⁴ Dr. E Çabej, *St. gjuhësore 1*, f. 52.

běj arkë, po bėj arkëtim, arsyetjo nuk del bėj arsyje, por bėj (jap) arsyetim, bėj emërtoj nuk del bėj emër, por bėj emërtimë, shtegtoj jo bėj shteg, por bėj emërtoj nuk del bėj pjesë, por bėj pjesëtim, shqiptoj jo bėj shqip, por shtegtim(e), pjesëtoj jo bėj pjesë, por bėj pjesëtim, shqiptoj jo bėj shqip, por bėj shqiptim, njoftoj jo bėj njoftje po bėj njoftim(e) e kështu me radhë.

Më duket mjaft me peshë fakti se nuk janë të rralla rastet kur folja më -TO- të dalë në përdorim më fort në formën diatezore veprare se sa në atë pësore. Krahaso: udhtëtoj, punëtoj, palëtoj, gjalpëtoj, frymëtoj, emërtoj, tregtoj etj., ngase format e tilla sa i përket kalimtarësisë e diatezës dalin më natyrshëm në përdorim vepror nga trajtat e tjera sinonimike paralele jokalitare po mbi të njëjtën bazë temë-fjalëformuese, gjithsesi jo: punëtohem, udhtëtohem (!) etj.

Në punimin "Prapashtesat e gjuhës shqipe"⁷⁵ bashkautorët Xhuvani - Çabej, duke folur për prapashtesën -TI shënojnë edhe emrat: shtektoj, tregëti, argëti të cilët, siç thonë ata, mund të kenë dalë nga foljet tregëtoj, argëtoj, shtektoj, ose edhe sipas mundësisë tjetër: "janë formime analogjike pas emrave të tjerë në -TI". Ne raste të caktuara ne shohim një ndikim të të dy sugjerimeve, i pari, për mendimin tonë, ka mbështetje edhe nga zberthimi i kuptimit të foljes së caktuar, si p.sh. tregtoj = bej tregti, shtektoj = bėj shtektim, emërtoj = bėj emërtimë etj. Sigurisht të papranueshme dhe jo normale dalin sqarimet si b.f. tregtoj - bėj treg(!) shtegtoj - bėj shteg, emërtoj - bėj emër!, ose trajtat e diatezës pësore, sipas stilit normal: tregtohem, shtektohem, emërtohem(!) e kështu me radhë Sigurisht në këtë "rregullsi" përjashtohen foljet e nëntipit dëmtoj dëmtohem, arsyetjo arsyetohem vetëm pjesërisht. Sidoqoftë, nga shembujt përfaqësues që jepen në gramatikën e Akademisë raporti del 16 me 5 në dobi të formës veprare.⁷⁶

Ndonjë trajtë të foljeve më -TO- e ndeshim në jetën tonë të përditshme, të cilat nuk janë shënuar në fjalorët përkatës normativë, si p.sh.: rëfkëtoj (Zëri" 25. X. 1986 f. 22), murgëtoj (murgëtim) (Kosovarja" nr. 2/87 f. 11) fiktohet (Kostallari), kryqtoj (J. Ceraja), bujtoj, zvetëtoj, paqetjoj, përvajtoj, vetëtoj (L. Poradeci), panyjëtoj (Rilindja kulturore) etj., fakte këto që dëshmojnë për njëfarë shumimi të numrit të foljeve me këtë prapashtesë duke e bërë të diskutueshëm përkufizimin e dhënë në ndonjërin

⁷⁵ A. Xhuvani - E. Çabej, *vepra e cit. f. 280.*
⁷⁶ *Morfologjia ...* (1985), f. 350.

nga burimet tona normative⁷⁷ rreth "numrit të kufizuar të tyre", siç u cek më sipër, por për arsye të zberthimit që bëmë më sipër nuk mund të themi se foljet më -TO, paraqesin ndonjë model fort prodhimtar, apo më prodhimtar se foljet më -RO e të tjera.

Dalja e formantit -TO- është e dukshme edhe te disa fjalë të huazuara në shqipe, siç janë b.f. shembujt: triskë triskëtoj, poen poentoj etj. pastaj te nëntipi koncipoj konceptoj, dedukoj deduktoj etj. për çka është bërë fjalë më gjerësisht në nënkreun e mëparshëm, ku shkalla e ndërlikueshmërisë semantike e stilistike, që shprehet me foljet më -TO- nuk largohet nga suazat e neutralitetit që shprehet zakonisht me foljet më -O- pa zgjerim.

Po përfundojmë, pra, me konstatimin se, veç rasteve të veçanta, shumica e foljeve me formantin -TO- nuk shprehin ngjyresa të veçanta stilistike të botës së brendshme të njeriut, por më tepër, siç u cek pak më përpara, kanë të bëjnë me veprimtarinë e jashtme të tij. Në mjaft raste kuptimi që shprehet me foljet më -TO- del sinonimik ose i ngjashëm sa i përket shkallës së intesitetit me veprimin që shprehet me foljet më -O- pa zgjerim, ngase një numër i përfillshëm i foljeve më -TO- fillimisht nuk e kanë paralelen me formantin -O- pa zgjerim. Por, megjithatë, janë do raste që me këtë formant del i emërtuar edhe ndonjë proces teknologjik me ndërlikueshmëri të theksuar, por, sidoqoftë, mbizotëron mbulimi i nëfushës semantike jashtë botës së brendshme të njeriut, madje edhe zberthimi kuptimisht del mbi bazë prejfoljori, d.m.th. del jashtë temës së cekur fjalëformuese.

4. Foljet më -SO-

Edhe mëvetësia e prapashtesës -SO- nuk sillet në dyshim, por edhe për këtë dalin mjaft çështje që lypsen sqarur. Sidomos ka nevojë të trajtohet më hollësisht ndërlidhja e saj me prapashtesën emërore -SI e të tjera.

Prof. Shaban Demiraj në Gramatikën e tij (1971)⁷⁸ shpreh mendimin se prapashtesa -SO- "duket të ketë dalë nga bashkimi i prapashtesës -SI me prapashtesën -O". Po aty, ky autor thekson se me këtë prapashtesë

⁷⁷ *Fonetika dhe gramatika...II*, Tiranë 1976.

⁷⁸ Sh. Demiraj, *Gramatika e gjuhës shqipe* (1971)

emrit të pamë përkatës: bef-, krah- me prapashtesën -ASO/j: bef+ASOJ krah+ASOJ?

Së katërti, edhe pse, sipas konstatimeve të deritashme një gjë e tillë mund të jetë e përgjithshme, është mirë gjithashtu të konstatohet edhe më mirë fakti se a mund të përcaktohet hisja e ndikimit të emrave përkatës të prejardhur më -S dhe më -SI (të vepruesit, përkatësisht të emrave të kup-timit, tipi: gjakës gjakësi -gjakësoj, lypës lypësi) - lypësoj, zëvendës, zë-vendësim, zëvendësoj, ndërmjetës ndërmjetësi(m) - ndërmjetësoj, madje sa mund të ketë hise emri i pamë gjak- gjak+ËSOJ, përkatësisht lypë-a (me lypë) lypësoj etj.?

Me fjalë të tjera, duhet vlerësuar fakti se cila formë a mënyrë mund të ketë hise më të madhe ndikimi në perceptimin e formantit -SO- si prapashtesë të mirëfilltë foljeformuese, edhe pse sipas nesh dihet se fjala e pamë qëndron si temë bazë perceptueshmërisht e formësuar, mirëpo për raste të caktuara nuk përgjashtohet as përngjizja e mundshme: -(Ë)S + I bashkë më -O-në formojnë një "konglutinat" të prapashtesës -SO-, ashtu siç e përmendim Xhuvani-Çabej,⁸⁴ kur i trajtojnë emrat e prejardhur: grykësi, gjakësi?

Këto çështje, që vetëm sa u preken këtu, meritojnë vëmendje më të madhe e vlerësim më të hollësishtë e kompetent. Gjithsesi, del e nevojshme që për çështje të caktuara të mbahet qëndrim. Dihet se, përgjigjen më të mirë e jep, sot për sot, kriteri i motivimit, ndërsa motivimin a jep pikërisht tema bazë prodhuese (qoftë emër a mbiemër, qoftë folje etj.) apo ndonjë formë tjetër, madje që del edhe si rrjedhojë e foljes më -SO-? S' do mend, më shumë motivon në formimin e foljes përkatëse më -SO- emri **gjak-** ndaj atij **gjakës-** e **gjakësi-**, **mjek-** ndaj **mjekës-** e **mjekësi-**, **lypë-a-** (me lypë) ndaj **lypës-** e **lypësi** e kështu me radhë. Për këtë arsye, pra, del i drejtë konstatimi që formanti foljor -SO- morfologjikisht del i cilësuar si një ndajsthesë e mirëfilltë fjalëformuese të shembujt e sipërcekur. Ky fakt do të na shërbejë ne si kriter për të vlerësuar edhe (si)variantet e tjera prapashtesore të diskutueshme, siç do të shihet në pjesën vijuese të këtij kreu, mirëpo zbrëhtimi sipas bazës sintaksore e semantike në një shumicë rastesh nuk ngel në temën morfologjish të qartë fjalëformuese, nuk

⁸⁴ A. Xhuvani - E. Çabej, *vepra e cit.*, f. 478, 480.

është fjala vetëm të rastet kur fillimisht del paronimisht folja më -O-, si p.sh. anoj (mbaj anë, ndaj anësoj - e bëj të anshëm, ndrit a ndriçoj - e bëj me dritë ndaj dritësoj - e bëj më të ndritshëm, ujoj e bëj me ujë ndaj ujësoj e bëj të ujshëm, anoj - mbaj anë ndaj anësoj e bëj të anshëm, trajtoj - e bëj (diçka) me trajtë ndaj trajtësoj - e bëj (më) të trajtshëm (atë që ka trajtë), keqoj - bëj keq ndaj keqësoj - e bëj më keq, lag - hedh ujë ndaj lagësoj - e bëj (më) të lagësht, lagështoj, vërtetoj - pohoj një të vërtetë ndaj vërtetësoj - verifikoj një fakt etj., përkatësisht: shndetësoj - e bëj të shëndetshëm a e bëj (më) me shëndet, përvetësoj - e bëj për vete, ndërmjetësoj - fute më ndër-mjet, bëhem ndërmjetës, lypësoj - shtoj lypën etj.

Nga lënda e konsultuar lidhur me këtë formant mund të nxirret konkluzioni se konstatimet e dhëna në burimet përkatëse të viteve '60-'70 rreth prodhimitarisë duhet të përplotësohen, ngase siç del nga lënda e regjistruar, në FGGJSSH⁸⁵ ndeshim mbi 100 shembuj (folje) me këtë prapashtesë, pra, fjalë aktive këto të gjuhës sonë letrare, të cilat e bëjnë gjithsesi të paqëndrueshëm konstatimin se kjo prapashtesë "është pak produktive", përka-tësisht me të formohet "një numër i kufizuar foljesh". Edhe shembujt e ri si p.sh. bardhësoj (te "Rilindja për fëmijë", 6. I. 1986 f. 4), trimësoj ("Koha", nr. 2/87 f. 137) e të ngjashëm, dëshmojnë se formimet me prapashtesën -SO- nuk janë të karakterit të mbyllur, por ato kanë karakter të hapur sa i përket prodhimitarisë. Po e cek faktin se në veprat e rilindësve tanë të parë e të mëvonshëm ky formant pati përdorim mjaft të madh, madje, atje ndeshim edhe trajtat si p.sh.: kryqësoj, dritësohet (Noli); mbrothëson, frymson (Mje-dja); bardhëson, fatbardhëson, madhësohet, fortësohet, poshtëson (Nai-mi); herësoj, prapësoj, naltësoj (M. Grameno); kombësoj, qiellësoj, dje-llësoj, botësoj, pastërsoj (L. Poradeci); gugsjoj, frymsoj (Gj. Fishta) e si-domos dallohet vepra e L. Gurakuqit ku ndeshim mbi 30 raste foljesh me këtë formant si b. f.: bujarësoj, shqiptarësoj, vërtetësoj, pikësoj, jashtësoj, shfrytësoj, çanësoj etj.

Gjithsesi formimet me prapashtesën -SO- duhen ndjekur dhe rive-lësuar edhe nga aspekti i nënfushës semantike që mbulohet me to. Shikuar përgjithësisht nga ky këndvështrim, foljet më -SO- shprehin një proces që lidhet mjaft qartë me tiparin e një cilësie. Me fjalë të tjera, foljet më -

⁸⁵ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1988. Shih edhe pasqyrën e numrit të shembuj-ve të konsultuar në kreun II të këtij punimi.

SO- kuptimisht lidhen me nënfushën semantike që shprehin edhe emrat e prejardhur abstrakt me prapashtesën -(E)SI, përkatësisht mbiemrat cilësorë më -shëm, siç e pamë të shembujt e mësipërm, mirëpo ky përkufizim funksionalisht do të dalë më qartë, kur të bëhet krahasimi i nënfushave semantike e stilistike që mbulojnë foljet përkatëse që karakterizohen në bazë të formanteve prapashtesore sinonimike të tyre, siç janë b.f. formimet paralele si: formoj/formësoj/formëzoj, frymoj/frymësoj/frymëzoj e të ngjashme.

Siç u përhoqëm ta paraqitim edhe më sipër, s'do mend se zbërthimi kuptimor i foljeve më -SO- nuk bëhet mbi bazë të emrit të prejardhur më -SI dhe as mbi emrin a mbiemrin më -S, por mbi fjalë-temën bazë të emrit, mbiemrit, foljes, ndajfoljes, e cila zakonisht del si fjalë e parme, por që gjithsesi shpjgohet parësorisht me mbiemrin përkatës cilësor. P.sh. *kripësoj* - e bëj (më) me kripë, (më) të kripshëm, *aftësoj* - e bëj (më) të aftë, i shtoj aftësinë, *njomësoj* - e bëj më të njomë, më të njomshëm a i shtoj njomësinë, *dritësoj* - e bëj më me dritë, më të ndritshëm, *pakësoj* - e bëj më pak, më të pakët, *pavdekësoj* - e bëj të pavdekshëm, *pamundësoj* - e bëj të pamundshëm, *lypësoj* - e shtoj a vazhdoj lypën etj.

Siç po shihet nga zbërthimi folja më -SO-, pa përjashtuar rastet, shpreh, rëndom, një shkallë më të lartë a më të ndërlikuar të kuptimësisë sesa ajo që shprehet a mbetet në shkallën e parë neutrale që shprehin foljet më -O pa zgjerim, përkatësisht ato më -TO-, por të vihet re se veprimi i shprehur mbi bazë të temës prodhuese nuk pëson ndryshim a shndërrim substance, por vetëm shënon rritje e ngritje cilësie, si ta quaja, të substancës kuptimore e lëndore të shprehur në temën prodhuese, qoftë nga pikëpamja stilistike, qoftë nga ajo semantike.

5. Foljet më -ZO-

Në kuadër të prapashtesave "me zgjerim të -O-së" a të formantit "O-me zgjerim" prej prapashtesave standarde vetëm prapashtesa -ZO-, në burimet përkatëse normative, konsiderohet si prapashtesë aktive dhe produktive, mirëpo rreth interpretimit të saj në raport me temën prodhuese fjalë-formuese si dhe mbi përcaktimin e nënfushës semantike mbesin paqartësi jo të vogla.

Ndërsa prof. Shaban Demiraj në gramatikën e tij (1971) supozon se "kjo prapashtesë, që duket se ka dalë nga bashkimi i prapashtesës -ZË dhe të prapashtesës -O-, u ngjitet temave emërore dhe është bërë disi produktive në gjuhën e sotme" si p.sh.: *lulëzoj, dorëzoj, pyllëzoj, gjunjëzoj, copëzoj, petëzoj*", prof. Selman Riza shpreh mendimin "përkritazi me tingullin -z-, i cili ndoshta nuk është veçse varianti i zëshëm i tingullit -s-" dhe konstaton se "ai si rregull ndërhyr atëherë kur tema fjalëndërtuese është emër femëror merr si tingull fundor zanorën -ë-, përkatësisht -i-, p.sh. *dorëzuar, fuqizuar* (f. 284), mirëpo si shembuj konkretë përveç shembujve mbi bazë emërore të gjinisë femërore si: (me) *degëzuar, dorëzuar, frymëzuar, kurorëzuar, lulëzuar, shkallëzuar, shtresëzuar, udhëzuar, fuqizuar, kufizuar, therorizuar*, jep edhe këta shembuj mbi bazë të emrave të gjinisë mashkullore: *djallëzuar, gjunjëzuar, kryqëzuar, kushtëzuar, pyllëzuar, shtetëzuar* si dhe mbi bazë mbiemërore: *shumëzuar, shterpëzuar* si dhe mbi bazë foljore: *kalb; kalbëzuar*⁸⁶. Edhe dr. Ragip Mulaku ka po këtë mendim, madje është më kategorik kur thekson se "Sufiksi -zo- mendoj se ka ardhur nga -so- me anë të sonorizimit nën ndikimin e -O-së pasuese."⁸⁷

Në gramatikën e Akademisë (1976)⁸⁸ përkufizimi del disi më i plotë në krahasimin me mendimin e parë të prof. Sh. Demirajt. Aty thuhet se "me këtë prapashtesë, e cila është bërë mjaft prodhimtare, janë formuar folje kryesisht nga emrat edhe nga pjesët e tjera të ligjëratës, sidomos nga mbiemrat (Aty f. 253) dhe për ilustrim jepen këta shembuj:

- 1) *bulëzon, copëzoj, dorëzoj, frymëzoj, gjunjëzoj, kolonizoj, kryqëzoj, kufizoj, lëngëzoj, lulëzoj, motëzoj, ndajfoljëzoj, petëzoj, pyllëzoj, rrokëzoj, shtetëzoj, trupëzoj, udhëzoj, valëzoj, vargëzoj*; (me temë emërore);
- 2) *dyzoj, njëzoj* (me temë numërore), *shumëzoj*; (me temë ndajfoljore);
- 3) *aktivizoj, centralizoj, industrializoj, kolektivizoj, kombëtarizoj, konkretizoj, ndërkombëtarizoj, belbëzoj* etj. (f. 251); (me temë mbiemërore).

Mund të konstatohet se nga disa fjalë-tema nga shembujt e mësipërm nuk dalin të përfuara foljet paralele më -O- pa zgjerim, por një mundësi e tillë nuk përjashtohet. Ato në nënvetëdije mund të qëndrojnë si

⁸⁶ Prof. Selman Riza, *vepra e cituar* f. 284, 285.

⁸⁷ Dr. Ragip Mulaku, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*..., Prishtinë f. 161

⁸⁸ *Fonetika dhe gramatika II*, Tiranë 1976.

rezervë e ofrueshme, natyrisht, nëse paraqitet nevoja për të shprehur, qoftë koncept të ri neutral, qoftë ndonjë tjetër. Edhe nga kjo pikëpamje ravijëzohet qartë autonomia kuptimore e prapashtesës -ZO-.

Në burimin "Gjuha letrare shqipe për të gjithë" (1976)⁸⁹ theksohet edhe më qartë mirëfillësia e prapashtesës në fjalë. Aty thuhet se "prapashtesa -ZO-, e cila është shumë produktive dhe aktive në gjuhën e sotme letrare, sidomos në publicistikë e në terminologjinë teknike e shkencore, bashkohet kryesisht me temë emrash". Për ilustrim jepën po ata shembuj që janë dhënë në burimin e cituar pak përpara. Në këtë tekst veçan ceket çështja e ndërkombëtarizimeve me -IZO- fundore, duke e cilësuar formantin -IZO- si prapashtesë më vete, por që nuk trajtohet veçan, veçse në kuadër të prapashtesës -ZO-. Aty thuhet se "krahas këtyre formimeve, në shqipen e sotme letrare përdoren folje me prapashtesën -IZO; zakonisht këto janë fjalë të huazuara që i janë nënstruar sistemit morfologjik të shqipes" dhe për këtë jepën këta shembuj: aktivizoj, ekranizoj, industrializoj, kolektivizoj, konkretizoj, militarizoj, rajonizoj, revolucionarizoj, stabilizoj etj.

Nën ndikimin e këtyre fjalëve në shqipen e sotme letrare kanë filluar të formohen edhe fjalë me prapashtesën -IZO- nga tema të vetë shqipes, si p.sh.: kombëtarizoj, shqiptarizoj etj. Këto formime janë shumë aktive⁹⁰ - theksohet në atë burim, mendohet për shembujt mbi temë të një fjalë ndërkombëtare, ngase ato mbi fjalë-temat e shqipes më normalisht do të dilnin trajtat pa infiksin -I/z, p.sh. në vend kombëtarizoj kombëzja o kombëtarëzjoj, në vend shqiptarizoj - shqiptarëzjoj a shqiptarj etj.

Vetë fakti i mosndarjes në grup më vete të foljeve më -IZO-, edhe pse duke e theksuar si variant më vete dhe duke i quajtur foljet më -ZO- se ato nuk janë fjalë të huazuara, e bën të diskutueshëm mirëfillësinë e formantit -IZO-, siç është bërë në kreun I të këtij punimi, por që do të rimerret në shqyrtim si pikë më vete edhe në nëntitullin vijues të këtij nënkreu, prandaj këtu nuk do të flitet më për veçoritë e këtij formanti të diskutueshëm.

Lidhur me foljet më -ZO-, është me interes të ceket fakti se prof. E. Çabej ashtu edhe prof. I. Ajeti, nga aspekti i morfologjisë historike, prapashtesën -ZO- e identifikojnë si formant më vete edhe kur e trajtojnë

⁸⁹ Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976., f. 229

⁹⁰ Po aty f. 229.

formimin e shembullit "kallëzjoj", nga kall- këllas *qell. Po këtë prapashtesë e cek prof. E. Çabej edhe te shembujt: pagëzjoj e trazoj.⁹¹ Edhe prof. A. Xhuvani e pranon se folja pronjëzjoj (pronësor) është krijuar sikurse "copëzjoj, shkumbëzjoj",⁹² d.m.th. me prapashtesën -ZO-. Ky autor trajton edhe këta shembuj: kukuzohem e qimzjoj (me qimzue e me qipzue). Sigurisht një analizë më e hollësishtme do të sillte rezultate edhe më me vlerë edhe rreth zbrërthimit të prejardhjes së paqartë në dukje të disa foljeve a të temave të atyre foljeve, siç janë shembujt: kilzjoj (kilzël!), shtërzjoj(!), mrizjoj (mriz), brizjoj (bri-), gëzjoj (gaz), - sepse tema motivuese e të cilave në gjuhën e sotme del me kuptimësi paksa të zbehur.

Nga shembujt e vjelë në FGJSSH⁹³ që kalojnë shifren 100, vërtetohen konstatimet e mësipërme mbi prodhueshmërinë e të tjera që u thanë lidhur me formimet e foljeve me këtë prapashtesë. Vërtet, shumica e shembujve dalin të formuar mbi temë emërore, por edhe mbi temë numërore, si p.sh.: dyzjoj, njëzjoj, dymëzjoj; mbi një temë ndajfoljore: shumëzjoj, shazzjoj; mbiemërore (ndonëse në numër fare të vogël) si p.sh. belbëzjoj, shterpëzjoj e ndonjë tjetër. Mbi bazë të temës foljore dalin këta shembuj: shtirzjoj, shkrifëzjoj, kalbëzjoj, unzohet e shkallzjoj.

Siç pos shihet, pos atyre me temë emërore, formimet mbi kategori të tjera dalin në numër të kufizuar, madje edhe ato, hiq ndonjë shembull, mund të shpjegohen si formime analoge, sipas modelit ekzistues mbi temë emërore.

Meqenëse kjo temë është trajtuar më hollësisht në kreun I të këtij punimi, siç u cek më sipër, këtu po theksoj a ritheksoj edhe ndonjë rast me interes, që më duket se shkon në dobi të përlotësimit të trajtimit të mëtutjeshëm të temës në fjalë.

E para, po përmend trajtat paralele, tipi: ekonomim ekonomoj/ ekonomizim ekonomizoj e të ngjashme. Folja në trajtën ekonomoj nuk ka shtrirje të gjerë në gjuhën tonë aktualisht, por ajo mund të dalë në saje të sistemit që ka struktura fjalëformuese e gjuhës sonë dhe se një formë e tillë del e

⁹¹ Dr. E. Çabej, St. gjuhësore II, Prishtinë 1976 dhe Dr. I. Ajeti, St. Gjuhësore III, Prishtinë 1988.

⁹² A. Xhuvani, St. gjuhësore, Prishtinë 1968, f. 128, 143.

⁹³ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.

ksa të fytyruara, por kjo nuk do të thotë se foljet më -RO- janë të përjash-tueshme në stilet e tjera të ligjërimit. Foljet më -RO-, mbi bazë tingulli-mit, nuk i nënshtrohen konstatimit të sipërcekur dhe as konkurrencës me foljet më -NO e të tjera.

2. Foljet më -LLO- të tipit: memecëllon, rrapëlloj, mykllohet, bu-bullon, fërfëlloj etj., pos atyre me temë onomatopeike, i karakterizon se-mantika që lidhet në njëfarë dore me veprimet të natyrës që kryhen jashta dëshirës së njeriut, paksa me hijesë zymtësie, që përshtatet me fenomenet a veprimet e natyrës që shprehen me foljet më -LLO-. Janë jo pak shembuj me këtë prapashitë, ku tregohet njëfarë ngritjeje intensiteti ndaj shkallës neutrale të kuptimësisë. Zakonisht shprehen elemente të stilit jo të mëveshur me kuptim të fytyruar. Tema nuk motivon drejtpërdrejt por tërthorazi, p.sh: rrapëlloj - bëj (bën) rrap -rrap, memecëllon - bën më-më, bën si memec etj.

3. Foljet më -TO- të tipit: burgëtoj, tregtoj, dëmtoj, rrugëtoj, copëtoj, shkaktoj, veshtoj etj., pos ndonjë rasti, pothuajse nuk motivojnë shkallëzim nuançe kuptimore a stilistike. Kuptimësia e tyre mbetet ajo e shkallës së parë, sidomos tek ata shembuj që fillimisht kanë dalë me këtë formant, duke e anashkaluar, si të themi, shkallëzimin -O- pa zgjerim, por në rastet kur folja më -TO- ka dalë si paralele ndaj sishoqes së saj ekzistuese më -O-, folja e tillë ka mundësi të marrë kuptim të shkallëzuar leksikor. Zbërthimi i foljeve më -TO- nuk del në të gjitha rastet ngjashëm si te foljet më -O- pa zgjerim me temë të qartë fjalëformuese, p.sh. dëmtoj - bëj dëm a bëj dëmtim, rrugëtoj - bëj rrugë a bëj rrugëtim) etj., por mbështetet edhe në emrin e prejardhur jo pjesërisht, si te shembujt e mëparashëm, po plotësisht, si p.sh. tregtoj - bëj tregti (jo *bëj treg*), shtegtoj - bëj shtegtim (jo *bëj shteg*), arsyetoj - bëj arsyetim (jo *bëj arsye!*) etj. Foljet më -TO-, përgjithësisht shprehen një veprim që, zakonisht, mbetet jashtë botës së brendshme të njeriut dhe jashtë fjalë-temës prodhuese fjalëformuese, por lidhur me prejfoljorin përkatës.

4. Te foljet më -SO-, tipi: plotësoj, bardhësoj, zotësoj, formësoj etj. dallon shkalla e intensitetit lidhur me pasqyrimin e veprimit a të gjendjes. Shprehja, vërtet, fiton ngritje cilësie në fushë të abstraktimit, por në këtë ndjeshmëri a ngritshmëri nuk ndryshon substanca që pasqyrohet me te-

mën prodhuese motivuese. Zbërthimi i tyre, zakonisht, del me shkallëzim lartësor në fushë të abstraksionit, si p.sh.: plotësoj - (e) bëj (më) të plotë, bardhësoj - e bëj (më) të bardhë, zotësoj - i dal zot më mirë, formësoj - e bëj më me formë, më cilësor etj., por, siç u tha, pa i ndryshuar substanca kuptimore e lëndërore konceptit themelor të temës prodhuese.

5. Te foljet më -ZO-, tipi: lulëzoj, sapunëzoj, emërzoj, formëzoj, se-ndëzoj etj. kemi të bëjmë jo vetëm me ngritje të shkallës së ndërlidhesh-mërisë, por kemi të bëjmë edhe me ndryshimin e substancës që lidhet me temën prodhuese motivuese, e cila gjatë procesit të punës nëkuptohet si lëndë e bërë nga shndërrimi i substancës. Zakonisht me foljet më -ZO- shprehen procese teknologjike kimike a të ngjashme, gjithësi me ndërlidheshmëri të një shkalle të lartë, por me to rëndom nuk shprehen ndjesi, pos ndonjë rasti të përdorur në mënyrë të fytyruar. Zakonisht zbërthimi i foljes së tillë mund të bëhet: *shndërroj në ...* (+ tema fjalëformuese), p.sh. kripëzoj - shndërroj (një lëndë) në kripë, sapunëzoj - shndërroj (një lëndë) në sapun etj.

Edhe në qoftë se mbi fjalë-temat e foljeve -O- me zgjerim fillimisht nuk janë shfaqur foljet më -O- pa zgjerim, një mundësi e tillë mbetet si rezervë e mundshme, e cila mund të shfrytëzohet në çdo kohë, po të jetë e nevojshme. Sigurisht një mundësi e tillë do të futet në veprim për kon-cepte a nuanca të reja kuptimore pa rrezikuar funksionet e formanteve -O- me zgjerim e anasjelltas, sipas nënfushave përkatëse semantike që mbulojnë hë për hë a priren të mbulojnë ato.

Edhe ky fakt duhet pasur parasysh me rastin e përfimit të shembuj-ve të rinj.

B. FOLJET E PREJARDHURA ME FORMANTET SI VARIANTE TË PRAPASHTESAVE TË MIRËFILLTA "O ME ZGJERIM"

Siç mund të jetë parë nga analiza e mësipërme, për formantet prapashtesore -RO-, -TO-, -SO-, -ZO- supozohet fillimisht se ishin krijuar nga "metaanaliza", përkatësisht nga përngjizja e formanteve emërore me ato foljore. Mirëpo edhe si të ishte kryer vërtet një *metaanalizë* e tillë, ky proces nuk pengoi aspak që ato edhe nga vetë autorët e supozimit të tillë, në *fjalëformim*, të cilësoheshin si prapashtesa të mirëfillta a *si variante sinonimike* të -O-së me zgjerim. Kështu, pra, siç u përmend më sipër (në parim) sipas prof. Sh. Demirajt:

-RO- mund të ketë dalë nga -RI (prapashtesë emërore) + O/j (prapashtesë foljore), si p.sh.: mishëri(!) mishëroj, kalëri - kalëroj;

-TO- nga -TI (prapashtesë emërore) + O/I (prapashtesë foljore) si p.sh. tregti tregtoj, fallti (!) falltoj;

-SO- nga -SI (prapashtesë emërore) + -O/I (prapashtesë foljore) p.sh. njomësi njomësoj; kripësi kripësoj;

-ZO- nga -ZË (prapashtesë emërore) + -O/I (prapashtesë foljore) si p.sh. shtetëz(!) shtetëzoj, sapunëz(!) sapunëzoj si dhe analogjikisht, do thoshim ne, edhe

-LLO- po ashtu supozohet se mund të ketë dalë nga -(ë)LL- (prapashtesë anatopeike) + O/j (prapashtesë foljore), si p. sh.: mbushulli(!) mbushulloj, vringëlli(!) vringëlloj;⁹⁴

Sigurisht dalja e shembujve të tillë dhe qëndrueshmëria e tyre, si në çdo proces tjetër gjuhësor, është kushtëzuar reciprokisht herë më pak e herë më shumë, qoftë nga shtytës jashtëgjuhësorë, qoftë nga ata brendagjuhësorë.

Pra, ne pa e kontestuar me çdo kusht supozimin e mësipërm, konsatojmë se për të ndikuar në ndjenjën gjuhësore që formantet e mësipërme të përkapen, pa hamendje, si prapashtesa të mirëfillta, pati më vonë edhe shtytës të tjerë të arsyeshëm, siç është numri relativisht i madh i formimeve të tilla, të përfuara qoftë edhe me analogji, por sigurisht të krijuara

⁹⁴ Shembulli më -LLO- i është shtuar supozimit, ngase autori në fjalë as nuk e mohan as nuk e pohan një mundësi të tillë metaanalize.

nga nevoja, dhe kjo dëshmohej sot për sot nga prija që rastet kaluan në dukuri dhe nga dukuria në model për të mbuluar kështu nënfusha të caktuara semantike me formantet e tilla foljore, siç u cek në nëntitullin e mëparshëm.

Pra, pa e kundërshtuar kategorikisht (në raste) supozimin e mësipërm lidhur me metaanalizën: -R/I+O, -T/I+O, -S/I+O etj., po shtoj se në gjendjen e sotme, si te shembujt e mësipërm e të ngjashëm me ta, në ndjenjën gjuhësore zor që mund të shihet ndonjë gjurmë e një kontaminimi të tillë, siç u përmend më sipër, ngase në të vërtetë, nuk ka gjasa të ekzistojnë, sot për sot, në përdorim të përditshëm normal emrat, si b.f.: kalër+i, fallt+i, njomës+i, kripës+i; shtetëz+ë, sapunëz+ë, mbushull+i, vringëll-i - ku do të mbështetej kuptimi i ri foljor, i cili, gjithsesi, gjen mbështetje të fjalëtema e parme kuptimplotë: kalë, (me) mbush/u/r(*n), fall, kripë, shtet, sapun e kështu me radhë.

Në këtë kuadër vlen të përmenden edhe tri fakte të tjera të ndërlidhura, të cilat nuk pengojnë identifikimin e prapashtesave përkatëse -O- me zgjerim:

E para, siç e thekson edhe prof. Selman Riza në punimin e tij, formantet e tilla, si tinguj ndërhyrës, nuk shërbejnë vetëm në sistemin foljeformues, por edhe në sistemin emërformues, ngase sikurse "*tingujshi -ën, -ër, edhe tingujt -s-, -t-, -z- në vend që të ndërhyjnë vetëm në ndërtimin e foljevet, përkundrazi si rregull ndërhyjnë barabar edhe në ndërtimin e emrave, qoftë të vetë cilësisë, qoftë bartësit të kësaj cilësie të fundit me të njëjtën temë fjalëndërtuese*"⁹⁵. Ç'është e vërteta, nuk mund të mohohet një fakt i tillë, krahaso: foljet më -RO- dhe formimet i sistemit emëror më -R- a -N- e ndërhyrës të tjerë si b. f.: burrëni/burrëri, burrënor/burrëror; hyjni, hyjnor; madhëni/madhëri, por edhe shembuj të tjerë ai p.sh. më -SO-: saktësi, aftësi, urtësi etj.; më -TO-: shkaktar, shtektar, tregtar; më -ZO-: lulëz, lulëzor, dorëz etj. Prandaj, pa e mohuar këtë ndërlidhje a koincidencë ky fakt nuk ka penguar që të identifikohet folja me prapashtesat përkatëse -O- me zgjerim, formante këto që i njih gramatika, por më gjerësisht po trajtohen në punimin tonë.

E dyta, gjithashtu dihet fakti tjetër se ka raste, pa e cekur trajtën eventuale të shumësit të emrave me -ër/-ën, që elementi i caktuar mbështetës të shërbejë edhe për formimin e foljeve me formante të tjera prapashtesore

⁹⁵ S. Riza, *Vepra 2*, Prishtinë 1997, f. 283.

si p.sh. *-e/fj, -i/fj, -it, -is* etj. si p.sh.: zbardhëlloj ndaj zbardhëllej, zbardhëllij⁹⁶; mumuroj ndaj mumurit, përralloj ndaj përrallos, përrallis etj., prandaj as ky fakt ngjashmërie nuk ka penguar që folja përkatëse të cilësohet si folje e prejardhur me formantin përkatës -O- me zgjerim.

E treta, ndonëse zbrëthimi i disa foljeve drejtpërdrejt nuk bëhet mbi temën morfologjiksht të qartë fjalëformuese, por zakonisht mbi prejfoljen përkatës, si, p.sh. **hapëroj** – jo nga bëj hap po nga togfjalëshi *bëj hapërim*, **arsyetoj** jo nga bëj arsye, po nga *bëj (jap) arsyetim*, **tregtoj** jo nga bëj treg po nga *bëj tregti(m)*, **farkëtoj** jo nga bëj farkë, po nga *bëj farkëtime*, **sapunëztoj** jo nga bëj sapun a përdor sapun, po nga (diçka që) *shndërroj në sapun* etj., fakt ky që aspak nuk ka penguar që foljet e caktuara të cilësohen me prapashtesat përkatëse, sipas temë-fjalës morfologjike.

Sidoqoftë edhe pse mirëfillësia e prapashtesave të mësipërme ende, për ndonjë pikë a shembull të caktuar, mund të paraqitet e diskutueshme, mbase edhe vetëm pjesërisht a vetëm në disa raste, besojmë se te shumica e shqipfolësve në përgjithësi dhe të studiuesve në veçanti, mirëfillësia e foljeve -O- me zgjerim assessi nuk vihet në dyshim. Me fjalët të tjera, pavarësisht nga zanafilla etimologjike e ndonjë shembulli të caktuar, ngjashmëria me raportin emërfomues e me raste të tjera foljeformuese etj., vetë zhvillimi i brendshëm i gjuhës sonë mundëson që sot formantet në shqyrtim morfologjiksht të perceptohen e si rrjedhim edhe të trajtohen pamëdyshje si prapashtesa të mirëfillta foljeformuese. Kjo ripërsëritje e konstatimit (ndoshta me tepri) rreth ecurisë së formëzimit të konceptit të rumbullakësuar, po bëhet prej nesh edhe për qëllim didaktik, ngase duke e shfrytëzuar parimin "nga e njohura tek e panjohura", një bindje e tillë do të na mundësojë për t'i kuptuar, cilësuar a perceptuar më me lehtësi dhe drejt edhe formantet e grupit të dytë si dhe ato të grupit të tretë si prapashtesa foljeformuese, edhe pse këtu, në këtë punim, ato të grupit të dytë i quajmë "(si)variante", ndërsa ato të grupit të tretë "**formante të diskutueshme**".⁹⁷

Është e vërtetë se ndonjëra nga (si)variantet e këtij grupi nga studiues të caktuar janë zënë në gojë edhe më përpara si prapashtesa foljeformuese

⁹⁶ Dhe kjo aspak nuk ka penguar në identifikimin e prapashtesës -LLO-.

⁹⁷ Sqarimi është dhënë në kreun II të këtij punimi.

më vete, mirëpo trajtime të veçanta lidhur me to nuk do të ketë pasur. Ato këtu do të paraqiten, me sa di unë, të trajtuara më gjerësisht se anjëherë më parë, ndonëse jo në mënyrë shteruese.

1. Foljet më -NO-

Kriteri i njëjtë që vlente për përcaktimin e mëvetësisë së prapashtesës -RO- mund të zbatohet edhe për formantin -NO-. Madje konsiderohet se historikisht formanti -N/O- në disa raste, që tash paraqiten me alternim, pa dyshim ka moshë më të madhe sesa formanti -R/O-. Siç dihet, këto dy fonema kundrohesh nga dy dukuri kundërvënëse: rotacizmit e jorotacizmit, të cilat mbi këtë bazë edhe sot mjaft ndërferkohen në gjuhën tonë. Këto dy dukuri, siç dihet, janë veçori dalluese të të dy dialekteve të shqipërishtes e gegërishtes. Edhe pse prof. E. Çabej për nazalizmin (jorotacizmin) shprehte mendimin se "pas gjase është një risim, një inovacion, relativisht i ri i gegërishtes, i kryer mbase aty nga mesjeta e herashme"⁹⁸, ne mund të shtojmë se rotacizmi duhet të jetë edhe ky fenomen ende më i ri, ngase nga formanti -N- (-NO-), thonë studiuesit, doli formanti -R- (-RO-). Rotacizmi, thotë Anastas Dodi, është "*alternimi i parë në planin ndërdialektor, fenomen ky që shpjegohet se -N-ja duke ndodhur midis dy zanoresh okluzioni nuk është kryer dhe me humbjen e nazalitetit është kaluar në R*".⁹⁹ Pra, alternimi n/r ndodhi si rezultat i dukurisë së rotacizmit, fenomen ky që e pati prekur kryesisht dialektin jugor të shqipërisë në periudhë të caktuar historike dhe që pushoi së vepruari, siç thuhet nga studiuesit, aty nga shekulli VII-VIII i erës sonë, ndonëse përfitimet me analogji, si raste, mund të shfaqen edhe aktualisht.

Profesor Selman Riza si "tingujsh ndërhyrës jokuqtimbartës bashkë me tingujt s, t, z të shqipërisë dhe atë të huajin -IZ-, quan edhe -ën- e -ër-, ndonëse, siç e shpjegon ai "*tingujshi -ën/-ër te folja (me) vëllazënuem, vëllazëruar mendohet se qenka mbarsë e numrit shumës të emrave përkatës,*

⁹⁸ Përveç prof. E. Çabej, A. Kostallari etj. për rotacizmin/jo rotacizmin (nazalizmin) shih edhe te A. Dodi në *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe* (1968), Prishtinë 1970, ku shprehet: "rotacizmi është alternim i parë në planin ndërdialektor. Ky alternim është i vjetër dhe ka pasur shprehje vepruar ndoshta aty kah shek. VII, VIII" (Aty f. 83).

⁹⁹ Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1978, f. 83.

*kurse tek foljet (me) pleqnuem, pleqëruar është tejshtrirje analogjike e së njëjtës mbarese.*¹⁰⁰

Sidoqoftë, me të drejtë prof. Idriz Ajeti bashkë me prapashtesa të tjera foljore cek edhe prapashtesën -(Ë)NOJ, për të cilën konstaton se është formuar "me zgjanimin e prapashtesës -OJ"¹⁰¹ dhe vazhdon se "me formantin -NOJ (tosk. -ROJ), -ËNOJ (-ËROJ) na dalin folje të formuara nga emra, mbiemra" dhe për këtë i shënon këta shembuj: "trimnoj (trimëroj), mbretnoj (mbretëroj), plehnoj (plehëroj), pastaj "burrënoj (burrëroj), qytetnoj (qytetëroj), turpnoj (turpëroj)" si dhe **vargnoj**, së cilës nuk i shënon pranë përgjegjësen e mundshme në toskërishte. Po ashtu i shënon dy raste me -RO-: **flakëroj** e **hudhëroj**, të cilave nuk u shënon pranë përgjegjëset e mundshme në dialektin e gegërishtes. Me gjasë, trajtat e tilla gjegjëse nuk ishin të zhvilluara fare në dialektin gegë (flakënoj, hudhënoj!), ashtu si edhe në toskërishte trajta vargëroj(!).

Pra, nga shembujt që sjell për ilustrim prof. I. Ajeti mund të nxirret përfundimi se format që shënohen në dy trajtat dialektore, ato, vërtet, edhe nuk paraqitin kundërvënien semantike, por ishin thjesht "trajta dysore", siç thuhet në gjuhësinë tonë. Mirëpo nga shembujt, ndonëse të pakët që i shënon autori vetëm në njërin dialekt, siç është rasti **vargnoj** me prapashtesën -NO-, në njërin anë dhe të dy shembujve: **flakëroj** e **hedhuroj** me prapashtesën -RO-, në anën tjetër, tregon për dukurinë tjetër se këto dy formante mund të paraqiten në raste, edhe veç e veç, që do të thotë, secila ka a mund të ketë zhvillim të pavarur në dialektin përkatës, por, si të tilla edhe të marrin shtrirje, madje edhe të zënë vend, në kuadrin të gjuhës së njëzuar letrare. Është i njohur fakti se gjuha jonë letrare kombëtare është shkrije organike e dy dialekteve të shqipës dhe se ka sistem të vetin që ndryshon në njëfarë dore nga sistemet e dialekteve, sipas kuptimit të ngushtë të tyre, atëherë, këto dy forma, secila veç e veç, brenda njërive të caktuara leksikore mund të shfaqen, pra, edhe në gjuhën e përbashkët letrare. Aq më tepër kjo dukuri është e mundshme të sendërhoet, kur dihet fakti se të dy këta tinguj sonantë kanë shtrirje dhe bëjnë jetë të pavarur në të dy dialektet, jo vetëm si tinguj brenda fjalës së caktuar, por edhe në përbërje të formantit të caktuar sinonimik prapashtesor.

Sa për kërshëri po e cek faktin se në FGJSSH nga fjalë-tema **varg-**ndeshim trajtat foljore: **vargoj**, **vargëtoj** e **vargëzoj**, por jo edhe atë **vargnoj** të shënuar nga prof. I. Ajeti. Mosfavorizimi i trajtës më -NO- **vargnoj** në FGJSSH nuk do të thotë se trajta e tillë nuk ekziston në sistemin e përgjithshëm të gjuhës sonë standarde dhe si e tillë në atë formë ajo nuk përdoret a nuk duhet të përdoret. Si dëshmi se vazhdon të përdoret fjala **vargnoj**, po përmend dy raste, njërin në revistën "Pionieri" 1-2/95 në togfjalëshin: "ia vargnoji filozofi" si dhe tjetrin në një poezi të A. Podrimes (Bujku, 25. X. 97, f.12), mirëpo, në anën tjetër, kjo nuk do të thotë që edhe trajta **vargëroj** nuk mund të dalë në përdorim për ndonjë arsye, mbase poetike e ku ta dimë në ndonjë stil ligjërimi. Sidoqoftë, shembujt si **vargnoj** e të tjerë, d.m.th. të formuar pa dysorin aktualisht, ta quajmë kushtëzimisht joekzistent në dialektin tjetër nuk janë raste të rralla, dhe kjo lypset trajtuar në mënyrë më të plotë, ngase siç e përmend J. Gjinari "gjuha letrare e njëzuar, ashtu si deri tashti do të vijojë të marrë edhe nga të folme të dialektit verior fjalë si njësi leksikore të veçuara, që do të kenë në përbërjen e tyre fonematike bashkëtingëlloren -N-".¹⁰² Po ashtu edhe trajtën "hudhëroj" dhe as atë "hedhuroj" nuk e ndeshim në FGJSSH, por vetëm atë **hedh**, por kjo aspak nuk i ul vlerën punimit të prof. I. Ajetit, pasi edhe trajta hudhëroj (hedhëroj) del a mund të dalë e përdorur fare natyrisht në praktikën tonë gjuhësore, jo më vetëm si trajtë thjesht dialektore, por sipas gjedhes ekzistuese, rastet e tilla mund të zënë vend në gjuhën tonë standarde kombëtare normalisht, kur dihet fakti se ka ndryshuar a duhet patjetër të ndryshojë koncepti njëdialektor për gjuhën e njëzuar letrare kombëtare. Tashti gjithnjë e më shumë del e formësuar ndjenja gjuhësore se një fjalë a formë shprehëse që i nevojitet gjuhës letrare pa marrë parasysh formën zanafillëse dialektore, ajo mund të integrohet në sistemin e saj dhe ka gjasa të jetë e përvetësuar dhe si njësi e nevojshme të zërë vend në thesarin me vlerë aktive të gjuhës standarde kombëtare.

Për të pasur ide edhe më të qartë rreth përparisë kohore të formantit -NO- ndaj atij -RO- po i referohemi konstatimit të prof. Shaban Demirajt, i cili thotë se "prapashtesa me origjinë mbiemërore është përgjithësisht që heret si formant pjesoreje në gjuhën shqipe, ku përdoret kryesisht si formant i tillë" dhe më poshtë konstaton "kjo prapashtesë në tos-

¹⁰⁰ Prof. S. Riza, *Vepra 2*, Prishtinë 1997, f. 283

¹⁰¹ Akad. Idriz Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe* (morfologjia historike), Prishtinë 1965, f. 87.

¹⁰² J. Gjinari, *Rotacizmi në dialekte dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë 1/86, f. 39.

kërishte ka pasur një shtrirje më të gjerë se në gegërishte. Kështu ndërsa në gegërishte foljet, që në të kryerën e thjeshtë dalin me temë në zanore në pjesore dalin më fort me prapashtesën -M; në toskërishte ato kanë dalë prej kohësh me prapashtesën -NO-, e cila në atë dialekt ka dhënë -RO-, nëpërmjet evolucionit të njohur -N : -R".¹⁰³

Siç dihet, në drejtshkrimin e gjuhës së sotme letrare shqipe u është dhënë përparësi trajtave me prapashtesën -RO- si p.sh. trajtat si: vejnjo, shterpnjo, zgjanjo etj. që ishin në FGJSH (1954) në FGJSSH 1980 dalin vetëm më -RO-: vejëro, shterpëro, zgjero etj, d.m.th. janë parapëlqyer vetëm trajtat me rotacizëm që është veçori e dialektit toskë, i cili edhe është marrë si dialekt bazë për gjuhën e njëzuar letrare, megjithatë, edhe pse "rotacizmi, sipas normës sonë letrare, mbizotëron, zotërimi i tij nuk është absolut", thotë prof. I. Ajeti, dhe për këtë përmend ndonjë rast të ndërhyerjes së tij, si p. sh.: "nga syri synoj", "jo hapësiror por hapësiror" dhe "duke ndjekur këtë prijje a logjikë të brendshme të zhvillimit të gjuhës sonë, vazhdon ai, "është normal të tolerohen shumësat barna, sepse themi barnatore, mbiemri burrënor (burnor burni) sepse burrëri - barrëra, me kohë do të kemi zhvillime të asimiluara burri, barra ..."¹⁰⁴

Pra, megjithë favorizimin e trajtave të formimit të foljeve më -RO-, në gjuhën e sotme letrare sipas FGJSSH dhe FSHS (1984)¹⁰⁵ janë ruajtur pa pësuar rotacizëm nga analogjia një numër foljesh si p.sh.:

Bishtnoj (bisht), penoj (pe-ri), frenoj (fre-ri), plënoj (plle), gardhnoj zhgardhnoj (gardh), zhburrnoj (burrë), krenohen, përkrenoj (krye/kren), përcudnoj (cudë), cubnoj (cub), dreqnoj, përdreqnoj (dreq), synoj (sy-ri), hijenjo (hije), drunoj (dru-ri), drynoj (dry-ri), breshitnohen (breshitë), gru(e)nohet (grue), shinoj (shi), vregnoj (vregë, vragë), zvetënoj (vetë-), laknoj (lak), përpikënoj (pikë) e ndonjë tjetër.

Është me interes të ceket fakti se asnjëri nga shembujt e sipërcekur sipas FGJSSH-së nuk e ka të zhvilluar emrin me prapashtesën -NI që e përmend prof. A. Kostallari, kur konstaton se në sistemin e gjuhës së sotme

¹⁰³ Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, f. 936-940.

¹⁰⁴ Dr. Idriz Ajeti, *Probleme aktuale të kulturës së gjuhës*, Gjurmime albanologjike, s. sh. fil., XI/81, f. 12.

¹⁰⁵ Është fjala për *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1880) dhe *Fjalorin e shqipes së sotme*, Tiranë 1984.

letrare kombëtare "është gjallëruar prapashtesa -(Ë)NI si pasojë e pranimit të thyerjes së rotacizmit nga gjuha letrare (Shih: brezni, besëtytni, hyjni, trysni, ardhmeni etj.),¹⁰⁶ dhe kjo, për mendimin tonë, dëshmon për autonominë fjalëformuese të prapashtesës -NO-, pa u ndërlidhur patjetër me prapashtesën emërfomuese -NI.

Edhe pse edhe për prapashtesën -NO- mund të qëndrojë supozimi i metaanalizës, siç u përmend për raste të tjera, si p.sh. -NI me -O- = -NO- si p.sh. trysni trysnoj, rini rinoj, hyjni hyjnoj, brezni breznjo etj., por mëvetësia e saj prapashtesore asses s'bën të mohohet.¹⁰⁷ Rikujto, arsyen që u tha më përpara, kur bëmë fjalë për dukurinë e metaanalizës, te foljet më -RO e të tjera.

Ç'është e vërteta, sipas materialit të vjelë në FGJSSH, foljet më -NO-, d.m.th. të parotacizuara kalojnë numrin 20, tek të cilat, sipas kriterëve tashmë të zbatuara për raste të tjera, mund të dalë qartë prapashtesa -NO- (përkatesisht të përkapet si e tillë). Përveç rasteve që u përmendën më sipër po i përmend edhe këto: hyjnoj (hyll-), mirënoj (mirë-, te A. Xhuvani), përvujtnoj (vuaj, me vuajtë), lumnoj (me lumue) e ndonjë tjetër. Pra, vetë prania e trajtave foljore me prapashtesën -NO- të regjistruara në FGJSSH, përkatesisht të përfshira në normën letrare, siç u cek më sipër, imponon nevojën që kjo mënyrë fjalëformimi, jo vetëm duhet të pranohet si fakt real, por edhe duhet të vlerësohet drejt, duke u dhënë vendin e merituar foljeve më -NO- dhe gjithësi, del e udhës, të shënohet ky fakt (si normë e lejuar) në burimet përkatëse udhëzuese teorike normative të gjuhës sonë standarde.

Me sa u tha më lart, duke pasur parasysh raportin rreth paraqitjes opoente të formanteve -RO- dhe -NO-, del e nevojshme dhe me interes të jepen sqarime, vlerësime dhe interpretime të arsyeshme. Mendoj se lidhur me foljet më -NO- duhen pasur parasysh këto çështje të veçanta, së paku sa për orientim:

¹⁰⁶ Prof. A. Kostallari, *Përsosja e e sistemit të gjuhës së sotme letrare kombëtare dhe të parët themelore të normës së sotme* (PAKGJSH), Prishtinë 1983, f. 28.

¹⁰⁷ E shoh të nevojshme të sqaroj rastin e daljes së trajtës dënoj, me kuptimin: dënoj (që e ndeshim në veprën e Çajupit, të Asdrenit, të F. Shirokës etj), e cila në gjendjen e sotme gjithësi asociacionon formantin -NO-, ngase mund të zërthehet me temën e qartë prodhuese: **dëm+noj** (sjell a pëson dëm), por, në të vërtetë, është huazim nga latinishtja: dammare.

1) Në të mirë të prapashitesës -NO- kundrejt asaj -RO- për raste të reja ndihmon fakti se, siç e thekson prof. A. Kostallari:

"në gjuhën letrare sot mbizotëron rotacizmi, por vlera e këtij mbizotërimi zvogëlohet për dy arsye: së pari, rotacizmi në shqipen është një fenomen i vdekur të paktën që nga shekulli VIII dhe si i tillë mund të pengojë në mënyrë pasive, por jo aktive përhapjen e jo-rotacizmit, së dyti, mund të themi se tashmë vlera sasiore e jo-rotacizmit është duke u kthyer në shqipen letrare në vlerë cilësore, strukturore, e cila do të vijë duke u rritur, po të kihet parasysh se jo-rotacizmi është një dukuri e re, e gjallë në gjuhën letrare të sotme dhe se ai mbështet gjerësisht në depërtimin e lirë të njësisve leksikore nga areali verior, kur ato sjellin vlera të reja në pasurinë leksiko-frazologjike e semantike të shqipes letrare".¹⁰⁸

Lidhur me konstatimin e mësipërm mund të rezultojë e vërteta se, kur është fjala në paraqitjen e autenticitetit stilistik, duhet me qenë të lejueshme edhe të qëndrueshme si trajtat me prapashitesën -NO-, ashtu edhe ato me prapashitesën -RO-. Pra në situata të caktuara, edhe pse nuk janë të shënuara në FGGSSH, trajtat: *dash(t)no, pleqno, trimno, vargno, emno, lumno, zotno, gjallno* etj. mund të qëndrojnë krahas trajtave: *dashuro, pleqëro, trimëro, vargo (vargëro), emëro, lumëro a lumtëro, zotëro, emëro, gjallëro*. Me fjalë të tjera, edhe pse dihet se norma e sotme letrare është në të mirë të trajtave: *dashuro, pleqëro, trimëro, emëro* etj., të cilat në stilin neutral letrar pa hamendje lypset respektuar, mirëpo, siç e thamë më sipër, kur kemi të bëjmë me tipizime, sipas kuptimit jo të ngushtë të fjalës, si dhe për koncepte të reja, ose koncepte deri tash të paplotësuara tërësisht, atëherë trajtat: *dash(t)no, pleqno, zotno, lumno, burmo, vargno, emno, çikno*, pra të kushtëzuara nga situata a vetë konteksti, mund të përdoren pa e rezikuar fare përdorimin normal të normëzuar të trajtave gjegjëse më -RO-. Sipas një vështrimi që u kam bërë trajtave në fjalë, ato mund të përdoren, pothuajse normalisht për fije konceptesh që nuk dalin të mbuluarra mjaftueshëm nga trajtat me -RO-. Lidhur me këtë mjafton të sjell ndërmend kuptimin e fjalës **pleqni**, përkatësisht të foljes **pleqno** që në botën shqiptare të Shqipërisë së Veriut, përkatësisht të Kosovës e më gjerë është një institucion i gjallë, ku ende, sadokudo, respek-

¹⁰⁸ Po aty f. 36.

tohen gjurmë të "Kanunit" dhe se forma **pleqni pleqnoj** (kujto sqarimin që i jepet kësaj fjale te Fjalori i "Bashkimit" (1908 f. 355) në italishte: "*Giudicare da anziani presi come arbitri in una divergenza*") i përgjigjen kësaj dukurie, ndërsa me fjalën **pleqëri, pleqëroj** që si trajtë ka përdorim më të madh në viset jugore shqipfolëse (por e përgjithësuar me anë të letrarishtes së sotme në të gjitha viset shqipfolëse) në radhë të parë kuptohet: të mbajturit e "një plaku në shtëpi" ose "kalimi i kohës së pleqërisë"¹⁰⁹ dhe ngarkesa me kuptimin polisemantik, siç u tha për fjalën **pleqni, pleqnoj, është** e dorës së dytë. Prandaj për rastet e tilla trajta **pleqnoj** del e udhës të zërë vendin e duhur në fondin aktiv të fjalësisë të gjuhës sonë, përkatësisht asaj duhet dhënë liri konkurrimi për këtë koncept. Lidhur me këtë mendoj se ia vlen të tërhiqet vërejtje se fjala **pleqësi** për pleqni që po dëgjohet aty-këtu, si të themi, në stilin thjesht zyrtar, nuk është mirë të favorizohet, ngase fjala **pleqësi** krijon homonimi me emërtimin e institucionit shtetëror-shkollor etj., që është mjaft e përhapur dhe e njohur në ndërgjegjen e shqipfolëse, sidomos në Kosovë, por që për koncept të ngjashëm kishte përdorim edhe në shtetin shqiptar në periudhën e Pavarësisë e më përpara.

Me fjalë të tjera me favorizimin e trajtave më -NO- do të lehtësohej ngarkesa e panevojshme polisemantike të trajtave më -RO- dhe do t'u rikthehej funksioni specifik që kishin në ish-shqipen letrare format më -NO- e që ende janë në përdorim të gjerë në pjesën më të madhe të shqipfolëse, madje edhe në shkrimet letrare të dialektit gegë. Fundja, s' do të ketë asnjë të keqe, jo vetëm diskutimi qëllimmirë edhe rreth kësaj çështjeje, por do të bëhej një punë shumë e vyer, nëse kjo temë trajtohet si temë e veçantë studimi nga gjuhëtarët tanë.

2) Në FGGSSH kur ndonjë antonim del dy trajtash: me prapashitesën -RO- dhe atë -NO-, si p.sh. *burrëroj/zburmoj*, atëherë, vërtet, s'ka arsye që të mos përputhen edhe trajtat shkrimore komponente të antonimit përkatës. Pra vetë prania dyformëshe shkrimore e antonimit të sipërcekur pothuajse na jep të drejtën jo vetëm të mendojmë, por edhe të veprojimë me të drejtën për përdorimin e të dyja trajtave dhe sidomos, kur kemi të bëjmë me autenticitetin burimor të kuptuar drejt, që u përmend në pikën e mësipërme. Me një fjalë, kundrejt fjalës *zburmoj* s'ka arsye të mos dalë përgjegjësi *burmoj*, ndërsa ndaj trajtës *burrëroj* s'ka arsye të mos dalë

¹⁰⁹ Shih: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1502.

ajo *zhburrëroj* (nëse ashtu përdoret në gjuhën e popullit të viseve të caktuara dhe nëse ka të bëjë me fazën e moshës së caktuar). Prof. E. Çabej përdor *burnoj zhburnoj* duke e përmendur faktin se në toskërishte përdoret koncepti del trajta **burrem** jo ajo burrërohem (e cila do të ketë dalë e shtrirë më vonë, mbase nën ndikimin e trajtës burr(ë)nohem (burr(ë)ni)). Lidhur me këtë nuk është keq të rikujtojmë mendimin e prof. I. Ajetit rreth asimilimit të mundshëm burrëroj burroj sipas ligjeve të gjalla fonetike të toskërishtes.¹¹⁰ Po e cek faktin se b.f. ASDRENI, Ali Asllani, ndonëse i takonin krahut të toskërishtes, në veprat e tyre, e përdorin trajtën burri (burrnjoi).

3) Duhet ta kemi të qartë se trajtat tashmë të ngulitura më -NO- si: drynoj, bishtnoj, cubnoj, rinoj, hyjnoj etj. pa hamendje duhen përdorur në këtë trajtë dhe nuk ka kurrfarë arsyeje të "letrarëzohen" a të rotacizohen ato, siç po ndodh shpesh në shkrime të ndryshme të ditës, sidomos te ne, në stilin neutral, si p.sh.: bishtrëroj, dryroj, cubëroj, etj.

4) Gjithashtu duhet pasur kujdes që trajtat, relativisht të reja gjithëpopullore, si p.sh. fillëroj, shkriëroj, shtazëroj, shqipëroj, kalëroj etj. kursesi nuk bën të "gegëzohen" për të njëjtin koncept me prapashtesën -NO- si b.f. shtaznoj, kalënoj (!) etj., trajta këto që ndoshta asnjëherë, si të tilla, nuk dëshmojnë të kenë qenë të shtrira në ndonjë të folme të gegërishtes. Madje ato as që del e nevojshme të përdoren a të farkëtohen rishtas, madje as për ngjyrimë thjesht stilistike, kur kemi parasysh rolin shoqëror të normës së pranuar të gjuhës së sotme letrare si dhe perspektivën e letrarishtes së njëzuar, si një variant i vetëm që do të përthithë në vete tërë pasurinë me vlerë të dialekteve a të të gjitha të folmeve të shqipes, sidomos të gegërishtes.

5) Do të shpreh edhe një mendim timin lidhur me rritjen e numrit të foljeve të prejardhura me prapashtesën -NO-, shumim ky që mund të vijë dy mënyrash:

E para, për arsye se në kontekste të caktuara nocioni përkatës nuk ka mundur të mbulohet tërësisht me trajtat e "toskëzuara" si p.sh.: *gruenohet, meshnohem, moçnohem*, që ceken në FGJSH 1954; *degnoj, gurënoj, benoj* të cekura nga Gazulli¹¹¹ (të cilat, siç u tha, nuk ndeshen të toskëzuara me -RO-). Po e përmend edhe ndonjë shembull tjetër nga tradita, të shënuar në buri-

¹¹⁰ Shih: Dr. E. Çabej, *Studime VII*, f. 389 dhe prof. I. Ajeti, *Probleme akt...* (vepër e cit. f. 92.

¹¹¹ Gazulli, *Fjalori i ri*, Tiranë 1941.

me të ndryshme, si p.sh. te K. Kristoforidhi: djelmënohem, zotnoj e zotërojoj, urdhënoj e urdhëroj, shenjtënoj e shenjtëroj.¹¹² Edhe te Sami Frashëri ndeshim: emënoj e emëroj etj., prandaj në raste të tilla të veçanta të *vetëruara* mund të përdoret trajta e variantit të caktuar varësisht nga natyra e lëndës që shprehet.

E dyta, të aktivizohen krijimet e reja me prapashtesën -NO- që po krijohen në realitetin tonë gjuhësor me mundësi reale për jetë të mëtejshme në këtë formë.¹¹³ Trajtat e tilla kur përdoren me kriter, siç e ka vënë re edhe prof. A. Kostallari, gjuha jonë do të pasurohet me fjalë të reja dhe kështu do të begatohet fondi leksikor, por edhe shprehja shqipe përgjithësisht do të marrë infuzion a gjak të ri. Në këtë plan ka vend të diskutohet me qëllim të integritimit në gjuhën letrare të foljes "emnoj" me konceptin: *e them me emër, e shenjoj me emër*, ngase me trajtën **emëroj** kuptohet parësorisht "urdhëroj, dekrettoj": "caktoj dikë në një detyrë", (koncept që përputhet me kuptimin e termit kuranor **emër** (emri a urdhëri i Zotit) (Shih edhe te Fjalori i Bashkimit f.102), ndërsa me **ëmërtoj**, siç dihet, kuptohet më tepër në terminologji "i vë emrin një koncepti" një sendi, e jo "me ia përmendë emrin vetjak dikuj", përkatësisht me **emnoj** plotësisht shprehet a mund të shprehet pra koncepti **i nominimit** (koncept i pambuluar ky, për të cilin edhe po tërhiqet vërejtja këtu). Mjafton të kujtojmë faktin se presidenti e kryeministri me ministra së pari nominohen (vetëm emnohen), proces ky pas propozimit e para dekretimit (zgjedhjes), d. m. th. paraprakisht **emnohen**, ceken një për një ose emër për për emër, por ende nuk janë zgjedhur (emëruar a dekretuar). Ja një shembull nga realiteti ynë, ku folja *emnoj* është përdorur për koncept, si me themë, të pambuluar, ngase trajtat emëroj, emërtoj a emërojoj mbulojnë koncepte të tjera semantike: "Due me i personalizue këto qëndrime tue **emnue bartësit** distinktiv të tyre, sepse kjo e ndihmon përshkrimin e situatës" (*gazeta Java*, 20 maj 2002, f. 17).

¹¹² Fjalori i K. Kristoforidhit (ribotim), Prishtinë 1977

¹¹³ Nga përditshmëria jonë po e cek ca shembuj: farefisnoj (krahas fisnoj e shfisnoj) (*Zëri* 7. III. 1987 f. 25); frytnohet, frytnoj (*Fjala* 15/86 f. 5); lodhnoj (*Gjuha shqipe* 1/84 f. 36), mëvrugnoj (*Rilindja* 28. VII. 1980 f. 12); vranoj (M. Gjevori - *Frazologjizmat*, f. 14, 239), mëvrugnoj (*Kosovarja*, 2/87 f. 24), magjimnoj (*Pionieri*, 1-2/87 f. 5), moçnoj (*Jeta e re*, 6/87 f. 80, katnoj (*Kosovarja*, 2/87 f. 24), magjimnoj (me kuptim imitim, përshprehje) etj. - prandaj foljet farefisnoj, shfisnoj, frytnoj, vrujnoj, kalbnoj, shtrambnoj, shtrambnoj, bishnoj, çiknoj (sinonim me vajzëroj) etj. mund të pranohen në fondin aktiv të fjalësit të gjuhës sonë.

Po e përmend rëshqitazi faktin se Sami Frashëri trajtën emënoj e përdor edhe me kuptim të konceptit të famës që për nga forma dallohet nga trajta *emër emëroj*.

Nëse del e nevojshme që konceptet e foljeve përkatëse si p.sh. shtërrnoj, shterponj, vrrinjoj, zhgardhnoj, vano, shtalbnjoj, zbutnoj etj. të shënuara nga dr. Abdullah Zymberi¹¹⁴ të futen në kuadër të shqipes standarde, atëherë, ma merr mendja, se trajtat e foljeve të tilla s'ka kurrfarë nevojë të toskezohen. Kështu mund të veprohet edhe për raste të tjera të kësaj natyre, siç është vepruar b.f. te trajta hijenoj¹¹⁵. Mirëpo krahas hijenoj, hijesoj, përhijoj, hijeshoj, hijezoj, hijeshtoj mund të shfaqet edhe trajta më -RO- *hijeroj*, nëse kjo ndjehet e nevojshme të përdoret për ndonjë hijesë poetike a ku ta dimë. Ç'është e vërteta, një trajtë e tillë fare nuk rrezikon në kundërvënje lojale trajtën e normëzuar më -NO- *hijenoj* për konceptin neutral që ajo sot mbulon.

Sidoqoftë, edhe në raportin e ndërferkimit të foljeve më -NO ndaj -RO ne shohim se pas një studimi të thuktë, mund të arrihet një harmonizim për lakmi, natyrisht duke përfillur edhe ndarjen e nënfushave të caktuara semantika, ashtu siç ka ndodhur e po ndodhë në raportin me foljet me -OS, ndaj atyre me -Oj, dukuri kjo që do të preket në kreun vijues, kur të bëhet fjalë për foljet më -OS.

Së fundi, për nga kuptimi në krahasim me foljet më -RO- në shumicën e rasteve foljet më -NO- kanë tjetër zberthim. Krahaso: bishtnoj i bëj bisht, vargnj - bëj varg, çudnoj - bëj çudi, pleqnoj - bëj pleqni, lumnoj - bëj lum-lum etj. - zberthim ky që i përgjigjen konceptit që shprehin foljet më -O- pa zgjerim me temë të qartë fjaleformuese.

Nga sa u tha më sipër, ma merr mendja se tash, pas tri dekadash të ngulitjes së drejtshkimit të njësuar të gjuhës sonë letrare, dalin krejt të natyrshme kërkesat e mësipërme rreth përcaktimit a ndarjes së fushave a nënfushave të caktuara kuptimore të përdorimit të foljeve të prejardhura me prapashtesat përkatëse sinonimike -NO- dhe -RO-. Siç u pa nga shembujt, si të karakterit paronimik, si të tjera, që u sollën paksa më sipër, jo vetëm se mund të diskutohet, por del e nevojshme edhe të merren qëndri-

¹¹⁴ Dr. Abdullah Zymberi, *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*, Prishtinë 1996.

¹¹⁵ Fjalori i gjuhës së soime shqipe, Tiranë 1980, f. 680.

me, ngase të dyja këto formante janë të pranishme në gjuhën tonë letrare kombëtare dhe se tashti nuk duhet të ekzistojnë tendenca divergjente që të ngrehin në anë të kundërta për të përjashtuar format konkurruese, por të pranohen që të dyja, duke i specifikuar praktikisht e teorikisht funksionet sipas nënfushave të caktuara semantike, kur për këtë ekziston mundësi e përligjshme. "*Toleranca në afrimin e standardit me gegërishten letrare*, thotë prof. Mehmet Çeliku, *është e nevojshme dhe mbështetet kryesisht te nevojat e standardit për pasurim dhe përsosje në përpunje me zhvillimin e tij të natyrshëm*".¹¹⁶ Një dukuri e tillë shkon, sigurisht, në dobi të njëzimit të mëtejshëm të gjuhës sonë standarde kombëtare. Nuk duhet harruar fakti se elementi -R- ka raste të dalë edhe në funksion të tingullit epentetik dhe se në raste të tilla elementi -n- nuk e shoqëron si dysor konkurrent, siç janë emërtimet e karakterit tingullimitues, tipi: uluron, mururon e murmuron, pastaj shembujt: lajmëroj, flakëroj, lavdëroj, fisnikëroj, foshnjëroj, dinakroj etj. Krahaso edhe rastet si dërlëk, dërlak, vërsulem etj., ku tingulli -r- konsiderohet si element shtues epentetik i parashtesës, mirëpo ka raste të tjera kur sonanti -n- kryen funksione morfologjike e fjaleformuese pa u ndërferkuar fare me tingullin -r- (Krahaso: bëhem, bënem si dhe trajtat foljore normëzuese më -no-).

Kur është fjala te përcaktimi i nënfushës semantike sipas formantit prapashtesor në raportin -RO/-NO-, përveç përpunjes si rezultat i favorizimit të ndonjërit dysor, këto formante, secila lufton ndaras për nënfushën e veçantë të caktuar. Kështu ndërsa foljet me prapashtesë -RO-, siç u tha, i takojnë më tepër pasqyrimin të botës shpirtërore të njeriut, këto më -NO- më tepër i përshtaten natyrës së shprehjeve neutrale, rëndom, me ndërlikueshmëri të shkallës së parë ose me ndonjë intensitet a shkallëzim të tjetër, d.m.th. me nuancim kuptimor a stilistik të ndryshëm nga trajta me R, dallim ky që nuk lidhet aq me mënyrën e fytyruar të shprehjes a me kuptimin e temës prodhuese (Krahaso: frytnoj me frytoj ndaj frytëztoj). Së paku kështu del në bazë të konsultimit që u bëmë të gjitha foljeve përkatëse më -NO- që u cekën më sipër, por edhe të tjera. Duhet ta kemi parasysh edhe faktin tjetër që njihet që moti se, siç e thotë L. Gurakuqi, N-ja si M-ja "*ka gjysë zani*", ndërsa R-ja "*ashë e plotë dhe e zashme*", përkatësisht, siç shpjegohet në fonetikën shkencore, ndërsa që të dyja janë sonante, "n-

¹¹⁶ (Shih. M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2001, f. 32).

ja është paragjuhore apokale, ka tension të dobët muskolor, ndërsa r-ja është sonante vibrante me tension me të dalluar¹¹⁷ dhe si e tillë R-ja dridhëse, siç u tha, del pa konkurrencë të N-së hundore në funksione të caktuara, pra edhe si element më i dalluar epentetik. Fundja, raporti r/n sipas gjendjes së sotme në përshtatje me normën standarde kërkon qasje e vëmendje më të kujdeshme.

E shoh me interes të paraqit faktin se vetëm te vepra poetike të Gj. Fishtes, përkrah foljeve më -NO- që janë me dhjeta, ndeshim këto trajta më -RO-: flakroj, ligjëroj, shporoj, felgroj, buluroj, pingroj, zhauron, bliroj etj., pa përmendur rastet e tjera nga jeta e letrarishtes së sotme që nuk janë të pakta, si: bubëron, cicëron, cingëron, gjelbëron, belbëron, blegëron, uluron, shqipëron, lavdëroj, ligjëroj, shkriëroj, nxiron, gocëron, vajzëron etj.

Sidoqoftë, formantet -RO- e -NO-, edhe pse ende ndërferkohen, ato përen që tash e mbas, t'i ndajnë më qartë nënfushat e caktuara semantike dhe kështu të bashkëjetojnë edhe si fqinj pa e dëmtuar fare njëra tjetrën, madje, si me thënë, ato duke bashkëjetuar fqinjërisht gjithsesi e ndihmojnë ekzistencën e njëra-tjetrës.

2. Foljet më -MO-

Siç është përmendur në pjesën A. të këtij nëntitulli, të dy elementet: si elementi -N- ashtu edhe elementi -R- kanë njëfarëdore lidhje burimore me elementin -M- (-MO-), ndërlihdje kjo që kishte të bënte me formantin fundor të pjesores së foljeve të caktuara në një stad të hershëm të gjuhës shqipe.

Studiuesi Kolec Topalli për këtë "ndërlidhje" shprehet:
Prapashtesat -m e -më (pam, frymë) mund të kenë burimin edhe në dy trajtat që ka pasur kjo prapashtesë në gjuhën indoevropiane: mo e meno, pasi një -en e patheksuar mund të përfundojë në zanorën -ë.. Në të vërtetë, një -om me një -m fundore në gjuhën shqipe duhet të ketë evoluar në -n, si në rastet tjera, duke dhënë zanoren -ë, pas temave me bashkëtingëllore (dekë) dhe diftongjet -UA/UE, YE pas zanores -O, krh. punue/punua/

¹¹⁷ Shih edhe te A. Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1970.

*lye/r .. Shkaku i diftongimit duhet kërkuar në praninë e një bashkëtingëlloreje hundore, që ka psur mbaresa -om e paskajores që në temel.*¹¹⁸

Lidhur me këtë prof. Besim Bokshi në veprën e tij "Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes", Prishtinë 1980, shpjegon se elementi -M(Ë) del si fundor i participit medial që reflektohet tek emrat në gjendjen e sotme si: bimë (bij), frymë (fryj) pështymë (pështyj), shqelm (shkel), mjelm (mjel), therm (ther) etj., forma këto që siç i shpjegon ai "janë shumë të vjetra, të krijuara në kohën kur participi kishte ruajtur karakteristikat emërore dhe foljore" dhe, siç përfundon ai, trajtat "i rrem, e rreme, i majm e majme" tregojnë se "ky" participi kishte arritur të behej fjalë bikategoriale pas humbjes së fleksionit".¹¹⁹ "Këta emra, shpjegon ai në një vepër tjetër, tregojnë se janë leksikalizime të formës mashkullore (mjelm, tharm) dhe të formës femërore (frymë, pështymë)..." të cilat kështu "janë bërë kur pjesorja në përdorim mbiemëror s' ishte ende e nryshme e kur operacioni i gjinisë realizohej me mbaresat zero e jo me E e TË të mëvonshme."¹²⁰ Edhe dr. Ragip Mulaku e cek këtë çështje duke theksuar se "shihet qartë se sufiksi -m me të cilin janë formuar mbiemrat e tipit i *tepërm* është rezultat i shndërrimit të mbaresës së pjesores së dikurshme të zhdukur në gjuhën shqipe në vlerën e sufiksit mbiemëror".¹²¹

Po ashtu edhe bashkautorët Xhuvani-Çabej në veprën "Prapashtesat ..."¹²² e prekin këtë çështje duke konstatuar se "kjo prapashtesë është autoktone në shqipet dhe është refleks i prapashtesës indoevropiane -MO, qoftë me funksion nominal, qoftë me funksion participor" dhe sqarojnë se "funksionet e këtij formanti në gjuhën shqipe janë të ndryshme".

Çështje e drejta, për temën që po trajtohet, sipas nesh, është me interes të dihet fakti se pa marrë parasysh origjinën foljore a emërore të formantit në fjalë, është e vërtetë se një element i tillë del qartë edhe në shqipen e sotme, qoftë te foljet (pjesoret) si bamë (bërë), ramë (rënë), pamë (parë) etj., qoftë tek emrat "deverbativë", siç quhen në veprën e sipërcekur të

¹¹⁸ (Shih Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë 1995, f. 224-235).

¹¹⁹ Besim Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980, f. 76. si dhe te.

¹²⁰ B. Bokshi, *Pjesorja e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1998, f. 49

¹²¹ Dr. R. Mulaku, *Prapashtesat e prapashtesat e gjuhës shqipe...* Prishtinë 1998 f. 157.

¹²² A. Xhuvani - Ç. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980, f. 517.

Xhuvani-Çabejt, si p.sh. ndihmë (ndih), dridhmë (dridh), brumë (mbruj), nismë (nis), lusmë (lus), pëshymë (pështy), bimë (bij) etj., d.m.th. me prapashtesën -MË, përkatësisht formantin -M si te shembujt: blem (blej), ngulm (ngul), sulm (sul), shqelm (shkel), them (ther).

Në ndërlidhje me shembujt e mësipërm dalin çështje të ndërfërkueshme rreth interpretimit të foljeve paralele (të karakterit paronimik) të tipit: ndih ndihmuj, ngul ngulmuj, sul sulmuj etj. Në raste të tilla foljet me -MO/j do të konsiderohen të ndërtuara, qoftë nga tema foljore, qoftë nga ajo emërore e që për ne po të gjykojmë subjektivisht për momentin më tepër ngreh në peshë cilësimi i -M-së si element foljor, si tingull ndërhyrës i -O-së me zgjerim.

Nga aspekti i analizës fjalëndërtuese dalja e foljeve të nëntipit ndihm(ë) ndihmuj mund të shpjgohet, pra, mbi temë emërore, por nga aspekti fjalëformues i shkallëzimit semantik mund të shpjgohet edhe nga tema foljore ndih- + MOj ndihmuj, ngase edhe folja e shkallës së parë mund të motivojë daljen e foljes së shkallës tjetër. Megjithatë, lidhur me këtë nëntip, hiq qëndrimin tim momental, mbesin çështje të diskutueshme, siç është ndërmikimi emër/folje, të prejardhur nga e njëjta temë prodhuese: sul: sulm e sulMOj, ndih e ndihMOj e kështu me radhë.

Te disa shembuj të tjerë vijëzimi i konceptit të mëvetësisë së prapashtesës foljeformuese -MO- del i perceptueshëm mjaft qartë. Ja disa shembuj: *Ther/thermuj, ngaz/ngazmuj, gaz/gazmuj, thek/thekmuj, shkall/shkallmuj, pastaj: bri/brimuj, kall/kallmuj, erë/erëmuj, xixë/xixëmuj, zhag/zhagmuj, gu-gu/gumuj, guf/gufmuj, hall/hallmuj, zhig/zhigomuj, dridh/dridhmuj, ngas/ngacmuj, ngul/ngulmuj, kundër/kundërmuj e shkundërmuj, prozh/prozhmuj, shkel/shkelmuj, thele/thelemuj, thek/thekmuj, fër-fër/fërmon, çuk-çuk/çuk(ër)muj, çukërmon, mot/motmuj (moçmuj), guf/gufmuj, vet/vetmuj, felefelemuj, qeth/qethmuj, përnyësh/përnyëshmuj (Gurakuqi) dysh/dyshmon (Naimi), pastër/pastërmuj (Kavaljoti) etj.*

Pra te foljet e sapocekura gjithsesi motivin e ndeshim te fjala e parë temëprodhuese, qoftë ajo folje, emër, mbiemër a onomatope, ngase në përdorimin e sotëm letrar mungon gjymtyra e ndërmjetme, d.m.th trajta e emrit, madje edhe e mbiemrit përkatës që mbaron me -M-në fundore del fort e zbehur.

Është e vërtetë se në gjuhën e sotme ndeshim emra, si p.sh.: gaz, erë, hall e jo gazm, erm hallm, prandaj në rastet e tillë, në gjendjen e sotme, ka arsye që formanti -MO- të perceptohet si prapashtesë e mëvetësisë me foljore. Ç'është e vërteta, sipas kriterëve që janë zbatuar për vlerësimin e prapashtesave të mirëfillta sinonimike, siç është theksuar më përpara, edhe ky formant i plotëson kushtet e njëjta për t'u vlerësuar si një formë e mëvetësisë me fjalëformuese, po në kuadër të strukturës përkatëse të sistemit foljor bashkë me simotrat e veta.

Prof. E. Çabej shpjgon se te "*gufmon/gufon/shihet epenteza e një m-je, më mirë mbështetja në foljet që përmbajnë -muj si rrokje fundore, si shkallmuj, dërmuj* (f. 301). Gjithashtu ai shpjgon se emri *ndihmë* është një "postverbal" që vjen nga folja "*ndih*" e "prej andej u formua verbi *ndihmuj*, mirëpo për "*ngallmuj*" pranon se "mund të jetë një zgjerim i *ngalloj*, siç thotë ai, *me një infiks -M, mbase me analogji me verbat shqelmuj, ngulmuj*",¹²⁵ fakt ky që nuk bie ndesh me gjykimin që u tha pak përpara prej nesh, në dobi të perceptimit të prapashtesës -MO- si formant të mëvetësisë me foljeformues.

Lidhur me këtë, po e përmend faktin se formanti i tillë me vlerë prapashtesore në strukturën foljeformuese vërehet edhe në shkrimet e traditës, por nuk është pa shenja edhe aktualisht. Në FJGJSSH ndeshim trajtën *qethmuj* i *qethmuar*.¹²⁶ Në veprën letrare të Atë Gj. Fishtes, ndeshëm: çukurmuj, ngarmuj, thjerrmon, balcmuj (me balcmue), ndërsta te L. Gurakuqi: gufoj e gufmuj, pastroj e pastërmuj, rrëzmuj, zhërmuj, shkel e shkelmuj etj. Edhe prof. E. Çabej për foljen ngallmuj thotë se ka dalë nga ngalloj, siç u cek më sipër, madje ky autor foljen çukurmuj e nxjerr nga "çuk -çuk"¹²⁷ +r/muj. Nga shkrimet e ditës po i cek disa shembuj: përcudmuj ("Kosovarja", 20. II. 1992 f. 26), dridhmuj ("Kosovarja", nr. 7/II. 1991 f. 8), frymëmojnë ("Shkëndija", 22. XII. 1991 f. 3), gufmoj/gufmim ("Bujku", 15. VIII. 1994 f. 9), zhurmëmoj ("Drita" 30. II. 1988, sipas gazetës "Bujku", 26. III. 1988 f. 9), thelëmoj ("Fjala" nr. 14/87 f. 9), zjarmoj ("Shkëndija", 10. II. 1992 f. 14), erëmoj/erëmim ("Rilindja", 13. VII. 1989 f. 13), mot-

¹²⁵ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore VIII*, Prishtinë 1988 f. 367, 368, 377.

¹²⁶ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980, f. 1603.

¹²⁷ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore IX*, Prishtinë 1989, f. 139.

moj (A. Zymeri) etj. Në revistën gjuha shqipe ndesha shembujt: gumon (nga gu-gu), thërmon, ndërsci te L. Poradeci: fërmon, shkundërmon.

Sigurisht edhe në burime të tjera mund të ndeshen shembuj të tillë (qoftë edhe të diskutueshëm) me formantin në fjalë, por mendoj se edhe këta që u sollën këtu mjaftojnë, jo vetëm për t'u përkapur çështja e mëvetësisë së prapashtesës foljore -MO-, por edhe për t'u bërë vlerësimi a përcaktimi i nënfushës stilistike a kuptimore që mbulojnë trajtat e përfutuara me formantin foljendërtues -MO-. Lidhur me këtë, d.m.th. rreth përcaktimit të nënfushës kuptimore që shprehet me foljet me -MO- na ndihmon edhe mendimi i prof. Ali Dhrimos, i cili shpjegon se elementi -M është fundor i pjesores edhe pse "po humbet karakterin formëformues për formimin e pjesores e po fiton atë fjalëformuese të mbiemrave". Është fjala për mbiemrat e tipit: i ardhëm e ardhme, i vyem e vyeme, i parmë e parme, i punuem e punueme etj., të cilët, siç e thekson autori "në gjuhën e sotme letrare, ky nëntip fjalëformues (nga pjesorja me prapashtesën -M) nuk ka gjetur përdorim".¹²⁸ Kuptohet, pra, siç u tha më sipër, se prapashtesa -M, etimologjikisht lidhet me pjesoren, përkatësisht mbiemrin prejpjesor, mirëpo, siç u cek nga prof. Dhrimo, edhe formimi i mbiemrave mbi këtë bazë nuk del i favorizuar, ngase vetë pjesorja me -M (kryesisht me origjinë gege, edhe sipas prof. Sh. Demirajt) del e pafavorizuar në gjuhën e sotme letrare. Megjithatë, nga konstatimi i mësipërm nxjerrim konkluzionin se foljet me -MO-, siç u cek më sipër, të cilat këtë element e kanë si relik të pjesores së hershme, përshtaten, pak a shumë, me kuptimin e mbiemrave prejpjesorë me -M (përkatësisht me -UA/R) tipi: i (e) punuar /i punue/m/, pasi semantikisht me foljet e tilla nuk shprehet një proces me intensitet të shtuar, por gjithësi, kur është fjala te foljet, mund të ketë ngjitje mbi shkallën e parë, por që me një formë të tillë tregohet një veprim i kryer, paksa i mbyllur, ndonëse mjaft emocionues në çaste, po gjithësi jo në rrjedhë.

E lyp vendi të ceket edhe konstatimi i studiuesit Bardhyl Demiraj, i cili duke e shpjeguar etimologjinë e fjalës javë- java nga *jev(v)em) e thekson se "bjerrja e rrokjes fundore -me është plotësisht e shpjegueshme me veprimet e ndjenjës popullore (etimologji popullore), pasi ndërtimet emë-

¹²⁸ A. Dhrimo, *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë 1975 f. 170.

rore me -me gjellojnë kryesisht si formime me funksion përgjasimi. Krahaso: vëlla pranë vëllam, motër ndaj motërmë".¹²⁹

Sidoqoftë, te foljet më -MO-, siç u tha, elementi -M- mund të jetë një relik i fundorit të pjesores së hershme, përkatësisht të mbiemrit a emrit të sotëm mbi këtë bazë me -M fundore. A do të riaktivizohen foljet me këtë element (që nuk i përket vetëm gegërishtes, por mbarë shqipes së hershme) mbetet që e ardhmja ta tregojë, por koncepti që mbulohet me to, siç u cek pak më sipër, mund të motivojë ripërfitim e foljeve të tilla. Zbërthimi i foljeve më -MO- zakonisht del kështu: erë+MO-j = (i) jap erë, xixë+MON = bën (qet) xixë; ngulmoj "kërkoj me forcë diçka", sulmoj "godas... bëj sulm" e të ngjashme, vërtet, tregojnë nënfushë të re semantike dhe me intensitet të ndryshëm në krahasim me trajtat paralele: ngul e sul/em.

Zgjon interes gjithashtu edhe formimi i disa foljeve mbi fjalë-temën mbiemërore, ku ruhet formanti -shëm (-shm/ë), si b.f. ndryshëm (nga Sami Frashëri), zëshmoj, përgjashmoj (Spiro Floqi), shishmoj nga i shijshëm, moçmoj nga i motshëm (trajta popullore) si dhe qëndruesmoj, ndryshmoj, përgjashmoj, volishmoj, posaçmoj - të përdorura nga prof. S. Riza,¹³⁰ por që nuk hynë në FGJSSH. Këto raste, edhe pse mund të konsiderohen si folje më -O pa zgjerim, asociaciononjë formimet me prapashtesën -MO-, për shkak të zhdukjes së ë-së brenda formantit -SHËM në SHM+), ku tingulli -M del si fundor i temës fjalëformuese.

Sido që të jetë, gjithësi është i dallueshëm përcaktimi i kuptimësisë që lidhet me karakterin e mbyllësisë në çaste që shprehet ngjashëm sikurse me mbiemrat me -ËM-, e jo me atë vazhdues ngjashëm me mbiemrat më -SHËM-, siç do të shihet më qartë kur të bëhet krahasimi përkatës me formante të tjera, siç del në foljeformim edhe formanti -SHO-.

3. Foljet më -RRO-

Në gjuhën tonë, edhe pse në numër të kufizuar më fort në dukje, dalin disa folje me formantin fundor -RRO-, i cili ka të gjitha gjasat të cilësohet si formant prapashtesor i mëvetësishtëm, ndonëse në ndonjë rast duket si një variant i prapashtesës -RO-.

¹²⁹ Bardhyl Demiraj, *Studime .. (ASHAK)*, Prishtinë 2001, f. 263.

¹³⁰ Prof. S. Riza, *Vepra 2 (ASHAK)*, Prishtinë 1997.

Prof. E. Çabej konstaton lidhur me geminacionin ekspresiv se në shqipe "vetëm likuida -R- ka një funksion të tillë me vlerë afektive".¹³¹ Dihet pra se elementi -RR- mund të ketë dalë nga geminacioni ekspresiv, siç e theksojnë së bashku Xhuvani - Çabej, përkatësisht mund të ketë dalë nga shkrija e togut -RN- e që edhe kjo dukuri lidhet me geminacionin ekspresiv, për t'u dalluar kështu fonetikisht nga fonema -R-. Në raste të caktuara mund të ketë dalë edhe nga bashkimi i dy R-ve (R+R) siç mund të shihet në ndonjërin nga shembujt e mëposhtëm: *shkatërroj* e *ngatërroj* që i trajton prof. Çabej, të cilët i nxjerr nga numër-tema *katër+roj*.¹³²

Në vazhdim po i paraqitim disa folje me këtë formant, shumica e të cilave janë fjalë aktive dhe zënë vend jo të padukshëm në fondin e përgjithshëm aktiv të fjalësit të gjuhës sonë letrare, p.sh:

cakërroj, cucroj, piprohëm, bubërroj, gabërroj, kacarroj, pikërroj, pushkërroj, gacërroj, gapërroj, ngasroj, ngurroj, hutërrohëm, vekërro, çikërro, thekërroj, dafurroj, microj, fundërroj, kuqërro, picërroj, vakërro, gafrohët, cucërro, pupërroj, hakërrohëm, çinçërro, (sh)kokërroj, puprohët etj.

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, tema fjalëformuese del e dalluar qartë kundrejt trajtës me formantin -RRO-, si p.sh.: *cak/cakërroj, pip/pipërroj, cik/cikërroj, vek/vekërroj, pikë/pikërroj, kuq/kuqërroj, ngas/ngasërroj, fund/fundërroj etj.*, po kjo nuk mund të thuhet për shembujt si: *sterroj (terr), hikërroj, kanërroj, ngurroj etj.*, sepse të shembujt e fundit ka gjasa që elementi -RRO- të ketë dalë nga bashkimi i dy -R-ve (r+r) *gur(ë)+RO ngurroj, hikër+ROj hikërroj etj.* Sidoqoftë, edhe të këto raste, si dhe të disa të tjera, shihet qartë shfaqja e dukurisë së ekspresivitetit.

Xhuvani - Çabej për të arsyetuar foljen *pikërro*, paramendojnë një emër *pikërr* si "pikël",¹³³ mirëpo një mundësi e tillë e "paramenduar", edhe pse nuk kontestohet, po të shikohet nga gjendja e sotme e gjuhës sonë, nuk mund të përgjithësohet si diçka e pranueshme asociacionisht, ngase në gjuhën e sotme nuk ekzistojnë fjalë-temat (emra a mbiemra), si p.sh.: *kuqërr*, por vetëm *kuq- pushkërr-*, po vetëm *pushkë- etj.* (Foljen *pushkërroj* e nde-

¹³¹ Dr. E. Çabej, *Sr. gjuhësore III*, Prishtinë 1976, f. 143.

¹³² Po aty f. 382.

¹³³ A. Xhuvani - Ç. Çabej, *vepra e cit. f.*

shim në Fjalorin e K. Kristoforidhit). Prandaj trajtat **kuqërroj** e **pushkërroj** gjithqysh na shtynjë të pranojmë se janë trajta të formuara nga fjalë-tema përkatëse: **kuq- pushkë-** plus prapashtesa **-RRO/j**. Po ashtu, siç dalin edhe disa shembujt të tjerë që u cekën më sipër. Numër jo i madh i tyre e dëshmon këtë që u tha. Në të vërtetë, numri i tyre mund të jetë edhe më i madh po të vilej materiali nga të folmet, përkatësisht nga atlasit leksikor i mbarët shqipes, por edhe nga burime të tjera.

Zgjon interes fakti se formanti fundor -RRO-, pos rasteve si "geminacion ekspresiv" natyrshëm nuk mund të këmbëhet as të zërthehet në njaft raste me prapashtesën -RO-, madje as me -NO- e -MO-, me të cilat ka takim origjine, por kryesisht ndërkëmbet me prapashtesën -LO-. Në të vërtetë, me formantin -LO-, prapashtesa -RRO- formon një kundërvënie, si ta quaj, stilistike, siç do të argumentohet në nëntitullin vijues. Në rastet e tilla folja e rastësishme paralele -RO- mund të shërbejë si pikënisje e bazës asnjane, si ai thumbi i peshores, nga e cila fillon ngritja ose ulja e përkrahllëzimit, ulës a zbutës apo ngritës a sforcoes, të intensitetit, sipas ngjyrës semantike a stilistike që shprehet me trajtat foljore më -RRO- ose -LO-.

Rreth ekzistimit të foljeve më -RRO- nuk dëshmojnë vetëm rastet e regjistruara në fjalorët përkatës si më sipër të gjuhës letrare, por edhe rastet e tjera që ndeshim, qoftë në burime folklorike, qoftë në të folmen e gjallë të përditshme, madje edhe në gjuhën e shkruar, si p.sh.: *gocërroj* ("Gjuha shqipe" 2/84 f. 43), *sakatërroj* ("Bota e re", I. XII. 1980 f. 17), *pikërroj* ("Rilindja për fëmijë" 9. I. 1990 f. 5, "Bujku" 18. I. 1992 f. 7); *xinxërro*, *cingërro* (Rilindja, 13. VII. 2000, f. 19, 11. VII. 2000, f. 17); *cucërroj* (Bujku, 19. IV. 1995 f. 11; 2. XII. 96 f. 7) etj. A. Zumberi (sipas veprës së cituar), në një trevë të skajshme shqipfolëse ka ndeshur edhe këta shembuj më -RRO-: *puproj, pikroj, flakroj, xhbokroj, kacroj, kokroj, plakroj*.¹³⁴

Gjithsesi formanti fundor -RRO- ka gjasa të vlerësohet si një prapashtesë e mëvetësishme sinonimike për formimin e foljeve më -O-, madje në burimet që konsultuam, numri i foljeve me këtë formant nuk del aq i vogël.

Semantikisht e stilistikisht foljet më -RRO- shprehin afektivitet të shkallës më të lartë në krahasim me simotrat me -O-, madje edhe në raport me prapashtesën -RO-.

¹³⁴ Dr. Abdullah Zumberi, *Leksiku bujqësor dhe blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*, Prishtinë 1996...

4. Foljet më -LO-

Siç është theksuar edhe në kreun e dytë të këtij punimi ekzistenca e prapashtesës -LO- pohohet edhe në gramatikën e Akademisë (1976)¹³⁵. Aty thuhet se me "prapashtesën -LO- janë formuar disa folje të rralla", fakt ky që ilustron me dy shembuj: **kuqëloj** dhe **shoshloj**, çështje kjo që nuk trajtohet më gjerë aty, madje me sa dimë, nuk është trajtuar as në burime të tjera.

Çështje e vërteta, përveç shembujve të lartcekur në realitetin tonë gjuhësor ndeshim edhe mjaft shembuj të tjerë që mund të perceptohen pa vështirësi si folje të formuara me prapashtesën e mirëfilltë foljeformuese -LO-. Kjo vërtetohet lehtë, kur kemi parasysh temën e qartë motivuese që faqëza del b.f. te shembujt e mëposhtëm:

bubulon, cakëloj, cangëloj, cingëlon, mangulon, cirloj, çapëloj, çikëloj, zdrangëloj, copëloj, skuçëloj, shpendloj, hakloj, hutloj, pifloj, kaploj, giciloj, humbëloj, bregaloj, picëlohem (M. Gjevori) e ndonjë tjetër si: ashkëloj, tuçëloj, gëlon, bagloj (bajgë), shkolloj, gazhëloj, zbardhëlon, bumloj, babloj, lingëloj, tingëloj etj.

Ndonjëri nga shembujt mund të dalë i diskutueshëm, si p.sh.: cangëloj, ashkëloj, tuçëloj, bagloj, gëlon (nga gë-gë ose gël- gël) etj., ngase elementi fundor -L- mund t'i referohet pjesës fundore të fjalë-temës së caktuar (zakonisht të emrit përkatës), por sidoqoftë, asociacionisht, për arsye ngjashmërie edhe rastet e tilla mund të përfshihen në kuadër të foljeve me prapashtesën -LO-, sepse te ndonjëri rast ekziston baza e njohur, si emëri i parmë), si p.sh. cangë, ashkë, bajgë etj., d.m.th. ekziston trajta emërore pa elementin Lx fundor.

Më duket se është me interes të ceket fakti se nga një mori emrash që cekin Xhuvani - Çabej¹³⁶, si emra të formuar me prapashtesë -LË-, -L-, nga asnjëri në gjuhën e sotme nuk është formuar ndonjë folje e prejar-dhur më -O-, përveç rastit pikël- pikëloj. Gjithsesi emrat me -L- fundor dhe foljet më -LO- ushqejnë ndërsjelltazi ekzistencën e tyre.

Sidoqoftë, faktet që u sollën më sipër besoj se mjaftojnë sa për të dëshmuar ekzistencën e prapashtesës foljore -LO-, madje edhe të parashihet një perspektivë e mirë përdorimi e shumimi të saj, sidomos kjo vërehet në stile të caktuara që përshtaten me stilin e gjuhës përkëdhelëse, si të themi, të gjuhës së fëmijëve.

Xhuvani-Çabej duke i analizuar emrat me prapashtesën -L- konstaton se kjo prapashtesë "në gegërishte nuk është produktive, por ka mbetur e ngurosur në disa rasa, më tepër me funksionin e kryehershëm të deminutivit"¹³⁷, pra, po ky konstatim rreth kuptimit të "deminutivit" vlen edhe sot, sidomos kur është fjala për stilin "e butë" përkëdhelës që shprehet me foljet më -LO-, ndërsa kur është fjala për produktivitetin e foljeve më -LO- nuk di sa mund të vlejë për sot e për nesër konstatimi "numër i kufizuar" i dhënë në burimet e sipërcekura për kategorinë e emrave më -L (-LË), por e themi me plotgojë se konstatimi i tillë për emrat më -L (-LË) nuk mund të përgjithësohet edhe për foljet më -LO-, sepse, siç u cek më sipër, duke u përcaktuar nënfusha semantike që mbulojnë foljet më -LO-, numri i përftimeve me këtë prapashtesë sigurisht do të shënojë rritje edhe më të madhe. Për një prirje të tillë do të mjaftohemi me këta shembuj: *shpendloj, babëloj, cikëloj, çapëloj, çupëloj* e të ngjashëm që i ndeshim zakonisht në vjersha për fëmijë. Me fjalë të tjera, kur kemi parasysh faktet që paksa u përmendën edhe në këtë punim-sprovë, konstatimi se me këtë prapashtesë janë formuar vetëm "disa folje të rralla", gjithsesi duhet të pësojë ndryshim a interpretim tjetër, sepse në gjendjen e sotme, siç del nga shembujt që regjistruam, numri i tyre nuk është edhe aq i vogël. Madje nuk do të ngelë i tillë, nëse, sadopak, ndërgjegjësohet favorizimi a prirja që u përmend lidhur me specifikimin e foljeve më -LO- për "gjuhën e fëmijëve" a stilin paksa më të butë në tjetër efekt a forcë të shtuar shprehës shkalla e ekspresivitetit. Kjo dukuri mund të shihet më mirë nga kundërvënja e foljeve më -LO- kundrejt atyre më -RRO-, -RO-, -LLO-.

Sidoqoftë, prapashtesa -LO- asesi nuk duhet trajtuar nën hijen e prapashtesës -LLO-, edhe pse me të mund të ketë lidhje originore, ngase siç e cek prof. E. Çabej "L-ja e sotme e shqipes ka dalë nga një L- gëmi-

¹³⁵ Fonetika dhe gramatika... II, Tiranë 1876.

¹³⁶ Xhuvani - Çabej, *vepra e cit.*, f. 511.

¹³⁷ Po aty, f. 512.

nate".¹³⁸ Si karakteristikë e mëvetësisë së formantit -LO- dëshmon fakti se kjo prapashtesë, pra, me elementin L që siç e thotë L. Gurakuqi, "asht e butë e ujtë" mund të ndërkëmbet (antonimisht) në mjaft raste me prapashtesën -RRO- si p.sh.: kuqëloj/kuqërroj, cikëloj/cikërroj, cakëloj/cakërroj, bubëllo/bubërro, hutloj/hutërro etj., por edhe me prapashtesën -LLO-. Krahaso edhe shembullin: bubulon (zhurmë e lehtë) ndaj bubullon (zhurmë e fortë),¹³⁹ pastaj cingëlloj me cingëlloj, pikëlloj me pikëlloj(!), cakërroj (gotat), cakëlloj (dhëmbët), cakëlloj (fëmija nga të ftohtit) etj.

Përcaktimi i nënfushës semantike të "gjuhës së fëmijëve a të stilit të butë" në të ardhmen, gjithsesi, do të favorizojë "lindjen" në numër të konsiderueshëm të foljeve me prapashtesën -LO-.

5. Foljet më -IZO-

Në kuadrë të prapashtesës -ZO-, në burimet tona normative është përmendur edhe prapashtesa -IZO-, e cila edhe cilësohet në njëfarë mënyre si prapashtesë më vete. Në gramatikën e Akademisë (1976)¹⁴⁰, siç është përmendur në kreutë I dhe II, sapo ceket fakti i ekzistimit të foljeve që formohen me prapashtesën -IZO- në shqipe, siç janë huazimet: aktivizoj, centralizoj, industrializoj, kolektivizoj si dhe kalkëzimet: kombëtarizoj e ndërkombëtarizoj, të cilat, siç thuhet aty, kanë dalë nga "mbiemrat" përkatës. Konstatimi i tillë në gjendjen e sotme s'di sa mund të jetë i qëndrueshëm, kur nga fjalët e huazuara të sipërhënuara mbiemër i mirëfillt në shqipe del vetëm fjala industrial-, ngase fjalët e tjera *central*, *kolektiv*, *aktiv* etj. mund të cilësohen pa mëdyshje, në radhë të parë, jo si mbiemra, po si emra të huazuara. Gjithashtu nga ai burim del i diskutueshëm edhe konstatimi tjetër se "siç po shihet, te foljet e formuara nga mbiemrat prapashtesa -ZO- paraqitet e zgjeruar me -I"¹⁴¹. Po kjo dukuri trajtohet më ndjeshëm në burimin "Gjuha letrare shqipe për të gjithë"¹⁴², ku thuhet se "krahas këtyre formimeve (d.m.th. të foljeve me prapashtesën

¹³⁸ Dr. Çabej, *Sudime gjuhësore I*, Prishtinë 1976, f.288.

¹³⁹ Shembulli është marrë nga *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 1984.

¹⁴⁰ *Fonetika dhe gramatika...* II, f. 301.

¹⁴¹ Po aty, f. 301.

¹⁴² *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976, f. 229.

-ZO-) në gjuhën e sotme letrare, përdoren edhe folje me prapashtesën -IZO-; zakonisht këto fjalë të huazuara i janë nënshtruar sistemit morfologjik të shqipes, si: aktivizoj, ekranizoj, individualizoj, kolektivizoj, konkretizoj, militarizoj, mobilizoj, rajonizoj, revolucionalizoj, stabilizoj, etj."

Sidoqoftë, vlen konstatimi se në burimin e sipërcekur formanti -IZO- quhet si prapashtesë e mëvetësishe, çka arsyetohet me shpjegimin se "nën ndikimin e këtyre fjalëve në shqipen e sotme letrare, kanë filluar të formohen edhe fjalë me prapashtesën -IZO- nga vetë tema e shqipes" dhe për këtë, si ilustrim jepen këta dy shembuj: kombëtarizoj dhe shqiptarizoj, duke përfunduar me të dhënë se: "këto formime nuk janë shumë aktive", konstatim me vend ky që meriton shpjegim, ngase aktiviteti i përfitimeve të tilla nga gjuhët e huaja nuk është i pa imponueshëm në vazhdimësi.

Lidhur me këtë prof. Selman Riza ka vërejtur "lavruetit letrarë të gjuhës sonë mbasi do të jenë bërë të ndërgjegjshëm për togtingujshin -IZ- në huazimet jo krejt të shqipëzuara për nga forma si: (me) motorizuar, nacionalizuar, organizuar dhe këtë tingujsh do të kenë bartur tek foljet të ndërhuara me tema nga të leksikut vendas si: (me) kombëtarizuar, shqipëtarizuar, shtetizuar etj."¹⁴³

Ç'është e vërteta, vetë prof. S. Riza u tregua mjaft dorilë në përdorimin e këtij formanti, ta quaj, me -I- a -IZ- të shpifur. Në veprën e tij ndeshim edhe trajtat: *gegizoj, toskizoj, sendizoj, emërizoj, mbiemërizoj etj.*, të cilat në gjuhën e sotme letrare, me të drejtë, dalin jo me formant -IZO-, po me -Ë/ZO: *gegëzjo, toskëzjo, sendëzjo, emëzjo, mbiemëzjo, shtetëzjo*, madje edhe *kombëzjo, shiptarjo a shqiptarzoj*.

Prof. Fadil Sulejmani në "Praktikumun" e tij është më i plotë, lidhur me përcaktimin e temës prodhuese të këtyre foljeve. Ai konstaton se këto folje (më -IZO-) janë formuar nga "disa emra e mbiemra të panyjshëm".¹⁴⁴ Ky autor bashkë me fjalët e huazuara që kanë cilësinë e ndërkombëtarizmes, shënon foljen shqipe "(ndër)kombëtarizoj", së cilës i shënon pranë dysonin "(ndër)nacionalizoj".

Vlen të theksohet gjithashtu fakti se foljet më -IZO-, si fjalë të huazuara ndërkombëtare, filluan të depërtojnë më dukshëm në gjuhën tonë që në vitet '20 të shekullit që shkoi. Po e elustroj vetëm me një fakt: L.

¹⁴³ Prof. S. Riza, *Vepra 2*, f. 183.

¹⁴⁴ Mr. F. Sulejmani, *Praktikumi i gjuhës shqipe*, Prishtinë 1980, f. 129.

Gurakuqi, krahas trajtave kategorizoj, organizoj etj., përdor edhe shqiparizoj. Në kohën tonë foljet e kësaj kategorie kanë zënë fushë mjaft të gjerë përdorimi. Numri i tyre në FGISSH kalon shifrën 100, ndërsa prej tyre me temë të qartë emërore a mbiemërore janë afro 70 sosh. Në këtë burim përveç trajtave të huazuara në cilësinë e ndërkombëtarizmes ndeshim këto fjalë mbi temë të shqipes: *kombëtarizoj, ndërkombëtarizoj, shqiptarizoj, moçalizoj, familjarizoj dhe pluhurizoj*. Ç'është e vërteta në realitetin tonë gjuhësor ndeshim edhe raste të tjera me prapashtesën -IZO-, si p.sh. *maskullorizoj, femërorizoj, afatizoj, zyrtarizoj, artizoj, thesarizoj, grupizoj, fshatarizoj*, të cilat (edhe pse janë krijuar nën ndikimin e trajtave të gjuhëve të huaja), në të vërtetë, janë në konkurrencë me trajtat paralele të shqipes me prapashtesën -ËZO- ose ato me prapashtesën -O-, dukuri kjo që trajtat më -IZO- i bën të diskutueshme, më mirë me thënë, mund t'i bëjë të paqëndrueshme, sidomos kur kemi të bëjmë me raste të reja, ngase, sipas mendimit tonë, duhen favorizuar trajtat me prapashtesën -O-, përkatësisht më -ËZO- kundrejt asaj -IZO-, sepse nga origjina janë më shqipe. Prandaj, kur kemi të bëjmë për mbulimin e konceptit të njëjtë gjithësi duhen parapëlqyer trajtat me -O- ose -ZO-, si p.sh.: grupoj, grupëzjoj; afatoj, afatëzjoj, visarjoj visarëzjoj, planoj planëzjoj etj. ndaj atyre të nëntipit më -IZO-, siç u cekën më lart: planizoj, grupizoj etj. Sidoqoftë, për raste të reja, siç u tha, varësisht nga konteksti, format më -IZO- sidomos mbi temë-fjalë të shqipes nuk duhen parapëlqyer, mirëpo për ato fjalë me cilësi ndërkombëtarizmi e të tjera, që tashmë e kanë fituar statusin e familjarizimit të plotë në shqipe me elementin fundor -IZ+O-, formanti i tillë patjetër duhet të jetë i tolerueshëm, por nuk duhet të mbrohen me çdo kusht, si p.sh.: alfabetizoj ndaj alfabetizoj, profetizoj ndaj profetizoj etj.

Për të mos lënë keqkuptim prapa, po riecek faktin se foljet më -IZO- kur semantikisht dalin me kuptimin e shkallës së parë, ato mund të zëvendësohen jo vetëm kuptimisht, por edhe lëndërisht pothuajse plotësisht me foljet më -O- pa zgjerim, si p.sh. afatizoj = afatoj, karbonizoj = karbonoj etj., por kur kemi shkallëzimit të ndërlikueshmërisë ose kur kemi të bëjmë me shndërrim substance të temës motivuese, atëherë në vend të foljes me formantin -IZO- mund të përdoret pamëdyshje folja me prapashtesën -(ë)ZO, si p.sh.: afatëzjoj, karbonëzjoj e kështu me radhë. Mirëpo njëherëpërnjëherë në raste nuk do të quhet shkelje e normës letrare, nëse

vazhdon tradita e përdorimit të trajtës më -IZO-, por gjithësi është mirë të kihet parasysh në perspektivë zgjidhja që po sugjerohet këtu.

E shoh të udhës të theksoj paksa dukurinë e gjallë të gjuhës sonë letrare që lidhet me ndërkombëtarizmat më -IZO- fundore në shqipe që sapo u cek. Është fjala për rastet si karbonizoj, polarizoj, magnetizoj, mobilizoj, organizoj etj. të cilat kanë krijuar çiftin antonimik (kundërvënës) me prapashtesën përkatëse të shqipes sipas shembullit model: kombëtarizoj/shkmbëtarizoj, kështu dalin edhe ato mbi bazë huazimi si: polari-zoj/shpolarizoj, magnetizoj/çmagnetizoj, militarizoj/çmilitarizoj, organizoj/çorganizoj, riorganizoj, aktivizoj/çaktivizoj, riaktivizoj etj., raste këto ku prapashtesa -IZO- del e zbrërthyeshme edhe sipas foljendërimit të shqipes. Në këto raste prapashtesa SH- dhe prapashtesa Oj shqipe, duke i dhënë kuptimësim të ri fjalë-temës së huazuar bëjnë asimilimin e saj. Po asimilim të plotë do të quanim atëherë, kur të mënjanohet plotësisht infiksi i huaj i panevojshëm -IZ.

Sidoqoftë, ma merr mendja se është mirë të mbahet qëndrim që fjalët me temë të huazuar mund ta ruajnë fundorin -IZ/O-, ashtu si edhe ato mbi temë të fjalës shqipe që tashmë kanë marrë formën e qëndrueshme të tipit kombëtarizoj, familjarizoj etj, ndërsa ato me burim të shqipes, si raste të reja, pa ngurrim duhet të marrin prapashtesën -ËZO-, përkatësisht -O- pa zgjerim, varësisht nga nënfusha semantike që mbulohet. Në FSHS (1984) është vepruar drejt, kur është hequr trajta *pluhurizoj* dhe në vend të saj është shënuar *pluhurzjoj*. Lidhur me një përcaktim të tillë, duhet par të shkallës së intensitetit, pasi kur huazohen, pa marrë parasysh formën, ato bartin me vete në shqipe vetëm një koncept, d.m.th. huazohet fillimisht koncepti i caktuar nga gjuha marrëse pa shkallëzimit stilistik a semantik që mund ta ketë atje. Dihet se shkallëzimi i kuptimit arrihet vetëm në kuadër të strukturës brenda gjuhësore të shqipes, përkatësisht, në kuadër të bashkësisë folëse që e përdor e ndikimi nga jashtë është diçka tjetër. Është e vërtetë se trajtat më -IZ- (-IS-) të burimit të huaj kanë ndikuar indirekt që formanti -ZO- i shqipes të specifikohet për nënfushën semantike të proceseve të ndërlikuara teknologjike, siç janë edhe proceset kimike.

Të rikujtohet fakti se fjalët e huazuara me -IZ-Oj (tipi: ekranizoj), si dhe ato me -ATIZ-Oj (tipi sistemartizoj) e -IFIK-Oj (tipi: elektrifikoj),

në shqipe, sipas nesh, hyjnë te grupi i foljeve më -O- pa zgjerim, sepse infiksi -IZ-, -ATIZ-, përkatësisht -IFIK-, i takon pjesës së fjalës së huazuar, prandaj kur kemi të bëjmë me procese të ashtuquajtura të shkallës së parë në vend moçalizoje a metalizoje, më drejt për mendimin tim është të shënohen trajtat më -O-: *moçaloj, metaloj*, përkatësisht, nëse kemi të bëjmë me procese tekniko-teknologjike a të një shkalle më të ndërlikuar a të shndërrimit të "substancës" kuptimore të përdoret trajta më -ËZO-: *moçalëzoj, metalëzoj*, e kështu me radhë.

Gjithsesi trajtat më -IZ/-, të cilat, siç u tha, bënë invazion në gjuhën tonë në vitet '20 të shekullit të sapokaluar e që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, mbesin karakteristike e stilit libror dhe nuk kanë gjetur shtrat përdorimi a përvetësimi mbi temat vendëse, prandaj nuk është mirë të lejohen pa nevojë edhe në jetën tonë ligjërimore a shkrimore as tashti as në periudhën e ardhme.

6. Foljet më -CO-

Edhe pse me origjinë dialektore, siç konstatohet në burimet tona normative, formanti -CO- del i pranishëm edhe te disa folje të prejardhura që ndonjëra prej tyre ka gjetur përdorim mjaft të gjerë edhe në letrarishten e sotme, mirëpo shumica prej tyre kanë mbetur me shtrirje periferike dialektore. Ja disa shembuj:

shalcoj (F. Bardhi), mëlcoj, laracoj, kërcoj, rrumcoj, grepcoj, galcoj, gropcoj, gjakëcoj, dromcoj, ujcon, gurëcoj, malcoj barcoj shkalcoj, belbëcoj, barcoj etj.

Ndonëse tingulli C korrespondon me zëshmin X, ky element i foljeformimit, pos që ka lidhje me prapashtesën emërore -C, -CË, pasi kanë prejardhje të njëjta, në fjalëformim konsiderohet si zhvillim i prapashtesës emërore -(Ë)S, përkatësisht i prapashtesës foljore -SO-. Kjo dukuri është vërejtur nga Xhuvani-Çabej, të cilët për prapashtesën emërore -C, -CË, thonë se i përgjigjet prapashtesës -(Ë)S, përkatësisht -SË dhe kjo ilustron qartë me shembuj: përdorc - përdorës, lojc - lojës, mjalçë - mjalhtëz,

kapce - kapëz etj. Edhe më bindës del konstatimi i autorëve të lartpërmendur, kur konstatojnë se "te disa emra veprues kjo prapashtesë ka dalë nga -TS- si p.sh. blojc - bluejtës, lojc - luejtës, tuc - tutës, fuc futës, vjedhe vjedhës etj."¹⁴⁵

Pra, analogjikisht, ashtu siç është formuar prapashtesa e mirëfilltë -SO-, ashtu mund të shpjegohet edhe përfimi i formantit -CO-, i cili, në të vërtetë, është vazhdim a zberthim i mëtejshëm i formantit të parë. Kjo shihet qartë te këta shembuj: mëlcoj, laracoj, kërcoj e ndonjë tjetër, ngase "ndërrimi i S-së në C është një fenomen fonetik i zakonshëm në të folmen e Veriut e të Shqipnisë së Mesme, siç e thekson A. Xhuvani në "Studime gjuhësore",¹⁴⁶ mirëpo formanti -CO- në ndonjë rast mund të jetë i këmbësor edhe me formantin -ZO-, madje një dukuri e tillë e përdorimit të C-së në ndërtim të tilla kishte shtrirje edhe në vise jugore.

Nga sa u tha më sipër del se rastet grimcoj (grimëcoj), dromcoj (dromëcoj), dalin të diskutueshme nga aspekti i temës mbështetëse fjalëformuese, sepse kemi emrat *grimçë* e *dromçë*, por njëherazi kemi në bazë edhe primitivet: *grimë* dhe *dromë*, si emra të parmë. Në të vërtetë, prof. E. Çabej¹⁴⁷ foljen dërmoj si dhe atë dromcoj (dromçë e dromkë) i nxjerr nga tema "dromë".

Te K. Kristoforidhi pranë foljes dërmoj shënohet edhe dërmëcoj.¹⁴⁸ Kjo që u tha më sipër nuk del e reflektuar te shembujt si: mëlcoj (mbëlcoj), që vjen nga i ëmbël, gurëcoj, e cila vjen nga gurë, laracoj nga larë, gropcoj nga gropë, gjakëcoj nga gjak, galacoj nga galë, grapëcoj nga grap, belbëcoj nga belbë (Noli) etj. ku, nga zberthimi, del fare e qartë tema motivuese, të cilës, siç shihet, i është shtuar prapashtesa -CO-. Perceptimi i formantit -CO- si prapashtesë e mëvetësishme foljeformuese arsyetohet lehtë me faktin se në gjuhën e sotme letrare nuk ndeshim kurrfarë gjurme të ekzistimit të ndonjë trajte emërore të supozuar me -C fundor, si: ëmbëlç, larc, gurg, belbc.

Në Fjalorin e K. Kristoforidhit¹⁴⁹ ndeshim ndonjë folje më -CO-, si p.sh.: ëmbëlcoj, egërcoj, fikëcon, urtëconj, dërmëconj etj., por në variante

¹⁴⁵ Xhuvani - Çabej, *vepra e cituar...*

¹⁴⁶ A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Prishtinë 1968, f. 163.

¹⁴⁷ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore* I, f. 142.

¹⁴⁸ K. Kristoforidhi, *Fjalori...* f.80.

¹⁴⁹ Po aty.

dialektore ndeshen edhe sot e kësaj dite mjaft trajta si: valloj, gurcoj, nalcoj - që në gjuhën letrare tashmë i kanë përgjegjësit e normëzuar paralelë, qoftë me prapashtesën -ZO-, qoftë me prapashtesën -SO-, si: vallëzoj, gurëzoj, naltësoj. Te vepra e A. Zymberit i ndeshim këta shembuj më -CO-: shkalcoj, vrancoj, egërcoj, thucoj, barcohet, nalcoj.

Siç dihet, kur është fjala për të njëjtin koncept as që ka nevojë të përdoren a t'u kthehet legjimiteti trajtave me prapashtesën -CO-, nëse në letrarishtet nocioni i tillë është mbuluar me prapashtesën tjetër, mirëpo kur kemi të bëjmë me tipizime a nuanca stilistike (humoristike etj.), ato mund të përdoren.

Në vazhdim po e cek edhe një dukuri që më duket se është me interes të dihet lidhur me temën që po trajtohet këtu. Trajtat foljore me fundorin -CO- nuk tregojnë vetëm ngjyresën dialektore, po ato njëherazi argumentojnë edhe lashtësinë e ekzistimit dhe të përdorimit të tyre në të dy arealet, ngase në periudhë mjaft të hershme është bërë alternimi i prapashtesës -SO- ose asaj -ZO- në -CO-. Kjo moshë dhe rrethanat e shndërrimit të tillë mbeten të përcaktohen. Krahaso: Frang Bardhi përdori trajtën shalcoj, me shalcue me kuptimin *eci kaluar*, Sami Frashëri përdori trajtën lehtson (lehtëson), F. Noli belbëcon (belbëzon), Çajupi: mëlcon. Në veprën e GJ. Fishtës ndeshim më shumë shembuj si p.sh.: ambëlcoj, grimcoj, lecoj (lehtësoj), egërcoj (egërtoj) etj.

Pikërisht për shkak të lashtësisë relative që ka forma e caktuar me prapashtesën -CO-, ndonjëra prej formave të tilla ka arritur të zërë vend në fondin aktiv të leksikut të sotëm të shqipes letrare kombëtare, siç janë edhe shembujt që u cekën më sipër. Kjo është edhe arsyeja që trajtat me -CO- i ndeshim edhe në burimet e caktuara të ditës si p.sh.: ujon (plaga), shih edhe te Fjalori shqip-frëngjisht i V. Kokonës (1977 f.544), malcoj ("Fjala, 13. VII. 1992, f. 3, "ua malcoj plagët e trupit"), por gjithsesi këto janë raste të rralla.

Sigurisht hulumtimi i mëtejshëm rreth kësaj dukurie mund të sjellë përfundime edhe më të kristalizuara rreth foljeve të formuara me prapashtesën -CO-, që ka të bëjë edhe me autenticitetin e nënfushës kuptimore e stilistike të përdorimit të saj, që në raste të caktuara dallohet qartë kuptimi demunitiv që shprehet me të.

Nëse foljet më -CO- si p.sh. grimcoj, dromcoj, gurëcoj, laracoj, groçoj, belbëcoj e të tjera ndërlihen asociacionisht paksa me emrat a mbie-

mrat demunitiv me prapashtesën -C (-CË), atëherë, në njëfarë mënyre, mund të motivohet edhe prodhimitaria e tyre, përndryshe foljet më -CO- aktualisht nuk paraqitin model lakmues me prodhueshmëri të theksuar.

Përmbyllje

1. Foljet më -NO-, tipi: cubnoj, vargnoj, burnoj, synoj, përcudnoj etj., përveç ngjasimit mbi bazë të paralelizmit me formantin -RO-, sa i përket nënfushës semantike jo vetëm në raste po ndryshojnë përgjithësisht. Foljet më -NO- më tepër shprehin kuptimësi të shkallës zanafillëse që kanë të bëjnë me temën e qartë prodhuese. Ato s'kanë të bëjnë sot për sot aq me stilin poetik që lidhet me botën shpirtërore të njeriut (përdetim subjekti të vetes së parë), siç veprohet me foljet me formantin -RO-. Sigurisht me foljet më -NO- tregohet autenticiteti i krijimit të tyre që lidhet me specifikën dialektore të formimeve të tilla, të cilat janë shtrirë edhe në gjuhën letrare kombëtare. Në gjuhën e sotme letrare ka mundësi, më mirë me thënë, ka arsye të përkrahet një mundësi e tillë diferencimi, që foljet e përfuara rish-tazi më -NO- dhe ato më -RO-, madje edhe mbi temë të njëjtë prodhuese, të përcaktojnë e specifikojnë, secila veç e veç, nënfushat përkatëse semantike e stilistike.

Zbërthimi i foljeve më -NO- ngjason me zbërthimin që u bëhet foljeve më -RO-, por jo në pak raste ndryshon, si p.sh. cubnoj = bëj punë cubi, bishtnoj – bëj bisht (fig.), çudnoj – bëj çudi, përcudnoj = bëj punë për t'u çuditur etj., ndërsa te foljet më -RO- kishim të bënim me një përdetim të dalluar subjektiv (poetik!), b.f. pleqëroj - kaloj (e ndjej) kohën e pleqërisë, ndërsa pleqnoj - bëj pleqni, gjykoj si pleqnar etj., pra trajta më -NO- s'ka të bëjë me ndjesi subjektive dhe në shumicën e rasteve përkon me semantikën që shprehin foljet më -O- pa zgjerim me temë të qartë fjalëformuese.

2. Foljet më -MO-, tipi: thekmoj, erëmoj, gufmoj, zhagmoj, zhigmoj, xixëmoj, moçmoj etj., edhe pse në numër jo aq të madh sa i përket semantikës karakterizohen me kuptimësi jo të hapur, d.m.th. me kuptimësi pak a shumë të mbyllur. Shprehin pothuajse po ato karakteristika semantike, siç shprehin edhe mbiemrat prejjesorë me prapashtesën -M a në mbësh-

tejtje të vetë pjesore me -M fundore të shqipes (gegërishtes), e cila në kohën tonë pasqyrohet vetëm te disa mbiemra. Ç'është e vërteta, mbiemrat me -M në gjuhën e sotme letrare nuk dalin të favorizuar (këtu është fjala për mbiemrat prejpjesorë të tipit: i moçëm, i nxemë, i ermë, i ardhëm, i thekëm, etj., mirëpo, gjasat janë të ofrueshme, nëse nevojitet në të ardhmen, bashkë me aktivizimin e foljeve me -MO-, sipas semantikës që sapo u cek më sipër, ndoshta mund të riaktivizohen edhe mbiemrat në fjalë. Madje me një veprim të tillë specifik ndërndikues, gjithsesi, gjuha jonë standarde nuk do të pësonte kurmjë të keqe, përkundrazi do të shfrytëzonte këtë pasuri të fjetur nga rezerva e vet, mundësi kjo që, nëse merr nxitje "të re", do t'i rijapë shprehjes së shqipes nuanca e ngjyresa të reja kuptimore e stilistike specifike edhe më të larmishme dhe të pakufizuara për nga numri.

3. Foljet e shoqëruara me geminacionin ekspresiv -RRO- janë karakteristike e vetë stilit ekspresiv afektiv në shqipë. Me ndihmën e -RR-së folja shpreh "geminacion ekspresiv", thotë prof. Anastas Dodi. Kështu p.sh. foljet: gocërroj, cakërroj, kuqërroj, vekërroj, plakërroj etj. i ndeshim vetëm në raste të rralla. Me formantin -RRO- folja (shprehja) fiton një intensitet të një shkalle të lartë, që ka lidhje kuptimore të pashkëputur me temën prodhuese fjalëformuese, qoftë kjo fjalë e rëndomtë, qoftë onomatope. Kjo prapashtesë foljore priret t'i japë shprehjes, e së këtejmi edhe stilit, pak a shumë ngjyresë të natyrës serioze, në krahasim me simotrat, foljet më -RO- e -LO-.

4. Me prapashtesën -LO-, tipi: kuqëloj, cikëloj, copëloj, pikëloj etj. formohen folje nga tema të qarta fjalëformuese, që janë karakteristike e stilit të butë, si të themi, të natyrës mikluese (fëmijënore), me mundësi të pakufizuar shumimi. Në njëfarë mënyre foljet më -LO- qëndrojnë në kundërvënien me foljet më -RRO-, -LLO-, si p.sh., tipi: kuqërroj/kuqëlloj, bubullon/bubulon etj. Edhe ky fakt shton arsyen që formantet e tilla të konsiderohen si prapashtesa të mëvetësishme foljeformuese.

5. Formanti -IZO- te shembujt si moçalizoj, kombëtarizoj, zyrtarizoj, metalizoj etj. nuk i takon frymës së traditës popullore, por stilit libror, sepse ka mbështetje në infiksionin e huazuar -IZ- (-IS) bashkë me trajtën përkatëse foljore, prandaj formanti i tillë, i krijuar nën ndikimin e formës së gjuhës

së huaj, nuk është mirë të parapëlqehet as nga huazimet pa nevojë, e jo më mbi fjalë-temat vendëse. Meqenëse foljet më -IZ/O-, shprehin në të shumtën e rasteve kuptimin e huazuar fillestar, foljet e tilla në shqipë semantikiisht ngjasojnë me nënfushën kuptimore që paraqesin foljet më -O- pa zgjerim., mirëpo në raste të caktuara mund të këmbëhen edhe me foljet më -ZO- e me ndonjë tjetër, prandaj, në situata të tilla më e rekomandueshme duhet të jetë për përdorim prapashtesa -O-, përkatësisht -ZO- se ajo hibridja -IZ/O-, me infiksionin e imponuar -IZ-.

6. Ndonëse me origjinë dialektore formanti -CO- që i referohet formantit -SO- në disa raste, si p.sh. malcoj, mëlcoj, gurëcoj, laracoj, gropcoj, gjakcoj, belbëcoj etj. ka arritur të ketë shtrirje edhe në gjuhën letrare. Semantikiisht foljet e tilla anojnë të shprehin kuptimësi deminutive. Ky formant sot për sot nuk del prodhimtar, por nuk përjashtohet ndonjë rast si shembull atraktiv që të parapëlqehet si mjet kreativ i formëzuar, kur kemi parasysh nënfushën semantike deminutive që mbulohet me foljet e tilla.

C. FOLJE TË PREJARDHURA ME FORMANTE TË TJERA TË DISKUTUESHME SI ZGJERIM I PRAPASHTESËS -O-

Përveç formanteve foljore prapashtesore të mirëfillta si dhe formanteve (si) variante të prapashtesave të mirëfillta, që u cekën në dy pjesët e para të këtij nënkreu, në realitetin tone gjuhësor dalin edhe disa formante të tjera, që bëjnë pjesë në kuadër të strukturës foljeformuese me prapashtesën -O- me zgjerim, që janë: -KO-, -SHO-, -SHTO-, -ÇO-, -ZHO-, -HO- e -JO-, të cilat do të trajtohen në vazhdim.

Këto morfema i ndamë si grup më vete dhe i quajmë **formante të tjera të diskutueshm** për arsye se këto, pothuajse të gjitha, karakterizohen për origjinë të ndryshme. Ç'është e vërteta, të gjitha këto nuk kanë qenë objekt trajtimi në mënyrë të veçantë nga studiuesit tanë, edhe pse kalimthi në raste të veçuara, pikërisht për hir të funksionit të tyre prapashtesor që kryejnë në situata të caktuara, patjetër do të jenë cekur si prapashtesa të foljeve më -O- me zgjerim, të cilat, gjithsesi, si të tilla kanë prani në kuadër të sistemit foljor të shqipes.

Edhe këto formante, siç do ta provojmë konkretisht, sikurse (si) variantet e prapashtesave të mirëfillta të -O-së me zgjerim, shërbejnë për të formuar folje, me të cilat shprehet një proces me ndërlikueshmëri të një shkalle të caktuar, qoftë relativisht të barabartë, qoftë të ngjashme ose më të lartë në krahasim me prapashtesat që u trajtuan në dy pjesët e mëparshme të këtij nënkreu.

Edhe analiza që pason duhet të ndiqet me vëmendje të veçantë, ngase kemi të bëjmë me lëndë pak a shumë të panjohur dhe gjithsesi, jo të studiuar e të sistemuar sa duhet në gjuhësinë tonë. Po e them me plot gojën, se kemi të bëjmë me lëndë interesante dhe me vlerë, jo të vogël, për gjuhën tonë në përgjithësi dhe për sistemin foljor me prapashtesim të gjuhës sonë, në veçanti.

1. Foljet më -KO-

Në ligjërimin tonë të përditshëm, por edhe në gjuhën e shkruar ndëshim mjaft folje që përdoren me formantin fundor -KO-, madje një formant i

tillë në disa raste në shqipen letrare fare qartë dallohet se del në funksion të prapashtesës foljeformuese. Kjo -KO- fundore mund të vërehet pa shumë vështirësi të shembujt e mëposhtëm:

fillkoj (fill filloj), füllkoj a tfillkoj (fjill a fjill), gjinikoj (gjini), rënkoj (rënë), rëndkoj (rëndë), mujkoj (muj mund), shpendkoj (shpend), birkoj (birë), ngalkoj e ngarkoj (kalë kaloj), bërdylkoj (dyll), telkoj (tel), shoshkoj (shoshë); udhako (udhë); kilikoj (kili - kili), çerrkoj (çerr-çerr), fërkoj (fër-fër), hejkoj (hej-hej), mukon (mu-mu), uhkon (uh-uh), kukon (ku-ku), ufkoj (uf-uf), ahkoj (ah - ah) krrakon (krra-krra), bahkon (bah-bah), fuskoj (fus), leqakoj (bëj leqe), mushtëkoj (mushtë), mëlkoj (mël-), shabakoj (shaba), buçkoj (buçe), loçkoj (loce, loke) etj.

Në veprën e Xhuvani-Çabejt për prapashtesat e gjuhës shqipe nuk përmendet prapashtesa foljore -KO-, por zihet në gojë vetëm prapashtesa -K- e sistemit emëror, për të cilën thuhet "kjo prapashtesë është refleks shqiptar i formantit indoevropian -KO-".¹⁵⁰ Natyrisht në shqipe ndihet i reflektuar pa zanoren fundore -O-, dhe kjo është kreu i krejt normale për sistemin emëror. Lidhur me këtë edhe prof. A. Xhuvani në një punim tërheq vëmendjen se "puna e prapashtesës -K- që është indoevropiane dhe haset edhe në gjuhë të tjera motra, meriton të studiohet e të vëzhgohet mirë në gjuhën tonë". Këtë vërejtje të prof. Xhuvanit me qëllim po e theksoj, si me thënë, në mënyrë të veçantë, ngase sigurisht formanti emëror -K- do të ketë pasur njëfarë ndërmikimi interferencor, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi edhe lidhur me shfaqjen e formantit -KO- foljor që po trajtohet këtu në cilësimin e prapashtesës -O- me zgjerim.

Ndërlidhja e prapashtesës emërore: -K-, -KË- me formantin prapashtesor -O-, -KO- shihet qartë edhe te këta shembuj: cullakoj a cullëkoj, dhelkoj, shpatukoj etj., pasi në gjuhën e sotme kemi emrat a mbiemrat e prejardhur përkatës: cullak, dhelkë, shpatuk, por njëherazi kemi edhe emrat e parmë: cullë, dhele, shpatë. Prandaj trajtat foljore mbi këtë bazë mund të interpretohen motivisht dymënyrash: sipas versionit të parë me prapashtesën -O- pa zgjerim çka nuk është aq larg mendsh dhe sipas versionit të dytë të prapashtesën -O- me zgjerim, d.m.th. me elementin -K mbë-

¹⁵⁰ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980.

shitetes: -KO-, mënyrë kjo e lejueshme që mund të përgjithësohet a të vlejë në interpretim edhe për disa raste të tjera, siç janë edhe disa shembuj të padiskutueshëm që u shënuara më sipër.

Lidhur me këtë vlen të përmendet edhe një mënyrë tjetër e pasqyri- mit të elementit -KO-, siç janë rastet birkoj, pjetkoj e ndonjë tjetër, të cilat prof. E. Çabej i shpjegon të dala si "përftim formash me anë asosacionesh të ndryshme që janë përzier me fjalë të tjera, e para birkoj nga biroj + kërkuj dhe e dyta pjetkohem nga pjetem + dedikohem".¹⁵¹ Edhe tema e trajtave ngalkoj (ngarkoj / shkarkoj / zhgarkoj / zhgalkoj) si dhe mallkoj, ndëshkoj (ndishkoj) e bekoj dalin qartë vetëm nga ana etimologjike, e para del nga fjalë-tema kalë (lat.vulg. e it. *calvacare*), ndërsa ndëshkoj (ndishkoj) lat. *costigere* e mallkoj përngjan me latinishten *maledicere*, ndërsa ajo bekoj gjithashtu me atë të latinishtes: *benedicere* etj. Sa ka të drejtë shqipja si protoshqipe të kërkojë pjesën e vet në ndonjë trajtë të latinishtes vulgare mbetet të gjurmohet. Sigurisht sugjerimi i tillë kërkon përgjigje dhe do të shohë dritë e do të kristalizohet më mirë në të ardhmen, por sa më parë e me kompetencë të behet kjo, aq më mirë do të jetë për njohjen tonë me protoshqipen dhe për shqipen e sotme dhe në vazhdim.

Pa marrë parasysh origjinën është i pamohueshëm fakti se te shumica e foljeve të sipërshtënuara formanti -KO- del i vijëzuar si prapashtesë e mëvetësishme në shqipe, gjë që lë shteg për t'u zbërthyer nga pikëpamja e ndërtimit edhe me elementet kuptimore të gjuhës sonë që mund të dalë nga tema e qartë fjalëformuese përkatëse: kalë-i, be-ja, ndi-(me ndi), mall-i etj. plus prapashtesa -KO-. Këtu e kemi fjalën për asociacione, jo vetëm të mundshme, por edhe të përligjishme, të cilat pa hyrë thellë në analiza etimologjike, mund të nxisin asociacionisht në të mirë të vijëzimit të mëvetësisë së formantit në fjalë në ndjenjën gjuhësore si dikur ashtu edhe aktualisht. Që formanti -KO- del si barasvlerës paralel me formantet e tjera sinonime mjafton të sjellë një shembull nga Fjalori i K. Kristoforidhit.¹⁵² Aty shënohen të barasvlershme këto forma foljore sinonime: *kilëzuj, giciluj* edhe *kilikoj / kilikos, gudulis* / (Krahaso: kilë+z0, gici+lo, kil+i+ko). Ingjashëm me këtë është edhe rasti: dhëmbkoj, ndaj dhëmbos; mëlkoj ndaj mëlmej e mëlcoj. Sa ishte "popullore" kjo prapashtesë në fillim të shekullit tonë, po

¹⁵¹ Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë 1986, f. 253, 254.

¹⁵² Fjalori i K. Kristoforidhit, f. 159.

e përmend vetëm shembullin "telkoj, me telkue", të nxjerrë nga Fjalori i "Bashkimit" (1908)¹⁵³, ku shihet qartë se emri "tel teli" shërben si temë e qartë fjalëformuese për foljen më -KO-: me telkue (telkoj). Prof. E. Çabej foljen *dyllkoj* e shpjegon me bindje të plotë se ka dalë nga fjala *dyllë* + prapashtesa -KO-j, d.m.th. nga ky autor në këtë shembull identifikohet formanti -KO- si prapashtesë foljeformuese. Edhe përdorimi i foljeve me -KO- mbi temë emërore shpreh prirjen për të treguar kuptimësi deminutive. Gjurmimi i mëtejshëm në këtë drejtim, sidomos rreth faktit se a ka ndonjëfarë ndikimi folja "koj" (mëkoj, jap ushqim a mëlkoj) i hedh gjellës yndyrë¹⁵⁴ etj. do të jetë i dobishëm për përcaktimin më me qartësi të nënfishës kuptimore që shprehin foljet më -KO-, si dhe për emrat a mbiemrat me prapashtesën -K-, -KË, të cilët, siç u tha, mund të ndërliiden kuptimisht, në njëfarë mënyre, me foljet më -KO-. Por më qartë si formant prapashtesor del te foljet që formohen mbi temë të një onomatopeje, si p.sh. hej-hej hejkoj, mu-mu mukon, kra-kra krrakon, of-of ofkon, ah-ah ahkon etj., duke shërbyer njëherazi fonema -K- si element ndërmjetës epentetik mbështetës para prapashtesës foljore -O-j, sidomos pas tingujve fundor: -j, -h, -f etj. Kështu, pra, ajo kryen funksionin prapashtesor si mbështetëse e prapashtesës -O-. Foljezimi i onomatopeve (tingullimitimeve) në këtë mënyrë duket se mund të vijëzohet një sirregull e qëndrueshme foljeformuese.

Sa kompleks, por me vlerë, del thellimi i mëtejshëm mbi vlerësimin e këtij formanti, po përmend një hamendje të prof. E. Çabej, i cili, siç u tha më sipër, njëherë foljen birkoj e nxjerr nga biroj + kërkuj¹⁵⁵, por në një vend tjetër për "birkon" nuk përjashton as mundësinë se "birkoj" do të ketë dalë nga një deminutiv me "KË" si birkë.¹⁵⁶ Pa marrë parasysh supozimin e prof. E. Çabej, në gjendjen e sotme trajta "birkoj" asociacionisht mund të zbërthet nga birë- (vrinë): bir+KO- birkoj (fig. *spiuanoj*) dhe të perceptohet në ndjenjën gjuhësore si prapashtesë e mëvetësishme.

Pra, hiq formimet foljore onomatopeike, mbi temat e të cilave formanti -KO- del fare qartë si prapashtesë foljeformuese, foljet më -KO-

¹⁵³ Fjalori i "Bashkimit", f. 451.

¹⁵⁴ Fjalori i shqipes së sotme, Titanë 1984, f. 707.

¹⁵⁵ Dr. Ç. Çabej, *St. gjuhësore VII*, f. 253.

¹⁵⁶ Po aty.

mbi temë emërore a mbiemërore më fort shprehin nuanca kuptimore a stilistike të natyrës deminutive, ngjashëm sikurse emrat e mbiemrat me prapashtesën -K (-KË), prandaj pikërisht në mbështetje të kësaj nënfushë semantike, formimet me foljore më -KO- mund të kenë shumim dhe të ardhme të favorizuar në shqipen standarde kombëtare.

2. Foljet më -SHO-

Në kuadër të foljeve të prejardhura me zgjerim të -O-së, dalin edhe disa folje me formantin fundor -SHO-.

Rreth daljes së elementit -SH- në përgjizje me prapashtesën foljore -O- është e nevojshme të konsultohen a të kihen parasysh tri mendime jo kundërvënëse që janë shprehur për prapashtesën emërore -SH- e variantet e saj.

Së pari, po cek gjykimin e N. Joklit, i cili elementin -SH- të fjalët: gjysh (tregjysh, katragjysh), pastaj moshë, pishë, plish, e sheh si "një refleks të zgjerimit të indoevropsishtes -SO- me kuptim emrash vepruesi (nomina agentis), kurse te fjalët vegsh, frymsh etj. nga studiuesit shihet "një procedim fonetik" të prapashtesës -SHËM "të shndërruar në SHM, e pas zhdukjes se M-së, në -SH".¹⁵⁷ Sipas po këtij burimi Spiterci "në elementin -SH- të fjalës lëshsh sheh një ablativ të fosilizuar të shqipes".¹⁵⁸ Edhe sipas Boppit, "ndajfoljet me -SH, si dysh, tresh etj. kanë dalë nga ablativi i shumës".¹⁵⁹ Xhuvani - Çabej edhe ndajfoljen **veç** e shjegojnë nga vetë - vetsh - **veç**.¹⁶⁰

Së dyti, po e shtojmë edhe këtë se Xhuvani - Çabej shprehin mendimin se po këtë rrugë zhvillimi "morfologjik e semantik" kanë edhe "mbiemrat e substantivuar" kalbsh, gërbulsh, frymsh etj. që mund të zërthehen kalbsh "një prej asosh që janë të kalbëta", përgjaksht "një prej asish që s'kanë gjak" etj.¹⁶¹ Prof. E. Çabej në një punim të tij shpreh mendimin se folja dyshoj "është formuar prej ablativit të dy-së".¹⁶²

Së treti, prof. Selman Riza shpreh mendimin se foljet më -SHO-, siç janë shembujt: (me) **hieshuar** (hijeshoj) dhe (me) ndriçuar ndriçoj ndrit-

¹⁵⁷ Xhuvani - Çabej, *vepra e cituar*, f. 538

¹⁵⁸ Po aty, f. 538.

¹⁵⁹ Po aty, f. 358.

¹⁶⁰ Po aty, f. 358.

¹⁶¹ Po aty, f. 358.

¹⁶² Dr. E. Çabej, *St. Gjuhësore I*, f. 151.

shoj, vijnë nga trajta ndajfoljore, përkatësisht mbiemërore: **hie+shëm** i **hieshëm**, **ndrit+shëm** i **ndritshëm**, kështu që "si temë emërore formanti -**shëm** humb pjesën -ëm"¹⁶³ (f. 282).

Pra, dy supozimet e para sigurisht mund të jenë gërshtuar në shembuj të ndryshëm edhe te foljet me formantin fundor -SHO-, por një mundësi e tillë nuk mund të quhet dukuri e përgjithësuar, ndërsa supozimi i tretë del disi më i pranueshëm.

Ç'është e vërteta, te shembujt, si p.sh.: "**epshoj, efsshoj**" zbrërthimi mund të dalë i interpretuar dymënyrash: së pari nga emrat me -SH fundor ngase ekzistojnë emrat: "epsh, efssh" dhe së dyti nga fjalët e parme, ku nuk del fundori -SH, si p.sh. nga folja: ep (epem), përkatësisht onomatopeja ef-ef. Pikërisht te këta shembuj vetëm sa nxjerr kokë perceptimi rreth formantit të mëvetësisshëm -SHO-, formant ky që do të dalë qartë, madje si formant prapashtesor i mëvetësisshëm, te shembuj të tjerë, si b. f.:

ngulshoj (ngul), etshoj (et-je), hershjoj (herët), hijeshoj (hije hijeshi), unshoj (u-ri, i unshëm), lëshoj (lë), turrshoj (turr-), mujshoj (muj mund), ofshoj (of- onomatope), krahshoj e krahëshoj (krah), erëshoj (erë), rrufshoj (rruf-), brishoj (bri) etj.

Është e vërtetë, siç u cek më sipër, se reflektimi i këtij formanti shihet si një "procedim fonetik" i prapashtesës mbiemërore -SHËM, si p.sh. i etshëm: **etshoj**, i hershëm, **hershjoj**, i unshëm **unshoj**, mirëpo procesi i shndërrimit mund të ketë ndodhur sipas ligjeve të caktuara që del i shpjegueshëm edhe në pikëpamje historike, por vetë fakti i një zbrërthimi të tillë nuk ka mundur të marrë deri tani formën e një rregullsie a të një modeli, ku gjithnjë del e pranishme trajta e caktuar mbiemërore, prandaj kjo dukuri në ndjenjën gjuhësore të shqipfolësve më tepër u perceptua, siç mund të përkapet edhe aktualisht, si një formant i vetëm foljeformues pa e pasur të shqiptuar elementin -ËM të zhdukshëm të prapashtesës mbiemërore -SHËM, siç e cek edhe prof. S. Riza.

Si mbështetje, nga sa u tha më sipër, do të na shërbejë zbrërthimi si-kurse te shembulli "hieshjoj": "e bëj (më) të hieshëm", mund të praktikohet

¹⁶³ Prof. Selman Riza, *Vepra 2*, f. 282.

edhe të shembujt e tjerë, si p.sh. *këndshoj* (e bëj më të këndshëm) e në raste të tjera si: *lumshoj*, *etshoj*, *ershoj*, *terrshoj etj.*, mundësi kjo që si nektar lulesh mund t'u shërbejë krijuesve, në radhë të parë poetëve tanë, por jo vetëm atyre, për të mbrumur sa më mirë mjaltin e fjalës së bukur shqipe.

Kur është fjala të përcaktimi i nënfushës semantike, që mbulojnë foljet me prapashtesën -SHO-, mund të thuhet se një nënfushë e tillë tregon një proces jo të mbyllur, ashtu siç shprehin a mbulojnë, si me thënë, edhe mbiemrat me -SHËM, proces ky që tregon cilësi në vazhdimësi. Në të vërtetë, folja më -SHO- mbart në vete asociacionisht pothuajse po atë kuptim që e ka edhe mbiemri më -SHËM. Shembujt e foljeve që dalin me formantin -SHO- në njëfarë mënyre mund të paraqiten në kundërvënie me foljet më -MO-, me të cilat, siç e pamë më përpara, paraqitin një veprim pak a shumë të mbyllur, pasi kuptimisht përkonin me semantikën e mbiemrave prejpjesor me -M(-r) fundor, ndërsa foljet më -SHO-, siç po provohet këtu semantikisht përputhen me kuptimin e mbiemrave më -SHËM, të cilët shprehin procese në vazhdim. Lidhur me këtë, po e paraqit sa për ilustrim shembullin paronimik nga fjalë-tema "erë-": *erëmoj* - proces i mbyllur "e bëj me erë (e bëj të ermë), d.m.th. procesi përfundon (ndërpritet), ndërsa te "erëshoj" - "e bëj me erë pandërprerë (e bëj të ershëm), d.m.th. jepet (lëshohet) erë vazhdimisht" duke u paraqitur si një proces që ka vazhdimësi, d.m.th. nuk ndërpritet. Sigurisht, sikurse ndërmikohen foljet më -MO- me mbiemrat prejpjesorë me -M fundor, ashtu ndërmikohen edhe foljet më -SHO- me mbiemrat me -SHËM fundor. Le të krahasohet ngjashmëria semantike e foljeve në shqyrtim me mbiemrat përkatës, në njërën anë, me raportin e mbiemrave të njëshmëm dyorë paronimikë, në anën tjetër, që dalin drejtpërdrejt prej emrash, si p.sh. i padëm – i padëmshëm, i pafaj – i pafajshëm, i pakujdes – i pakujdesshëm, i pander – i pandershëm etj., ku ndjeshmëria semantike e grupit të pare del e ndërprerë po më me ngarkesë të veçuar emocionale, ndërsa kuptimësia e grupit të dytë me prapashtesën -shëm del e pa ndërprerë dhe pa ndonjë ngarkesë të veçuar, kuptimësi kjo që përkon me foljet më -SHO që po trajtohen këtu (Shih: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, 204).

Nëse ndërgjegjësohet favorizimi i një prirje të tillë kundërvënëse, d.m.th. të foljeve më -MO- ndaj atyre më -SHO-, sipas nënfushës semantike që mbulojnë, çka e mundëson vetë sistemi dhe logjika që del nga she-

mbujt konkretë, pra me një kundërvënie të lehtë, atëherë kjo prirje ka mundësi të kalojë në një model me perspektivë të mbarë e me vlerë shumë të ndieshme në gjuhën tonë letrare kombëtare.

Gjithsesi, kjo prirje, po përsëris, jo vetëm se duhet të ndiqet, por është mirë edhe të favorizohet në mënyrë të ndërgjegjshme, kur kemi për bazë nënfushat semantike e stilistike, që sapo u cekën, të cilat mbuloohen, duke i futur në përdorim foljet me prapashtesat përkatëse: -SHO/j /-MO/j.

3. Foljet më -SHTO-

Në gjuhën tonë kemi disa folje që mbarojnë me formantin fundor -SHTO-j. Sigurisht këtë formant në analizë ndërtimore duhet kërkuar së pari nga bashkëngjitja e togut -SHT- mbiemëror a ndajfoljor me prapashtesën foljore -O- = -SHT+O- -SHTO- ose si një refleks të foljes SHTOJ (me shtue, shtuar), siç janë shembujt:

Dyshtoj, *lashtoj*, *korishtoj*, *krahishtoj*, *kreshtoj*, *kundërshtoj*, *lagështoj*, *ligështoj*, *madhështoj*, *mprapshtoj*, *mbarështoj*, *mundshtoj*, *rishtoj*, *mallështoj*, *njomështoj*, *vrashtoj*, *madhështoj*, *kundërshtoj etj.*

Nga konsultimi i formanteve emërore prapashtesore: -ISHT, -ISHTE, ISHTË si dhe -SHTË e -SHT,¹⁶⁴ kuptojmë se prapashtesa emërore -SHTË, -SHT, do të ketë qenë e pranishme në gjuhën tonë, që në periudhën e hershme parasllave. Lidhur më temën që po trajtojmë është me rëndësi të konstatohet se nga shembujt e konsultuar me këtë formant del se, nga emrat me -ISHT, -ISHTË e -ISHTË në gjuhën tonë nuk del qartë se është pasqyruar ndonjë folje më -O-, madje edhe as nga emrat me prapashtesat -SHTË, -SHT, siç janë emrat: ashtë a ahishtë (nga ah ah), bliishtë a bliinishtë (nga bli bliri), drushtë a drunishtë (nga dru druri), vreshtë (nga verë), kashtë (nga kallë kallëz), heshtë (nga hell), fishtë (nga fiq), lashtë (nga lag), bisht (nga bi(th) etj., nuk janë përfutur folje më -O-. Në këtë kuadër bëjnë përfashitim nja dy raste: *vjeshtoj* dhe *kreshtoj*. E para, supozohet nga *vjeshtë* (vjel?) dhe e dyta, nga *kreshtë* (kreh?) Dhe së këtejmi janë përf-

¹⁶⁴ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat ...*, f. 501, 544.

tuar, pra, foljet: *vjeshtoj* dhe *kreshtohem* (sinonim i fjalës kreshpërohem), të cilat ndërtimisht mund të zëbrthehen sipas skemës: tema fjalëformuese: *vjeshtë-*, përkatësisht *kreshtë-* + *prapashtesa -O-*, ndonëse mund të supozohet se fillimisht mund të ketë pasur ndërmikim a implikim folja *shtoj* (me shtue shtuar) në raport me temën prodhuese përkatëse: *vjel-shtoj* (*vjeshtoj*), *kreh-shtoj* (*kreshhtoj*) (!).

Sikurse foljet *vjeshtoj* e *kreshtohem*, ku elementi *-SHT-* fundor pa mëdysheje i takon temës emërore e jo temës së mundshme foljore, d.m.th. nuk është element mbështetës i *-O-së*, ashtu mund të thuhet edhe për trajtat foljore, si *thjeshtoj* (nga i *thjeshtë*), *ngushtoj* (nga i *ngushtë*), *brishtoj* (i *brishtë*), mirëpo për rastet: *plogështoj* (i *plogësht*), *mbrapshtoj* (i *mbrapësht*), *lagështoj* (i *lagësht*), *ligështoj* (i *ligësht*) e të ngjashme, mund të shprehet ndonjë grimcë rezerve, ngase shembujt e tillë mund të zëbrthehen edhe ndryshe, nga fjalë-tema pa fundorin *-SHT*, kur kemi parasysh trajtat, si p.sh.: *plogët*, i *plogët* krahaso me i *plogësht*; i *ligë*, e *liga* me i *ligsht*; *lag*, i *lagur* me i *lag(ë)sht* etj.

Ç'është e drejta, në gjendjen e sotme është e vërtetë se krahas trajtave të mësipërme të mbiemrave, kemi edhe trajta të tjera, të cilat, në raste të caktuara paraqiten më të favorizuara, siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm. Të krahasohen edhe njëherë: trajtat nga folja "lag": i *lagur* (mbiemër), i *lagët* me trajtën i *lagsht*, ndajfoljen: *lagsht*, foljen: *lagshtoj* etj. Në të vërtetë, mbiemri i *lagësht* mund të ndërkëmbetet me trajtën i *lagët*, i *lagshëm* a i *lagur*, ndërsa trajta foljore *lagshtoj*, sa i përket përdorimit, jo vetëm se nuk zbehet, por ajo mbetet e qëndrueshme po në këtë trajtë, duke na kujtuar asociacionisht gjithnjë foljen e shkallës së parë *lag*. Kështu që, mbase, kjo dukuri ka ndikuar që formanti *-SHTO-j* të perceptohet si një prapashtesë e mëvetëshme foljeformuese. Nuk di sa ndjehet një dukuri e tillë aktualisht të shembujt si:

Korishtoj (*kori*), *lëngështoj* (*lëng*), *këmbështoj* (*këmbë*), *kundërshtoj* (*kundër*), *mbarështoj* (*mbarë*), *kapshtoj* (*kap*), *mundshtoj* (*mund*), *imshtoj* (*imët - imsh?*), *ashtu si edhe të rishtoj* (nga *ri - a risht?*), *krahishtoj* (*krah*), *hirshtoj* (*hir*), etj.,

por dihet se trajtat e tilla paraqitin vijëzim të qartë të prapashtesës *-SHTO/J-* e cila qëndron mbi fjalë-temën e qartë fjalëformuese.

Shpjegimet, siç është edhe ai i prof. E. Çabejt, për fjalën "kapshtoj", të cilën e zëbrthen si "përtim forme me anë asociacionesh" ose foljen "mbarështoj" që mund të zëbrthehet, mbase nga përngjitja *mbarë + shtoj* a "shtoj + mbarë" e të ngjashme, madje edhe fjalën kundërshtar (ashtu si dhe foljen kundërshtoj), profesor E. Çabej e quan si zhvillim a "formim i brendshëm i shqipes e jo nga lat. *constratarius* që nuk del e dëshmuar asgjekundi", siç thotë ai.¹⁶⁵ Edhe prof. Selman Riza i dallon këta dy shembuj: (me) *kundërshtuar* kundërshtoj dhe (me) *madhështuar* madhështoj dhe kur i krahason me *barasvlerësit* e *gjuhës latine*: *contrare*, *magnificare*, kontaton se formanti *-sht/uar* është i gjuhës shqipe.

Së këtejmi del se shembujt e tillë ndihmojnë vijëzimin e konceptit për formëzimin e perceptimit që ka të bëjë me mëvetësinë e formantit *-SHTO-* si prapashtesë foljeformuese. Këtu, këtë rast, edhe njëherë po e ritheksoj faktin se s'kemi të bëjmë me analizë prejardhjeje a për një etimologji të zbehur, por kemi të bëjmë me fjalëformimin a perceptimin e foljeve si zhvillim i brendshëm i shqipes që e ka të formëzuar logjikën e vet, mëtim ky që arsyetohet dhe perceptohet në gjendjen e sotme në mënyrë asociacionore. T. Kavaljoti përdori mallështoj, Sh. Gjeçovij foljen me *mundshtue* e shpjegon me *barasvlerësin* me *mundue*, ndërsa Asdreni e përdor trajtën *hirshtoj* etj. Edhe nga këta shembuj asociacionisht del i arsyeshëm perceptimi i formantit *-SHTO-* si prapashtesë foljeformuese.

Pra, pa marrë parasysh interpretimin se forma e tillë do të jetë e përfutur, qoftë si kontaminim, qoftë nga trajta e shumësit të caktuar, qoftë nga përngjizja e formave të caktuara me foljen *shtoj* (me shtue) e ku ta di, trajta *-SHTO/j* tashti funksionalisht del si ndajshesë fjalëformuese. Po e lyp vendi këtë rast të kujtohet fakti, siç thotë prof. E. Çabej, se "edhe etimologjia popullore mund të ketë ndikim në formimin e trajtave a të fjalëve të caktuara më *-shtoj*".¹⁶⁶

Sigurisht del e nevojshme të bëhen trajtime më të hollësishe për çështjet si kjo. Nuk është pa interes të sqarohet rasti sesa është i mundshëm edhe implikimi i prapashtesës ndajfoljore *-(i)sht* në këtë dukuri? Sidoqoftë, mendoj se veprimi i prof. I. Ajetit, i cili e shënon veçan si formant prapashtesor trajtën *-SHTO-j*, është me vend dhe mund të arsyetohet

¹⁶⁵ Dr. E. Çabej, *St. Gjuhësore VII*, f. 267.

¹⁶⁶ Dr. E. Çabej, *St. Gjuhësore I*, f. 334.

het, jo me shumë vështirësi, siç u përpoqa ta bëj më sipër. Edhe prof. E. Çabej për foljen mbarështoj (mbarështroj) me kuptimin "administroj, rregulloj, krahishtoj" konsideron se "vjen prej "mbarë- (mbarësoj), formim analogjik pas kapshtoj".¹⁶⁷ Krahaso: mbarë+shtoj mbarështoj, kap+shtoj kap-shtoj. Siç po shihet, ndërsa që të dy këta gjuhëtarë faktikisht pranojnë ekzistencën e prapashtesës -SHTO-, prof. S. Riza nuk shprehet qartë. Prof. S. Riza të dyja trajtat *mbarështroj* edhe *mbarështoj*¹⁶⁸ i shënon si forma përfaqësuese të fjalë-foljes së përbërë. Mirëpo për që formanti -SHTO- konceptohet si një prapashtesë foljeformuese e jo si gjymtyrë kompozite -SHTO/j (me shtue) po e përmend edhe faktin se A. Xhuvani e shënon trajtën "mbarashtraj"¹⁶⁹ (mbarështroj), po me të njëjtin kuptim që mori trajta "mbarështoj" edhe në punimin e prof. Çabejt. Po kështu del tash e regjistruar edhe në burimet leksikografike të gjuhës së sotme letrare. Trajta **mbarështoj**, pra, me prapashtesën -SHTO- j zëvendësoj trajtën kompozitë **mbarështroj (-shtroj)**. Kështu nga togfjalëshi: "shtroj mbarë" që i përshatet më mirë konceptit që mbulon, për hir të modelit, në bazë të analogjisë a vetë specififikimit të prapashtesës -SHTO-, nëse mund të thuhet kështu, ajo, d.m.th. njësia leksikore si gjymtyrë fjalëformuese e kompozitës kaloi në një tip tjetër të foljeformimit, d.m.th. nga kompozimi doli të formimi i foljes së prejarthur me prapashtesim.

Sidoqoftë, përdorimin e formantit në fjalë në shqipen e sotme e ndeshim gjithnjë e më shpesh. Po përmend vetëm edhe një rast. Në një poezi të botuar në revistën "Brezi" nr. 9/96, Tetovë, del e përdorur folja *njomështoj*: "...Eja ...e **njomështuar** në bardhësi" (Aty f. 19). Edhe te "Bujku" (3. III. '97 f. 9) e ndeshëm të përdorur po këtë fjalë. Ç'është e vërteta, shembuj të tillë mund të ndeshim pothuajse normalisht edhe në burime të tjera, sidomos kur kemi të bëjmë me krijimtarinë poetike.

Gjithsesi edhe mbi këtë formant është e nevojshme të diskutohen gjërat dhe të jepen vlerësimet e duhura. Sidomos del e nevojshme të trajtohen format paralele të karakterit paronimik, të tipit si: lëngështoj lëngëzgjëtoj lëngëzgjëtojtë e të ngjashme si këto, duke vënë theksin në dukuri-

¹⁶⁷ Po aty, f. 334.

¹⁶⁸ Prof. S. Riza, *Vepra 2*.

¹⁶⁹ A. Xhuvani, *Vepra II*, Tiranë 1990 f. 135.

në se secili formant, në funksion paronimik, prirret të specifkohet për nënfushën e caktuar sinonimike kuptimore a stilistike.

Në bazë të nënfushës semantike që mbulojnë foljet më -**shtoj**, mund të thuhet se kuptimësia e foljes *shtoj* (me shtue, shtuar) nuk del pa gjurmë, madje jo të padukshme. Gjithsesi me këtë formë në gjuhën tonë standarde mund të shfrytëzohet mundësia e shtimit të numrit të foljeve me këtë formant. Më duken shumë të përkapshme dhe të mirësearchura trajtat, si p. sh.: *bardhshtoj*, *hirshtoj*, *mirështoj*, *keqshtoj*, *vrapshtoj etj.* të farkëtuara si neologjizma të shtytrur nga vetë modeli që na dhurohet. Dhe vërtet, s'ka kurrfarë pengese a paradoksi që foljet e tilla të mos përdoren a të mos favorizohen në jetën tonë të përditshme gjuhësore, sidomos në stilin letrar e gjetiu, sa herë që del e nevojshme.

Semantikisht foljet më -SHTO- j mbulojnë një nënfushë të caktuar që lidhet me ndajfoljet, por edhe me tema të kategorive të tjera leksikogramatikore për të shprehur sadokudo konceptin e shtimit, i cili nënkuptohet nga vetë fjalë-folja me formantin -SHTO- j, por që edhe më qartë do të dalë kuptimi i saj shtues nga konteksti përkatës i togfjalëshit ose i fjalisë.

4. Foljet më -ÇO-

Si variant i mundshëm i formantit fundor -SHO- që kishte prirje të cilësohej si prapashtesë të -O- së me zgjerim me elementin -SH- del edhe formanti -ÇO-. Këtë formant e ndeshim në disa folje në përdorim të gjerë, por edhe në disa trajta dialektore.

Më poshtë po i përmend disa shembuj që bien në sy më tepër:

dhëmbçoj, *rrufçoj*, *moçoj*, *ndriçoj*, *gulçoj*, *gëlçoj*, *gumëçoj*, *graçoj*, *dyllçoj*, *gërremçoj*, *vraçoj*, *rangçoj*, *gropçoj*.

Te Fjalori i K. Kristoforidhit¹⁷⁰ del edhe gurëçoj, trajtë kjo me të cilën shërbehet edhe prof. E. Çabej, por gjithsesi numri i foljeve me këtë formant është mjaft i vogël në krahasim me formantet e tjera sinonimike që u trajtuan më sipër në këtë punim.

¹⁷⁰ Fjalori i K. Kristoforidhit, f. 122.

Prapashtesa -Ç nga Xhuvani-Çabej përmendet si prapashtesë emërore dhe lidhur me të thuhet "Ç-ja nuk është veçse prapashtesa -SH me fortim të frikativës në afrikatë",¹⁷¹ prandaj edhe ndonjëra nga trajtat që këtu perceptohen me prapashtesën -ÇO- mund të shpjegohen mbi bazë të temës emërore me prapashtesën -Ç (-Ç+Oj). Është e vërtetë se disa trajta foljore më -ÇO- dalin si forma paralele (dysore) me ato më -SHO- si p.sh.: gulçoj e gulshoj, rruçoj e rrufshoj e ndonjë tjetër. Ndeshim, pastaj, ndonjë rast që elementi -Ç të ketë dalë nga togu -TS- a -TSH-, si p.sh. ndriçoj ndritsoj a ndritshoj, moçoj (motshoj)/i motshëm i moçëm/ etj. Por siç mund të shihet nga ndonjëri nga shembujt e mësipërm, kemi raste që prapashtesa -ÇO- si prapashtesë foljore del e identifikuar qartë në funksion të prapashtesës foljeformuese si është shembulli *dylçoj* a *dylçoj* (nga *dyll+ÇOj* me *dyllçue*), siç e përmend prof. E. Çabej,¹⁷² gurëçoj "ndoshta los guricëtë" (K. Kristoforidhi),¹⁷³ pastaj dhëmbçoj, rruçoj etj. Edhe A. Zymberi,¹⁷⁴ nga një terren i skajshëm sjell këta shembuj: gropçoj, gulçoj, rançoj, dyllçoj etj.

Është interesant se në rastet e tilla nuk del shpjegimi sipas asosacionit të përngjithjes së foljes ÇOJ (me çue, çuar) me fjalë-temën përkatëse fjalëformuese, edhe pse një mundësi e tillë asociacionisht mbase fillimisht në raste mund të ketë qenë e përkapshme, si p.sh. jashtëçoj, largçoj me radhitje të përmbytur të togut: çoj jashtë, çoj larg etj., ndonëse askush kështu deri tashmi nuk e ka parë të arsyeshme ta shpjegojë. Sipas prof. E. Çabejt, me foljen "çoj", shprehen këto 10 kuptime (polisemantike): 1. shupte, 2. përrëlq, 3. dërgoj, 4. nis, 5. ngre, 6. zgjoj, 7. kaloj, 8. shkoj, 9. gjej dhe 10. rriem.¹⁷⁵ Gjithsesi edhe kjo mundësi del e nevojshme të vlerësohet, edhe pse, siç u tha te shembujt e sipërcekur, nuk vërtetohet.

S'do mend se del me interes që edhe formimet me formantën -ÇO- të trajtohen në kuadër të strukturës së përgjithshme të formimeve të foljeve -O- me zgjerim. Të kujtojmë vetëm një rast që e merr në shqyrtim prof. E. Çabej: guloj, gulshoj, gultoj dhe *gulçoj* mbi bazë të temës gul-, ku shton se te fjalët gulçoj gulçim gjan të ketë ndikuar çoj nëpërmjet të një etimologjie popullore.¹⁷⁶

¹⁷¹ Xhuvani -Çabej, *Prapashtesat...*, f. 458.

¹⁷² Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore IX*, f. 373.

¹⁷³ Fjalori i K. Kristoforidhi, f. 122.

¹⁷⁴ A. Zymberi, *te vepra e cituar*.

¹⁷⁵ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore IX*, f. 122.

¹⁷⁶ Dr. E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* bl. IV, Tiranë, 1996, f. 302.

Me fjalë të tjera, nëse e lyp nevoja në raste të caktuara, formanti -ÇO- mund të lidhet me foljen "çoj" (me çue) siç është rasti gurëçoj "i çoj gurëzit në lojë guricëtë", siç e thekson K. Kristoforidhi, mirëpo sipas shembujve të tjerë që u cekën më sipër, ka gjasa se me këtë formant më tepër të jenë formuar e formohen folje që shprehin nënfushën e caktuar semantike, ku mbizotëron kuptimi deminutiv (i emrit a mbiemrit me prapashtesën -Ç), si p.sh. zorçoj, dhëmbçoj, rrypçoj etj., ndoshta nga një zorç-, dhëmbç- rrypç-, ndërsa interpretimi gjithsesi lidhet me fjalë-temën prodhuese me kuptim strumbullar (pejorativisht): zorrë-, dhëmb-, rryp- e kështu me radhë.

Nga shembujt dhe analiza e mësipërme del se foljet më -ÇO- assesi s'mund të njëjtësohen me foljet më -SHO- sa i përket nënfushës semantike që mbulojnë, sepse foljet më -ÇO- prirën të shprehin një kuptim deminutiv (pejorativ), ndërsa ato më -SHO- kuptimisht përputhen me kuptimin e mbiemrave më -SHËM, d.m.th. shprehin kuptimësi të karakterit vazhdues (jopejorativ).

Foljet më -ZHO-

Është cekur në kreun II të këtij punimi se prof. E. Çabej foljen **me drangzhue**¹⁷⁷ e thekson të zhvilluar nga *drang* (dajak), të cilën e gjen të përdorur me kuptimin "me rrahë kend për së tepërmi". Përveç foljes *drangzhoy*, e cila nuk është shënuar në FGJSSH, në jetën tonë të përditshme dëgjohet edhe ndonjë tjetër, si: *gumëzhon* (gumëzhit), *gërzhoy* (gërzhit), *bubuzhon* (bubëzhit), *zhurmëzhon* (zhurmëron), shembuj këta që nuk janë të shënuar në FGJSSH,¹⁷⁸ por që nuk do të thotë se nuk mund të ndeshen në burime të tjera.

Trajtat më -ZHO- mund t'i ndeshim pothuajse normalisht në stile përkatëse, nëse paraqitet e nevojshme për të shprehur efekte të caktuara të karakterit të një intensiteti të lartë. L. Poradeci b.f. përdori foljet **zhuzhon** (zhuzhim), **gumëzhon** (gumëzhim). Te Naim Frashëri e ndeshim trajtën *gumëzhim* (nënkupto: gumëzhon). Gjithsesi, ekzistimi i trajtave të

¹⁷⁷ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore IX*, f. 304

¹⁷⁸ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 2268.

tilla më -ZHO- dëshmohe, pra, tërthorazi edhe nga fakti, se në fjalorët normativë ashtu si edhe në jetën e përditshme dalin emrat prejfoljorë me prapashtesën -ZH/IM (-ZH/IMË), të cilët nënkuptohet se kanë dalë zakonisht nga folja me prapashtesën -ZHO-, siç janë shembujt e L. Poradecit e te Naimi. S'do mend, pra, se trajtat, si p.sh. gumëzhim e gumëzhimë, bubëzhim, gërzhim (gurzhim) etj., ashtu si të gjitha emrat më -IM, buri-misht kanë mbështetje, përkatësisht mund të gjejnë shpjegim te folja përkatëse më -ZHO-: gumëzhjo, gërzhjo, bubuzhon etj. Ç'është e vërteta, foljen gërzhit gërzhjo gërzhim e kam dëgjuar edhe si gurzhim, gurzhjo që asociacionisht përputhet sadopak etimologjikisht me rrënjën *gur(ë)*- edhe sipas kuptimit strumbullar që jepet në FGJSSH¹⁷⁹ "Thaj fort sa që mund të shkoqet e të thërmohet (për gjethet e bimëve, për lëvozhgat e bishatajave etj.), d.m.th. lëndët përkatëse spirrohen (copëzohen), forcohen, bëhen si gurë (spirra) që të vrasin duart, që ka ecuri pothuajse të ngjajshme formëzimi me foljen gurëzjo. Ja edhe disa raste të mundshme të përfutimit të foljeve më -ZHO-: dangëzhon, plangëzhjo, gërhanëzhon, gllabëzhon, gu-guzhon, gangëzhon, treqëzhon, kërmëzhon e të ngjashme që mund të shfrytëzohen në situata a kontekste të caktuara si stilema përkatëse të pranueshme.

Rastet e mësipërme ne i cekim vetëm si një mundësi reale që e ka gjuha jonë për të paraqitur ndonjë shprehje me ekspesivitetin e dëshiruar, duke shfrytëzuar elementin -ZH-. Siç dihet, elementi ekspresiv -ZH-, sipas ligjeve fonetike, ka mundësi të shtrihet edhe te shembuj të tjerë, sidomos kur tema fjalëformuese mbaron me një okluzive të zëshme, siç janë: b, d, g, por edhe nga tema me bashkëtingëllore të tjera, zakonisht të zëshme. Për që shtegorja e zëshme -ZH- zgjon asociacione të një natyre, si të themi, të ashpër, serioze, kundrejt të pazëshmes -SH- mjafton të krahasohet kuptimi leksikor i trajtave foljore antonime: **zhuzhurit** dhe **shushurit**, që të dyja këto të ndërtuara mbi bazë onomatopeike: zhu-zhu, përkatësisht -shu-shu + prapashtesa: -r/IT, të cilat pa kurrfarë pengese do të mund të dilnin edhe me prapashtesë -O- -RO-: zhuzhon (me zhuzhje zhuzhuar), zhuzhuron (me zhuzhurje zhuzhuar) ose shushon (me shushje shushuar) shushuron (me shushurje shushuruar) ose me ndonjë for-

¹⁷⁹ Po aty, f. 550.

mant tjetër. Sido që të jetë, me foljen **zhuzhurit** (me sinonimet: zhuzhet, zhuzhit, zhurmëron, uturin, buçin) kuptohet (dëgjohe), siç shpjegohet në FGJSSH,¹⁸⁰ një zhurmë, por jo çfarëdo zhurme, por një zhurmë e rëndë "e mbytur, një gjëimim a krismë e fortë". Një asociacion i tillë i natyrës rënduese del e shprehur edhe në kuptimin figurativ të foljes së caktuar po me formantin -ZHO-.¹⁸¹ Ndërsa, në anën tjetër, edhe me foljen **shushurit** ose **shushuron**, d.m.th. me elementin e shurdhët -SH-, si mjet fonetik (me sinonimet: shushurin, fëshfërin, çuçurit, fërfërin, çuçlon), siç shpjegohet aty, shprehet gjithashtu një zhurmë, por tashti nuk kuptohet një zhurmë e rëndë, por një si "zhurmë e lehtë, e vijueshme" si një valëvitje e flamurit në erë, valëvitje bimësh a lulesh nga era e lehtë, përkatësisht kuptohet "zhurma që lëshojnë valët e vogla nga ujrat që rrjedhin shtruar" etj. Po ky kuptim për "mbresa të lehta, të këndshme" kalon edhe në përdorim të fyturuar.¹⁸²

Prandaj, nisur nga ky fakt mund të arsyetohet përfutimi i foljeve të reja më -ZHO- në shqipe për të shprehur nuanca kuptimore të natyrës së "rëndë". Sigurisht, po të ndiqet kjo dukuri në vëzhgimet e mëtejshme më të thelluara të gjuhëtarëve dhe të stilistëve në këtë drejtim do të sjellin rezultate edhe më të argumentueshme.

Gjithsesi, kur kemi parasysh specializimin e prapashtesave të caktuara për paraqitje specifike kjo prapashtesë realisht qëndron a mund të qëndrojë si mjet potencial i gatshëm mbështetës i foljes më -O-, përkatësisht -ZH+O- = -ZHO-. Mundësia e tillë, pra, del e ofrueshme dhe varet nga shfrytëzuesi se si do ta vërë në veprim.

Foljet drangëzhjo, bubëzhohet a bubuzhon, zhuzhon, gumëzhon, pastaj zhurmëzhon, gurëzhon, gëzhgëzhon a gëzhon (nga gëzh-gëzh) e ndonjë tjetër që mund të farkëtohen në stile të caktuara, edhe në kohën tonë arsyetojnë atë që e ka vërejtur dhe theksuar qysh atëherë profesor Çabej për foljen **drangëzhjo** (me drangëzhje).

Me fjalë të tjera, formimet e tilla pasi ndeshen në ligjërimi të caktuara, s'ka arsye të mos shtrihen edhe në gjuhën e shkrimit, sidomos në stilin letrar (artistik) dhe jo vetëm aty, pasi krijimet e tilla, siç dëshmohe

¹⁸⁰ Po aty, f. 2269.

¹⁸¹ Po aty, f. 1559.

¹⁸² Po aty, f. 1559.

së paku nga shembujt që sjellin a përdoren prof. E. Çabej, N. Frashëri e L. Poradeci, kaherë kanë pasur jetë përdorimi në gjuhën tonë.

Zh-ja, përkatësisht prapashtesa foljeformuese -ZHO-j është apo jo vazhdim i elementit -Z- ose është korresponduese e elementit të pazëshëm -SH- apo vjen nga ndonjë refleks tjetër si asociacion i zhurmës së fortë, mbetet për t'u hulumtuar më mirë, por qenia e këtij tingulli edhe si element ekzistues foljeformues, jo vetëm se s' mund të mohohet, por duhet të pranohet si një element që do të ketë perspektivë të mbarë në gjuhën tonë në të ardhmen dhe për këtë s' duhet pasur as më të voglin dyshim. "Tingujt ndikojnë mbi ne, madje marrin vlera emotive dhe estetikë", thotë Xhevat Lloshi, kur flet për "simbolizmin tingullor".¹⁸³

Duke u mbështetur në faktin që sapo u cek më sipër, nuk duhet të ishte kurfarë befasië për jetën tonë gjuhësore, nëse për nuanca të caktuara stilistike e kuptimore në jetën tonë shkrimore të ndeshen foljet si p.sh. "më dangëzohet (dregëzohet brengëzohet, gungëzohet, bullungëzohet) zemra, shpirti etj., etj.", kuptim ky që mund të motivohet dhe të nënkuptohet lehtë nga vetë tema e qartë prodhuese fjalëformuese plus prapashtesa -ZHO-, por që do të varet kryesisht nga përzgjedhësi dhe nga konteksti që imponohet. Si dihet në raste të tilla nuk luan rol aq të madh përbërja tingullore sa intonacioni ose shqiptimi i tingullit të caktuar.

Pra, në raste të caktuara për nënfushën semantike, që lidhet me shprehje ekspresive të natyrës afektive, formanti -ZHO- mund të shfrytëzohet si mjet i përshtatshëm për të farkëtuar folje mbi bazë të temës fjalëformuese që zakonisht mbaron me ndonjë okluzivë të zëshme, por jo vetëm me ato.

6. Foljet më -HO-

Në gramatikën e Akademisë (1976) në kuadër të foljeve me prapashtesën -O- (pa zgjerim), pasi cekën foljet e formuara me temat emërore, mbiemërore, ndajfoljore e foljore, thuhet se "me këtë prapashtesë janë formuar edhe foljet pohoj (po+hoj) e mohoj (mo+hoj), përkatësisht nga pjesëzat e pohimit dhe të mohimit po, mo(s), me një -H- kundër hiati".¹⁸⁴

¹⁸³ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 54, 57.

¹⁸⁴ *Fonetika dhe gramatika ... II*, f. 299.

Për temën që po trajtohet këtu mjafton konstatimi i mësipërm që të veçantohen foljet me formantin fundor -HO-, sepse funksionalisht formanti -H- "epenetik", në këto raste kryen punën e një elementi mbështetës të prapashtesës foljeformuese -O-. Ç'është e drejta, më duket se vetë tema e punimit që po trajtohet këtu, imponon nevojën që kjo dukuri të trajtohet më në hollësi.

Përveç trajtave **pohoj** e **mohoj** me këtë formant dalin edhe folje të tjera, si p.sh.:

cirihoj, shtihoj, roghon, vrahoj, psehon, nxehoj;
alohon, guhon, uahon, buhon, ohon (nga pashirrrmat).

Pasi elementi -H- nuk trajtohet si prapashtesë emërore në burimet e deritashme (as nga Xhuvani - Çabej,¹⁸⁵ as nga të tjerë) mendoj se vlen të vihet në pah a të sqarohet më mirë raporti emër + folje, si p.sh. moh/mohoj, grihë/grihoj (grij, me gri), rrah/rrahoj (ra-ja treja), ah/ahoj (pashirrmë), pah/pahoj (shoh, me pa), nxech/nxechës nxechëse (Krahaso në Kosovë përfitimet: nxemje qendrore, nxemëse a nxese elektrike nga paskajorja a pjesorja (gege): (me) nxe/(më) (nxej) etj., sepse në analizë duhet pasur parasysh edhe mundësinë që trajtat e tilla me -H të jenë ndikuar edhe nga trajta foljore më -O- me një -H- mbështetëse epenetike, pra nga formanti -HO- foljor. Si shkas për një supozim të tillë mund të na shërbejë vetë shembulli i foljes mo+HOj mohoj: moh/mohu mohim/mohimi ashtu si edhe me pa (me pamë, shoh): pah/pahu pashi, me rrahë/rrahoj rrah/rrahu, gri (me gri, grij): grihë/griha grih grihoj, me nxe nxech nxehoj etj.

Siç po shihet nga këta shembuj s'ka dyshim se trajtat normative: moh, pah, rrah, grih(ë), janë emra të prejardhur me prapashtesën -h, po pse kjo mënyrë emërformimi, ndonëse në numër fare të kufizuar, nuk është cilësuar kështu në asnjërin nga burimet e deritashme, nuk e di?! Si-gurisht edhe kjo dukuri ia vlen të sqarohet dhe të vlerësohet, por për ne, s'ka dyshim se këta emra kësisoji mund të shpjegohen si emra të formuar nga ndërhyrja e tingullit -H në funksion të elementit fjalëformues dhe në këtë kontekst duhet parë ndërndikimi i trajtës foljore -HO-j për daljen e formës së emrave në fjalë. Kjo aq më tepër, del e arsyeshme të trajtohet, kur dihet fakti se trajta foljore domosdo e përfshin në vetë këtë fonemë

¹⁸⁵ Shih përmbajtjen e veprës së cituar *Prapashtesat e gjuhës shqipe* nga Xhuvani - Çabej (1962).

epentetike si element mbështetës, rikujto shembujt: rrah: rrahoj, pah: pahoj (me pa(rë), grih: grihoj?)(me gri(rë)). Me fjalë të tjera shtrohet çështja emri apo folja do të ketë dalë fillimisht apo ndërsjelltas janë ndikuar në këtë dukuri? Lidhur me këtë të kihet parasysh edhe përfutimi i emrave përkates, siç u cek më sipër, te ne nga folja *nxe*, përkatesisht (*me*) *nxe(m)(nxej)* po përdoren pothuajse normalisht, si p.sh. nxemje qendrore, si proces kompleksi, nxemës, nxemëse si emërtime të mjeteve të llojllojshme për ngrohje: me rrymë, me gaz etj.

Edhe prof. E. Çabej elementin -H- e quan sufiks për shembujt, siç është folja *grih*, ndonëse nuk e lidh domosdo me prapashtesën -O-. Ai thotë se folja "grihoj" e të ngjashme si kjo "këto të gjitha mbajnë sufiks inkoativ të tipit ftoh, njoh, shoh" dhe vazhdon se "ky sufiks u shtri analogjikisht edhe te deh, grih, mah",¹⁸⁶ Për qëndrueshmërinë e fundorit -h te foljet inkoative në letrarishten e sotme flet edhe fakti i shënuar në gramatikën e Akademisë, ku thuhet se "nga pikëpamja e sotme ndajfoljet ftohtë, ngrohtë, nxehtë, mund të interpretohen si të formuara nga tema foljore dhe prapashtesa -të."¹⁸⁷

Gjithsesi, mbetet për t'u diskutuar më tej kjo çështje që ka rëndësi të dyfishtë, në njërën anë, do të sqarohet përfutimi i emrave me prapashtesën -H dhe në anën tjetër, do të sqarohet edhe formimi i foljeve temash të ndryshme me këtë element, pra jo vetëm nga pjesëz-temat: MO- e PO-, siç janë cekur në gramatikën e Akademisë (1976)¹⁸⁸, por edhe ndonjë fjalë-temë: emërore, foljore, përmërore a pasthirmore, të cilat shërbejnë si tema të qarta motivuese për foljet më -HO-j.

Sidoqoftë, emrat me -h fundor si dhe foljet më -HO/j mund të ndërnikohen e ndërferkohen ndërsjelltazi edhe në të ardhmen.

Sigurisht zgjon vëmendje të posaçme mënyra e formimit të foljeve në mbështetje të ndonjë fjale a pasthirme që mbaron me zanore, të cilave pothuajse rregullisht mund t'u shtohet një -H- epentetike, element ky që në fjalëformim tash mund të cilësohet si një formant prapashtesor, si p.sh. nga përemri pyetës: Pse? (pse-pse?) del a ka mundësi të dalë folja: psehoj pse-hon (Mos pseho, por puno). Po ashtu, nga pasthirrat si: nga aaaa! del folja a-hon (ahuar), oooo! O-hon (ohuar), nga pthu! pthuhon (pthuhuar,

¹⁸⁶ Dr. E. Çabej, *Si. gjuhësore I*, f. 215.

¹⁸⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe* (morfologjia), Tiranë 1985, f. 376.

¹⁸⁸ *Fonetika dhe gramatika ... II*, f. 299.

nga ua-ua! del ua+hon = uahon (me) uahuar: çuditet (me u çuditë), bën ua- ua!); bu-bu! *buhon*, bo-bo! - *bohon* Mos *buho* pa nevojë!), ba-ba! bahon, alo-alo! alohon etj. Po kështu mund të formohen folje edhe nga pasthirrma të tjera, ku -H-ja mund të cilësohet edhe si pjesë e pasthirrmës, edhe pse ka raste që ajo herë-herë shënohet e herë-herë jo si pjesë e temës, si p.sh.: uh- uh e u- u-!; ih ih e i i!; oi oi e oih! etj. dhe siç është cekur më përpara pasthirrat me -h-në fundore foljen e formojnë zakonish me formantin -KO-.

Siç u pa nga shembujt e sjellë këtu në letrarishten e sotme, sipas burimeve normative, nuk ndeshim shumë raste me këtë formant, mirëpo në ligjërim të gjerë mund të dalë numër më i madh i rasteve të tilla. Me shembujt e lartpërmendur kjo çështje vetëm sapo shtrohet për analizë. Sidoqoftë, siç e thotë, prof. Koleç Topalli "në çdo rast bashkëtingëllorja -h- është një shtesë jo etimologjike, e lindur në kushtet e hiati" (K. Topalli, *vepra e cituar* f. 332).

Sa i përket ndërlidhshmërisë të shkallës semantike foljet më -HO- shprehin intensitet të shkallës së parë, asnjëse, pa ndonjë ngritje të veçantë të intensitetit stilistik krh. pohoj - bëj pohim, rrahu : i bëj rrah, mohim : bëj mohim, grihur : bëj grihje etj., ndërsa, siç dihet, vetë pasthirrat, qoftë vetëm për vetëm, qoftë në kontekst me fjalë të tjera, shprehin afekte të caktuara.

7. Foljet më -JO-

Arsytë që na shtynë për të venduar fundorin -HO- si formant që të mund të vlerësohet si prapashtesë foljeformuese, aq më tepër vlejndë dhe shkojnë në dobi të formantit -JO- për ta vlerësuar edhe atë si prapashtesë të mëvetësishme foljeformuese. Në të vërtetë, edhe bashkëtingëllorja -J-, sikurse ajo -H-, në gjuhësinë tonë është vlerësuar, me të drejtë, si element epentetik, antihiatizues, qoftë në formimin e emrave, qoftë në formimin e foljeve. PO përmendim këtë rast mendimin e prof. K. Topallit, i cili konstaton se "në sand'hin e brendshëm tingulli -J- në sistemin foljor ndërhyjnë në formimet prapashtesore, në rastet e ndeshjes së rrënjave që mbarojnë

me yanore, me prapashtesat -O- dhe -OS-, si te fejoj nga emri fe, flijoj emri fli, nga mbiemri i zi zijos e mavijos nga mavi (K. Topalli, vepra e cit. f. 326).

Në realitetin tonë gjuhësor ndeshim mjaft raste që elementi -J- vendoset para prapashtesës -O-, në radhë të parë për lehtësi shqiptimi, por që një veprim i tillë njëherazi, për hir të funksionit që kryhet, pa dyshim, mund të vlerësohet edhe si prapashtesë fjalëformuese. Dihet fakti se funksioni antihiatizues i elementit -J- shtrihet edhe në sfera të tjera të fjalëformimit, d.m.th. në kuadër të morfologjisë dhe të semantikës. Prof. E. Çabej ka theksuar se folja "fejoj" është formuar nga fjalë-tema "fe-", pra me elementin -J- mbështetës para prapashtesës -O-j, që është formim i brendshëm i shqipes, jo fort i hershëm, sepse te Buzuku e ndeshim këtë trajtë pa elementin mbështetës -J-, pra: "feuum feej feen". Kështu, gjithandej, e ndeshim, siç thotë prof Çabej, "pa këtë konsonant që zhduk hiatin",¹⁸⁹ Është me interes të ceket këtu edhe shpjegimi që jep po prof. E. Çabej për foljen brijoj: "mbush buljerën nga vrima anësore", për të cilën thotë ai se ka "lidhje të brendshme me bri brini", vërtet është afër mendsh, ngase "ajo sqaron më mirë edhe formën brinjë"¹⁹⁰. Pra, edhe te ky shembull, gjithësi, elementi -J- kryen funksionin mbështetës të prapashtesës foljeformuese: J+O = -JO-.

Në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954) dhe në burime të tjera, hasim mjaft trajta foljore me formantin -JO- si p.sh.:

lejoj (lë leje), flijoj (fli), bijoj (bi), ç'mijoj (mi), brijoj (bri), fijon (fi-a), shijon (shi-u), dhijon (dhi-a) kokërrdhijon (kokërrdhi-a), cijon (ci-ci), hijoj (hi-ri), ndryjoj (ndry), riprijoj (pri), tujon (ti-a), syjon (sy-ri), zijon (/i/ zi), skijon (ski-të), jojoj (jo-jo), dyjon (dy), dopijon (dopio), industrijon (industri), depojon (depo) etj.

Pra, siç mund të shihet edhe nga shembujt e mësipërm nga tema e qartë fjalëformuese dallohet formanti foljeformues -JO-, përkatësisht dallohet prapashtesa -O-, e cila për lehtësi shqiptimi merr elementin -J- mbështetës.

Del e nevojshme të sqarohen edhe tri gjëra lidhur me daljen e elementit -J- epentetik në mes të dy zanoreve:

¹⁸⁹ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore I*, f. 178.

¹⁹⁰ Dr. E. Çabej, *St. gjuhësore VIII*, f. 326.

e para, ka të bëjë me dukurinë që disa emra, etimologjikisht në trajtën e pashquar, dalin me -JË (*-lë) fundore siç është tipi: shkëndijë-a (*shkëndilë), prandaj te folja shkëndijoj J-ja mund të konsiderohet si pjesë e temës fjalëformuese, jo si element mbështetës i prapashtesës -O-, por te rastet siç janë foljet e tipit: me fry fryrë: fryj fryjoj, me ndry ndryrë: ndryj ndryjoj gjendja ndryshon.

e dyta, ka të bëjë me faktin se tek emrat si fe- feja fejoj, e ve- e veja vejoj etj. elementi -J-, gjithësi, del si element mbështetës i prapashtesës -O-, por që del i shfaqur edhe në trajtën e shquar të emrit përkatës dhe e treta ka të bëjë me rastet si "shi shiu", ku te përfitim i foljes "shijon" epentetika -J- del vetëm për vetëm si pjesë përbërëse e foljes më -O-j.

Studiuesit e mirënjohur Xhuvani-Çabej me rastin e trajtimit të prapashtesës emërore -JE, konstatojnë (sipas Pedersenit e Joklit) se prapashtesa -JE ka dalë nga prapashtesa -LË, përkatësisht -JË, si p.sh. vdekëlë vdekjë -vdekje, duke e nxjerrë prapashtesën -JË më te vjetër se atë -JE.¹⁹¹

Ne po e përmendim kalimthi këtë fakt duke aluduar se në raste të caktuara elementi -J-, si element mbështetës i prapashtesës foljore -O- mund të ketë origjinë emërore. A. Zymberi, sipas veprës së lartpërmendur, i ka ndeshur edhe këta shembuj: brijon (bri), vrrijon (vri), pejoj (pe-ri), drujon (dru-ri).¹⁹²

Sidoqoftë, janë disa shembuj, siç u cekën edhe më sipër, si b.f. shi shiu, li lia e së këtejmi folja shijon (me shijue shijuar), lijoj (me lijuë lijuar), nga dhi dhia del folja përkatëse: dhijoj (me dhijue dhijuar) a kokërrdhijoj (me kokërrdhijue, kokërrdhijuar), hi (hiri hini) folja hijoj (me hijue hijuar), ski/skitë, folja skijoj (me skijue skijuar) etj. gjithësi elementi -J- s'mund të interpretohet ndryshe, pos si një element mbështetës i prapashtesës -O-.

Sa ishte me vend propozimi që nga emër-tema ski- (skitë) mos të dalë folja skioj po skijoj, e dëshmoi vetë jeta, ngase me formantin -JO-, kjo trajtë vazhdon të përdoret fare natyrshëm sot e gjithë ditën. Po kështu është vepruar edhe me disa raste të tjera që u cekën më sipër.

Në bazë të shembujve që u sollën më sipër, mund të përvijëzohet rregulla gramatikore (fjalëformuese), e cila mbase mund të përkufizohet kështu: *Pas fjalë-temave fjalëformuese të cilat mbarojnë me një zanore të*

¹⁹¹ Xhuvani - Çabej, *Prapashtesat ...*, A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980.

¹⁹² Dr. A. Zymberi, *vepra e cit.*

theksuar, zakonisht -I, -Y-E, folja më -O-j formohet duke marrë rregullisht epentetikën -J- mbështetëse dhe kështu të dyja këto elemente, -J + O-, perceptohen si formant i mëvetësisshëm prapashtesor -JO-.

Kështu, pra, në të vërtetë, (nga njëjksi i pashquar i emrit) praktikohet a duhet të praktikohet edhe me disa shembuj të rinj që ndeshen jo rrallë në realitetin tonë gjuhësor si p.sh. ide: idejoj, sasi: sasijoj, dobi: dobijohet, parti: partijohet, indutstri: industrijohet, (i)zi: zijoj, sy: syjoj etj. Po rikujtoj këtë rast se sipas drejtshkrimit shumica e emrave të tipave të tillë trajtën e shquar e bëjnë pa elementin -J-, si p.sh. sasi sasia, parti partia etj., prandaj shfaqja e -J-së vetëm në formimin e foljes përligjet sipas rregullave të fjalëformimit.

Në këtë kontekst vlen të theksohet konstatimi me vend i Kolec Topallit, i cili i bazuar në mësimet e M. Domit, thotë: *Sjellim si shembull trajtat thuaj, lyej, laj, ku bashkëtingëllorja J ka lindur në kushte të hiatit, të krijuar nga ndeshja e zanores fundore të temës me një trajtë të shkurtër përemërore (thua-j-e), kurse më vonë ky tingull është bërë pjesë organike e foljes*¹⁹³.

Edhe te shembujt tanë, pra, dalja e elementit J fillimisht mund të shpjegohet si element kundër hiatit, po ajo ndërkohë, nga pikëpamja e fjalëformimit tashti perceptohet pamëdyshje si pjesë organike e formantit të foljes -O- me zgjerim.

Nënfusha semantika që mbulohet me foljet më -JO përcaktohet nga konteksti, por mund të themi se me foljet me -JO- nuk shprehet ndonjë ndërlikueshmëri e shkallës së lartë, por përgjithësisht ajo mbetet me ndërlikueshmëri të shkallës së parë asnjanshë. Krahaso: lejoj "jap lejë", flijoj "bëj flijimë", hijoj "bëj hij", idejoj "jap ide", sasijoj "shtoj sasi" etj.

Përmbyllje

1. Formanti -KO- del i identifikuar si prapashtesë foljore në një numër të konsiderueshëm rastesh, si p.sh. fillkoj, birkoj, mushtëkohet, mukon, hejkon etj. Te tema onomatopeike -K-ja del si element epentetik para prapashtesës -O-, nëse mund të thuhet kështu, dhe të dyja bashkë kryejnë funksion të qartë prapashtesor. Me fjalë të tjera, ashtu si te fjalët

¹⁹³ Shih: *Studime filologjike 1-4*, Tiranë 1992, f. 42 edhe te *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë 1995 f. 327.

e prejardhura, qoftë mbi temë emri, qoftë mbi temë mbiemri me prapashtesën -K a -KË, ashtu edhe te përfitimet foljore del i shfaqur konotacioni deminutiv. Te foljet më -KO- të përfutara mbi një temë onomatopeike kuptimi del pothuajse pa ndonjë ngjyresë stilistike të shkallëzuar, ndonëse vetë onomatopea ka efektin e vet. Sidoqoftë, mund të thuhet se foljet e perceptuara me këtë formant pësojnë ndonjëherë njëfarë intensiteti të një shkalle të dukshme, ashtu siç ngjan me emrat a mbiemrat deminutivë me prapashtesën -K a -KË. Zbërthimi i foljeve më -KO- mbi temë emërore a mbiemërore del: fillkoj = bëj fill (fije), birkoj = bëj birë birkë(!), ndërsa mbi temë onomatopeike, folja më -KO- prirret të foljezojë onomatopenë a pas-thirrme e përsëritur, ashtu edhe zberthehet, si p.sh.: hej-hej: hejkoj (= bëj hej-hej); mu-mu: mukon, (= bën mu-mu), bre-bre: brekon, kr-ra-kr-ra: krrakon; puf-puf: pufkon,, uf-uf: ufkon, of-of: ofkon, oh-oh: ohkon, bah-bah: bahkon etj., por siç u tha, pa ndonjë ngrije të shkallës së intensitetit.

2. Formanti -SHO- del qartë te disa folje, si p.sh.: hijeshoj, unshoj, turshoj, mujshoj, rufshoj etj. Si duket edhe semantikisht edhe etimologjikisht forma e tillë lidhet me mbiemrat më -SHËM në shqipe, tipi: i hershëm, i turshëm. Kështu që me foljet e tilla tregohet zakonisht një veprim në proces, pra, jo veprim i karakterit të mbyllët, por i karakterit të hapët. Zbërthimi i foljeve të tilla zakonisht del kështu hijeshoj - e bëj të hijeshëm, hershshoj - e bëj të hershëm etj. Ky tip i foljeformimit ka bazë për shumim për hir të nënfushës së qartë kuptimore që mbulon, prandaj potencialisht mund të jetë i favorizueshëm në të ardhmen për të shprehur nuanca përkatëse stilistike e kuptimore, d.m.th. të nënfushës që tregon një proces a cilësi të karakterit jo të mbyllur.

3. Edhe foljet me formantin -SHTO- të tipit: lëngështoj, mundshtoj, kundërshtoj, hirshtoj, njomështoj etj. dalin të identifikuar në shqipe. Edhe pse karakteri prapashtesor i formantit të tillë mund të quhet i formuar në mënyrë kontaminative: d.m.th. nga formanti mbiemëror -SHT + Oj/ në një-rën anë dhe folja -SHTOJ në anën tjetër, sa i përket semantikës koncepti shtues te këto folje në njëfarë dore del i pranishëm. Kjo dëshmohet edhe nga zbërthimi si p.sh. hirshtoj - shtoj hirin, mundshtoj - shtoj mundin etj. Për hir të nënfushës së qartë semantike të specifikuar që kanë foljet e tilla ekziston mundësi reale për shumimin e shembujve me një formant të tillë si tashti si në të ardhmen.

4. Në shqipe dalin të formuara edhe disa folje me formantin -ÇO- si p.sh. dhëmbçoj, rrufçoj, dyllçoj, gurëçoj, gulçoj etj. Folja ÇOJ (me çue) edhe pse ndoshta do të ketë pasur ndikesë në formimin e ndonjë trajte, si b.f. gurëçoj, ajo të shembujt e tjerë pothuajse nuk ndihet fare. Në raste të caktuara foljet më -ÇOJ mund të ndërëkëmben me format më -SHO-si: gulçoj/gulshoj, por në përgjithësi foljet më -ÇO- mbulojnë semantikë tjetër nga ajo që mbulohet me foljet më -SHO-, siç e pamë më sipër. Te foljet më -ÇO- është i pranishëm ne shumë raste kuptimi deminutiv paksa keqësues i veprimit a i gjendjes, dhe kjo përafrohet me semantikën e mbiemrave a të emrave më -Ç-, të tipit: dhëmbç (dhëmbçoj), zorrç (zorrçoj) e kështu me radhë, ndërsa te foljet më -SHO- kishim të bënim me një veprim në proces të karakterit të hapur, të natyrës jo deminutive.

5. Edhe pse, foljet me formantin -ZHO-, nuk i ndeshim të regjistruara në burimet leksikografike të gjuhës letrare, ato dalin në ligjërimi popullore e në ndonjë shkrim letrar, përgjithësisht në mbështetje të ligjërimit bisedor, siç janë rastet: drangëzhoj, dregëzhoj, guguzhoj, dangëzhoj, gurëzhoj, bubuzhoj, zhuzhoj, gumëzhoj, brengëzhoj etj. Karakteristikë e këtyre trajtave është se të shprehurit i japin një ekspresivitet të lartë, i cili lidhet kuptimisht me fjalë-temën prodhuese përkatëse, e cila zakonisht mbaron me okluzive të zëshme: d, b, g, mirëpo kjo prapashetë mund të dalë edhe mbi fjale-tema të tjera kategorish të ndryshme leksiko-gramatikore ose onomatopeike, varësisht nga ekspresiviteti që kushtëzohet a dëshirohet të shprehet. Gjithsesi me foljet më -ZHO- mund të shprehen ngjyresa më të dalluara për nga intensiteti, jo vetëm ndaj korrespondencës së pazëshme -SHO-, d.m.th. me elementin -SH- mbështetës, por edhe kundrejt foljeve me prapashetës -LLO- dhe -RRO-. Për këtë arsye themi se foljet më -ZHO-, d.m.th. me shtegoren e zëshme -ZH-, si element mbështetës i prapashetës -O-, potencialisht kanë mundësi të favorizohen, si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën tonë të shkruar. Si të tilla, duke e pasur paksa të përvijuar edhe nënfushën e caktuar semantike e stilistike, në të ardhmen, gjithsesi, pritet të "lindin" raste të reja, të cilat do të zënë vend më të merituar edhe në burimet tona leksikografike.

6. Në shqipe dalin edhe disa folje me formantin -HO-, d.m.th. me një -H- mbështetëse epentetike, si p.sh.: pohoj, psehon, pahoj, buhon, puhon, mohoj etj. Ky formant, pos rasteve jo të shumta mbi ndonjë fjalë-temë

prodhuese motivuese, zakonisht u shtohet pasthirmave të shqipes. Semantikisht foljet e tilla shprehin procese të shkallës së parë pa ndonjë ndërlikueshmëri të caktuar a të shkallëzuar kuptimore, edhe pse dihet se vetë pasthirmat kanë në vetvete elemente ekspresiviteti. Foljet më -HO- zakonisht mbulojnë (foljezojnë) dy pasthirra të përsëritura si p.sh. ba-ba! /bahon, bu-bu! /buhon, u-u! /uhon, bra-bra! /brahon etj. Ndërsa kur pasthirra merr h ose f fundore foljezimi zakonisht bëhet me k+o = -KO-/ofkon, buhkon etj.

7. Edhe foljet më -JO-, d.m.th. me një -J- mbështetëse epentetike, siç janë p.sh.: syjon, fijon, mbrijon, hijon, shijon, zijon, fejoj, sasijon, partijon etj. shprehin zakonisht një veprim të shkallës së parë, d.m.th. nuk tregojnë ndonjë intensitet të shtuar të shkallëzuar. Fjalë-temat e caktuara prodhuese mbarojnë zakonisht me një -I-, -Y- a -E- të theksuar.

(3) GRUPE KONSONANTESH SI REFLEKSE TË DISKUTUESHME TË PRAPASHTESËS -O- ME ZGJERIM

Përveç formanteve të diskutueshme që u cekën në këtë punim si elemente mbështetëse të prapashtesës -O- mund të dalë edhe ndonjë grup konsonantesh zakonisht prej dy elementesh (konsonantesh) të tjera që nuk janë cekur më sipër veçan si formante me fizionomi të qartë prapashtesore të foljes më -O-. Ja disa shembuj-raste:

- rl-, siç del shembulli: qypërloj;
- rt-, siç është shembulli hapërtoj;
- trr-, siç është rasti: bytron;
- rg-, siç është rasti: labërgoj (lapërkoj);
- rm- siç janë rastet: çukërmoj, shkundërmoj (...) etj.

Këta shembuj dhe të tjerë që mund të ndeshen në ligjërimi të caktuara të gjuhës sonë, në punimin tonë janë cilësuar se bëjnë pjesë në grupin e foljeve sipas elementit të fundit. P.sh. çukërmoj, shkundërmoj si folje më -MO-, kështu edhe u cekën kur trajtuam foljet më -MO-, në punimin tonë, ashtu si edhe qypërloj më -LO-, bytron si folje më -RRO- etj., ngase elementet -R- në të gjitha këto raste më tepër duket se kryen funksion epentetik.

Megjithatë shembuj që u shënuan më sipër mbeten si raste të veçuara, për këtë arsye edhe elementet e caktuara nuk mund të cilësohen si formante prapashtesore sinonimike, siç kishin mundësi të perceptoheshin formantet që u trajtuam në punimin tonë, (formantet e *mirëfillta* foljeformuese, (si)variantet e tyre, qoftë edhe ato të tjera të diskutueshme), ngase këto nuk i plotësojnë kriteret as sa i përket sasisë, as sa i përket modelit, as sa i përket mbulimit të nënfushës së caktuar semantike. Prandaj, formantet dykonsonanteshe foljore u quajtën: grup i diskutueshëm refleksesh të prapashtesës -O- me zgjerim.

Gjithsesi për të pasur një ide më të plotë rreth struktursë së foleve më -O- pa - e me zgjerim, duhet pasur parasysh edhe refleksat e grupkonsonanteve si më sipër ndër të tjera.

KONSTATIME PËRMBYLLËSE RRETH RAPORTIT NDËRSINONIMIK TË FOLJEVE MË -O- (ME - E PA ZGJERIM)

Për ta pasur edhe më të qartë ndërlkueshmërinë që ka të bëjë lidhur me raportin ndërsinonimik brenda vetë foljeve më -O- (pa - e me zgjerim), që u prekën në analizë në këtë krye të punimit, do të përipiqemi t'i përmbledhim konstatimet lidhur me ndërfërkimet ndërmjet tyre dhe të zgjidhjeve që ofrohen nga spektri semantik, pa e lënë anash edhe atë stilistik e pragmatik. Sigurisht këtu do t'i kemi parasysh a do t'i shfrytëzojmë konstatimet a përkufizimet që u theksuan përmbledhtas në fund të krerëve e nënkrerëve përkatës, sidomos në përmbylljet e pjesëve të nënkreut të dytë të këtij kreu.

Gjithnjë duke i pasur parasysh specifikat që kanë ndërmjet tyre strukturat e caktuara formëzuese e fjalëformuese: morfologjike, sintaksore, semantike e stilistike, si dhe konceptet që lidhen, jo vetëm rreth normës së sotme standarde, por edhe më gjerë me qëllim përsosjeje e përplotësimi të saj, i prire edhe nga parimi i lejuar pragmatik, në vazhdim në disa pika, po japim disa nga konstatimet me interes, të cilat si çështje ia vlen, jo vetëm të dihen e të njihen, por edhe të ritrësohen, të ritrajtohen edhe më me përkushtim të shfrytëzohen, në mënyrë që problemet tash të hapura, të jenë sa më të përkapshme dhe të ejejnë zgjidhje teorike e praktike sa më të natyrshme, të pranueshme dhe të harmonishme në kuadër të strukturës foljeformuese të gjuhës sonë:

Së pari, edhe pse prapashtesa -NO- i referohet prapashtesës -RO-, kur kemi parasysh ndërkëmbimin e dukurive rotacizëm /jorotacizëm, megjithatë, përfundi i mjaft foljeve më -RO- dhe -NO-, nga pikëpamja semantike nuk mund të përjashtojnë apo ta zëvendësojnë plotësisht njëra tjetrën. Jo vetëm për faktin se rotacizmi është fenomen që ka pushuar së vepruari disa shekuj përpara, por për arsye se formimet foljore më -RO-, të përfutuara, qoftë me analogji, qoftë për hir të traditës ose për arsye se elementi -R- mund të përdoret edhe si element epentetik më tepër se ai -N- etj., vazhdojnë të jenë prodhimtare edhe sot e gjithë ditën, gati-gati po aq ose edhe më tepër se formimet me prapashtesën -NO-, ndonëse në shu-

micën e viseve shqipfolëse kjo mënyrë fjalëformimi nuk ka qenë e prekur aq nga rotacizimi, por, sa u përket nënfushave semantike që mbulojnë ato, gjithnjë e më tepër prirën të diferencohen. Kështu që, siç na thotë mendja, për koncepte të reja, me kuptim neutral, formanti -NO- tani nuk duhet rotacizuar. Madje në disa raste ato të diferencuara kuptimisht mund të qëndrojnë pranë njëra-tjetrës dhe për këtë ekziston arsye e plotë:

a) qoftë duke u përpëlqyer vetëm njëra e mënjauar tjetra, në stilin neutral, si p.sh. (ç)kishëroj, bredhëroj, fisnikëroj, lavdëroj, në njërën anë, përkatësisht lidhnoj, vargnoj, qoftë edhe me koncept të ri, siç janë rastet: plotnoj, çiknoj, shtalbnj etj., në anën tjetër, kur shembujt e tillë mund të motivohen ndërsjelltazi edhe nga emrat më -NI, si plotni, çikni, fajni e të ngjashme;

b) qoftë duke bashkëjetuar në shembuj të rinj që të dyja trajtat, por secila sipas nuancimit kuptimor përkatës që mbulon, siç janë rastet: burrnoj ndaj burrëroj, pleqnoj ndaj pleqëroj, emëroj ndaj emnoj, zotëroj ndaj zotnoj, lumëroj ndaj lumnoj etj.;

c) qoftë duke i dhënë përparësi njëres ose tjetrës trajtë, si: barnoj ndaj barëroj, farnoj ndaj farëroj e të ngjashme ose bredhëroj ndaj bredhnoj(!), flakëroj ndaj flaknoj(!) etj.

Sidoqoftë, assesi, asnjëherë, nuk bën të veprohet në dëm të formave me prapashtesën -RO-, siç është vepruar në mjaft raste në gjuhën e sotime letrare në dhjetëvjetëshat e fundit në dëm të formimeve më -NO- (ku janë "toskëzuar", për çudi edhe frazeologjizmat e qëndrueshëm). Në raste të tilla, duhet me qenë fort të kujdesshëm. S' duhet lënduar asnjëra formë-trajtë. Paqetëri duhen favorizuar trajtat me -RO- tashmë të ngulitura, si: lumturoj, gjallëroj, blegëroj, shurdhëroj, madhëroj, (sh)kishëroj, priftëroj gjelbëroj etj., d.m.th. për të gjitha konceptet që deri tashti del e normëzuar forma e tillë, madje po kjo rregull vlen edhe për ato trajta që mund të lindin aktualisht në arealin toskërishtfolës ose nga adhuruesit e formës së tillë, mirëpo për raste të tjera të reja, më mirë me thënë, për koncepte të reja, krahas foljeve më -RO- mund të jenë të pranueshme edhe të lejueshme në konkurrencë lojale edhe trajtat më -O- si dhe ato më -NO-, p.sh.: shtalboj krahas shtalbnj (pa e mohuar trajtën e mundshme shtalpëroj, e cila mbase mund mbetet si rezervë e ofrueshme), gjalloj krahas gjallnoj, pa e mohuar atë gjallëroj, lumoj e lumnoj përkrah lumturoj etj, të cilat varësisht nga

situatat mund të bashkëtojnë. Në të vërtetë, fjala **lumni lumnoj** s'ka arsye të mos përfillet dhe të shtrihet si e tillë në mbarë truallin shqipfolës si term kishtar (i sferës katolike) që mbulon konceptin e "**lumnimit**", d.m.th. të fazës së parashenjërimit të ndonjë shembëlltyre të caktuar.

Në këtë kontekst po e cek faktin se në veprën poetike të Gj. Fishtes, përkrah formave më -NO- që janë mbizotëruese, ndeshim foljet më -RO-: ligjëroj, flakroj, hunguron, pungroj, zhauron, shporon (= shpon me heshta) etj. pa u bërë përpjekje që formanti -RO- të "gegëzohet" në -NO-, ashtu mund të veprohet, në raste të caktuara, edhe në arealin e ashtuquajtur toskërishtfolës lidhur me foljet më -NO- të trajtave që sapo u përmendën më sipër, por edhe të tjera që do të përftohen në të ardhmen.

Me fjalët të tjera, pritet që formimet me të dyja formantet -RO- dhe -NO- të kenë ardhmëni në bashkëjetesë të natyrshme të hamonizueshme. Sot për sot, siç u cek në analizë, foljet me formantin -RO- më tepër prirën të mbulojnë nënfushën semantike të botës shpirtërore të njeriut, ndërsa ato më -NO- zakonisht në sferën e kuptimësisë neutrale, d.m.th. pa ndjesi të theksuar subjektivizëm.

Së dyti, foljet më -MO-, ato më -SHO- e madje edhe ato më -ÇO-, -KO- e -CO- që si duket shpjegohen me vend se kanë mbështetje të mbulimit të nënfushave të caktuara semantike deminutive, në mjaft raste mbi bazë mbiemërore, si p.sh. thekmoj - i thekëm, hershoj - i hershëm, gropqoj - gropqë, birkoj - birkë, vjedhcoj - vjedhcë e kështu me radhë, sa i përket kuptimësisë a nënfushës semantike që ato mbulojnë, zënë vend jo të pa rëndësishtëm në kuadër të strukturës së përgjithshme të foljeve më -O- me zgjerim. Mirëpo, duhet pasur parasysh faktin se kuptimësia e foljes ndryshon a specifikohet sipas formantit përkatës, kështu foljet më -MO- prirën të tregojnë një proces pak a shumë të mbyllët, foljet më -SHO- një proces të hapët, të vazhdueshëm, ndërsa foljet më -ÇO-, ato më -KO- e -CO- një kuptimësi të natyrës deminutive, madje në raste edhe të karakterit keqësues. Sidoqoftë, te shumica e foljeve me formantet e mësipërme shihet e mbuluar një kuptimësi deminutive.

Së treti, formantin -LLO-, ndonëse ka marrëdhënie fqinjësore a burimore asociacionore me prapashtesën -LO-, sa i përket nënfushës semantike që mbulon ndryshon nga ajo. Kështu që, foljet me prapashtesën -LLO- më tepër prirën nga stili rëndues që lidhet me fenomene të natyrës, të cilat

nuk i rezervohen dëshirës së njeriut, ndërsa përfitimet më -LO- i referohen më tepër stilit të një natyre më të butë, brenda dëshirës së njeriut, siç është stili përkëdhelës ledhatues që përshtatet me gjuhën e fëmijëve. Po kështu, njëfarë kundërvënije duket edhe në raportin e prapashtesave -OS ndaj -OJ, përkatësisht -IJ e -EJ ndaj -OJ (pa - e me zgjerim), siç do të preket rrëshqitazi në kreun vijues. Te ndonjë rast, siç del shembulli: bubu-llon ndaj atij më -LO- bubë-lo-n, shihet një kundërvënie semantike, duke e pasqyruar kështu edhe ndryshimin e tipit të kuptimësisë.

Së katërti, foljet më -HO-, -JO-, dhe -IFIK/O-, -IZ/O-, -ATIZ/O e -IRO (të huazuara), nuk dallohen nga intensiteti që shprehin foljet më -O- pa zgjerim. Me fjalë të tjera, lidhur me të shprehurit e procesit a të gjendjes së caktuar, foljet me këto formante, pos ndonjë rasti të veçuar, mbesin, si të thuash, në shkallën e parë të të shprehurit të intensitetit, veçori kjo që nuk mund të thuhet për foljet e përfuara me prapashtesën -SO-. Kur është fjala te formimet fillimisht me -O- me zgjerim pa e shfrytëzuar mundësinë e -O- së pa zgjerim, atëherë intensiteti a vargu i shkallëzimit të kuptimësisë del paksa i çrregulluar. Po i jap nja dy shembuj përfaqësues karakteristikë:

E para, ndërlihet me fjalë-temën këngë. Si duket nga tema këngë-ende nuk ka dalë e regjistruar folja më -O- (pa zgjerim): këng+OJ këngoj, por mbi këtë temë ka dalë fillimisht folja më -TO-: këngë+toj këngëtoj. Po kjo gjithashtu mund të thuhet edhe për fjalë-temat e tjera si: treg tregtoj, fall falltoj, arkë arkëtoj, shteg shtegtoj, copë copëtoj, arsye arsyetoj etj. Ndërkaq nuk do të thotë se edhe trajta përkatës më -Oj nuk mund të dalë në kontekste të caktuara, por tash sigurisht me kuptim tjetër, d.m.th. me aso ngjyrimi që, sigurisht, nuk do të jetë identik me kuptimin e mbuluar fillimisht me foljen më -TO- e të tjera.

E dyta, ndërlihet me fjalën gjak. Ngjashëm me shembullin e mësipërm po e cek faktin se nga fjalë-tema gjak- fillimisht kanë dalë trajtat gjak+ËSOJ, gjak+ËTOJ e gjakOS e pastaj ajo gjakoj, ngase trajta gjakoj del vetëm me kuptim të fyturuar (poetik).

Sidoqoftë, rastet e tilla nuk bien ndesh aq me përkufizimin dhe as që i rrezojnë konstatimet e dhëna lidhur me raportin: prapashtesë e specifikuar / kuptimi i shkallëzuar, sipas nënfushave të caktuara semantike, siç u konstatuan në këtë punim.

Së pesti, foljet më -SO-, siç është bërë e ditur, shprehin ngritje të cilësisë së shkallës së intensitetit kuptimor që dallon nga ato që shprehin me formantet e sipërcekura. Në një farë mënyre po këtë funksion e kryejnë edhe disa folje me formantin -CO, por që për nga kuptimi pothuajse s'kanë afri semantike me foljet më -SO-, p.sh. malcoj (ëmbëlcoj), del e kundërta e të së ëmbëlës (ëmbëlsoj), laracoj (e bëj me lara, e laros) dallon nga laroj (larësoj!), d.m.th. zbukuroj me lara etj., por që të dyja, edhe SO-edhe -CO- tregojnë një cilësi të shkallës së lartë (të tjetërndryshme) të të shprehurit pa iu ndryshuar temës prodhuese substanca lëndëzore semantike, kuptim ky që nënkuptohet nga vetë tema e qartë motivuese.

Së gjashti, foljet më -ZO- tregojnë procese të ndërlikuara në rritje sikurse foljet më -SO-, por dallimi në mes të këtyre dy formanteve është i madh. Te foljet më -SO- shihet një shkallë e ngritjes së intensitetit nga pikëpamja e cilësisë (edhe në fushë të abstraksionit), siç u tha, ndërsa te foljet më -ZO- kemi të bëjmë me ngritje a përrthellim të shkallës kryesisht vetëm në procesin teknologjik të punës (jo të ndjenjave a të kuptimësisë). Me fjalë të tjera, te foljet më -SO- nuk ndryshon substanca materialëzuese e temës prodhuese, ndërsa sa u përket foljeve më -ZO- s'kemi të bëjmë, pothuajse aspak, me ngritje intensiteti ndjenjor të ngjyritim stilistik e kuptimor, por kemi të bëjmë me dukurinë e shndërrimit a të ndryshimit teknologjik të substancës së cekur, d.m.th. të lëndës përmbajtëseore të fjalë-temës fjalëformuese. Në njëfarë dore, folja e tillë më -ZO- tregon tjetërsimin (shndërrimin) që ka ndodhur a mund të ndodhë me përpunim e sipër në substancën e fjalë-temës së caktuar dhe kjo pasqyrohet me veprimin që shprehët e foljen përkatëse. Kështu, siç u tha, ndërsa tek ajo më -SO-, pos intensitetit të shtuar cilësorisht (abstrakt), ndryshim substance nuk ka, te folja më -ZO po. Kjo rregull është me rëndësi të njihet dhe të zbatohet në të ardhmen në mënyrë sa më të kujdesshme dhe të prerë. Me një fjalë, nuk duhet ngatërruar, pa nevojë, funksioni diferencues i këtyre dy formanteve për mendimin tonë duhen korrigjuar të gjitha rastet, siç është sinonimike. Për mendimin tonë duhen korrigjuar të gjitha rastet, siç është b.f. rasti në FGJSSH, ku "lëngëzimi i një lënde" është quajtur "ujësim" (ujësoj ujësohet), në vend: ujëzim (ujëzoj ujëzohet). Po kështu duhet të veprimet edhe me rastin kripësoj ndaj kripëzoj. Kripësim (kripësoj) do të quhet procesi, kur diçka për nga cilësia njelmësohet, d.m.th. i shtohet me njelmësimi (kripa), pa u prekur substanca e brendshme e saj, ndërsa me kripëzim (kripëzoj) do të kuptohet ndryshimi i vetë substancës së për-

mbajtjes së fjalë-temës përkatëse, d.m.th. kur një lëndë shndërrohet në kripë. Me një fjalë, këto dy formante mund të jenë sinonime në disa raste, por jo edhe identike, prandaj nuk është mirë të ndërkëmbehen as në gjuhën e shkrimit as në gjuhën e folur.

Së shtati, foljet më -ZHO- ashtu si edhe ato më -RRO- edhe pse nuk ndërkëmbehen njëra me tjetrën, por në krahasim me simotrat e tjera, shprehin shkallë më të lartë të ekspresivitetit. Foljet më -ZHO-, përkatësisht -RRO-, në njëfarë mënyre, ndeshen në disa raste në konkurrencë kundërvënëse me foljet më -II, përkatësisht me foljet më -O- e -OS e ndonjë tjetër, siç do të shohim në kreun tjetër, por jo në të njëjtin drejtim shkallëzimi. Në praktikën e deritashme nuk ndeshet ndonjë ballafaqim të formantit -ZHO- me formante të tjera, por lidhur me foljet më -RRO-. Mund të thuhet se ato më tepër ndeshen në kundërvënie me foljet me prapashtesën -LO-, edhe pse fonetikiqisht edhe kjo ka më tepër afërsi me prapashtesën -RO-. Në të vërtetë, prapashtesa -RO- në raste të caktuara mban pozicionin ndërmjetës të peshores ndaj foljeve më -LO- që i karakterizon stili i butë, në njërin anë dhe të foljeve më -RRO-, që i karakterizon stili me intensitet shues, si me thënë, të një natyre paksa më të fortuar, në anën tjetër të peshores.

Së teti, kur një onomatope (tingullimitim) del në funksion të një teme foljeformuese, siç vërtetohet me shembuj konkretë, varësisht nga konteksti a nënfisha semantike, për të foljezuar atë, mund të dalin të angazhuara disa prapashtesa, si: -LLO- tipi bu-bu - bubullon, trak-trak - trakëllon, trok-trok - trokëllon, pësh-pësh - pëshpëllon etj., -KO- (sidomos pas temave me j, f, h fundore: hej-hej hejktoj, of-of afkon, bah-bah bahkon, krra-krra - krrakon, mu-mu - mukon etj., ndërsa raste me formantet: -HO-, -RRO- (-RO-) e -LO-, -MO- e -SHO- e të tjera nga lënda që trajtuam del se janë paksa më të rralla.

Së nënti, kur për temë fjalëformuese shërben një *pashirmë* a fjalë pyetëse e të ngjashme të ngjyrimit tingullimitues, atëherë, si element mbështetës i prapashtesës -O-, del epentetika -H-, duke u formëzuar kështu trajta -HO- si një prapashtesë foljeformuese, si: bu-bu - buhon, pse pse - psehon, po po - pohoj etj. Ndërsa pas fjalë-temave me zanore të theksuar -i, -y, -e, -o folja më -O- merr zakonisht epentetikën parambështetëse -J- dhe kështu ky tingull del në funksion të prapashtesës foljeformuese me kuptimësi neutrale -JO-, si p.sh. brijon, syjoj, shijon, idejoj, jojon etj.

Siç del nga përkufizimet e konstatimeve të mësipërme në analizën gramatikore e kemi trajtuar bashkë me atë semantike, por duke mos e lënë anash as spektrin stilistik e pragmatik. Siç dihet stilistika dhe pragmatika nuk karakterizohen me "norma të rrepta ose me rregulla të prera", si në rregulla gramatikore të cilat, siç e shpjegon Xh. Lloshi, "parathënë" se cilat "trajta ose cilat ndërtime të fjalëve janë të drejta" e cilat jo, sepse ne e konsiderojmë se kjo çështje në pika të caktuara del jashtë normës së deritashme gramatikore e semantike, ngase në atë pikëpamje, siç është thënë, ende nuk është trajtuar sa duhet ky material, prandaj edhe trajtat e drejta e jo të drejta do të ripërcaktohen ndërkohë e me kohë, sipas rrafsheve të caktuara duke përplotësuar edhe rregullat gramatikore.

Këto tipare, sipas mendimit tonë, ishin veçoritë kryesore të foljeve më -O- pa- e me zgjerim, deri tashti jo mjaft të vërejtura nga studiuesit tanë, të cilat gjithsesi duhen shqyrtuar e vlerësuar dhe tash, këndeje e tutje. Për të qenë analiza sa më complete, siç u paracek, prandaj në kreun vijues, do të bëhet përqasja semantike e foljeve më -O- (pa- e me zgjerim), por edhe ndaj foljeve me prapashtesa të tjera, si dhe atyre me prapashtesa kryesore dhe mënyra të tjera të foljeformimit në gjuhën shqipe.

Kreu IV

PËRTHELLIM RRETH RAPORTIT NDËRSINONIMIK TË FORMANTEVE TË FOLJEVE MË -O-, NË PËRQASJE ME FORMANTE TË TJERA BRENDA STRUKTURËS FOLJEFORMUESE NË KUADËR TË SISTEMIT FOLJOR TË SHQIPES

Për të pasur një ide edhe më të qartë rreth raportit ndërsinonimik të formanteve të foljeve më -O- (pa - e me zgjerim), me formante të tjera, në këtë krye të punimit do të bëjmë një përjasje më të përituar brenda strukturës foljeformuese, duke vënë në pah:

së pari, raportin ndërsinonimik brendapërbrenda nënstrukturës së foljeve më -O- në përjasje me prapashtesat e tjera temëformuese e fjalëformuese të shqipes;

së dyti, raportin ndërsinonimik të prapashtesave foljeformuese me -O- (pa - e me zgjerim) në përjasje me parashtesat e disa siparashesa foljeformuese si dhe me mënyrat e tjera fjalëformuese në kuadër të strukturës foljeformuese të shqipes;

së treti, disa shembuj përftime foljesh paralele me formantet -O-, pa - e me zgjerim, mbi fjalë-tema të njëjta dhe

së katërti, analizën përmbyllëse nga trajtimi i kësaj teme, nxitje e sfide kjo për detyra të reja për lexuesit e studiuesit.

(I). Raporti ndërsinonimik brendapërbrenda nënstrukturës së foljeve më -O- dhe në përqasje me prapashtesa të tjera temëformuese e fjalëformuese

Lidhur me sa u përvijua në krerët e mëparshëm, në vazhdim do të japim ndonjë konstatim a interpretim përbledhës me interes që ndërlidhet me specifikimin e nënfushave të caktuara semantike a stilistike në raport ndërsinonimik (edhe të karakterit paronimik), brenda formanteve të foljeve me -O- pa -e me zgjerim dhe në përqasje më ndajshesa të tjera foljeformuese, në të vërtetë, këtu në dy pjesë do të përmendet:

së pari, përqasja e foljeve me temë në **-O- pa zgjerim**, në raport me formante të tjera temëformuese, përkatësisht foljeformuese, ndërsa së dyti, përqasja e formanteve **-O- me zgjerim** në raport, me raste të formanteve të tjera foljeformuese.

A) 1. Foljet më -O- me formante temëformuese në përqasje me formante të tjera temëformuese

Është cekur në fillim të këtij punimi-sprovë se te foljet më -O- pa zgjerim, qoftë me burim vendës, qoftë të huazuara, d.m.th. me burim të huaj, tipi: **pushoj, evokoj** - të cilat nuk karakterizohen nga tema e qartë fjalëformuese, kuptimi leksikor i tyre del përgjithësisht nga vetë kategoria leksiko-gramatikore që ka folja si pjesë e ligjëratës dhe veçoritë e caktuara të saj vijëzohen veçantisht nga konteksti¹. Foljet e tilla rëndom shprehin procese me ndërlikueshmëri, si të themi, të shkallës së parë, d.m.th. me intensitet asnjansë zakonisht pa zhvillim polisemik. Në këtë grup foljesh u klasifikua edhe një pjesë e foljeve të huazuara më -IZ/O- e -ATIZ/O, si edhe ato me -IFIK/O- e -IR/O të tipave: **mekanizoj e formatizoj; sakrifikoj; variroj(?)** edhe pse në disa raste, tema prodhuese e tyre del pjesërisht e qartë, përkatësisht e analizueshme edhe në shqipe, si p.sh.: **elektrizoj, sistematizoj, elektrifikoj, graviroj(!)**. Sidoqoftë, formanti

¹ Vijëzimi i mundshëm është bërë në bazë të analizës që doli nga tre krerët e mëparshëm të këtij punimi.

-O- në këtë nëngrup foljesh, siç janë shembujt e tipit: *shkoj, koj, shtoj, mësoj* etj., mund të quhet, me të drejtë, si prapashtesë a mbaresë temëformuese. Foljet e tilla, sipas rregullit, janë monosemantike (njëkuptimshë) dhe nuk ndodh të hasin në konkurrencë me prapashtesat e tjera temëformuese, qoftë ato me temë në zanore, qoftë ato me temë në togzanor, siç janë foljet e zgjedhimit të parë, p.sh: foljet: më -EJ, tipi: rrej, mbrej, ndjej, blej; IJ: vij, grij, arrij; -UI: buj; -ËJ: bëj; YJ: fryj; AJ: laj, mbaj; -UAJ: shkruaj, shuaj, ruaj; -IEJ: ziej; -YEJ: lyej.

Po ky konstatim vlen edhe për foljet me temë jomotivuese në bashkëtingëllore, të zgjedhimit të dytë, pa cilësinë e dalluar të prapashtesës foljeformuese tipi: marr, mat, ngas, plas, qit, pulit, molis, qendis, sos, kros/em, të foljeve vokalike, të zgjedhimit të tretë, me mbaresë zero, tipi: vë, nxë, ngre, të foljeve supletive shoh, vij, jap etj. e gjysmësupletive si lë, vdes, vete etj.

Mirëpo edhe këto, nëse ndodh të shprehin sinonimi, mund të krahasohen sa i përket nuancimit kuptimor a intensitetit stilistik, brenda vetë kontekstit që shprehet.

2. Foljet me -O- pa zgjerim me temë të qartë prodhuese në përqasje me folje me formante të tjera prapashtesore

Lidhur me foljet më -O-, pa zgjerim, me temë të qartë fjalëformuese, karakteri ndërsinonimik del paksa më i ndërlikuar në krahasim me foljet më -O- me temë jo të qartë fjalëformuese. Njëherazi, për arsye të motivimit të qartë që e jep tema, formimet e tilla dalin më të kapshme. Këtu së pari po dallojmë foljet me temë të qartë fjalëformuese, të preardhura pa ndajshesa (me prapashtesën zero ose me konversion) siç janë shembujt: hap, pjell, rrjedh, plas, ndjej, tjer etj. dhe së dyti të preardhura me prapashtesën -O- pa zgjerim. Lidhur me grupin e parë prof. Selman Riza konstaton si vijon: "*Prapashtesëzimi pa ndërhyrje të ndonjë tingulli e tingullshi, midis prapashtesës -ur sKupto: prapashtesën Ë ose zero a pa ndajshesë- sqarimi im) dhe temës fjalëndertuese, si p.sh.: (me) dark/un, drek/un,*

me forma a fomante të tjera, p.sh. në vend bojatis – bojis, në vend telatis telkoj, në vend këmbatis, këmboj a këmbis, në vend terratis terroj a errë-soj e kështu me radhë.

Këtu nuk po hymjë në hollësi për të identifikuar rastet kur folja me -IS del e huazuar fillimisht bashkë me temën prodhuese (emrin përkatës), d.m.th. kur del e huazuar krejt trajta foljore me -IS fundor.

Është e vërtetë se paronimisht në gjuhën e përditshme mjaft folje më -IS dalin në konkurrencë me foljet më -O- pa zgjerim, si, p.sh. përrallis/përralloj, sapunis/sapunoj, tellallis/tellalloj - duke konkurruar kështu, si me thënë, secila trajtë për nënfushën e caktuar semantike, sipas stilit a kontekstit përkatës.⁵

c) Foljet me prapashtesën -IT

Foljet më -IT fundor në shqipëri ndeshim në numër të konsiderueshëm. Në FGJSSH dalin të regjistruara afro 170 raste, por, vetëm te një numër i tyre, formanti -IT del si prapashtesë fjalëformuese, siç janë shembujt: *kosit, llogarit, korit, mahit, shkopit, ujit, radhit* etj. Në krahasim me foljet më -O- e të tjera, ky formant nuk del i parashoqëruar me elemente mbështetëse ndërhyrës. Në disa raste, jo të shumta, prapashtesa -IT del në konkurrencë me prapashtesën -O- (pa - e me zgjerim) e me të tjera, por ajo, në të vërtetë, bashkëjeton me to pa e rrezikuar ekzistencën e njëra tjetrës. T'i krahasojmë vetëm këto raste: *ngul: ngulit: ngulmoj; ujit ujoj ujësoj, trokëllit trokëllon trokëllin, trokëllis etj.*

Siç dihet, një numër i caktuar i foljeve të shqipes, si trajtë përfaqësuese (kryesisht vetëm në vetën e parë njëjës), del edhe në trajtën e lejueshme por jo të detyrueshme me -IS, si p.sh. përsërit (përsëris), shtëllit (shtëllis), shkopit (shkopis), zhurit (zhuris) etj., duke ndihmuar asociacionisht, në njëfarë mënyre, qëndrueshmërinë e foljeve më -IS, që u cekën më sipër. Ç'është e drejta, nuk mund ta dimë se çfarë zhvillimi do të ketë një dukuri e tillë në të ardhmen, por na merr mendja se gjuhësisht s'di sa humbet apo fitohet, nëse ndërjegjësisht do të favorizohen trajtat më -IS, vetëm për veten e parë njëjës, sepse edhe ashtu formanti -IT del tek vetat

⁵ Shembujt i ndeshim të regjistruar në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.

e tjera (!), përkatësisht tek aoristi, urdhërorja, format jokalamatore (pësore) etj. si dhe te infinitivi (a pjesorja) si trajtë-formë përfaqësuese morfemantike në analizë.

Edhe te foljet e këtij tipi ndeshim rastet kur formanti -IT i shtohet temës me -I fundore: përsëri (përsërit), çudi (çudit), habi (habit), llogari (llogarit) etj. me ç' rast zhduket I-ja fundore e temës si p.sh. përsëri: përsëri+IT përsëri(it) *përsërit* e kështu me radhë.

Sidoqoftë, prapashtesa -IT bashkëjeton me prapashtesën -O- (pa - e me zgjerim) dhe me të tjera, por pa e pasur të përcaktuar ndonjë nënfushë të veçantë semantike, pos asaj nënfushë asnjënjëse, si të themi, tradicionale, të ngulitur me kohë në sistemin tonë foljor ligërimor.

ç) Foljet me prapashtesën -OS

Lidhur me foljet më -OS fillimisht po japim dy konstatime të studuesve tanë të dëgjuar, A. Xhuvanit dhe S. Rizës, të shkruara në faza kohore jo aq të largëta nga njëra - tjetra. Prof. A. Xhuvani, tërhiqte vërejtjen se pos foljeve më -O- "*shqipja ka edhe disa denominativa më -OS, si fundos nga fund, plagos nga plagë etj.(...)* Këto folje që në gegërishtet thuhet më fort më -Oj (faros faroj, tymos tymoj etj.) tregojnë një influencë të kohës së ardhëshme të foljevet greqishte dhe janë të pakta në gjuhën tonë. Mund të mbeten këto që janë formue që me kohë..., por të tjera s'asht nevoja të krijohen, tek kemi ato me -Oj, që janë të natyrës së shqipes".⁶ Ndërsa, prof. S. Riza, kohësisht jo shumë më vonë, po ashtu konstatonte dhe tërhiqte vërejtjen se "*siç shihet nga përkufizimi gjenetik*" (...) "*mbaresë-prapashtesa -UR prirë nga togtingujshi -OS, merr kuptim të ngjashëm me ato me fundje-prapashtesën -UAR*" si p.sh. barkosur /barkuar (barkoj), ballsamosur /ballsamar (ballsamoj, burgosur /burguar (burgoj) etj. dhe, ballsamosur /ballsamar (ballsamoj, burgosur /burguar (burgoj) etj. dhe, si duket, pa ironi jepte konstatimin tjetër se "*formimet nga tingujshi -OS (me prejardhje nga greqishtja deri vonë ekskluziv i toskërishtes) janë aq të shumta, madje aq në rritje sa që zgjedhimin konsonantik përndryshe të praktikisht joprodhor e kanë shndërruar në njëfarë shemri të vokalikut*".⁷

⁶ Aleksandër Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980, f. 188.

⁷ Prof. S. Riza, *Vepra 2*, f. 220, 288.

Ç'është e drejta, supozimi i prof. S. Rizës rreth prodhueshmërisë del i shprehur edhe në burimet e letrarishtes së sotme, ngase foljet me prapashtesën -OS, si p.sh.: *hekuros, ngjyros, muros, brengos, varros, jetos/sem* etj., edhe në burimet tona normative cilësohen si formime *më prodhimtare* nga sishoqet e tjera, d.m.th. ndaj foljeve në temë me bashkëtingëllore, që i takojnë zgjedhimit të dytë.

Edhe pse në FGJSSH numri i tyre i regjistruar del më i vogël nga ai i foljeve më -IT (ndonëse edhe këto e kalojnë shifrën 100), po të shikohet nga ana tjetër, formimet e reja me prapashtesën -OS, me temë të qartë prodhuese, dalin në numër mjaft të madh, madje dalin më vepruese se foljet më -IT. Ku qëndron arsyeja, përgjigjja si duket lidhet me nënfushën e përcaktuar semantike që mbulojnë a prirën të mbulojnë në kuadër të strukturës foljeformuese të foljeve me prapashtesim. Pra, për ne zgjojnë interes foljet më -OS, pikërisht për nuancat kuptimore që mbulojnë brenda kontekstit. Siç vërtetojnë shembujt e vjelë nga FGJSSH, trajtat më -OS në shqipen e sotme letrare prirën të shprehin zakonisht një shkallëzim stilistik, ku mbizotëron kuptimësi pak a shumë e natyrës rënduese e vendende edhe keqësuese, por, gjithësesi, të diferencuar në raport me prapashtesa të tjera, sidomos ndaj foljeve me prapashtesën -O. Kjo veçori vërehet, sidomos në raport me formimet paronimike paralele, si p.sh. **plagos** (i shkaktoj plagë, e brengos, e pikëlloj) ndaj **plagoj** (i bëj plagë); **sheqeros** (fig. e zbukuroj me tepri) ndaj **sheqeroj** (e bëj të ëmbël), **gëlqeros** (lyej, regj lëkurën) ndaj **gëlqeroj** (hedh gëlqere), **ngjyros** (i jap ngjyrë, një sipunë mekanike) ndaj **ngjyroj** (i jap hijesë, zbukurim (artistik) etj. Ç'është e vërteta, në afro 100 raste të foljeve më -OS, sa janë, pra, të regjistruara në FSHS (1984),⁸ për nga 30 sosh tashmë ekzistojnë paralelizma me formantën -OJ, mirëpo këto trajtat e fundit sa i përket kuptimit të shkallës së parë, mund të thuhet se dalin me konkurrencë të fituar për nënfushën a pjesën e caktuar kuptimore, por sa u përket shkallëzimeve të tjera kuptimore jo, d.m.th. për kuptime të tjera polisemantike, madje as që konkurohen për ngjyresa me ngarkesa, si të themi, rënduese. Krahaso vetëm shembullin **plagos** ndaj **plagoj**. Sido që të jetë, është e vërtetë se si formanti -OS, ashtu edhe ai -OJ janë në përdorim e sipër pa rrezikuar ekzistencën e njëri-tjetrit. Pothuajse në të gjitha rastet më -OS ka mundësi të

⁸ Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984.

dalin foljet paralele më -OJ e ndonjë tjetër për të "zbutur", si të themi "zymtinë" a rëndesën që shprehet fillimisht me prapashtesën -OS, por mund të ndodhë edhe fenomeni i kundërt. Të kujtojmë vetëm rastin e foljeve mbi emër-temën: **jetë**:- paralel me **jetoj** (jetësoj, përjetësoj, përjetoj) d.m.th. gjalloj, rroj, shkoj jetën etj. doli edhe **jetos/em** d.m.th. me kuptim keqësues: plakem shumë, më le këmba e dora nga pleqëria.⁹

Është e vërtetë se nga 29 shembujt përfaqësues të foljeve më -OS (-OSUR) që shënon prof. Selman Riza (vepra e cit. f. 290), pothuajse që të gjithë në shqipen e sotme shprehin, si të themi, njëfarë "zymtësie" a rëndese dhe shumica prej tyre i kanë tashmë në përdorim të përditshëm përgjegjëset me -O-, të cilat, si me thënë, e neutralizojnë atëfarë gjendjeje jo të këndshme. Me fjalë të tjera, është fat i gjuhës sonë, kur foljet më -OS, dikur më tepër karakteristikë e të folmeve të Jugut, dhe ato më -O- me shtrirje të gjerë, por më popullore dhe më aktive në të folme të Veriut, ndërkohë pa ndërferkime të mëdha u afruan dhe sot po bashkëjetojnë për mrekulli, duke i ndarë paksa nënfushat semantike që mbulojnë, siç u cek më sipër. Ky harmonizim le të shërbejë si shëmbëll edhe për raste të tjera që ende dallohen nga karakteri dialektor, siç është rasti i foljeve me -NO/-RO e ndonjë tjetër. Edhe të rastet e ngjashme e më të nxehta, siç është raporti paskajore/lidhore, jo vetëm spontanisht, por edhe ndërtegjësisht e me urtësi, duhet të gjenden e të ofrohen zgjidhje të përshtatshme, sikurse ka ndodhur e po ndodh, pra, siç u tha, me foljet më -OS dhe -OJ. Çdo vlerë dialektore sidomos ato që kanë shtrirje të gjerë gjeografike duhet të përthithen nga letrarishtja. Për mendimin tonë është krahas krejt normale që krahas foljes **burgos** të dalë **burgoj** ashtu si krahas **prangos**, siç e lexova këto ditë në gazetën *Rilindja* (8.1.'02), të dalë **prangoj**. *Kështu b.f. mund të qëndrojë lajmi sensacional: N.N. që e kishin burgosur dhe prangosur fill pas arrestit, i cili si i tillë, i burguar dhe i pranguar vuajti mbi 6 muaj, sot u shpall i pafajshëm nga gjykata!*

Sidoqoftë, foljet më -OS, edhe pse nuk ndërëmben me foljet më -LLO- ato sa i përket nënfushës kuptimore që mbulojnë shkallëzimi rëndues paralelizmi, d.m.th. që të dyja asociacionjnë njëfarë shkallëzimi rëndues semantik. Këtyre foljeve, në njëfarë dore, u kundërvihen lidhur me "zbutjes

⁹ Po aty, f. 467.

e rëndësës", siç u tha, foljet me -O-, përkatësisht -LO-, -RO-, -I/J e ndo-një tjetër.

Si karakteristikë e përgjithshme e këtyre katër prapashtesave të mirëfillta është se në raste dalin të ndërkëmbyera njëra me tjetrën mbi temë të njëjtë prodhuese, por, megjithatë, prapashtesa -IS del e ndërlidhur me shumë me prapashtesën -IT, ndërsa ajo -OS me formantin -Oj-, por nuk mungojnë as ndërfërkime edhe me formante të tjera.

Favorizimin e foljeve me -O- në shqipen e sotme ndaj formimeve me prapashtesa të tjera e ka vërejtur edhe prof. Jani Thomai, kur konstaton se po ndodh "ngushtimi i formave foljore me prapashtesat -OS dhe -IT për shkak të thithjes (që po u bëhet) nga foljet me prapashtesën -O- (ajros, ajrit - ajroj, firmos - firmoj) sidomos gjatë formimeve të reja".¹⁰ Proces ky që vihet re më përpara edhe nga A. Xhuvani e S. Riza, por që vazhdon edhe tani.

b. Ndërfërkime me prapashtesa të tjera të identifikuar

Lidhur me konstatimin e sapocekur rreth ndërfërkimeve po i shënojmë disa variante foljesh paralele mbi temë të njëjtë prodhuese, pa ua mohuar karakterin paronimik rasteve me -it, -is, -os e -oj, krahas tyre dalin edhe të tjera. Të vihet re formanti i shembullit të parë më poshtë edhe të rasteve të tjera të nënvizuara, si:

- *radhit* radhoj, rrezit rrezoj, gogësit *gogësi* gogësoj, djersit *djersij*, murmurit *murmuroj*, *murmuri*, shoshit *shoshoj*, çokit *çokas* çokoj *çokat*, trokëllit *trokëlloj* *trokëllij*;
- *rrokullis* *rrokullej*, përrallis përralloj përrallo, pajis pajoj, batis batoj;
- *fjalos* fjaloj, lijos lijoj, sheqeros sheqeroj, vendos vendoj;
- *sapunoj* sapunis, flakëroj flakërit *flakërij*, zbardhëlloj *zbardhëllej*, humboj *humbas*, kunjoj *kunjas*, zukon *zukat* *zukas*, fërkoj *fërkat* etj.

¹⁰ Jani Thomaj, te *Seminari... 19/2000*, Prishtinë 2000, f. 256.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm paralelë, krahas prapashtesave të shënuara në burimet tona gramatikore: -O- (pa- e me zgjerim), -IS, -IT, dhe -OS, të shembujt paralelë u shfaqën a sapa u identifikuan këtu edhe foljet me prapashtesat:

- I/J(-IN) (djersij, murmurij, trokëllij, gogësi, flakërij);
- E/J (rrokullej, zbardhëllej);
- AS (çokas, humbas, kunjjas, zukas) dhe
- AT (çokat, zukat, fërkat), të cilat duhen vlerësuar.

Në të vërtetë, të gjithë shembujt e mësipërm, ndërtimisht dalin të zbërthyeshëm, ngase nuk u mungon tema e qartë prodhuese, kjo ndodh edhe me formantet, siç u tha, këtu të sapoidentifikuara, prandaj del e nevojshme që një dukuri e tillë të qartësohet paksa, duke i trajtuar më radhë foljet me prapashtesat: -I/J, -E/J, -AS dhe -AT.

a) Foljet me prapashtesën -I/J

Foljet më -I/J (-IN), si p.sh.: *gogësi*, *trokëllij*, *djersij*, *mërij*, *shpij*, *rij*, *përtërij*, *blegërij*, *këllij*, *përshkëllij*, *cicërin* *mbëllij*, *kërpj*, *lëpij*, *gjëllij*, *gogësi*, *bubullin*, *oshëtin*, *kërcëllin*, *zgërdhij* etj., numri i të cilave i regjistruar në FGJSSH arrin në afro 60 sosh, tashmë në saje të formantit prapashtesor, kanë arritur të mëvetësohen si grup më vete. Formanti i tillë më tepër del në funksion temëformues, por në një numër të konsiderueshëm, siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, del edhe në funksion fjalëformues prapashtesor, d.m.th. foljet dalin mbi temë të qartë prodhuese.

Po e cek edhe një veçori të foljeve më -I/J. Hiq njëra tre shembujt që e bëjnë pjesoren si foljet më -IT: *arrij* (me arritë *arritur*), *bredhërij* (me *bredhëritë* *bredhëritur*) dhe *ulërij* (me *ulëritë* *ulëritur*), të gjitha të tjerat e bëjnë pjesoren më -rë, si b.f. tipi: *pështëllij* (me/ *pështëlli/rë*), *flakërij* (me/ *flakëri/rë*), *lëpij* (me/ *lëpi/rë*), *shëllij* (me/ *shëllirë*) (me) ri, gri, shkri, pertëri, me u thi, me u përbti, me u zgërdhi etj., fakt ky që tregon për autonominë e këtyre formantit foljeformues si nëntip më vete.

Nga analiza doli se foljet më -IJ, si ato me temë jo të qartë, e sidomos ato me temë të qartë prodhuese, kanë arritur paksa ta ravijëzojnë nënfunksionin e tyre semantike-stilistike. Ato, disi më tepër se të tjerat, dallohen

në sferën e subtilitetit poetik, duke u bërë konkurrencë të lehtë foljeve më -RO- e të tjerave. Këtë përshlyetje mund ta fitojë paksa lexuesi edhe nga këta shembuj konkretë, natyrisht po të shikohen në kontekst:

ndrin (ndrij) ndaj ndrit përndrit e ndrigoj, *pipërin* ndaj pipëron, *fërfëllin (fërfëllij)* ndaj fërfëllon, *mjaullin* ndaj mjaullon, *cicërrin* ndaj cicërron (cicëron) e cicëlon, *djersij* ndaj djersit, *rij (përtërij)* ndaj rijoj (riroj) ngërcëllij ndaj ngërcëllej etj.

Kur të bëhet fjalë rreth mënyrës së fjalëndërtimit ia vlen të sqarohet fakti se ndërsa te shembulli *djers/ij*, e shembuj të tjerë, shihet qartë prapashtesa -Ij (-IN) si prapashtesë foljeformuese: *djers(ë)+IJ* *djersij*, te shembujt e tjerë, siç janë b.f. *rastet ndrij, rij* etj. pason zhdukja e zanores fundore -I e temës prodhuese: *ndri(t) +IJ* *ndr(i)IJ = ndrj; ri+IJ* *r(i)+ij = rij* etj.

Sidoqoftë, prapashtesa -IJ del me fizonimi të qartë foljeformuese edhe në formimin e emrave më -(I)MË që dalin mbi këtë bazë. P.sh.: *grij* *grimë, fërfërij* *fërfërimë, hingëllij* *hingëllimë, bubullij* *bubullimë, blegërij* *blegërimë, pipëtij* *pipëtimë* etj. Siç po shihet edhe në formimet e tilla emërore shërben pjesorja (paskajorja) e gegërishtes, d.m.th. pa mbaresën -rë, p.sh. *grij* (me gri (trë), *gri+IMË* *grimë, grifërfërij* *fërfëri(trë) fërfëri+IMË fërfërimë*, prandaj edhe këtë fakt hartuesit e gramatikës sonë normative duhet ta kenë në konsideratë, për ta cilësuar dhe trajtuar formantin -IJ si prapashtesë të veçantë foljeformuese.¹¹

Del e nevojshme të ceket fakti se foljet pa vetore me -in fundor tipi *bubullin* (moti), kur përdoren me kuptim të fytuar, atëherë normalisht në gojë e njeriut, kur flet për botën e tij, dalin me vetat përkatëse, p.sh. unë *bubullija* (si dhe vetë natyra!); ti veton e *bubullon* (por sa para bën!) etj.

Në fund po theksojmë në mënyrë të vacantë se, duke pasur parasysh nënfushën stilistike që lidhet me subtilitetin poetik, mund supozojmë me të drejtë, se bashkë me specifikimin, pritjet edhe shumimi i konsiderueshëm i foljeve me prapashtesën -Ij (-IN).

¹¹ Gramatika e gjuhës shqipe (morfologjia), Tiranë 1985 f. 143.

b) Foljet me prapashtesën -E/J

Foljet me prapashtesën -E/j (formant ky që e njej edhe D. Sheperi) si p.sh.: *kryej* (me *krye(r)*), *krye+E/j*), *shkërbej* (*shkrep*), *shembëllej*, *rrokullej*, *zbardhëllej*, *fërfëllej*, *përbej*, *vërej*, *mëlmej* etj., zgjojnë interes të posaçëm, jo aq për numrin relativisht të madh që zënë në krahasim me grupet e tjera me prapashtesat e lartpërmendura (numri i tyre arrin në afro 50 sosh të regjistruara në fjalorët normativë,¹² por dhe për arsye se shumica mbeten pa temë të qartë fjalëformuese, e gjithësi për faktin se foljet më -E/J dalin më pak të këmbëra me prapashtesa të tjera. Grupin më të madh të foljeve më -E/J e lidh i njëjti zgjedhim, në të njëjtën nënklasë (tip), me foljet më -Oj, madje nga foljet e tilla (-Oj dhe -Ej) në të shumtën e rasteve (sipas modelit të normëzuar) janë reflektuar e reflektohen automatikisht emrat e veprimit më -IM si dhe emrat e vepruesit më -s, si dhe mbiemrat e ndajfoljet me -SHËM, që dalin në mbështetje të temës së pjesores së ish-gegërishtes letrare, tipi: mësoj (me mësure, mësuar): mësim, mësuës, (i) mësueshëm; shkëlqej (me shkëlqye, shkëlqyer): shkëlqim, shkëlqyes, (i) shkëlqyeshëm.

Në disa raste formanti -EJ del i mbështetur në elementin -LL-, si kurse te disa folje më -LLO, p.sh. rrokëllej, rrekëllej, fërfëllej, shembëllej, vakëllej, ngazëllej, po këto, si duket, kanë dalë në funksion kundërvënës e që tani mund të hyjnë në punë "për të zbutur" a neutralizuar në nuanca në njëfarë mënyre "zymtinë" që në raste kontekstore shprehin foljet më -LLO, siç u konstatua më sipër, në punimin tonë.

Edhe te foljet më -E/j, si te rastet: *përbej*, *përdhej*, *vërej*, *ndërkreje* ndonjë tjetër, bie në sy rasti i zhdukjes së -E-së fundore të temës prodhuese me rastin e formëzimit të foljes, p.sh. *përbe+EJ* *përbe+ej > përb(e)ej* *përbej*; *përdhe+EJ* *përdh(e)+ej > përdhej*; *vëre+EJ* *vër(e)+ej > vërej*, *krye+EJ* *krye(e)j* *kryej* etj.

Nënfusha semantike e foljeve më -EJ që dikur ishin më prodhimtare, nuk del e specifikuar, por mbulohen përafërsisht ato nënfusha që mbuloohen edhe me foljet më -Ij dhe -O-j (pa - e disa me zgjerim), por pa ngritur intensitetin përkatës.

¹² Fjalorë normativë; Fjalori i gjuhës së some shqipe, Tiranë 198), Fjalori i shqipes së some, Tiranë 1984, Fjalori i foljeve të Zgjedhimi i foljeve të Z. Munishit, Prishtinë 1998.

c) Foljet me prapashtesën -AS

Në gjuhën tonë ndeshim disa folje më -AS, si p.sh.:

çokas (çok-çok), pikas (pik-), gajas (ga-ga), kunjas (kunj), humbas (humb), gërgas (gër-gër), kukas (ku-ku), çuçuras (çu-çu), bërtas (brit), gërhas (grah), përkas (prek) pëlças (plas), gërshas (grish), boças (boçë), pastaj të ngjashmet: mërdhas (mërdhij, mërdhit), ta-rakas, ngolas, llundras, lloçkovas, guhas, kokas, qokas, cakas etj.,

që të regjistruara në FGJSSH numri i tyre kalon njëzetëshin, në përqsje me prapashtesa të tjera, edhe ky formant dallohet qartë në funksion të prapashtesës foljeformuese.

Së këtejmi, mund të thuhet se ky formant, në mjaft raste, si shumica e shembujve të mësipërm, del me fizionomi të qartë foljeformuese, por tash për tash nuk mund të thuhet se foljet me këtë formant e kanë të përcaktuar qartësisht nënfishën përkatëse të veçantë semantike a stilistike.

Foljet më -AS (me përjashtim të një grupi jo të madh që në paskajore (pjesore) e në të kryerën e thjeshtë e ndryshojnë fundorin në -IT: bërtas /bërtita, (me) britë a bërtitur, rrëshqas rrëshqita, (me) rrëshqitë a rrëshqitur) zakonisht e bëjnë aoristin, infinitivin, përkatësisht pjesoren me prapashtesën Ê/-UR, duke e ruajtur formantin -AS, p.sh. kunjias: kunjasa, (me) kunjasë kunjatur, plas plasa, (me) plasë a plasur etj.

ç) Foljet me prapashtesën -AT

Edhe me prapashtesën temëformuese -AT, sipas lendës së vjetër në FGJSSH dalin, mjaft shembuj, mbi 30 sish, prej tyre janë disa raste që formanti në fjalë del në funksion të qartë fjalëformues, si p.sh.:

çokat, vilat, zukat, cijat, vizat, kukat, deg/at/em, rrag/at/em, therccat (thercc), rrakat (rrak-rrak), ngulat (ngul), shukat, nducat, kërhat, curulat, skopat (skop) etj.

Edhe të foljet me këtë formant nuk vërehet ndonjë nënfishë e caktuar e veçantë semantike, prandaj nuk pritet rritje e konsiderueshme e numrit të trajtave me këtë prapashtesë. Vlen të ceket edhe prirja e ngjashme me raportin e foljeve më -IT ndaj -IS edhe ndërmjet trajtave -AT me -AS, si p.sh. vikat (vikas), vizat (vizas), kërkat (kërhas) etj., ndërferkim ky që ia vlen të ndiqet me vëmendje.

Prof. S. Riza, pasi shpjegon se "ndërhyrja e infiksit -AT në format e të së tashmes me lloje të ndryshme ndikimi fonetik mbi temën e saj trokat - trokas nga AT-io", shton se "zanorja A e zgjatimit tematik (më drejt e infiksit -AT ka qenë theksuar, prandaj përveç formës vras edhe forma ngaS ka rrjedhë nga nga+AT-io (-S))".¹³

Pa hyrë në etimologji të caktuara mund të konstatohet se të gjitha foljeve më -AT në aorist dhe në infinitiv nuk u ndryshon ky formant fundor, si p.sh. vizat: vizata, me vizatë/vizatur, e kështu me radhë.

Sidoqoftë, të rastet e sipërhënuara dhe të disa të tjera shihet qartë formanti -AT si dhe ai -AS në funksion të prapashtesës fjalëformuese, e cila në raport me foljet më -Oj e të tjera, edhe pse nuk del e favorizuar sa i përket përcaktimit të nënfishës përkatëse semantike, shihet se ekziston, prandaj funksioni foljeformues i këtij formanti nuk bën të mohohet.

Ç'është e vërteta edhe nga studiues të tjerë formantet: -IJ, -EJ, -AS, dhe -AT dalin të identifikuar si prapashtesa foljeformuese, siç është edhe konstatimi i prof. Selman Rizës, i cili cek dy formantet e para -IJ dhe -EJ kur thekson se "në gjuhën shqipe foljet vokalice të prejardhura, qoftë me parapashtesëzim, qoftë me shtesëzim të dyanshëm, jashtë grupit masiv të foljeve me në dftorën e tashme karakteristiken -O- si: rij, mësyj, lëvrij, nxij, kryej janë numerikisht të paçpërfillshme dhe kryesisht vetëm leviorë",¹⁴ madje ai përmend, siç e pamë edhe më sipër edhe formantet -AS e -AT, mirëpo as nga ai as nga të tjerë, kjo temë, d.m.th. ku do të trajtohet lënda përkatëse me qëllim identifikimi të tyre si prapashtesa foljeformuese, nuk është shoshuar me gjerësinë e duhur.

¹³ Prof. S. Riza, *Vepra 2...*, f. 223-226.

¹⁴ Prof. S. Riza, *vepra e cit.*, f. 282.

prapashtesat: -I/j e -E/j, si p.sh. bubullin (-I/I) bubullon, fërshëllin (-I/j) fërshëllen (-E/j) fërshëllon (-Oj) etj., ashtu si edhe elementi -L- të raste: cicëroj cicëroj cicëloj (cicërin) cicëlin ose cakëloj (cakënoj) cakëroj cakëlloj cakoj cakëllin, cakëllat cakëlin e cakos) dhe të gjitha këto i shtojnë ngjyrimin semantik e stilistik shprehjes së caktuar, prandaj nuk duhet "thjeshtësuar" arbitrarisht.

E pesta, po e përmend edhe një fakt mjaft me interes. Është fjala se nga të gjitha foljet si ato me temë në bashkëtingëllore ashtu edhe të tjera dalin emra prejfoljorë, por mbi temën e të gjitha foljeve më -O- zhvillimi a prodhueshmëria serike e tyre është më e madhe. Kështu b.f. nga folja: **dërgoj** (me/dërgue, dërguar) automatikisht dalin prejfoljorët: dërgim, dërgues, dërguese (vegël), (i) dërgueshëm, i dërguar, pastaj dërgesë, dërgatë ose nga **shtrëngo**j (me shtrëngue/ shtrënguar): shtrëngim, shtrëngojë, shtrëngues, shtrënguese (vegël), (i) shtrëngueshëm, pastaj shtrëngesë, shtrëngatë etj. Është e vërtetë se edhe nga tipat e foljeve të tjera dalin prejfoljorë më -JE, -IMË e ndonjë tjetër, por gjithsesi me mundësi më të kufizuar shumimi.

E gjashta, është konstatuar se huazimet foljore më shpejt pranohen, adaptohen (asimilohen) në gjuhën tonë duke marrë prapashtesën karakteristike -O- në shqipë, për arsye se nënklasa a tipi i foljeve më -O- ka zgjedhim më të rregullt dhe më të plotë se të gjitha nënklasat, tipat a grupet e tjera të sistemit foljor të shqipes.

Sidoqoftë konstatimet e mësipërm a që bien ndesh me rregullën se kryesisht mbi qdo fjalë-temë të shqipes mund të formohet një folje më -O-, qoftë pa zgjerim, qoftë me zgjerim, mirëpo në raste të tilla duhen respektuar edhe kriteret të tjera. Pos nevojës duhen pasur parasysh edhe formimet me prapashtesat e tjera të lartcekura, ngase secila, siç dihet, e ka vendin e vet në kuadër të mozaikut të strukturës së përgjithshme foljeformuese të shqipes, por njëherazi mos të harrohet se foljet më -O- e përbëjnë boshtin kurrizor të sistemit foljor të gjuhës shqipe.

(II). Raporti ndërsinonimik i foljeve më -O- pa -e me zgjerim në përjasje me formantet prapashtesore e mënyra të tjera të foljeformimit në shqipë

Këtu së pari do të paraqiten prapashtesat kryesore foljeformuese të shqipes¹⁵, pastaj siparapshesat, përkatësisht foljet me para-prapashtesim njëherazi, njëfjalëzimi i lokucioneve foljore dhe kompozitat dhe të gjitha këto do të hetohen në përjasje, duke i rikujtuar kuptimësitë e caktuara që shprehen me foljet më -O- pa -e me zgjerim dhe të tjera.

1. Ndërlidhja semantike e foljeve më -O- me foljet me prapashtesim në shqipë

Për të pasur një ide më të qartë rreth raportit të tipit të foljeve më -O- ndaj foljeve të të gjithë tipave të tjerë të formuara me prapashtesim a mënyra të tjera nga prapashtesa e njëjtë pjesë e temës fjalëformuese, të cilat edhe nuk dalin domosdo si folje me -O- me para + prapashtesë njëherazi, po japim shembuj të foljeve me disa prapashtesa, përkatësisht numrin e tyre sipas rubrikave përkatëse, ashtu si i ndeshim të regjistruara: 1) në FGJSH 1954¹⁶, 2) në Fjalorin e foljeve (në tabelë: FF) të letraritës së sotme, të hartuar nga studiuesi Zijadin Munishi¹⁷ dhe 3) në FGJSSH 1980:

Tabela e numrit të foljeve me prapashtesat përkatëse aktive

Nr. r.	Parashtesa	FGJSH			FF			FGJSSH		
		-O-	Tj	Gj	-O-	Tj	Gj	-O-	Tj	Gj
1.	ç-	16	37	53	25	15	40	40	30	70
	sh-	12	21	33	26	28	54	44	28	72
	zh-	7	11	18	18	28	46	22	24	46
	xh-	-	3	3	-	-	-	-	-	-
2.	për-	49	148	197	65	149	214	72	164	236
3.	të-	1	5	6	1	3	4	1	4	5

¹⁵ Rreth prapashtesave shih: *Parashtesat e gjuhës shqipe*, nga Xhuvani - Çabej, A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980, pastaj *Fonetika dhe gramatika ...II*, 1976.

¹⁶ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954

¹⁷ *Zijadin Munishi: Zgjedhimi i foljeve*, Prishtinë, 1998.

fjalë-temën e njëjtë fjalëformuese nuk shprehen nuanca të karakterit paronomik. "Në këtë tip strukturor parashtues - thotë prof. Selman Riza - foljes i lëviz kuptimi midis vënies në dukje dhe nxjerrjes në jashtë"²⁰ dhe vazhdon "madje me ndërngjyresimin kuptimor jo gjithaq të kundërveprimit asgjësues sa shumë më tepër të përsëritjes së një drejtimi tjetër, përdorja e së njëjtës parashtesë, praktikisht është e mundshme gati në çdo folje. Atëherë folja këshu e parashtesëzuar shoqërohet me të thjeshtën përkatëse, p.sh. *endem e çndem, mendoj e çmendoj*".²¹

Vërtet, një pasuri e tillë, e prekur paksa edhe nga prof. Xh. Lloshi,²² duhet të theksohet më mirë në burimet tona normative të së ardhmes që nuk është karakteristikë vetëm e foljeve të prejardhura me parashtesën sh (ç, zh) në raport me foljet e thjeshta, por edhe me formante të tjera si: pranova spranova, bluaj e përbluaj, dashtë e padashtë(!) etj.

2) *Parashtesa PËR-* në kuadër të parashtesave del më prodhimtare. Ky formant u jep foljeve të prejardhura një kuptim intensiv, por ndonjë herë edhe ndonjë kuptim të fyturuar. Në të vërtetë, sipas burimeve përkatëse, foljet me parashtesën PËR- dalin të specifikuar për këto tri nënfushëza kryesore semantike:

- a) me kuptim përforsues, zakonisht me temë foljore, si p.sh. përqesh, përbëj, përkryej, përmbaroj, përgëzoj, përbluaj, përngaj, përul, përthej etj.;
- b) me kuptim të fillimit të veprimit si përskuq, përshenj përqpap, përqpas etj. si dhe
- c) me kuptim të veprimit zakonisht të fyturuar mbi tema emërore, si p.sh. përflak, përbalt, përbuz, përdredh, përdudh etj.

Kjo parashtesë funksionalisht mund të krahasohet me parashtesat e specializuara ose të mirëfillta që kanë krijuar tashmë gjedhe, siç është, në mjaft raste, edhe prapashtesa -RO-, prapashtesa -ZO- për procese të ndërlikuara teknologjike etj.

Në kuadër të kësaj del trajta e shkurtër **P(Ë)-**, siç janë shembujt: pshurr, pëshhtëllij, pëshëtim, të cilat mund të kenë paralelizëm me trajtat më -O/j, mbi temë të qartë motivuese.

²⁰ Po aty, f. 290.

²¹ Po aty, f. 294.

²² Xhevat Lloshi, *Silistika e pragmatika*, Tiranë 1999, f. 118.

3) *Formanti TË-* foljeformues (që vjen nga nyja e përpame mbie-mërore a të një emri), si p.sh. *tëhuaj, tëheq, fllloj, tëfund, tëkorr, tëhidhet, tëharr, tëholl, tfaq* (Naimi) etj. - u përngjitet disa fjalë-temave dhe këshu nga përngjitja formohen folje me kuptim të ri, por përfitimi i ri nuk pëson ngritje intensiteti të dalluar. Krahaso edhe: *tëhumoj, tujcoj, tdrasoj, tlanoj, tfulqoj* - të shënuara nga Abdullah Zymberi²³. Lidhur me këtë kuptimësi, mund të kujtohen asociacionisht disa folje me prapashtesën -TO-.

4) *Me parashtesën SHPËR- (SHPË-)* është formuar një numër i dukshëm i foljeve si: *shpërndaj, shpërngul, shpërdor, shpërfaq, shpërlaj (shpërlaj), shpërallohem, shpërmend, shpërfill, shpërdredh, shpërhap, shpërfik, shpërnjoh, shpërthej, shpërthiq* etj. Edhe të këto folje dallohen nuancime kuptimore me një shtim intensiteti e herë-herë edhe me nuancim të ri semantik që asociacionisht na nxit të kujtojmë foljet e prejardhura me prapashtesën -SHO-, -SHTO-j e ndonjë tjetër. edhe nga foljet me parashtesat: ZBËR-, ZDËR-, ZGËR-.

5) *Folja me parashtesën TËR-*, si p.sh. *tërheq, tërhedh, tërhuz* - pëson nuancim kuptimor jo të ri por të sforcuar pa u shkëputur nga kuptimi fillestar që del nga tema prodhuese. Prof. S. Riza thotë se "ekzistenca e variantit **tërhol** (*me*) tërholur të foljes **tëhol** (*me*) të hollur na sugjeron idenë se edhe tërheq rrjedh nga tëheq".²⁴ Në me gjithë sugjerimin e dhënë i trajtuam veç e veç formantet -tër e -të, sepse këto, në fakt, duket se mbulojnë nuanca të ndryshme kuptimore a stilistike. Nënfushëza që mbulojnë foljet më -tër na i kujtojnë ato që mbulojnë edhe foljet me prapashtesën më -O- me zgjerim me elementet ndërhyrëse -RR-, -T- në raste e ndonjë tjetër.

6) *Folja me parashtesën STËR-* folja shpreh ngjyrimin e *zmadhim*, si p.sh.: *stërholloj, stërthem (stërflitet), stërvjedh, stërvalem, stërpik, stërkeqem, stërshitem* etj., marrin konotacion të teprisë. Prof. S. Riza e përfizon funksionin e parashtesës STËR- si një formant "që tregon përsëritje më të tepërta të të njëjtit veprim, qoftë shpëniën e tij përtej kufirit më të skajshëm"²⁵, funksion ky që në njëfarë mënyre sjell ndërmend foljet me prapashtesën -RRO-, përkatësisht -ZHO- e ndonjë me -SHTO- si p.sh. stërflak / flakështoj, stërmadhoj / madhështoj etj.

²³ A. Zymberi, *Gjurmime albanologjike...* 24/94, Prishtinë 1994.

²⁴ Prof. S. Riza, po aty, f. 292.

²⁵ Po aty, f. 293.

7) *Me parashtesën S- (Z-)*, në mjaft raste, si p.sh.: *sforcoj, spastroj, skuq, sprovoj; zbardh, zbarcoj, zbatoj, zbukuroj* etj. - folja merr kuptim intensiv, ashtu siç ndodh edhe me ndonjë prapashtesë që mund të jetë edhe vetë prapashtesa -S e tipit: *zbrap -zbraps /spras(moj), sqaroj /qartësoj, zgjat (ngjat) /gjatësoj, zverdh /verdhoj (vërdhëzoj), zbërthej /thyesoj, zvogëloj vogëlsoj, zgjesh /ngjesh* etj.

8) *Parashtesa N-*, si p.sh.: *ndryj, ndruaj, ngush, ngjall, ndal, ndrit, ngjiz, nxij* etj. - nuk i jep foljes aq intensitet, por kuptimi i saj gjithsesi sforcohet brenda kontekstit, duke u lidhur paksa forcërisht me temën prodhuese, veçori kjo që mund të arrihet edhe me elemente të ndonjë prapashtese, siç e pamë të pasqyruar në ndonjë folje më -RO(-NO) e -RRO-. Në të vërtetë prapashtesa n- ka paralelizëm me parashtesën sh-: ngarkoj/shkarkoj, ndrydh/shtrydh, ngreh/shkreh etj.

9) *Edhe me parashtesën M- (MË-, ME-), MBË- (MB-), MBËR-*, si p.sh.: *mburr, mbart, mbars, mërrudh, mbuloj, mplak, mpleks; mëkoj, mëkëmb, mësyj; mbështjell; mbudh; mbërthej, mbërdhëz/em, mposht, mplakem, mpreh, mpak* etj. - folja nuk fiton intensitet të veçantë, por brenda kontekstit trajta foljore del me formë të sforcuar kuptimësie pa e zbehur lidhshmërinë e saj me temën prodhuese. Kështu ndodh edhe me ndonjë element prapashtesor, siç është, b.f. rasti me foljet më -TOj/, p.sh. përbej përbotoj, tregtoj, arsyetoj etj. Lidhur me këtë asociacionist vlen të kujtohet edhe prapashtesa -MO-, por edhe ndonjë tjetër, siç do të parafrazohet pak më poshtë të paralelizmat e mundshme, si. p.sh. *mpak pakësoj, mposht poshtëroj, mësyj syjoj, mbars barsoj* etj. Si variant i prapashtesën MË- del formanti ME-, kjo shihet qartë të këta dy shembuj: *merendoj, menderoj*. Është e vërtetë se edhe sonanta m në funksion prapashtese, sikurse n-ja që kishte me sh-, ka paralelizëm me parashtesën z- si p.sh. *mbuloj/zbuloj, mbath/zbath, mbërthej/zbërthej, ndrit/zdrit* etj, por ka raste që foljet e këtij tipi të kenë ndonjë paralelizëm semantic me trajtat me prapashtesim. Krahaso: *mposht/poshtoj* e *poshtëroj*, *mërrudh/rrudhoj*, *mbars/barsoj*, *mpleks/pleksjoj* etj.

10) *Parashtesa LË-*, që na aspektin historik Kolec Topalli në raste i gjen përdorim të zakonshëm, por që ka pasur shumë ndryshime a variantizime "gjatë evolucionit", si p.sh. la (lavar), li (lidhos), lu (lubardh), lo (lokomend), le (kelemend), ly (lyft),²⁶ në shqipen e sotme ka mjaft përdor-

²⁶ Kolec Topalli, *Studime filologjike 1-4*, Tiranë 1992, f. 52 dhe të *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë 1995 f. 180.

rim të gjerë, kur kemi parasysh nënfushën semantike që mbulon, si p.sh.: *lëbardh, lëkuq, lëmbarem, lëmburrem, lëbyr, lëthur, lëpij, lëkund, lëmek, lëvar, lëvërdh, lëfar* etj., me të cilën folja merr kuptimin që tregon një "pakësim a një lehtësim veprimi", na kujton drejtpërdrejt rolin që ka formanti -LO- si prapashtesë foljeformuese, ashtu si edhe ai -LJ (-IN) në raste.

11) *Edhe te foljet me parashtesën SH-*(nistore) a **SHK(Ë-)**, si p.sh.: *shndrit (shndrij), shkërbëj, shkërdhej; shkokëloj, shkaklovit, shkakloj* etj. dallohet një intensitet i shtuar në krahasim me trajtat e thjeshta.

12) Ngjashëm me pikën e mësipërme edhe nga foljet *me parashtesat variacione me Z-* nistore: *zbër-, zdër-, zgër-*, ndonëse me temë etimologjiksht jo të sqaruara, si p.sh.: *zbërthej, zbërdhul; zdërgjahem, zdërhallem, zdërvij, zdërllaq; zgërdhij, zgërqesh/em, zgërllaq* etj. shprehen kuptimësi me shkallëzim të një intensiteti të dalluar, ashtu siç shprehen koncepte edhe me foljet me prapashtesat më -O-, -ZO-, -SO- etj.

13) *Formanti prapashtesor RI-* i huazuar nga italishtja që nuk u zëvendësua me barasvlerësin rish- (rish) të shqipes, për hir të ngjashmërisë së trajtës -RI- si pjesë e fjalës shqipe në raste të tjera, prandaj në shqipen letrare të sotme numri foljeve me ri- është mjaft i madh, pos përsëritjes së çfarëdo veprimi, s'kemi të bëjmë me ndonjë shkallëzim stilistik, por sa i përket nënfushës semantike foljet e tilla gjetën, siç thuhet, mjaft *qeliza të zbrazëta* në gjuhën tonë dhe i plotësuan ato. Krahaso: *ritregoj* (parafrazoj), *rikujtoj* (promoraroj), *ripunoj* (riparoj) etj, pastaj: *ribashkoj, ribëj, rivendos, rishqyroj* etj.

14) *Me parashtesën QË-* atraktive, e cila te foljet nuk është prodhimtare, del e qartë vetëm folja: *qëmtoj* (që+mëtoj).

15) *Me parashtesën RRË-* dalin mjaft shembuj si: *rrëmih, rrëmbush, rrënxin rrënxij (nxij), rrëshqej, rrëgjak/em, rrëqeth, rrëshqit, rrëbist, rrëkutem (skutem), rrëkëllej (këllej)* me të cilat shprehet intensitet i një kuptimësie të re të përafërt me atë që shprehet me fjalë-temën prodhuese, motivuese, së cilës i paravihet, intensitet ky që na i kujton, domosdo, foljet me prapashtesën -RRO-. Xhevat Lloshi²⁷ na i rikujton stilemat e mundshme: *nxinte e rrënxinte, shqyente e rrëshqyente*, - të cilat, për hir të intensitetin që shprehin, edhe mund të kenë përhapje me favor në jetën tonë gjuhësore.

²⁷ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë f. 1999., f. 118.

16) *Me parashtesën K(Ë)*- me variacionin **KA**-, si p.sh: *këqyr* (qyr); *këput*, *këlyshet* (*lyhet), *kapërdij* (përdij), *kapërthej* (për/thej), *kërqethem*, *kërlesh*, *kërtyl*, *kërcënoj*, përkatësisht *gërfej* (fej), *gërgas* (ngas), *gërvisht*, *gërgas* (ngas); *gëlçoj* (çoj) etj., proces i ngjashëm ku sikurse arrihet me prapashtesën -KO-j (kërlesh leshkoj) e me disa folje me prapashtesat, -RO- e -RRO-, -LO -.

17) *Parashtesa KËR*- me variacionet **GËR**-, **GËL**- asociacionon intensitet të dukshëm të shembujt: *kërqethem* (qethem), *kërvesh* (vesh) *kërlesh*, *kërtyl*, *kërcënoj*, përkatësisht *gërfej* (fej), *gërgas* (ngas), *gërvisht*, *gërgas* (ngas); *gëlçoj* (çoj) etj., proces i ngjashëm ku sikurse arrihet me prapashtesën -KO-j (kërlesh leshkoj) e me disa folje me prapashtesat, -RO- e -RRO-, -LO -.

18) *Me parashtesën KATRA*-, si janë shembujt: *katravesh* (vesh), *katrapilop*, *katrasyll* e ndonjë tjetër. Sipas Xhuvani-Çabejt foljet e tilla "tregojnë një veprim ose një gjë të ngatërruar a të shtrembër"²⁸, të cilat pjesërisht mund asociacionohen më ndonjë folje me prapashtesim. Kjo mundësi shprehore më duket se nuk del mjaft e shfrytëzuar në realitetin tone gjuhësor.

19) *Për foljet me prapashtesën SPËR*-, si p.sh.: *spërlat* me *spërlatë* (latë), *spërhell*, me *spërhellë* (hell), *spërdredh*, me *spërdredhë*, *spërdrit* me *spërdritë* (dritë), Xhuvani-Çabej thonë se "kjo parashtesë jep idenë e së tepërmas a të shpërndarjes,²⁹ koncepte këto që vetëm pjesërisht mund të krahasohen me foljet me prapashtesat përkatëse, të tipit më -SHTOJ, -RRO- etj.

20) *Me parashtesën V(Ë)*- dhe me të pazëshmen korresponduese të saj, **F(Ë)**- ndeshim disa shembuj si p.sh. *vdës* (dës), *vdjerr* (djerr), *vagëll* *vagëllij*, *vlug*, *vëshitroj*, *vërsulem*, *vështroj*, *vërgjakem*; *fshaj* (shaj), *fshij* (shij) *fshitrem*, (vë/shtirem shtirem) e ndonjë tjetër. Edhe foljet me këto formante sikurse shembujt me n-, e m- parashtesor shprehin kryesisht përforcim intensiteti semantik e stilistik.

21) Tash së voni dalin mjaft të hetuara disa folje të përfutuara me *parashtesën pa*- si p.sh.: *pavdekësoj*, *paafhtësoj*, *pavlefhtësoj*, *paanësoj*, *pasakhtësoj*, *pamundësoj* etj., të cilat, si duket, kanë ndërlikim kuptimor me

emrat e formuar me prapashtesën -SI: *pavdekësi*, *pasakhtësi* etj., mirëpo zbrëthimi kuptimor i tyre nuk del mbi këtë bazë, por mbi bazë të mbiemrit përkatës, ashtu si edhe te foljet antonime pa këtë parashtesë. P.sh. e *pavdekësoj* "(e) bëj të pavdekshëm", e *paafhtësoj* "e bëj të paafhtë", e *kështu me radhë*.

22) *Nga shembujt më d(Ë)*- (dër- dërr-) si p.sh. *dëboj*, *dëftoj*, *dëftej*, *dëkoj* (mëkoj), *dëllir*, *dërmekas*, *dërlak*, *dërmmoj*, *dërrudhem*, *kuptohet* se kjo parashtesë dikur ishte më prodhimtare e aktive se sot në formimin e foljeve. Siç shihet nga shembujt edhe me këtë parashtesë më tëpr sforcohet kuptimi i foljes përkatëse temëprodhuese sesa formohet një folje me kuptim te ri.

23) *Me prapashtesën mbi*- janë formuar disa folje si: *mbishkruaj*, *mbiharxhoj*; *mbisundoj*, *mbiçmoj*, *mbivlerësoj*, *mbijetoj*, *mbikëqyr* etj. me të cilat shprehet një veprim që zhvillohet, i shtohet ose qëndron më lart diçkajes, përkatësisht që ka përmasa a sasi më të mëdha se zakonisht, por gjithsesi tregon një shkallëzim në rritje të veprimit. Mund të thuhet se veprimi i shprehur me këtë formant është i ngjashëm, por jo identik me funksionin e disa prapashtesave të foljeve më -o- me zgjerim me të cilat shprehet rritje intensiteti.

24) *Edhe me parashtesa nën*- ndonëse antonim i parashtesës mbi-, formohen folje, jo gjithmonë mbi bazë kundërvënijeje. Krahaso: *nënshkruaj*, *nënvlerësoj*, *nënçmoj*, *por edhe: nënshtroj*; *nënkuptoj*, *nënqesh* etj., me të cilat shprehet një veprim që ndodh jo vetëm poshtë diçkaje, por edhe ndonjë vlerësim më i ulët sesa bëhet zakonisht.

25) Ndonëse *me parashtesën ndër*-, formohen folje që shprehin ngjyrim të ndryshme kuptimore, si p.sh.: *ndërdy* (dyshoj), *ndërhyj*, *ndërlidh*, *ndërllek*, *ndërltkoj*, *ndërmjetësoj* etj., nuk është formuar numëri i madh i foljeve. Nënfisha semantike që mbulojnë foljet e tilla është mjaft specifike dhe zgjon interes, ngase me foljet e tilla tregohen veprime që ndodhin ndërmjet dy a më shumë gjërave.

26) Zgjojnë interes të posaçëm disa folje me **ZH**- (*nistore*) ose **ZHA**- si p.sh.: *zhdavarit*, *zhgjakos*; *zhakëmbej*, *zhabarit*, *zhaparit*, *zhapëlloj*, *zhangëlloj*, që bashkë me shembujt si zhavorroj, zhabërzhyej e ndonjë tjetër a i përket efektit na i kujtojnë foljet me prapashtesën -ZHO-, por sigurisht të një natyre tjetër.

²⁸ Xhuvani-Çabej, *Parashtesat...*, f. 404.

²⁹ Xhuvani-Çabej, *Po aty*, f. 404.

* * *

Sidoqoftë, siç del nga materiali i shtruar më sipër (që nuk është shterues), sa i përket shkallës së kuptimësisë shumica e foljeve me prapashtesë zero mund të krahasohen me gjegjëset me prapashtesat -O- pa zgjerim ose ato me zgjerim, por edhe me prapashtesat e tjera. Pra nuk mohohet edhe mundësia që asociacionisht të këmbehen edhe me versione të tjera që dalin me formante paralele, sinonime këto, pjesa më e madhe e tyre të shënuara në fjalorin normativ, mirëpo në këto raste kuptimi i shprehur me parashtesë në shumicën e rasteve del me specifikë të veçanta, siç mund të kuptohet edhe nga ndonjë përkufizim që u cek përkatësisht, mirëpo ndeshim edhe raste me shenja paralelizmi kuptimësie a ndonjë fije ndërlidhjeje lidhur me funksionin e prapashtesës përkatëse. Pikërisht këtë raport me mundësi kundërvënije ndërsinonimike metatezore ndërmjet prapashtesave e prapashtesave foljeformuese që u cekën më sipër, që ndonjë rast del i përfutur spontanisht a me përputhshmëri rasti, po në mbështetje të gjedhes që ofrohet mund të jetë i qëndrueshëm, prandaj dukuritë e tilla ta sapoheutara do të përpiqemi t'i përmbledhim tash fill.

3. Paralelizmat e mundshme në raportin prapashtesë/prapashtesë foljeformuese

Këtu po i trajtojmë vetëm nja 10 formante më karakteristike që asociacionohen ndërsjelltazi, qoftë për nga vetë forma, qoftë për nga funksioni, duke pasur parasysh, pra, jo vetëm anën formale morfemformuese, por paksa edhe ngjashmërinë e brendshme semantike:

1) Foljet me parashtesën -L (-LË) edhe kuptimisht mund të lidhen me foljet me prapashtesën -LO- Si veçori del, pra, vetë elementin -L- mbështetës: Krahaso: lëbardh - bardhëloj, lëkuq - kuqëloj etj. Për foljet me prapashtesën LË- ashtu edhe për foljet me prapashtesën -LO- në burimet përkatëse është dhënë me vend konstatimi i ngjashëm se folja e tillë, "tregon një pakësim, një lehtësim veprimi" Dhe, vërtet, kjo cilësi kuptimësie shihet te shembujt përkatës, pra, edhe me parashtesën -LË, edhe me prapashtesën -LO-.

2) Konstatimi i ngjashmërisë semantike që sa u tha në pikën e mësipërme, vlen edhe për foljet me parashtesën S-, të tipit: spastroj, sforcoj, skuq etj., të cilat mund të kenë paralelizëm me -S-në prapashtesore: mbraps, mpiks, por aq më tepër me prapashtesën -SO- Krahaso: sqaroj me qartësoj, skuq me kuqëson, sëmbar me mbarësoj e ndonjë tjetër. Paralelizëm kuptimor ka edhe me foljet më -LO-, -RO-, -TO- e ndonjë tjetër, si p.sh. krahaso: skuq me kuqëloj a kuqëroj, spastroj me pastërtoj e pastër(m)oj, sforcoj me forcëroj etj.

3) Po ashtu edhe foljet me parashtesën z-(gër) mund të vërehet ndonjë paralelizëm me prapashtesën -ZO-, si p.sh. zverdh a zverdhoj me verdhëzj (shndërrim ngjyre), zdërllaq e zgërllaq me lagëzj (lagështoj).

4) Foljet me parashtesën PËR- mund të krahasohen kuptimisht e stilistikisht për ndonjë nuancë me foljet me prapashtesën -RO-, si p.sh. *përshpirt* me *shpirtëroj*, përhijon me hijeroj, përlëvdoj, lavdëroj, ngase që të dyja karakterizohen me kuptim sforcoes që lidhet me temën fjalëformuese dhe me to shprehet njëfarë ngjyrese stilistike brenda botës subjektive të njeriut. Si barasvlerëse të përafërta u qëndrojnë përveç foljeve më -RO-, -LO- edhe folje me prapashtesa variantesh të tjera të -O-së me zgjerim.

Më e hetueshme del paralelizma e foljeve të variantit më P(Ë)- me trajta më -O- pa zgjerim, si p.sh.: pshurr/shurron, pëshhtëll/shhtëllon pëshhtëll/pëshhtëllij/shhtëllon, pësh/tym/tymon (thaj me tym).

5) Foljet me parashtesën M-(MË)-, N-, V(Ë) e D(Ë)- si mësyj mund të krahasohet me syjoj, mposht me poshtëroj (poshtnoj), nxij me zijon, ngjall me gjalloj, vërsul me sulmoj, vërgjak me gjakos, dëlir me liroj, dërlak me lakoj, ndërsa te rastet: synoj, nxiron, ngjalloj (gjallëroj, gjallnoj), vdjerr (djerroj), dërrudhem (mudhohej) shihet se dallimi është paksa më i vërejtshëm, ngase merr një shkallëz tjetër intensiteti stilistik a kuptimor.

Të vihet re fakti se foljet e tilla me M(Ë)-, N-, V(Ë) e D(Ë)- megjithatë, tregojnë njëfarë përforcimi semantik a stilistik, por intensiteti përsëri mbetet në suaza, si me thënë, të asnjësisë, pra nuk shfaqin ndonjë shkallëzim të ri kuptimor të dalluar. Kjo kuptimësi është e ngjashme sikurse pamë te ndonjë folje më -NO- e -MO-, të cekura në nëntitullin e mësipërm.

6) Po ashtu edhe foljet me parashtesën TË- mund të krahasohen me foljet më O- pa zgjerim ose edhe pa të (me temë zero) mbi temën e njëjtë fjalëformuese, siç janë rastet e mundshme më -TO-, tëholl hollëtoj, tëhedh hedhëtoj, siç janë rastet e mundshme më -TO-, tëholl hollëtoj, tëharr harr, tëhedh hedh etj. hedhtoj, po edhe të tjera si: p.sh.: tëholl hollëtoj, tëharr harr, tëhedh hedh etj.

7) Për disa folje me parashtesat jo aq produktive, që paraprihen nga një **SH-** nistore, si p.sh. **SHKA-**, përkatësisht **SHPËR-**, konstatohet se, duke marrë parashtesën e tillë përkatëse, foljeve u shtohet cilësia e intensitetit, madje ka raste kur me një veprim të tillë mund t'u ndryshojë edhe nuancimi semantik i shprehjes, ngase me to tregohet ngritje e një ndërlikueshmërie të shkallës së lartë, duke u mveshur edhe me ndonjë ngarkesë afektive që arrin deri te ndonjë ngritje drastike, jashtë mase, të efektit. Po cekim vetëm disa shembuj: *shpërfik* që asociacionon me foljen *përfikto*, *shpërmall*oj, e cila na i kujton formimet: *mallëngjej*, *mallshtoj* a *mallëzoj*; *shkarravit* me *ravizoj*, *shkapërderdh* me *derdhëlloj*, shpërndrit me dritëshoj, dritështoj. Kështu që mund të thuhet se stilistikisht dhe semantikisht foljet e tilla mund të krahasohen me foljet me prapashtesat përkatëse që dalin nga shembujt e mësipërm, por edhe me foljet me prapashtesat **-ZHO-** ose **-RRO-** a ndonjë tjetër, varësisht nga konteksti.

8) Edhe pse në numër të kufizuar, më tepër se të gjitha të tjerat, foljet më **RRË-** dhe ato më **-RRO-** ndërliohen për nga paraqitja e intensitetit përkatës, por që në njëfarë mënyre i lidh edhe ngjyrimi semantik. Krah: *rrënxin*/*nxir*(r)on, *rrëkutem*/skutërrrohem (skutëllohem), *rrëgjakem* / *gjakërohem* (gjakosem).

9) Edhe parashtesa **KËR-** në ndonjë rast ka ko incidencë me prapashtesën **-KO-**, te shembujt: *kërlesh* me *leshkuj*, *kërqthem* me *qethkohem* e ndonjë tjetër.

10) Është mjaft i tejdukshëm paralelizmi kuptimor në mes të foljeve me **STËR-** dhe të atyre të mundshme më **-O** me zgjerim. Krahaso: *stërtremb* me *trajtat* e mundshme: *trembëzhøj*! a *trembështoj*, *stërmadhøj* me *madhështoj*, *stërmundøj* me *mundshtoj*, *stërzgijat* me *zgjatøj*, *stërkeq* me *keqërroj*, *keqshtoj* etj.

Natyrisht, në kontekste të caktuara, nuancimi kuptimor a stilistik i shembujve del më i dalluar dhe këtë specifikim mbetet ta vlerësojë vetë shfrytëzuesi që ka të bëjë me përzgjedhjen e trajtës që dëshiron, e cila edhe i nevojitet atij, d.m.th. e përzgjedh trajtën me parashtesë ose me prapashtesë ose pa të fare ose me të dyja bashkë, sipas nevojës e shijës së tij, sigurisht

duke respektuar normën e situatës e duke shfrytëzuar në parim të dhënat nga konstatimet e mësipërme.

Sidoqoftë, ngjashëm me analizën që u bë për foljet me formante të mirëfillta parashtesore, në krahasim me formantet përkatëse prapashtesore, mund të vepohet edhe për foljet me parashtesën **STËR-**, dhe ato më **-TEJ** e ndonjë tjetër, mirëpo meqë këto formante kanë më tepër elemente sindajshesash (ndajfoljesh), d.m.th. i takojnë grupit të ndajfoljeve "prashtesave ekzistuese si fjalë më vete", shembujt do të trajtohen paksa pak më poshtë, pasi të shqyrtohen fare shkurtazi formimet me para-prapashtesim njëherazi dhe formimet me njëfjalëzimin e lokucioneve foljore.

4. Foljet e prejardhura më **-O-** me para-prapashtesim të dyanshëm në përqasje me tipa të tjerë

Në gjuhën shqipe një numër foljesh të prejardhura formohen me para-prapashtesim njëherazi. Edhe në këtë dukuri foljet më **-O-** mbizotërojnë për nga numri, si p.sh.: *përballøj*, *përfundøj*, *përmailloj*, *përdorøj*, *përgënjështoj*, *përkeqësoj*, *përshkallëzoj*; *shfrytëzoj*, *shkripëzoj*, *zhodganoj*, *zgjeroj*, *zbukuroj*, *spastroj*, *mposhtøj*, por nuk mungojnë, ndonëse në numër më të vogël edhe folje me prapashtesa të tjera si p.sh.: *nguroj*, *shpërralloj*, *shpërkëndit*, *përkryej* etj.

U tha më sipër se foljet e këtij tipi dalin më të përkapshme në shqipen e sotme edhe ndaj foljeve me parashtesim, por pa prapashtesë, siç është tipi i foljeve: *përball*, *përdor*, *mposht* ndaj trajtave: *përballøj*, *përdorøj*, *mposhtøj* etj. Është vendi të rikujtoj faktin që u dha si ilustrim në *Tabelën* e mësipërme rreth numrit të foljeve të formuara me 10 prapashtesat përkatëse, ku shuma e foljeve më **-O-** kryesisht me para + prapashtesim njëherazi kapte shifrën jo të papërfillshme prej afro 600 rastesh, të cilat, në të vërtetë, janë fjalë aktive në letarishten e sotme.

5. Njëfjalëzimi i togfjalëshave foljorë lokucionorë dhe foljet më -O-

Siç dihet në shqipe mjaft togfjalësha foljorë të lire e frazeologjike me cilësinë e lokucionit,³⁰ duke ruajtur mëvetësinë e tyre kuptimore në raste, prirjen të njëfjalëzohen dhe kështu në bashkëjetesë me foljen e njëfjalëzuar, zakonisht të ndërtuara me pranëvënie, me prejardhje a me përbërje, gjithsesi ruajnë raportin ndërsinonimik. Formimet e tilla zënë vend mjaft të rëndësishëm në kuadër të sistemit foljeformues në gjuhën shqipe. Krahaso: bëj ballë - përballoj, ndjej mallë - përmallohem, bie fli - flijohem, qes fall - faltoj, jap forcë - forcëroj, marr idhnim (hidhërim) - idhnohem (hidhërohem), tjerë holl - stërholloj, vras mendjen a mbledh mendjen - mendohem, fal nder - falnderoj, ngre peshë - peshoj, ngre lart - lartësoj, zë besë - besoj, bëj vijë - përvijoj; mbaj krahun - përkrah, vë re - vërej, bëj zë - bëzaj, heq dorë - dorëheq, heq udhë - udhëheq, ngul këmbë - këmbëngul, ngjit bashkë - bashkëngjit, ngas rend - ngarend, jap leje - lejoj, lëshon shkëndija - shkëndijon, bëj shoqëri - shoqëroj, vë theksin - theksoj, rrah me çekan - çekanoj, shpoj me shtizë - shtizoj; grij për silazh - silazhuj, merrem me çobani - çobanoj, zë me kurthë - kurthoj; rrjedh si rrymë - rrymon, lëviz si gjarpër - gjarpëron, e bëj si hark - harkoj etj.

Kur është fjala për raportin e togfjalëshave të tillë a frazeologjizmat e të tillë lokucionorë³¹ me foljet më -O- mund të nxjerrim këto tri konstatime të ndërlidhura:

E para, jo të gjithë togfjalëshat e mësipërm e kanë marrë cilësinë e frazeologjizmës së qëndrueshme, por të gjithë kanë marrëdhënie sinonimike me foljen përkatëse. Sigurisht njëfjalëzimit i ka paraparirë togfjalëshi frazeologjik. Këtë çështje mjaft mire e ka sqaruar L. Buxheli, kur shpjegon se "nga pikëpamja kronologjike janë përdorur në fillim togfjalëshat foljorë, si një formë më e thjeshtë, më konkrete dhe më analitike e të menduarit, kurse foljet sinonime me këta togfjalësha janë krijime të mëvonshme që përfaqësojnë një shkallë më të lartë abstraksioni" (Vepra e cit. f. 70).

E dyta, mjaft folje paralele që më përpara nuk ekzistonin, ndonëse emri i ashtuquajtur prejfoljor ishte i aktivizuar, si emër i prejardhur a i përbërë,

siç e parashikonte Jani Thomai,³² sipas mënyrës së "riformimit regresiv", tashmë, në realitetin tonë gjuhësor gjithnjë e më tepër po gjejnë përdorim. Krahaso: ngul këmbë - këmbëngulje - këmbëngul, marr hak - hakmarrje - hakmerrem, marr pjesë - pjesëmarrje - pjesëmarr, heq dorë - dorëheqje - dorëheq etj.

E treta, siç po shihet nga shembujt e mësipërm disa togfjalësha janë njëfjalëzuar, qoftë sipas mënyrës së prejardhur, qoftë sipas përbërjes si ndajshesore, dukuri kjo që do të preket më poshtë, por çastësisht s' mund të anashkalohej pa u përmendur fakti, siç shihet edhe nga shembujt e sipërrregjistruar, se edhe në këto raste mbizotërojnë trajtat e foljeve me prapashtesat përkatëse më -O-, ngase është tipi praktikisht më prodhimtari e më popullori në kuadër të strukturës foljeformuese të gjuhës sonë. Sidoqoftë përhëllimi edhe në këtë dukuri sigurisht do të mund të sillte rezultate të tjera edhe më me interes.

6. Foljet me siparashtesa dhe kompozita në shqipe në përfaqje semantike me foljet më -O-

Për të pasur një ide më të qartë për vendin e foljeve më -O- të prejardhura me siparashtesa³³ (kryesisht me prejardhje ndafoljore), të cilat prof. S. Riza i quan "*parashtesa ekzistuese si fjalë më vete*"³⁴ këtë çështje do ta shtrojmë në tri pika:

së pari, do të japim tabelën e numrit të foljeve të formuara mbi bazë të disa siparashtesave më vepruese, aktive, material ky i vjelë nga tri burime: FGJSH 1954, Fjalori i foljeve të Z. Munisht (FF) dhe FGJSSH (1980), së dyti do të trajtohet mundësia e paralelizimit të foljeve me siparashtesa me disa folje me prapashtesën -O- me zgjerim dhe së treti, do të vihet re përfaqja e mundshme e disa foljeve më -O- me zgjerim me folje të përbëra.

³² Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1977, f. 97.

³³ Mendoj se termi siparashtesë në vend të trajtës prefiksoid, del tashmë i pranueshëm në gjuhësinë tonë. Ne i trajtuam kështu edhe disa formante me prejardhje ndafoljore, të cilat kanë fituar fizionomi të plotë parashtese.

³⁴ Prof. S. Riza, *vepra e cituar*, f. 297.

³⁰ Gramatika e gjuhës shqipe (morfologjia), Tiranë 1985, f. 41, 260.

³¹ Shih: Mehmet Gjevoçi, *Frazeologji shqipe*, "Rilindja", Prishtinë 1968.

a) Foljet me siparashesat më aktive e produktive

Në tabelën e mëposhtme sipas burimeve të lartcekura në rubrikat përkatëse është shënuar numri i foljeve me -O dhe numri i foljeve të tjera (në tabelë: Tj). Siç dihet folja më -O- në këto raste zërthehet: (si)parashtesë + tema + prapashtesa, që nuk është domosdoshmëri edhe për foljet e tjera më të cilat krahasohet për nga numri dhe që janë njehësuar prej nesh.

Tabela e numrit të foljeve me siparashesat përkatëse

Nr. r.	Siparashesa	FGJSH			FF			FGJSSH		
		-O-	Tj.	Gj	-O-	Tj.	GJ	-O-	Tj	Gj.
1.	para-	7	5	12	13	12	25	18	11	29
2.	kundër-	2	-	2	4	3	7	5	4	9
3.	bashkë-	4	1	5	10	6	16	15	7	22
4.	tej-1	-	1	3	4	7	3	4	7	
5.	vetë	-	-	-	-10	10	20	10	9	19
6.	keq-	1	-	1	4	-	4	5	2	7
7.	mirë-	-	-	-	1	3	4	2	4	6
8.	ndaj-	-	-	-	1	2	3	1	2	3
9.	drejt-	-	-	-	2	1	3	2	1	3
Gjithsej		15	6	21	48	41	89	61	44	105

Siç po shihet nga tabela e mësipërme tipi i foljeve më -O- në njërin anë, në krahasim me të gjithë tipat e foljeve të tjera, në anën tjetër, janë pak më shumë në të dy burimet e mëvonshme, madje në burimin e dytë janë afro 20 shembuj suksesivisht më shumë, ndërsa në burimin e tretë 5 herë më shumë nga sa ishin në FGJSH 1954. Të vihet re se me siparashesën përkatëse: vetë-, mire-, ndaj- dhe drejt- në burimin e parë nuk dilte i shënuar asnjë rast. Shënojnë rritje të dukshme edhe foljet me siparashesën *bashkë-, para-*, kurse të tjerat, kanë numër të përafërt ose shënojnë rritje jo aq të ndjeshme. Është fjala për shembuj të regjistruar, sepse në jetën e përditshme, numri i tyre (i foljeve më -O-) del shumë më i madh.³⁵

³⁵ Shikuar në tërësi në *Fjalorin e foljeve* (FF) nga vepra e cituar e Zijadin Munishit, sipas njehësimit të lirë, dolën të regjistruara gjithsej 3547 folje, prej tyre 2068 ose 58,30% janë folje më -O-, foljet me prapashtesa të tjera të identikuara janë si vijon: më -OS 115, -EJ 67, -

Mirëpo edhe nga këto pak fakte statistikore kuptohet mjaft mirë vendi kyç tejet i rëndësishëm që zë folja më -O- në sistemin verbal të gjuhës sonë.

b) Mundësi paralelizmi të foljeve me siparashesim me disa folje me prapashtesa -O- me zgjerim

Te foljet me siparashesat (të karakterit ndajfoljor), që disa më aktivet u dhanë në tabelën e mësipërme, dihet se mbartet kuptimi që shoqëron fjalë-temën e caktuar (foljen përkatëse), prandaj kuptimet e tilla (edhe ato të karakterit antonimik), sipas rregullit, nuk konkurrohen as tërthorazi nga foljet me prapashtesa përkatëse, sigurisht as nga prapashtesa e foljeve -O- me zgjerim, megjithatë, po të shikohet çështja e ndërlikueshmërisë në thellë, asociacionisht mund të ndeshet ndonjë paralelizëm të foljeve me siparashesa me ato me ndonjë prapashtesë dhe njohja më e thelluar me snjë dukuri të tillë do të na ndihmonte jo vetëm që stili a sfondi i të shprehurit të jetë më i plotë dhe i më larmishëm, por edhe dija shkencore për këtë çështje të jetë më e plotë.

T'i krahasojmë shembujt e mëposhtëm që paksa semantikisht mund të krahasohen:

ndajthith me thithmjo, ndajthur me thurmjo;
tejnxe me nxehtësoj, tejholl me hollësoj,
ndërvar me (ndër)varshtoj, nëpërkasht me kashërroj
e ndonjë tjetër.

Pra edhe një mundësi e tillë trajtimi më të thelluar do të na shpiente në rezultate jo pa interes.

IS 71, -IT 181, -IJ 59, -AT 43 dhe me -AS 24 që gjithsej bëjnë 560 ose 15,78%, ndërsa folje në mënyra të tjera kapin shumën 919 ose 25,90%. Pra nga numri i përgjithshëm i foljeve aktive në letarishten e sotme, sipas përqindjes dalin afro 60 përqind me prapashtesën -O-, afro 16 përqind me prapashtesa të tjera dhe afro 26 përqind sipas mënyrave të tjera të foljeformimit. Në të vërtetë, në krahasim me numrin e regjistruar në FGJSH 1954 dalin afro 400 folje më -O- të regjistruara më shumë. Ndërsa vetëm në shembujt nga tabelat në shqyrtim në këtë punim, në krahasim me burimin e parë (1954) folje më -O- shënojnë rritje: në burime dytë 89, ndërsa në të tretin 165 shembuj, d.m.th. më shumë.

c) Foljet me kompozim në përqsasje me disa folje më -O- me zgjerim

Në fjalëformim përfutim me siparshtesa, ashtu si qëndron çështja edhe me siprapashtesa, nga disa studiues konsiderohen si formime me parashtesa e disa me kompozita (fjalëpërbërje). Dihet se kompozitat më të afërta për nga kuptimi me foljet me parashtesim a me prapashtesim janë ato, ku gjymtyra e parë përcakton të dytën, tek të cilat si gjymtyrë e parë mund të paraqitet një siparshtesë, si p.sh. bashkë-: bashkëpunoj, para-: parashtrij, mirë-: mirëkuptoj, keq-: keqtrajtoj, nëpër-: nëpërkëmb, anash-: anashkaljoj etj. - shembuj këta që është e pamundur të krahasohen me foljet e prejardhura me prapashtesa, ngase vetë shembujt i bartin ato.

Mirëpo përveç kompozitave përcaktuese të tipit të sipërcekur janë të njohura edhe kompozitat e tipit tjetër, ku veprimi shprehet, jo nga gjymtyra e parë, por nga gjymtyra e dytë si p.sh.: udhëheq, rrethshkruaj, duartroktoj etj. Pikërisht me këtë grup kompozitash mbase mund të lidhen asociacionisht edhe tri trajtat e foljeve -O- me zgjerim të nëntipave më -ÇO-j, -KO-j dhe -SHTO-j.

Po të lexohen sipërfaqësisht formantet e tilla, d.m.th. me -J- në fundore karakteristike të foljes: çoj (me çue, çuar), koj (me kue kuvar), shtoj (me shtue, shtuar) asociacionimi mund të jetë më i kapshëm. Me fjalë të tjera, trajta *gurëçoj b. f.*, *si rast*, mbase mund të lidhet me togfjalëshin "*gurë+çoj*" a "*çoj gurë*"; *dhelkoj* mund të lidhet me "*dhela+koj*" a "*koj (ushqej) dhela*", ndërsa *lëngështoj* mund të zërbërhet me "*lëng + shtoj*" a "*shtoj lëng*" etj.

Nga analiza doli se dy shembujt e parë semantikisht janë pothuajse të përjashtuar, ngase kuptimi primitiv i foljeve *çoj*, *koj* nuk përgjithësohet për shembuj të tjerë, pos rasteve të veçuara që u cekën më sipër, kështu që formanti -ÇO- as në ndërdije nuk asociacionon tashti kuptimin e foljes *çoj* (me çue): -ÇO/OJ. Kjo vlen edhe për formantin -KO- ndaj kuptimit të foljes *koj* (me kue = ushqej), mirëpo për rastin e tretë d.m.th. të foljet më -SHTO/j, kuptimi i foljes primitive *shtoj* (me shtue), me koncept shtimësie, del, si me thënë, i struktur nënvetëdijshëm në të gjitha foljet e këtij nëntipi.

Megjithatë, mendoj se foljet më -SHTO/j më tepër kanë konsideratë të merendohen si pjesë të foljeve të prejardhura me prapashtesim, ashtu,

siç i kanë konstatuar prof. I. Ajeti, E. Çabej e të tjerë, sesa të cilësohen si kompozita me gjymtyrën e dytë -shtoj (me shtue), siç veproj b.f. prof. S. Riza me foljen : mbarështoj (me) mbarështuar, të cilën e shënon si shembëll përfaqësues të fjalë-foljes së përbërë. Arsyeja qëndron në faktin se dukuria e tillë, edhe nëse vjen si relik i një përfutimi më të hershëm të foljes *shtoj*, tani ajo nuk ndihet në ndjenjën gjuhësore si e tillë. Forma -SHTO/j e ka aq të errësuar kuptimin foljor primitiv në raste të veçanta e përgjithësisht, sa që tash i ka mbetur sheshazi vetëm kuptimi prapashtesor i një formanti të specializuar, që shpreh koncept shumësie të nëntipi i foljeve përkatëse më -SHTO/j e jo kuptimin e komponentit përbërës të kompozitës.

Sidoqoftë, kjo çështje ia vlen të vëzhgohet dhe të vlerësohet më mirë dhe me kujdesin e duhur.

Përmbyllje

Nga lënda e sipërshtuar në këtë nënkrye dhe nga ajo e konsultuar lidhur me këtë po i paraqitëm këto konstatime që besoj se zgjojnë vëmendjen:

Së pari, në burimet tona normative e shkencore lidhur me raportin parashtesë/prapashtesë lypset bërë përplotësimë më fort të karakterit informativ që ka të bëjë me prodhimtarinë (shumësinë) e formanteve përkatëse. Po i përmendim menjëherë disa të dhëna statistikore. Në gramatikën e Akademisë (1976, 1995) b.f. dalin të shënuara nga 9 prapashtesa (me variantet), ndërsa si parashtesa (me alomorfet) përmenden dyfish më shumë, mbi 20 sosh.³⁶ Gjithashtu në punimin e Xhuvani - Çabej³⁷ ndeshim afro 70 formante foljeformuese parashtesore (ndonëse jo të gjitha dalin aktive). Madje po t'i shtojmë këtij numri parashtesat *pa-*, *që-* dhe siparshtesat *mirë-*, *keq-* dhe *vetë-* që i trajtuam ne në këtë punim dhe të tjera që janë në përdorim e sipër në shqipen e sotme letrare që Xhuvani-Çabej nuk i patën përfshirë në punimin e tyre, numri i përgjithshëm i parashtesave foljore kalon edhe 80-shin, që numerikisht janë afro 3 herë më shumë në krahasim me numrin e prapashtesave që ne e identifikuam. Këtu pak më sipër ne trajtuam 26 parashtesa produktive, aktive a atraktive që bashkë

³⁶ Po aty f. 344 dhe 348

³⁷ *Vepër e cit. A. Xhuvani - E. Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956).

me siparshesat aktive foljeformuese kapin shumë 35, që gjithsesi janë më shumë, jo vetëm se nëntë a *dhjetë* "prapashtesat e gramatikës", por edhe në krahasim me 17+1 prapashtesat e tjera "të reja" të identifikuar në punimin tonë. Së këtejmi del e nevojshme, pra, të bëhet sqarimi i konstatimit të dhënë në gramatikën tonë normative, ku thuhet se "*formimi prapashtesor është tipi më prodhimtar në grupin e foljeve të prejardhura*"³⁸, kundrejt formimeve me parashtesim e mënyra të tjera. Të jemi më të qartë, nuk është kontestues fakti, siç dihet, se në *sistemin emëror "ndër mënyrat e formimit të emrave, për nga prodhimtaria dhe shtrirja vendin kryesor e zë prapashtesimi"*³⁹ ndaj atij me kompozim e parashtesim, por lypset sqarimi, kur kemi të bëjmë me *sistemin foljor*, ngase në këtë sistem, siç e pamë, kur kemi parasysh raportin numror, faktet ndryshojnë. Kur themi *lypset sqaruar* kemi ndërmend kuptimin e togfjalëshit: **tip fjalëformues prodhimtar a produktiv** që sipas burimeve tona normative në vetvete del me kuptimin se mbulohet një shumësi operimi mjatesh e formash fjalëformuese, formime këto që mund të jenë **vepruese a aktive ose jovepruese a joaktive**,⁴⁰ prandaj konstatimi i mësipërm lidhur me foljet në raportin parashtesim/ prapashtesim duhet të pranohet me rezervë. Gjithsesi mbetet për t'u verifikuar e përplotësuar më mirë të dhënat, qoftë sa i përket prodhimtarisë, qoftë sa i përket shtrirjes a shumësisë.

Së dyti, edhe sa i përket karakterit veprues, d.m.th. aktivitetit të foljeve me formantet e caktuara të specifikuar a të specializuara, që ka lidhje gjithsesi edhe me prodhimtarinë e tyre, lypset një konstatim më i saktësuar. Siç u pa nga analiza edhe nga fusha e parashtesimit, ashtu si nga ajo e prapashtesimit paraqiten gjedhe standarde të përfillshme, sigurisht të formëzuara më përpara, por edhe aso në formim e sipër. Krahaso lidhur me këtë formimet me parashtesat (pa hyrë në siparshesata) **për-, ç-(sh-,zh-), stër-, shpër- lë-, ri-** e të tjera, në njërën anë dhe ato me prapashtesat **-O-, -zo-, -os-, -i/j** e të tjera, në anën tjetër. Siç doli nga analiza në FGJSSH më shumë folje dalin të regjistruara me parashtesën **për-** (236), e me alofonet **ç-(sh-, zh-)** (188) sesa me foljet e mirëfillta **-O-** me zgjerim e të tjera, të cilat sipas tabelave që paraqitëm në këtë punim gjithsesi dalin në numër më të vogël.

³⁸ Shih *Gramatika e gjuhës shqipe*, Morfologjia (1995), f. 344.

³⁹ Po aty, f. 132.

⁴⁰ Po aty f. 59 dhe *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976, f. 202.

Së treti, po ashtu edhe sa i përket specifikimit të nënfushave semantike që mbulojnë formantet përkatëse lypset sqarim, sepse raporti i foljeve me parashtesat e siparshesat: **shpër-, ri-, stër-, bashkë-, para-, vetë-** etj. ndaj disa foljeve me **-O-** me zgjerim (varianteve të foljeve të mirëfillta dhe të atyre (si)varianteve e të tjerave të diskutueshme) dhe me prapashtesata të tjera sa i përket nënfushave semantike a shkallëzimeve semantike e stilistike që mbulojnë, nga pikëpamja e prodhimtarisë, parashtesimi del më i larmishëm dhe më me shumësi të konsiderueshme gjedhesh. Prandaj edhe nga kjo pikëpamje lypset përplotësim.

Së katërti, është me interes që të shihet raporti i numrit të parashtesave autoktone ndaj prapashtesave anase, prandaj edhe një fakt i tillë duhet të kihet parasysh dhe të qartësohet më mire, ngase si duket më i madh del numri i parashtesave se i prapashtesave anase, pra,nga pikëvështrimi i karakterit burimor të tyre.

Së pesti, siç vërehet nga shembujt konkretë, në shqipen e sotme letrare, një numër i konsiderueshëm i foljeve me **-O-** formohet kryesisht sipas mënyrës me para-prapashtesim ose me para-sipraprashtesim njëherazi. Vetëm në FGJSSH dalin mbi 300 shembuj aktiv të regjistruar të foljeve më **-O-**, kryesisht sipas kësaj mënyre foljeformuese, pa i përjashtuar rastet kur parashtesata shtohet foljes më **-O-** drejtpërdrejt, prandaj edhe ky ndërfërkim duhet pasur parasysh.

Sidoqoftë, pa hyrë në hollësi të tjera, në analizën e karakterit veprues të tyre, tejdukshmëria cilësore dhe efektive e prapashtesimit më **-O-** është më e dallueshme dhe më me perspektivë dhe kjo nuk vihet në dyshim nga konstatimet që u bënë më sipër. Rikujto disa nga përkufizimet që ndërlihdhen me raportin rreth nënfushave semantike që mbulohet me parashtesim, qoftë me prapashtesim ose njëkohësisht me para-prapashtesim, ku elementi **-O-** është i papërcjashueshëm dhe transparent

Së fundi, kur kemi për bazë kretjt këtë që u tha deri këtu rreth shumë mësisë, autoktonisë, shtrirjes, prodhueshmërisë e veprueshmërisë, munc të themi se njohja dhe përtëllimi i njohurive rreth raportit: parashtesim prapashtesim në përqasje me foljet më **-O-** pa e me zgjerim, në kuadër të sis temit foljor të gjuhës sonë standarde kombëtare është jo vetëm i dobi shëm, por edhe i domosdoshëm, ngase me një veprim të tillë, jo vetëm d

të njihet më mirë, por edhe do të ndihmohet ndërsjelltazi konsolidimi i përdorimit të foljeve si me parashtesim, ashtu edhe me prapashtesim e para-prapashtesim njëkohësisht, ku folja më -O-, siç dihet dhe u vërtetua edhe në këtë punim, zë vendin më kyç ndaj të gjitha prapashtesave të tjera, por edhe sipas mënyrave të tjera të foljeformimit.

(III). Disa shembuj përfitim foljesh me formantet -O- (pa - e me zgjerim) mbi fjalë-tema të njëjta

Për të ridëshmuar dhe përforcuar ekzistimin, zhvillimin dhe perspektivën e formanteve -O- sinonimike (pa - e me zgjerim), të karakterit paronimik, më poshtë do të paraqitim tri grupe shembujsh karakteristike kategorish të ndryshme leksiko-gramatikore mbi fjalë-tema të njëjta që janë relativisht aktive në përditshmërinë tonë gjuhësore:

1) Nga fjalë-temat ndajfoljore (mbiemërore): kuq-, bardh-, ri- (i ri):

Gjithsej

raste:

- | | |
|--|---|
| a. kuq-: kuqon, kuqëlon, kuqërron; kuqëron, kuqëson; | 5 |
| b. bardh-: zbardhoj, zbardhëllon, bardhëson; | 3 |
| c. ri-: rinoj, rishtoj, risoj, ritoj; | 4 |

2) Nga fjalë-temat emërore: gurë-, sy-, erë-:

- | | |
|---|----|
| a. gur(ë)-: guroj, gurëztoj, gurëcoj, gurëtoj, gurëçoj, nguroj, gurënoj, ngurroj, ngurtësoj; ngurrëtoj, gurëzhoj(!) | 11 |
| b. sy- syjoj, synoj, syztoj; | 3 |
| c. er(ë)- eroj, erëmon, erëzon, ershoj, erëtoj, erëron; | 6 |

3) Nga fjalë-temat foljore: mund-, dridh-(em), et-(em):

- | | |
|---|---|
| a. mund-: mundoj, mundshtoj, mundësoj; | 3 |
| b. dridh-: dridhmoj, dridhtoj, dridhëroj; | 3 |
| c. et-: etohem, etshoj. | 2 |

Gjithsej 40

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, të cilët u volën kryesisht nga FGJSSH-ja, por edhe nga ndonjë burim tjetër (siç është edhe FGJSH 1954, Fjalori i K. Kristoforidhit etj.)⁴¹, nga secila fjalë-temë prodhuese dalin të përfutuara dy ose më shumë trajta foljore paralele më -O-,

⁴¹ Të gjithë këta shembuj janë ndeshur në burime të caktuara, përveç shembullit gurëzhoj, i cili m' u përfutua disi jo aq spontanisht sa asociacionisht nga shembulli gërzhjoj/ gërzhim.

edhe pse po mbi temën përkatëse mund të ekzistojnë edhe trajta të tjera, si p.sh. nga **kuq**: skuq, përskuq, lëkuq, kuqërris; nga **bardh**: zbardh, zbërdhul, lëbardh, zbardhëllej, zbardhëllij; nga **ri**: rij, përtërij, ripërtërij, përsërit(!) etj. Për të gjithë shembujt e sipërsënuar mund të thuhet me plot gojë se, jo vetëm që janë të kuptueshëm për çdo shqipnjohës, por edhe se janë në përdorim e sipër aktualisht në stile të caktuara në ligjërimin tonë, pragmatikisht të lejueshme.

Ndër këta 9 shembuj fjalë-temash kategorish leksiko-gramatikore të ndryshme dolën në përdorim 16 formante paralele sinonimike më -O- prapashtesore, të cilat ndërtimisht zbërthehen a deshifrohen me lehtësi në çdo rast të veçantë, siç shihet në tabelën vijuese:

Tabela e numrit të rasteve sipas shembujve të mësipërm

Nr. Prapashtesa	Shembujt	Raste gjithsej
1)	-O- kuqon, zbardhroj, guroj, nguroj; mendoj, eroj, etohem;	7
2)	-SO- kuqëson, ngurtësoj, mundësoj, rison, bardhëson;	5
3)	-TO- dridhtoj, ngurrëtoj, gurëtoj, ritoj, erëtoj;	5
4)	ZO- gurëzoj, syzoj, erëzoj;	3
5)	-NO- synoj, rinoj, gurënoj;	3
6)	-RO- dridhëroj; erëron, kuqëron;	3
7)	-RRO- kuqërron, ngurron;	2
8)	-SHTO- rishtoj mundshtoj	2
9)	-SHO- etshoj; ershoj	2
10)	-MO- dridhmtoj, erëmtoj;	2
11)	-LLO- zbardhëllon;	1
12)	-LO- kuqëlon;	1
13)	-CO- gurëcoj;	1
14)	-ÇO- gurëçoj;	1
15)	-JO- syjoj;	1
16)	-ZHO- gurzhoj (!)	1
Gjithsej		40 raste

Siç po shihet nga këto 9 fjalë-tema me ndihmën e 16 formanteve -O- prapashtesore, dolën 40 fjalë-folje të prejardhura, me të cilat dihet se

operohet në gjuhën tonë, të cilat, në të vërtetë, shprehin paronimisht nocione a nuanca konceptesh të ndryshme përkatëse stilistike a semantike, pa hyrë në mundësinë e zhvillimit polisemik që mund të ketë secila fjalë veç e veç, dhe pa hyrë në mundësinë që ka secila fjalë-folje për të formuar varg a fole (çerdhe) fjalësh të reja të prejardhura, të cilat pothuajse qëndrojnë me vijëzim të gatshëm e të qartë prodhues në saje të modeleve fjalëformuese që ndonjëri prej tyre është aq i përkapsëm në gjuhën tonë.

Nga tërësia e formanteve -O- me zgjerim mbi fjalë-temat, që shfrytëzuan si shembuj, në skicën tonë nuk i ndeshëm të zhvilluara vetëm këto formante prapashtesore foljeformuese: -KO-, -HO e -IZO-, të cilat dalin të shpjelluara në punimin tonë, prandaj e shoh të arsyeshme ta jap, sadopak, njëfarë sqarimi lidhur me këtë:

1) Kur kemi parasysh specifikën epentetike të përdorimit të prapashtesës -KO-, më qartë mbi tema onomatopeike të tipit *hejkon, mukon* ose të kuptimisësisë deminutive të kësaj prapashtese, gjithashtu daljen e prapashtesës -HO- më tepër mbi tema pasthirmore e raste të tjera si dhe të prapashtesës -IZO-, e cila del si përfitim a huazim libror, mosdalja e tyre mbi fjalë-temat nga shembujt karakteristikë të sipërsënuar mund të arsyetohet fare lehtë, sepse vetëm rastësisht nuk ka qëlluar fjalë-tema prodhimtare që do të kushtëzonte specifikisht daljen e formanteve të tilla.

2) Trajtnë më -ZHO- **gurzhoj**, që e shënova me pikëçuditjen, e *kam me të dëgjuar ose më mirë mund të themi se u "shpik" a më mire del e modofikuar* në bazë të fjalës **gërzhoj**, gërzhim. Siç është thënë më përpara, me fjalën gërzhoj gërzhim shprehet koncepti i ashpërsisë, sikur duart që i presin gurët e palatuar, prandaj për ne nuk do të ishte aspak befasi që edhe ajo të shfaqej e shpjeguar me shndërrimin e -U-së në -Ë- (gurëzhoj/ gërzhoj/ gërzhit), proces fonetik ky, i cili nuk është i panjohur në gjuhën tonë, si p.sh. i hidhur hidhëroj, i hedhur hedhëroj etj.

Mendoj se në kontekste a situata të caktuara s'ka pse të mos jetë e arsyetueshme dhe e qëndrueshme edhe dalja e foljes me prapashtesën -ZHO-, siç u cek më sipër. Të kihat parasysh shprehja e mundshme: "më gurëzohet trup i cek më sipër. Të kihat parasysh shprehja e mundshme: "më gurëzohet trup (zemra, shpirti) kur... (!)" etj. -ngase edhe kështu, pa kontekst, shprehja del mjaft e efektshme dhe gjithësi e kuptueshme, sepse me fjalë (folje) del tilla mund të pasqyrohet gjendja e rëndë shpirtërore e kumtuesit.

Sidoqoftë, shembujt e mësipërm si dhe krejt tema e trajtuar në këtë punim-sprovë, mund të na shërbejnë si shkas përsiatjeje për analiza të tjera edhe më të thukta për ta njohur edhe, gjithsesi, për ta shfrytëzuar mirë e më mirë tërë thesarin e sistemit foljor të trashëguar, që na dhurohet nga sistemi aktual që e ka gjuha jonë, ndonëse, siç mund të thuhet, ky thesar ende qëndron, pak a shumë, i pazbuluar, ashtu siç mund të kenë mbetur të pazbuluara dhe të pa shfrytëzuara edhe shumë thesare të tjera të lëndës së parë të nëntokës dhe të nënqiellit tonë kulturor, shpirtëror e lëndëzor.

Me fjalë të tjera, nëse njihet dhe favorizohen modelet e caktuara, siç u përpoqëm t'i paraqitnim në këtë punim-sprovë, sigurisht do ta kishim më të lehtë ballafaqimin me koncepte e me modelet formëzuese e fjalëformuese të gjuhëve të huaja, të cilat konsiderohen më të zhvilluara edhe nga aspekti i studimit ndaj gjuhës sonë.

(IV). Rezultatet nga trajtimi i kësaj teme nxitje dhe sfidë

Rreth përcaktimit të formanteve përkatëse si prapashtesa foljeformuese, sidomos për ato që nuk dalin të regjistruara në burimet e deritashme normëzuese, pos lexuesve të pasionuar e krijuesve që duhet ta vrasin mendjen, duhet të nxitet dhe të sfidohet e vërteta, sidomos nga studiuesit, të cilët duhet t'i kenë parasysh dhe t'i verifikojnë e ritrajtojnë e vlerësojnë dhe, pse jo, edhe t'i sendërzojnë rezultatet e konstatimet që dalin, jo vetëm nga ky punim-sprovë, por edhe më gjerë, sigurisht duke i pasur parasysh faktet si dhe kriteret që u trasuan këtu, siç janë:

- numri përkatës relativisht jo i vogël i foljeve të formuara sipas mënyrës së njëjtë fjalëformuese, është fjala sidomos për foljet me prapashtesat përkatëse të konstatuara që ende nuk dalin të përfshira dhe as të vlerësuara si duhet në burimet tona të deritashme normative;
- nënfusha e përcaktuar semantika e stilistike që mbulohet me foljet me prapashtesën përkatëse;
- konstatimi i ndërferkimit, i sinonimisë (të karakterit paronimik) dhe i kundërvënies së prapashtesave të tilla, si në kuadër të nënstrukturës foljeformuese brendapërbrenda foljeve më -O- (pa -e me zgjerim), si dhe në kuadër të strukturës së përgjithshme prapashtesore dhe të atyre prapashtesore e mënyrave të tjera foljeformuese, në kuadër të sistemit foljor të shqipes;
- vlerësimi e verifikimi i modeleve foljeformuese ekzistuese si dhe prirja e përfitimeve të caktuara, jo vetëm në vijëzimin e strukturës foljeformuese të shqipes, por edhe në raport me sistemin foljor të gjuhëve të tjera.
- rëndësia sociolinguistike e një veprimi të tillë, jo vetëm për gjuhësinë shqiptare, por edhe për vetë shqipfolësit e, në veçanti, për krijuesit e të gjitha profileve, por sidomos për ata të krijimtarisë letrare.

Nga krejt kjo që u tha deri këtu, rezulton se prapashtesat -O- pa zgjerim si ato -O- me zgjerim: të mirëfilltat (-ro-, -to-, -llo-, -so-, -zo-), (si)variantet e tyre (-no-, -mo-, -rro-, -lo-, -izo-, -co- si dhe formantet e tjera të diskutueshme (-ko-, -sho-, -shto-, -ço-, -zho-, -ho-, -jo-), faktikisht, zënë vend të rëndësishëm në strukturën e përgjithshme foljeformuese brenda sistemit foljor të gjuhës shqipe, ndonëse ende nuk dalin të shënuara e të

squara si e sa duhet në burimet tona normative. Gjithsesi, vendi i tyre në sfondin e strukturës foljeformuese do të jetë edhe më i konsoliduar pasi të njihen, të përqafohen e përpunohen më në hollësi nënfushat e caktuara semantike që mbulohen a prirën të mbulohen me foljet me formantet e tilla. Materiali lidhur me këtë që u paraqit këtu si provë, edhe pse kërkon plotësim, në raste të caktuara mund të shërbejë edhe si provë, gjithsesi, e argumentuar, së cilës kemi bindjen se e ardhmja jo e largët do t'i japë vullën dhe vlerën merituese.

Me fjalë të tjera, nga lënda e vjelë dhe e sjellë në këtë punim del se prapashtesat -O- me zgjerim, jo vetëm ato që janë cekur në burimet tona normative, mirëfillësia e të cilave edhe këtu u sfocua se del e drejtë, por edhe të tjerat paraqesin një thesar paksa të fshehur ose një lëndë të parë jo të njohur aq deri tash, por e hetuar fare mirë nga individë të caktuar gjatë rrugës së tyre studimore nga këndvështrime të ndryshme e që këtu vetëm sapo shpërfaqet a sistematizohet tërë ai material, por në mënyrë paksa më të plotë. Kjo lëndë e parë e hetuar jo vetëm prej nesh, siç mund të thuhet në zhargonin e fushës ekonomike, po që se eksplorohet a shfrytëzohet profesionalisht, qoftë nga krijuesit shkencorë e ata letrarë, qoftë nga ekspertët e gjuhës e të tjerë, me siguri, për kulturën tonë gjuhësore nuk do të thotë pak.

Me fjalë të tjera, kam bindjen se ky thesar po që se përpunohet me fare pak mjeshhtëri e përkujdesje do t'i japë gjuhës sonë, më mirë me thënë, të gjitha stileve funksionale të saj, jetë e gjallëri si asnjëherë më parë. Këtë e themi me plot gojë dhe me vetëbesim, kur kemi parasysh faktin se elementet prapashtesore e parashtesore dhe vetë foljet ndihmojnë mrekullisht shtrirjen, nuancimin dhe intensitetin stilistik e kuptimor të shprehjes shqipe. Kujto edhe prejfoljet mbi këtë bazë që varësisht nga momenti, situatat dhe rrethanat e caktuara, gjuhën tonë e pasurojnë automatikisht në mënyrë të pakrahasueshme. Mjaft fjalë-shembuj që momentalisht dalin të paregjistruar në fjalorët përkatës dhe burimet e tjera normative, qëndrojnë si pjesë të fondit të rezervës, përkatësisht qëndrojnë në vendshërbesën e nënvetëdijes sonë gjuhësore si lëndë e gatshme, të cilën, nëse dimë dhe duam ta (ri)aktivojmë, do të na ndihmonte shumë në përplotësimin më me lehtësi të të gjitha nevojave që shtrohen para nesh, para nënstrukturave shprehëse të sistemit foljor të shqipes, përkatësisht do të ndihmonin që shprehja

në shqipë të dalë sa më e plotë dhe e saktë, siç u tha, sipas nënfushave të caktuara semantike.

Sa për ilustrim, duke kërkuar të rikujtohen edhe shembuj të tjerë, si me thënë në prodhimin serik, t'i vëmë në pah trajtat e prejardhura foljore nga këto katër fjalë-tema: **kripë-**, **udhë-**(rrugë-), **flakë-** dhe (i) **madh-**:

- 1) kripë-: krip (kripos), kripoj, kripësoj, (kripshtoj), kripëzoj;
- 2) udhë- a rrugë-: (për)udh, udhoj a rrugoj (udhos a rrugos, udhëtoj a rrugëtoj, udhëzoj, udhakoj);
- 3) flakë-: flak (mflak), përfllak, shpërfllak, tejflak, flakoj (flakos, flakëzoj, flakështoj), flakësoj, flakëroj, flakërij, flakërit.
- 4) madh-: madh/em, madhoj, stërmadhoj, zmadhoj, madhëroj, madhnoj, madhështoj, madhëtoj (madhësoj, madhëzoj).

Të gjitha trajtat e mësipërme, që dalin të shënuara në burimet përkatëse i takojnë modelit përkatës fjalëformues, duke pasur mbështetje edhe nënfushën e përcaktuar semantike që e mbulojnë a prirën ta mbulojnë. Si pjesë të rezervës nga shembujt e mësipërm, tash për tash, mund të konsiderohen trajtat e shënuara brenda kllapash, mirëpo edhe të tjera si ato që nuk u shënuan prej nesh, kanë mundësi të shfaqen në praktikë, varësisht nga intensiteti a nënfusha e caktuar semantike e stilistike që synohet të shprehet. Vetë nevoja e shprehjes arsyeton "lindjen", ekzistimin dhe fuqizimin e formave të caktuara në kuadër të modelit përkatës dhe modeli mundëson përfundimin e shirë të pakufizuar të trajtave përkatëse, si të themi, të prodhimit serik.

Duke u nisur nga fakti se çdo gjë që lind në gjuhë lind nga nevoja, për mendimin tonë thjeshtësimi i elementeve të tilla, veç rasteve të përzgjedhjes së trajtave të caktuara në stilin zyrtar thjesht administrativ, do t'i sillte varfëri sfondit të përgjithshëm të shprehjes së shqipes standarde. Pikërisht prapashtesat foljore sipas nënfushave të caktuara semantike që mbulojnë, që u trajtuan në këtë punim, janë ato që mundësojnë një laryshmi më të madhe dhe efektive për të shprehur, si intensitetin e caktuar stilistik ashtu edhe nuancimet semantike më të hollësisht të sfondit të mozaikut tonë gjuhësor.

Për studiuesit e gjuhës shqipe, duke pasur parasysh të mbërrimit e mëdha që janë bërë deri më sot, qoftë në kristalizimin e të dhënave gramatikore, qoftë të shkencave të tjera albanologjike përgjithësisht, tema "Foljet më -O- në gjuhën shqipe", si shtyllë kurrizore e sistemit verbal të *mbasaj*, mbase nuk sfidon shumë, por për ta nuk do të jetë pa interes përmbasajja e këtij punimi, ngase këtu për të parën herë, me sa dihet, në njëfarë mënyre, bëhet përpjekje për paraqitje të plotë të sistemit fjalëformues verbal të shqipes, ku folja më -O- (pa- e me zgjerim), si tip i veçantë, vërtet zë vend kyç. Do t'u interesojë patjetër studiuesve dhe të tjerëve për risimet që dalin për të parën herë sheshazi në këtë punim e që si më të dukshmet janë:

Së pari, numri relativisht i plotë i prapashtesave dhe parashtesave. Dihet fakti se në gramatikën normative të letrarishtes së sotme njihen vetëm 6 formante prapashtesore të foljeve të zgjedhimit të parë të nënklausës më -O-, që janë: *-o-, -ro-, llo-, -to-, -so-, -zo-* si dhe 3 të foljeve të zgjedhimit të dytë: *-s/-is-, -it dhe -os*, ndërsa në këtë punim-sprovë, grupit të parë i janë shtuar edhe 13 +2 formante të reja të pacëkura veçmas më përpara që janë 6 të ashtuquajtura (si) variante të prapashtesave të mirëfillta të -O-së me zgjerim: *-no-, -mo-, -rro-, -lo-, -co-, -izo-* dhe 7 formante të tjera të diskutueshme të -O-së me zgjerim: *ko-, -sho-, -shto-, -ço-, -zho-, -ho-, -jo-*, se dhe *-l/j-, -e/j-*, po mbi bazë të temës zanore a togzanore, kurse për grupin tjetër gjithashtu dolën të hetuara dy formante të reja prapashtesore: *-AS dhe -AT*, majde edhe *-S* duke i ndarë alomorfort më drejt variantet *-s e -IS*, që do të thotë se në këtë punim-sprovë "u zbuluan" apo u argumentua ekzistenca e 17 (+1) formanteve të reja foljeformuese, që gjithsej numri i tyre arrin në 27.

Së dyti, u konstatua se të gjitha prapashtesat fjalëformuese, kryesisht më -O-, priren të mbulojnë nënfusha të caktuara semantike e stilistike, fakt ky që bën se ato, në të ardhmen, do të jenë më të vëzhguara dhe kristalizimi i tyre për nënfushat përkatëse semantike e stilistike do të jetë më i qartë dhe më i ndërgjegjësuar dhe së këtejmi edhe numri i foljeve me formantet e caktuara do të shënojë rritje ose ndonjëri formant mund të pësojë edhe reduktim. Kjo vlen për të gjitha prapashtesat, por sidomos, siç u tha, për foljet më -O- pa -e me zgjerim.

Së treti, tërë struktura foljeformuese prapashtesore u pa, gjithashtu, në raport me parashtesat foljeformuese, të cilat janë numerikisht më shumë nga prapashtesat Madje u prek paksa edhe përkueshmëria e formave parashtesë/prapshtesë si p.sh. *lë- me -lo-, për- më -ro-, të- me -to-, rrë- me -rro-, kë- me -ko-* etj. si dhe me sindajshesat e kompozitat foljeformuese, duke u vënë në spikamë parashtesat e siparashtesat ashtu edhe prapashtesat e siprapashtesat më vepruese e prodhimtare, duke përfunduar me sfidën se lënda e tillë e paraqitur, edhe pse jo e plotë, duhet pasur në konsideratë për të mëturjeshmen dhe nëse kjo punë ndërgjegjësohet sa më parë, aq më mirë do të jetë, ngase, vërtet, për mendimin tonë, ka vlerë edhe teorike shkencore, por edhe më shumë praktike gjuhësore me interes të pakrahasueshëm shoqëror.

Me fjalë të tjera, me shfrytëzimin me vend të të gjitha elementeve foljeformuese (edhe të 17 formanteve "të reja", gjithsesi ekzistuese), siç u vu në pah në këtë punim-sprovë, gjuha jonë do të jetë edhe më e aftë dhe më e aftësuar për të kryer funksionin e vet shumëdimensional, qoftë në rrafshin brendakombëtar, qoftë në raporte ndërkombëtare dhe njëherazi do të radhitej ndër gjuhët me formante të zhvilluara foljeformuese me mundësinë e specifikimit dhe të specializimit të tyre sipas nënfushave të caktuara semantike. Është e vërtetë se modelet e qëndrueshme fjalëformuese, në mbështetje të elementeve të specializuara fjalëformuese janë karakteristike e çdo gjuhe të zhvilluar dhe të përpunuar, prandaj me pak më shumë përkujdesje e përkushtim, gjuha jonë mund të arrijë kualifikimet e dëshiruara.

Duke përfunduar po tregoj se gjatë punës kam pasur parasysh mendimet e dy mësuesve tanë të mëdhënj të gjuhës shqipe, së pari të prof. Eqerem Çabej, i cili na mësonte se

*"vetëm kur gjuha kundrohet në tërësinë e saj të pandarë, me fjetet e ndryshme që kanë endur pëllhurën e formimit të saj, me degëzimet, formimet e reja "krijimet elementare" e të tjera që ka përfutuar, duke u liruar nga skemat e vjetra, vetëm atëherë kuptohet gjallëria e vitaliteti i saj në hapësirë e kohë"*⁴²

dhe së dyti të prof. Androkli Kostallarit, i cili porosiste që:
"shkrimtari (lëvruesi) me vetëdije të lartë shkencore dhe i frymëzuar nga dashuri e zjarrtë për gjuhën (amtare) nuk duhet të shfrytëzojë

⁴² Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë 1986 f. 228.

vetëm ato mjete të shprehjes së fondit themelor të asaj që duken në sipërfaqe, por duhet të depërtojë edhe në shtresat e thella të saj, të njohë aftësitë potenciale krijuese, ripërtëritëse të saj...dhe të arrijë e të vërë në pah vlerat që fshihen në gjirin e saj, atëherë, vetëm atëherë edhe gjuha i shpërblen pikërisht ata që e duan dhe e nderojnë".⁴³

Prandaj edhe unë në mbështetje të këtyre mësimëve - porosi, natyrisht i prirë nga dashuria për gjuhën, pa e pritur dhe pa e ditur sesa dhe si do të jetë shpërblimi i saj, jo vetëm për mua, por për tërë adhuruesit e saj në përgjithësi, u përpoqa ta bëj një punë të ndërgjegjshme, së paku në të shtruarit e problemit të foljeve më -O- në kuadër të sistemit verbal të gjuhës sonë, prandaj shpreh gjykimin se nëse në përpjekjen time kam arritur sadopak ta paraqit çështjen, jo vetëm sipërfaqësisht dhe të arsyetoj ekzistimin, pos tjerash, të prapashtesave (si) variante të prapashtesave të mirëfillta "-O- me zgjerim" (-no-, -mo-, -rro-, -lo-, -co-, -izo-) si dhe të prapashtesave të tjera sinonimike të diskutueshme (-ko-, -sho-, -shto-, -ço-, -zho-, -ho-, -jo-), gjithsej 13 sosh dhe sidomos mundësinë a prirjen e vijëzimit të të gjithave sipas nënfushave semantike, atëherë do të ndieja lehtësi, ngase synimin që i vura vetes për të shtruar në analizë këtë temë do ta konsideroja të plotësuar.

Gjithashtu i bëj si të miat konstatimet e tre gjuhëtarëve tanë bashkëkohës, zotërinjve: prof. Ali Dhrimos, prof. Xhevat Lloshit dhe prof. Mehmet Çelikut.

1. Prof. Ali Dhrimo, për një rast të ngjashëm, pikërisht duke bërë fjalë për çështje brenda sistemit foljor të shqipes, konstatonte: "*Diskutimi dhe sqarimi i këtyre çështjeve si edhe i shumë të tjerave do ta ngrejë edhe më tej kulturën tonë gjuhësore dhe do ta bëjë edhe më të qartë strukturën e sistemit foljor, edhe më të përpiktë përdorimin e trajtave të ndryshme foljore në gjuhën tonë letrare*".⁴⁴

2. Ndërsa prof. dr. Xhevat Lloshi nga një pikëvështrim më i gjerë shprehet: "*Tabloja e realitetit është tepër e ndërlikuar dhe vetë njohja është gjithmonë një kërkim i papërfunduar*" mirëpo "*nxjerrja në pah e një pro-*

blemi, formulimi i tij me fjalë, është hapi i parë kryesor për ta trajtuar dhe për ta zgjidhur atë" dhe në këtë kontekst për ne, del qartë roli i njëzimit të shqipes standarde kombëtare të përbashkët, sepse "*njësia e gjuhës është e domosdoshme që ajo të luajë rolin shoqëror e kulturor në shkallë gjithëkombëtare, të sigurojë trashëgiminë e pandërprerë pa shkëputje të ndjeshme midis brezave ose shtresave të popullsisë...*", ku kuptohet, edhe sipas nesh, se bën pjesë edhe tërë sistemi fjalëformues ekzistues i shqipes ende jo i studiuar sa duhet, i cili kërkon zgjidhje po në këtë kuadër të shqipes standarde, kur dihet mirëfilli se tashmë s' kemi të bëjmë me vendosje a rivendosje që nga fillimi të normës, por kemi të bëjmë me çështjen "*e përsosjes dhe të pasurimit të sistemit të gjuhës letrare (e ngulitjes së normës standard*"⁴⁵, dhe në këtë kuadër "*për të shmangur pohimet absolute*" duhet të "*shfrytëzohen nuanca të holla të modalitetit të foljeve*", dhe se "*prania e dy prirjeve të kundërta njësisë dhe variacionit*" duhet kuptuar si një "*forcë lëvizëse e zhvillimit dhe e lëvrimit të gjuhës, si tashit si në të ardhmen*".

3. Gjithashtu parapëlqej dhe i bashkohem mendimit të prof. Mehmet Çelikut, i cili është mjaft konkret kur shprehet se "*shqipja standarde*", përveç "*disa elementeve të nevojshme që ka marrë nga areali verior*".. "*të tjera elemente duhet të integrojë në të ardhmen*", d.m.th. disa "*gegizma e kosovarizma duhet të gjejnë vendin që u takon në standard*", ngase, në këtë mënyrë ndihmohet "*jo vetëm kristalizimi i gjuhës letrare, por edhe përsosja, pasurimi e zhvillimi i saj*"... "*e kuptueshme*" se është fjala për një kërkesë të ligjshme a për një "*diskutim konstruktiv, në asnjë mënyrë përmbyës, po vetëm plotësues, përmirësues*" sepse jemi të vetëdijshëm se "*gjuha letrare e njësuar përbën thelbin e unitetit dhe të identitetit kombëtar, ajo është treguese dhe mburojë e kombit*".⁴⁶

Ky ishte ndër të tjera edhe objektivi i punimit tonë, që në pika të caktuara edhe u prekën çështje të kësaj natyre.

Sigurisht mbetet detyrë e hapur para intelektualëve tanë në përgjithësi e para gjuhëtarë dhe krijuesve letrarë e shkencorë e të tjerë, në ve-

⁴³ Prof. Androkli Kostallari, *Seminari XV/89*, Prishtinë 1995, f. 62.

⁴⁴ Ali Dhrimo, *Probleme të normës letrare në sistemin foljor të gjuhës letrare shqipe*, PAGJSH, Prishtinë 1983, f. 176.

⁴⁵ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë 1999, f. 346, 192, 147.

⁴⁶ Shih: M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2001, f. 32, 106, 113.

çanti, që t' i shfrytëzojnë të dhënat e konstatimet që dolën të ofrueshme në këtë punim dhe të shpiejnë më tej zbardhjen e çështjeve të diskutueshme të saposhtuara.

Gjithsesi priten punime edhe më të thelluara, qoftë të karakterit të përgjithshëm, qoftë për tema të veçanta, të cilat në këtë punim vetëm sa u cekën. Nëse kjo lëndë trajtohet edhe në raport me strukturat foljore të gjuhëve të huaja, sigurisht vetë kuptimi dhe konsolidimi i nënfushave semantike në gjuhën tonë do të jetë edhe më i qartë dhe më i kristalizuar.

Përfundim

Si për çdo strukturë gjuhësore edhe për strukturën foljeformuese me prapashtesim në kuadër të sistemit foljor të shqipes del e nevojshme të bëhen studime më të thelluara, dhe kjo u provua të bëhet në këtë *punim-sprovë*, siç u quajt fillimisht, për foljet më -O-, që është tipi bosht i sistemit foljor të shqipes. Këtu, në të vërtetë, më gjerësisht e më hollësisht se asnjëherë më parë, në mënyrë të veçantë, u bë trajtimi i **foljeve më -O- pa -e me zgjerim**.

Së pari u trajtuan foljet më -O- pa zgjerim, ato të parme, pa temë të qartë prodhuese si dhe ato të prejardhura, me temë të qartë prodhuese, të cilave iu bashkuan edhe foljet nën ndikimin e participit latin dhe

së dyti, u trajtuan mjaft intësisht foljet me formantet -O- me zgjerim, të cilat u paraqiten si strukturë më vete duke u ndarë në tri grupe:

1. foljet më -O-, pos atyre pa zgjerim, dalin edhe me zgjerim, me formantet: -RO-, -LLO-, -TO-, -SO- dhe -ZO-, të cilat këtu u quajtën prapashtesa të mirëfillta, sepse dalin të pranuar si të tilla në burimet përkatëse të gjuhës letrare shqipe;

2. foljet më -O- me zgjerim të formuara me formantet (si) variante të prapashtesave të mirëfillta: -NO-, -MO-, -RRO-, -LO-, -IZO- dhe -CO-, të cilat, edhe pse nuk paraqiten veçanërisht në burimet e caktuara normative, në të vërtetë, janë të pranishme në realitetin tonë gjuhësor, të cilat edhe kanë ndërfërkime a njëfarë ndërlidhjeje origjinore me formantet e grupit të parë;

3. foljet më -O- me zgjerim me formantë të tjera të diskutueshme: -KO-, -SHO-, -SHTO-, -ÇO-, -ZHO-, -HO- dhe -JO-, të cilat edhe pse fun-

ksionalisht kryejnë detyrën e formantit të mirëfilltë prapashtesor, nuk dalin të shënuara veçanërisht në asnjërin nga burimet e derisotme normative të gjuhës sonë letrare, ndonëse ndonjëra prej tyre nuk del e pahetuar nga studiuesit e caktuar të gjuhës sonë.

Ç'është e vërteta, në gramatikën e Akademisë (1976) bashkë me prapashtesën -O-, vetëm sa janë shënuar 5 formantet e grupit të parë (që këtu, siç u tha, u quajtën prapashtesa të mirëfillta sinonimike, mirëpo ekzistimi dhe qëndrueshmëria e formanteve të tilla, të (si) varianteve të tyre dhe të formanteve të tjera të diskutueshme, siç provohet në këtë punim, nuk mund të mohohet. Shembujt nga praktika jonë gjuhësore e dëshmojnë këtë fakt.

Edhe pse mbesin mjaft gjëra të diskutueshme, siç është edhe kriteri i vlerësimit individual e institucional etj., nga analiza del mjaft qartë vijëzimi dhe përcaktimi i nënfushave semantike që mbulojnë a prirjen të mbulojnë foljet me formantet prapashtesore përkatëse për secilin nëntip të foljeve veç e veç. Kështu, ndërsa foljet më -O- pa zgjerim, që një shumicë del e përfutur nga procesi i huazimit, karakterizohen zakonisht me të shprehurit e procesit të shkallës së parë të ndërlkueshmërisë (procese të ashtuquajtura mekanike), me foljet -O- me zgjerim (që pothuajse të gjitha janë autoktone, zhvillime të brendshme të shqipes) ose shprehen procese të specifikuar ose shprehet gjithsesi ndonjë intensitet i veçantë, duke shfaqur, në një farë mënyre, ndonjë shkallë tjetër të ndërlkueshmërisë. Gjithsesi, disa formante, diku më shumë e diku më pak, japin shenja specifike me prirje specializimi për nënfusha të caktuara semantike e stilistike.

Ç'është e vërteta, ky vijëzim stilistik e semantik del edhe më qartë, në kuadër të sistemit verbal të shqipes, jo vetëm në ndërprerjet e formanteve të foljeve më -O- me e pa zgjerim ndërmjet tyre, por edhe në krahasim me formantet e tjera foljeformuese, qoftë me prapashtesa të tjera, qoftë me prapashtesa e fjalëpërbërje.

Gjithsesi, lënda e shtruar në këtë punim do t' u shërbejë gjuhëtarëve tanë si sfidë dhe nxitje për t' u marrë me zgjidhjen e çështjeve të shtruar, që ndërlidhen me emërtimin sa më drejt të proceseve tekniko-teknologjike e të tjera, aq më tepër, tashti kur nevojat për një punë të tillë janë gjithnjë në rritje, qoftë për nevoja mbarëkombëtare, qoftë edhe ato në raport me gjuhët e kulturat e tjera, si në rrafshin e përgjithshëm kulturor,

ashtu edhe në fushën e zhvillimit tekniko-teknologjik, në veçanti. Themi *zhvillimi tekniko-teknologjik*, ngase dihet fakti se pikërisht "gjuha teknike" është ajo, më e dallueshja ndër të tjera, që shton dhe shtron nevojën me transparencë të dukshme për emërtime të reja dhe sa më me saktësi të proceseve tekniko-teknologjike në çdo gjuhë të botës, ashtu si edhe në gjuhën tonë, procese këto të cilat shprehen zakonisht me folje a me prejfoljorë të caktuar.

Nga analiza e të gjitha këtyre formanteve, përkatësisht të foljeve me prapashtesat përkatëse -O- (pa zgjerim e me zgjerim), qoftë të mirëfilltat: **-ro, -llo, -to, -so, -zo**, qoftë (si) variante të tyre: **-no, -mo, -rro -izo, -co** ose formantet e tjera të diskutueshme: **-ko, -sho, -shto, -ço, -zho, -ho, -jo**, që u trajtuan mjaft në hollësi në tre krerët e parë të këtij punimi, siç rezultojnë edhe nga konstatimet përmbledhëse, por edhe në përfaqje me formantet e tjera foljeformuese (prapashtesa e parashtesa), siç u trajtuan në kreun e katërt, mund të dalin këto konstatime, të cilat po i cekim më poshtë fare shkurtimisht:

Së pari, foljet më -O- pa zgjerim, pa ose me temë të qartë prodhuese, (pa përfashtuar rastet e veçara) prirën të shprehin procese të caktuara të ndryshme, por edhe aso tekniko-teknologjike kryesisht të ndërlikueshmërisë së shkallës së parë, siç janë b.f. proceset e ashtuquajtura: **proceset mekanike** të llojlojshme. Shkallë e ngjashme (pa përfashtuar karakterin paronimik) sa i përket intensitetit të ndërlikueshmërisë së veprimit shprehet edhe me foljet me prapashtesat -HO, -JO -NO, -TO pjesërisht), me infikset fundore IFIK/O-, -IZ/O-, -ATIZ/O-, e -IR/O- (të huazuara) e më pak me prapashtesa të tjera, ku tema e qartë fjalëformuese motivon procesin e caktuar.

Së dyti, foljet më -ZO- zakonisht prirën të shprehin procese tekniko-teknologjike të një shkalle të lartë të ndërlikueshmërisë, siç janë b.f. **proceset teknologjike kimike** e të **ngjashme**, procese këto ku tema fjalëformuese, si me thënë, pëson shndërrim substance, dhe sipas kuptimit neutral, nuk ka të bëjë aq me botën e brendshme të njeriut.

Së treti, me të gjitha foljet me prapashtesat e tjera siç janë -RO, -LLO, -SO, pastaj -MO, -RRO, -LO, -CO, -SHO, zakonisht shprehet një intensitet stilistik a ngjirim kuptimor me shkallëzime të caktuara, duke dhënë

edhe ngjyrimet stilistike e semantike të llojlojshme, qoftë më të butë, siç janë foljet me prapashtesën përkatëse: -LO, -RO e -SO, qoftë të një intensiteti më të fortë (gjithsesi më të ntrusur) siç dalin foljet me prapashtesat përkatëse: -RRO, -ZHO, -LLO, pastaj edhe ato të karakterit deminutiv, siç janë foljet me prapashtesat: -KO, -SHO, -CO, -ÇO.

Së katërti, vihet re foljezimi i onomatopeve me prapashtesat -LLO, -KO e ndonjë tjetër si dhe të pasthirmave me -HO.

Së pesti, me foljet me prapashtesat: -SHTO, -ZHO, -RRO shprehen procese që tregojnë koncepte shtimi, teprie, gjithsesi të një ekspresiviteti shkallëzues të theksuar.

Së gjashti, nga përfaqja e formanteve më -O- (pa - e me zgjerim) me formantet e tjera prapashtesore foljeformuese si me prapashtesat e mirëfillta: **-s/-is, -it** dhe **-os** të cekura në gramatikën normative të gjuhës sonë si dhe në ato që dolën nga analiza e bërë prej nesh: **-i/j, -e/j** (mbi temë në zanore a togzanor), **-as** dhe **-at** (mbi temë në bashkëtingëllore), u pa më mirë sadokudo raporti ndërferkues e ndër këmbës të tyre në sfondin e mozaikut të përplotë të strukturës foljore në gjuhën tonë dhe sidomos specifikimi i formanteve të caktuara në mbulimin e nënfushave përkatëse semantike e stilistike në krahasim me foljet më -O- (pa - e me zgjerim).

Së shtati, në raportin e foljeformimit me parashtesa dhe me prapashtesa dalin konstatime që lypset përsqaruar, rishikuar, madje edhe rivlerësuar në burimet tona normative disa nga konstatimet e deritashme, siç është çështja e shumësisë së parashtesave ndaj prapashtesave foljeformuese, çështja e specifikimit të fomanteve përkatëse (parashtesore e prapashtesore), sipas nënfushave semantike e stilistike që mbulojnë si dhe mundësia e paralelizmit të disa parashtesave dhe prapashtesave përkatëse në aspekte të ndryshme semantike e stilistike si dhe nga ana formale metatezore që del hetueshëm ndërmjet formanteve përkatëse si: **për- (pë-) me-ro- e -o-, lë- më -lo-, rrë- me -rro-, s- me -so , k(ë) me -ko-** e ndonjë tjetër. Sidoqoftë, vitaliteti i foljeve më -O- del edhe më i qartë në kuadër të kësaj analize.

Nga sa u tha më sipër, mund të nxjerrim si përfundim të përgjithshëm se nëse ndërgjegjësohen prirjet e vërejtura më përpara si dhe ato të sapovërejtura në këtë punim-sprovë për favorizimin e prapashtesave

përkatese foljeformuese sipas nënfushave të caktuara semantike (të karakterit paronimik), vërtet ky fakt për gjuhën tonë do të ishte me shumë interes dhe me vlerë, ngase, struktura e formimit të foljeve me prapashtesim dhe me formante e mënyra të tjera në veçanti, do të dilte në të ardhmen, sigurisht edhe më e konsoliduar. Gjithsesi formantet e caktuara do të dilnin më pak të ngarkuara me kuptimësi polisemantike të karakterit homonimik dhe njëherazi për mjaft ndajshtesa të huaja infiksore (si: -IFIK-, -IZ-, -ATIZ-, -IR-) do të pushonte nevoja në masë të madhe, mbase për ndonjërin prej tyre nevoja do të mund të shuhej fare.

Gjithsesi njohja me gjendjen reale të sistemit foljor të shqipes dhe mundësitë që jep ai do t' u ndihmojnë studiuesve, krijuesve dhe domosdo të gjithë shqipfolësve në përgjithësi të të gjitha profileve, për t' u qasur kësaj çështjeje në mënyrë më të thelluar për të arritur kështu rezultate edhe më të mira në përvetësimin dhe shfrytëzimin e tërë thesarit gjuhësor që na dhurohet si trashëgim nga gjuha jonë.

Kemi bindjen se nëse njihen, shfrytëzohen e favorizohen trajtat foljore, sipas nënfushave të caktuara semantike, siç u theksuan në këtë punim, në bazë të specifikimit me prirje specializimi të ndajshtesës fjalëformuese të caktuar, sidomos kur kemi parasysh faktin se pothuajse të gjitha foljet e formuara më -O- me zgjerim, mbështeten mbi fjalë-tema të gjuhës shqipe (qoftë autoktone, qoftë të përvetësuarra me kohë), siç u trajtua në këtë punim, atëherë gjuha jonë do të mund të radhitej dhe të cilësohej si gjuhë me zhvillim të lartë të sistemit foljor fjalëformues autokton.

Dr. Nuhi Veselaj

VERBS WITH Q IN ALBANIAN

SUMMARY

Similar to any other language structure, the Albanian verb system needs to be studied in details concerning its verb-formation structure with suffixation. This preliminary study is a temptation work in analysing the verbs with q, which present a crucial type of the verb system of the Albanian language. In this study, indeed, a more profound and detailed analysis more ever before is carried out, in particular, the study of the verbs with q, with and without derivation.

First, here were studied the verbs with q without derivation, primary ones, without a clear productive stem and the derived ones, with a clear productive stem, which are joined by verbs under the influence of the Latin participle, and

Second, the verbs with q with derivation have been studied in details. They appeared as a separate structure and were divided into three groups:

1. The verbs with q, beside those without derivation, emerge also with derivation, with formants: -ro-, -llo-, to-, so-, zo-, which are here called genuine suffixes, because they emerge accepted as such in respective sources of the standard Albanian language.

2. The verbs with q derived with formants as variations of the genuine suffixes: -no-, -mo-, rro-, lo-, izo- and -co-, the ones which despite not

being presented separately in the normative specified sources, actually are present in our language reality, the ones that have some inner frictions or a kind of an origin relation with the formants of the first group.

3. The verbs with *o* derived by other disputable formants: -ko-, -sho-, -shto-, -co-, -zho-, -ho- and -jo-, which despite playing the role of the genuine suffixation formant, do not appear as specifically marked in any of the normative sources of our standard language, though none of them appears unobserved by the certain scholars of our language.

As a matter of fact, in our normative grammar (1976), only 5 (five) formants of the first group were mentioned with the suffix *o*, as were here called genuine synonym suffixes, but the existence and persistence of such formants, of their variations and other disputable formants, as it is proved in this preliminary study, cannot be denied. The examples of our language practice manifest this fact.

Even though a lot of issues remain disputable, such are also the criteria of the institutional and individual evaluation, etc. From the analysis, the outline and determination of the semantic subdivisions that cover or are biased to cover the verbs with respective suffix formants for each subgroup separately become quite clear. Therefore, while the verbs with *o* without derivation appear to be productive in a large number from the process of borrowing and are usually characteristic for the expression of the process of the first scale complexity (therefore called mechanical processes), the verbs with *o* with derivation (that are mainly autochthonous, internal developments of the Albanian language), or specified processes or some internal intensity is expressed, show in a way another scale of complexity. However, some formants, somewhere more and elsewhere less, give signs of specification with an inclination to specialization for certain semantic and stylistic subdivisions.

What appears to be true is that this semantic and stylistic outline, becomes clearer within the verbal frame of the Alb. Language, not only on the approach of the formants of the verbs that end in -*O*- with and without width between itself, but even in comparison with other verb forming formants, whether they be with other suffixes or with prefixes and word composition.

Nevertheless, the issue presented in this preliminary study will serve to our linguists as a challenge and stimulation to get interested in finding solutions to those questions which are interlinked in finding more appropriate technical and technological processes, even more now when the need for such a task is increasing, be that for the entire national need or in relation to other languages and cultures, or in general cultural field, and also in the field of technical and technological development in particular. We say technical-technological developments because "technical terminology" is the distinguished one that makes and urges the need with clear transparency for new and more accurate denominations of the technical and technological processes in every other language in the world, therefore in our language as well, which are usually expressed with certain verbs or verbal forms.

From the analysis of all these formants, respectively of the verbs with *o* (with and without derivation), be they genuine: -ro-, -to-, -llo-, -so-, -zo-; or their variations: -no-, -mo-, -rro-, -izo-, -co-; or other disputable formants: -ko-, -sho-, -shto-, -co-, -zho-, -ho-, -jo-; which were analysed quite thoroughly in the first three chapters of this study, as it results from the summarized conclusions, and the approaches with other verb-formation formants (suffixes and prefixes), as were studied in the fourth chapter, the following conclusions can be drawn that are given very briefly below:

Firstly, the verbs with *o*, without derivation, with or without a clear productive theme, (not excluding special cases), are likely to express certain different processes, but also technical and technological ones, mainly from the first scale of complexity, such as, for example, the so-called processes: various mechanical processes. A similar scale (without excluding the paronymic character) regarding the intensity of the action of complexity, is also expressed with verbs with the suffixes: -ho-, -jo-, -to (partially), -izo-, -at/iz/o-, -ifik/o-, -ir/o- (borrowed), and less with other suffixes, where the clear word-formation stem motivates a certain process.

Secondly, verbs that end in -zo- are usually likely to express technical and technological processes of a high scale complexity, such as e.g.: chemical and technological and similar processes that the word-formation stem, so to speak, undergoes substance transformation, and accord-

ing to its neutral meaning, which has not so much to do with the inner human world.

Thirdly, with other verbs that end in other prefixes such as: -ro-, -llo-, -so-, then with -no-, -mo-, -rro-, -lo-, -co-, -sho-, is usually expressed a stylistic intensity or a meaning nuance with certain gradation, giving in this way various stylistic and semantic shades, be that a lighter form, such as the verbs with respective suffixes: -lo-, -ro-, and -so-, or a form of stronger intensity (anyhow compressed) as there are the verbs that end in respective suffixes: -rro-, -zho-, -llo-, then those with a diminutive character, such as the verbs that end in suffixes: -ko-, -sho-, -co-, -ço.

Fourth, the verbalization of onomatopoeia with suffixes -llo-, -ko-, or some other suffix, and verbalization of the interjections that end in -ho- become apparent.

Fifth, the verbs that end in suffixes: -sho-, -zho-, -rro-, expressed processes that show concepts of increase and surplus, in any case of an expressively more emphasized gradation.

Sixth, from the approach of the formants that end in -O- (with or without width) with other verb suffixation formants, such as with genuine suffixes: -s/-is, -it and -os, mentioned in the normative grammar of our language and of those that appeared from our analysis: -i/j, -e/j, with the theme upon the vowels and diphthongs, and -as, and -at with the theme upon the consonants, it was given a better view of their internal friction and internal exchange relations, in the background of the mosaic of the verbal structure of our language, and especially their specification in covering certain stylistic and semantic subdivisions in comparison with the verbs that end in -O- (with or without derivation).

Seven, in relation to verb-formation with prefixes and suffixes, there appear some conclusions that need to update, reviewed and reassessed in our normative sources, such as the issue of multiplicity of the prefixes for verb-formation suffixes, the issue of specification of the respective formants (prefixes and suffixes), according to stylistic and semantic subdivisions that they cover and the possibility of parallelism of some of the respective prefixes and suffixes in different stylistic and semantic aspects and in a formal way of metathesis that appears through respective

formants such as: -për- (pë-), with -ro-, and -o-, -le-, with -lo-, -rre-, with -rro-, -s-, with -so-, k(e), with -ko-, or some other. Therefore the vitality of the verbs with *o* appears obviously within the frame of this analysis.

In reference to what was said above, we can conclude that if the previously noticed tendencies are noticed (in this preliminary-work) for favouring the respective verb-forming prefixes according to certain semantic subdivisions (of the paronymic character), then this fact for our language would indeed be very important and of great value, because the structure of verb-formation with suffixation, with formants and other ways of formation, it would have appeared more consolidated in the future. Certainly, some formants would appear less loaded with polysemic meanings of the homonymic character and at the same time with some foreign affixes, such as: -ifik, -iz, -atiz, -ir, the need for using them would perhaps cease to exist and some others would perhaps extinguish.

Therefore, familiarity with the real condition of the Albanian verb system and the possibilities that it gives, would help the other researchers, creators and naturally all Albanian speakers of all the profiles, in general, to approach this problem in a more profound way, so that to achieve better results in acquiring and exploiting of all our language treasures, which have been given to us as inheritance by our language.

I have the impression that if verbal forms are known, exploited and favoured, according to certain semantic subdivisions, as mentioned in this preliminary work, on the basis of specification with specialization tendency of a certain word-formation affix, especially when we take into account the fact that almost all the verbs formed with *o* with derivation, are based on Albanian word stems (be they autochthonous or adopted in the course of time), as they were analysed in this study, our language would have been ranked and qualified as a language with high development of the autochthonous verbal word-formation system.

(Translated by Besa Veselaj)

Literatura

1. Aleksandër Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980. II, Tiranë 1990; Studime gjuhësore, Prishtinë 1968.
2. Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme letrare shqipe* (1967), Prishtinë 1970.
3. A. Kostallari, *Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njësuar*, Gjurmime albanologjike, s. shk. gj., 20/90, Prishtinë 1991 dhe punime të tjera të tij të botuara në Studime mbi leksikon ... I, II dhe III.
4. Bratoljub Klaić, *Veliki rječnik stranih riječi*, izraza i kratica, Zagreb 1968.
5. Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, Prishtinë 1998.
6. Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore I - IX*, Prishtinë 1976-1989; Studime etimologjike (IV) DH - J, Tiranë 1996.
7. Dr. Idriz Ajeti, *Sudime gjuhësore në fushë të shqipes I-IV*, Prishtinë 1982-1989; Historia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1965.
8. *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Tiranë, 1976; Gramatika e gjuhës shqipe (morfologjia), Tiranë 1995.
9. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954.
10. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.
11. *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë 1984.
12. *Fjalor serbokroatisht-shqip*, Prishtinë 1974.
13. *Fjalor shqip-serbokroatisht*, Prishtinë 1981.
14. *Fjalor i fjalëve të huaja (grup autorësh)*, Prishtinë 1988.
15. F. Sulejmani, *Praktikumi i gjuhës shqipe*, Prishinë 1981.

16. *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976.
17. Jani Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë 1989;
Leksikologjia shqipe, Prishtinë 1970; 1977.
18. Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2001.
19. M. Ndreca, *Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja*, Prishtinë 1986.
20. *Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe*, Prishtinë 1983.
21. Selman Riza, *Studime albanistike I*, Prishtinë 1979; *Vepra 1*, Prishtinë 1996; *Vepra 2*, Prishtinë 1997.
22. *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe (grup autorësh)*, Tiranë I, II (1972), III (1989);
23. Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988; *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë 1989; *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1981; *Gramatika e gjuhës shqipe (fonetika e morfologjia për shkollat e mesme)*, Prishtinë 1968.
24. Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë 1999.
25. Zijadin Munishi, *Zgjedhimi i foljeve*, Prishtinë 1998.

Dr. Nuhi Veselaj

FOLJET MË -O- NË GJUHËN SHQIPE

Disenji dhe realizimi kompjuterik



U shtyp në shtypshkronjën
shkrota
Prishtinë